FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 142

Tiranë – E premte, 3 korrik 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 26.6.2026	Për miratimin e rregulloreve "Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar" dhe "Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2	13041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 30.6.2026	Për miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. IV ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) *GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për programin "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimi dhe formimi profesional" (ProSEED)	13187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.6.2026	Për miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. II ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) *GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në sektorin ekonomik" (SANECA II)	13198
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 30.6.2026	Për miratimin e rregullave, të kritereve dhe të masës për trajtime të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit	13210

VENDIM
Nr. 486, datë 26.6.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE "PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E POSAÇME TË AUTORIZIMIT PËR SHKARKIMET E GAZEVE ME EFEKT SERRË NGA OPERATORI I INSTALIMIT DHE SUBJEKTI I RREGULLUAR" DHE "PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E SHKARKIMEVE TË GAZEVE ME EFEKT SERRË NGA OPERATORI I INSTALIMIT, NGA OPERATORI I AVIONIT DHE NGA SUBJEKTI I RREGULLUAR DHE TË EFEKTEVE NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 6, shkronjat "a", "b", "d" e "dh", 11, pika 6, shkronjat "a", "b" dhe "d", dhe 11, pika 7, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregulloreve "Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar", sipas parashikimeve të shtojcave I dhe II që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi në shtojcën III dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Dispozitat e rregulloreve që miratohen me këtë vendim, të cilat parashikojnë kryerjen e kërkesave dhe të procedurave nëpërmjet sistemit elektronik, zbatohen pas realizimit të përmirësimeve të nevojshme të këtij sistemi për përmbushjen e tyre.

4. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

SHTOJCA I
RREGULLORJA PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E POSAÇME TË AUTORIZIMIT PËR SHKARKIMET E GAZEVE ME EFEKT SERRË (GES) NGA OPERATORI I INSTALIMIT

1. Operatori i instalimit aplikon për t'u pajisur me autorizimin për shkarkimet e GES-it në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit *"e-Albania",* duke përdorur identifikimin elektronik të subjektit, në përputhje me parashikimet e nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe dorëzon në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për pajisjen me autorizim për shkarkimet e GES-it;

b) Draftin e fundit të planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) Një dokument që përmban përmbledhjen e informacioneve të mëposhtme:

i) përshkrimin e instalimit dhe veprimtarive të tij, duke përfshirë teknologjinë e përdorur;

ii) listën e lëndëve të para dhe të lëndëve ndihmëse, përdorimi i të cilave ka gjasa të çojë në shkarkimin e gazeve të renditura në pjesën A, të

[1] Ky akt është i përafruar:

- pjesërisht me direktivën 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 tetor 2003 për krijimin e një sistemi për tregtimin e kuotave të shkarkimit të gazeve me efekt serrë brenda BE-së dhe për ndryshimin e direktivës së Këshillit 96/61/KE, numri CELEX 32003L0087, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian , seria *L*, numri 275, datë 25.10.2003, faqe 32–46;

- plotësisht me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2066, datë 19 dhjetor 2018, mbi monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në zbatim të direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që ndryshon rregulloren e Komisionit (BE) nr. 601/2012, numri CELEX 32018R2066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numri 334, datë 31.12.2018, faqe 1–93.

shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

iii) listën e burimeve të shkarkimeve të gazeve të renditura në pjesën A, të shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, nga instalimi;

iv) listën e masave të planifikuara për monitorimin e raportimin e shkarkimeve, në përputhje me planin e monitorimit;

ç) një përmbledhje joteknike të detajeve të përmendura në shkronjën "c" më sipër;

d) Faturën (mandat arkëtimi), që provon se ka paguar tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ministrisë, në shumën 5.000 (pesë mijë) lekë, e cila është e pakthyeshme.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin verifikon pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e aplikimit për pajisjen me autorizimin për shkarkimet e GES-it, nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatori i instalimit është i plotë, i saktë dhe në përputhje me parashikimet e pikës 1 më sipër. Kur konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori i instalimit ka mangësi, pasaktësi ose mospërputhje me parashikimet e pikës 1 më sipër, i kërkon operatorit të instalimit plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e njoftimit nëpërmjet portalit "*e-Albania*".

3. Ministria përgjegjëse për mjedisin miraton autorizimin për shkarkimet GES nga operatori i instalimit brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e aplikimit për pajisjen me autorizimin për shkarkimet e GES-it nga operatori i instalimit ose brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga plotësimi i dokumenteve, sipas pikës 2 më sipër. Ministri miraton, me urdhër, modelin e autorizimit për shkarkimet e GES-it, që përmban të paktën elementet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Çdo autorizim mban një kod unik, i cili gjenerohet nga sistemi elektronik.

4. Ministri përgjegjës për mjedisin refuzon autorizimin për shkarkimet GES kur operatori i instalimit nuk plotëson dokumentacionin dhe pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 më sipër. Operatori i instalimit mund të ankohet kundër refuzimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Autorizimi për shkarkimet GES është i vlefshëm derisa verifikohet një nga kushtet e shfuqizimit të parashikuara në pikën 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

6. AKM-ja ose struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, sipas rastit, njofton menjëherë ministrin përgjegjës për mjedisin kur verifikohet një nga rastet që përbën kusht për shfuqizimin e autorizimit për shkarkimet GES, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

7. Ministri përgjegjës për mjedisin brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e njoftimit sipas pikës 6 më sipër, pas marrjes së dijenisë edhe kryesisht, verifikon rastin dhe merr vendim për shfuqizimin e autorizimit për shkarkimet GES dhe pezullimin e aktivitetit, që shkarkon GES-in kur përmbushen kushtet e pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

8. Operatori i instalimit mund të ankohet kundër vendimit të shfuqizimit të autorizimit për shkarkimet GES dhe pezullimit të aktivitetit që shkarkon GES-i, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Ministria përgjegjëse për mjedisin mban të dhënat për kërkesat për autorizime për shkarkimet e GES-it. Formati i të dhënave dhe mënyra e administrimit të tyre miratohen me urdhër të ministrit.

10. Tarifat që paguhen në zbatim të këtij vendimi derdhen në buxhetin e shtetit.

11. Autorizimi për shkarkimet e GES-it ndryshohet në rastet e mëposhtme:

a) Kur ndodh një ndryshim në identitetin e operatorit të instalimit, autorizimi për shkarkimet GES duhet përditësuar, duke përfshirë emrin dhe adresën e ndryshuar të operatorit të instalimit;

b) Kur operatori i instalimit kryen ndryshime në natyrën apo funksionimin e instalimit ose çdo zgjerim apo reduktim të rëndësishëm të kapacitetit

të vet, që konsiderohet ndryshim i rëndësishëm i kapacitetit në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

c) Kur plani i monitorimit i operatorit të instalimit ka pësuar ndryshime të konsideruara si ndryshime të rëndësishme, në përputhje me shkronjat "a", "b", "c", "dh", "e", të pikës 3, të nenit 15, të shtojcës III, të këtij vendimi, që janë miratuar nga AKM-ja;

12. Operatori i instalimit, aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin për miratimin e ndryshimeve të autorizimit të shkarkimeve GES menjëherë pas verifikimit të njërit prej shkaqeve të përcaktuara në pikën 11 më sipër dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm;

a) Kur është rasti i parashikuar në shkronjën "a", të pikës 11 më sipër, përshkrimin e ndryshimeve të identitetit të operatorit të instalimit, duke përfshirë emrin dhe adresën e ndryshuar të operatorit të instalimit dhe certifikatën e regjistrimit në QKB;

b) Kur është rasti i parashikuar në shkronjën "b", të pikës 11, më sipër, dokumentin që përmban përmbledhjen e informacioneve të mëposhtme:

i) përshkrimin e instalimit dhe të veprimtarive të tij, duke përfshirë teknologjinë e përdorur;

ii) listën e lëndëve të para dhe të lëndëve ndihmëse, përdorimi i të cilave ka gjasa të çojë në shkarkimin e gazeve të renditura në pjesën A, të shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

iii) listën e burimeve të shkarkimeve të gazeve të renditura në pjesën A, të shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, nga instalimi;

iv) listën e masave të planifikuara për monitorimin e raportimin e shkarkimeve, në përputhje me planin e monitorimit;

v) një përmbledhje joteknike të detajeve të përmendura në nënndarjet "i"-"iv", të kësaj shkronje;

c) Kur është rasti i parashikuar në shkronjën "c", të pikës 11, më sipër, planin e monitorimit të ndryshuar e të miratuar nga AKM-ja.

13. Ministria përgjegjëse për mjedisin verifikon pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e aplikimit për ndryshimin e autorizimit për shkarkimet e GES-it, nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatori i instalimit është i plotë, i saktë dhe në përputhje me parashikimet e pikës 12 më sipër. Kur konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori i instalimit ka mangësi, pasaktësi ose mospërputhje me parashikimet e pikës 12 më sipër, i kërkon operatorit të instalimit plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e njoftimit.

14. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton ndryshimet e autorizimit për shkarkimet GES nga operatori i instalimit brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e aplikimit për ndryshimet e autorizimit për shkarkimet e GES-it nga operatori i instalimit ose brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga plotësimi i dokumenteve, sipas pikës 13 më sipër.

15. Ministria përgjegjëse për mjedisin refuzon miratimin e ndryshimeve të autorizimit për shkarkimet GES, kur operatori i instalimit nuk plotëson dokumentacionin dhe pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 13 më sipër. Operatori i instalimit mund të ankohet kundër refuzimit ,në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Në fund të çdo viti kalendarik, AKM-ja njofton ministrinë përgjegjëse të mjedisit për ekzistencën e ndryshimeve të planit të monitorimit të operatorëve të instalimit. Brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga njoftimi i AKM-së, ministria përgjegjëse për mjedisin njofton operatorët e instalimit përkatës për detyrimin e përditësimit të autorizimit të shkarkimeve GES kur plotësohen kushtet e përmendura në pikën 11 më sipër.

17. Procedura e ndryshimit ose e përditësimit të autorizimit për shkarkimet e GES-it, të përcaktuar më sipër, nuk pengojnë vazhdimin e aktiviteteve të operatorit të instalimit.

SHTOJCA II
KUSHTET DHE PROCEDURA E POSAÇME E AUTORIZIMIT PËR SHKARKIMET E GAZEVE ME EFEKT SERRË (GES) NGA SUBJEKTET E RREGULLUARA

1. Subjekti i rregulluar aplikon për t'u pajisur me autorizimin për shkarkimet e GES-it, në përputhje me parashikimet e nenit 9, të ligjit nr. 155/2020,

"Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe dorëzon në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për pajisjen me autorizim për shkarkimet e GES-it;

b) Variantin e fundit të planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) Një dokument që përmban përmbledhjen e informacioneve të mëposhtme:

i) përshkrimin e subjektit të rregulluar;

ii) listën e llojeve të lëndëve djegëse të hedhura për konsum, që përdoren për djegie në sektorët e përcaktuar në pjesën D, të shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe mjetet nëpërmjet të cilave hedh për konsum lëndët djegëse;

iii) përdorimin ose përdorimet fundore të lëndëve djegëse të hedhura për konsum për aktivitetet e përcaktuara në pjesën D, të shtojcës II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

iv) listën e masave të planifikuara për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, në përputhje me planin e monitorimit;

ç) një përmbledhje joteknike të detajeve të përmendura në shkronjën "c", më sipër;

d) Faturën (mandat arkëtimi), që provon se ka paguar tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ministrisë, në shumën 5000 (pesëmijë) lekë, e cila është e pakthyeshme.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin, për çdo aplikim të bërë sipas pikës 1, duhet të sigurojë vetë, nëpërmjet sistemit, këto dokumente:

a) Kopjen e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për subjektin e rregulluar;

b) Kopjen e lejeve të mjedisit dhe/ose licencave të zotëruara nga subjekti i rregulluar për ushtrimin e aktiviteteve të tij, kur është rasti;

3. Ministria përgjegjëse për mjedisin verifikon pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e aplikimit për pajisjen me autorizimin për shkarkimet e GES-it nëse dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rregulluar është i plotë, i saktë dhe në përputhje me parashikimet e pikës 1 më sipër. Kur konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rregulluar ka mangësi, pasaktësi ose mospërputhje me parashikimet e pikës 1 më sipër, i kërkon subjektit të rregulluar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e njoftimit.

4. Ministria përgjegjëse për mjedisin miraton autorizimin për shkarkimet GES nga subjekti i rregulluar brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e aplikimit për pajisjen me autorizimin për shkarkimet e GES-it nga subjekti i rregulluar ose brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga plotësimi i dokumenteve sipas pikës 3 më sipër. Ministri miraton, me urdhër, modelin e autorizimit për shkarkimet e GES-it, që përmban të paktën elementet e përcaktuara pikën 5, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Çdo autorizim mban një kod të veçantë shifror.

5. Ministri përgjegjës për mjedisin refuzon autorizimin për shkarkimet GES kur subjekti i rregulluar nuk plotëson dokumentacionin dhe pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 më sipër. Subjekti i rregulluar mund të ankohet kundër refuzimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Autorizimi për shkarkimet GES është i vlefshëm derisa verifikohet një nga kushtet e shfuqizimit të parashikuara në pikën 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

7. AKM-ja ose struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, sipas rastit, njofton menjëherë ministrin përgjegjës për mjedisin kur verifikohet një nga rastet, që përbën kusht për shfuqizimin e autorizimit për shkarkimet GES, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

8. Ministri përgjegjës për mjedisin, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e njoftimit sipas pikës 7 më sipër, ose pas marrjes së dijenisë edhe kryesisht, verifikon rastin dhe merr vendim për shfuqizimin e autorizimit për shkarkimet GES dhe pezullimin e aktivitetit që shkarkon GES-e, kur përmbushen kushtet e pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

9. Subjekti i rregulluar mund të ankohet kundër vendimit të shfuqizimit të autorizimit për

shkarkimet GES dhe pezullimit të aktivitetit që shkarkon GES-e, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ministria përgjegjëse për mjedisin mban të dhënat për kërkesat për autorizime për shkarkimet e GES-it. Formati i të dhënave dhe mënyra e administrimit të tyre miratohen me urdhër të ministrit.

11. Tarifat që paguhen në zbatim të këtij vendimi derdhen në buxhetin e shtetit.

12. Autorizimi për shkarkimet e GES-it ndryshohet në rastet e mëposhtme:

a) Kur ndodh një ndryshim në identitetin e subjektit të rregulluar, autorizimi për shkarkimet GES duhet përditësuar, duke përfshirë emrin dhe adresën e ndryshuar subjektit të rregulluar;

b) Kur plani i monitorimit i subjektit të rregulluar ka pësuar ndryshime të konsideruara si ndryshime të rëndësishme, në përputhje me shkronjat "a", "b", "ç", "d", të pikës 3, të nenit 94, të shtojcës III, të këtij vendimi, që janë miratuar nga AKM-ja;

13. Subjekti i rregulluar aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin për miratimin e ndryshimeve të autorizimit të shkarkimeve GES menjëherë pas verifikimit të njërit prej shkaqeve të përcaktuara në pikën 12 më sipër dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm;

a) Kur është rasti i parashikuar në shkronjën "a", të pikës 12, më sipër, përshkrimin e ndryshimeve të identitetit të subjektit të rregulluar, duke përfshirë emrin dhe adresën e ndryshuar të tij dhe certifikatën e regjistrimit në QKB;

b) Kur është rasti i parashikuar në shkronjën "b", të pikës 12, më sipër, dokumentin që përmban përmbledhjen e informacioneve të mëposhtme:

i) përshkrimin e subjektit të rregulluar;

ii) listën e llojeve të lëndëve djegëse të hedhura për konsum, që përdoren për djegie në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe mjetet nëpërmjet të cilave hedh për konsum lëndët djegëse;

iii) përdorimin ose përdorimet fundore të lëndëve djegëse të hedhura për konsum për aktivitetet e përcaktuara në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

iv) listën e masave të planifikuara për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, në përputhje me planin e monitorimit;

v) një përmbledhje joteknike të detajeve të përmendura në nënndarjet "i"-"iv", më sipër;

vi) planin e monitorimit të ndryshuar dhe të miratuar nga AKM-ja.

14. Ministria përgjegjëse për mjedisin verifikon pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e aplikimit për ndryshimin e autorizimit për shkarkimet e GES-it, nëse dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rregulluar është i plotë, i saktë dhe në përputhje me parashikimet e pikës 13 më sipër. Kur konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rregulluar ka mangësi, pasaktësi ose mospërputhje me parashikimet e pikës 13 më sipër, i kërkon subjektit të rregulluar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e njoftimit.

15. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton ndryshimet e autorizimit për shkarkimet GES nga subjekti i rregulluar brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga marrja e aplikimit për ndryshimet e autorizimit për shkarkimet e GES-it nga subjekti i rregulluar ose brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga plotësimi i dokumenteve sipas pikës 14 më sipër.

16. Ministri përgjegjëse për mjedisin refuzon miratimin e ndryshimeve të autorizimit për shkarkimet GES, kur subjekti i rregulluar nuk plotëson dokumentacionin dhe pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 14 më sipër. Subjekti i rregulluar mund të ankohet kundër refuzimit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

17. Në fund të çdo viti kalendarik, AKM-ja njofton ministrinë përgjegjëse të mjedisit për ekzistencën e ndryshimeve të planit të monitorimit të subjekteve të rregulluara. Brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga njoftimi i AKM-së, ministria përgjegjëse për mjedisin njofton subjektet e rregulluara përkatëse për detyrimin e përditësimit të autorizimit të shkarkimeve GES kur plotësohen kushtet e përmendura në pikën 12 më sipër.

18. Procedura e ndryshimit ose e përditësimit të autorizimit për shkarkimet e GES-it, të përcaktuar më sipër, nuk pengojnë vazhdimin e aktiviteteve të subjektit të rregulluar.

SHTOJCA III
RREGULLORE "PËR MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E SHKARKIMEVE TË GAZEVE ME EFEKT SERRË NGA OPERATORI I INSTALIMIT, NGA OPERATORI I AVIONIT DHE NGA SUBJEKTI I RREGULLUAR DHE TË EFEKTEVE NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2"

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1
FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi:

a) i rregullave, procedurave, afateve, dhe tarifave për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit;

b) i rregullave, procedurave, afateve, dhe tarifave për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga subjekti i rregulluar;

c) i rregullave, procedurave, afateve dhe tarifave për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i avionit;

ç)i rregullave, procedurave, afateve dhe tarifave për monitorimin dhe raportimin e efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 nga operatori i avionit;

d) i autoritetit kompetent për shqyrtimin e rregullave, procedurave, afateve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe operatori i avionit dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 nga operatori i avionit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, subjekti i rregulluar dhe operatori i avionit gjatë kryerjes së aktiviteteve të përcaktuara në shtojcën II, pjesët A, B dhe D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

2. Kjo rregullore zbatohet gjithashtu për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 nga operatori i avionit për aktivitetet e kryera prej tij të përcaktuara në pjesën B, të shtojcës II, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

1. Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1) "Të dhënat e aktivitetit" janë të dhënat për sasinë e lëndëve djegëse ose materialeve të konsumuara ose të prodhuara nga një proces, që janë të nevojshme për metodologjinë e monitorimit që bazohet në llogaritje, që sipas rastit shprehen në njësitë matëse tera-xhaul, masë në ton ose (për gazet) në vëllim në metër kub normal;

2) "Rrymë shkarkimi" ka kuptimin e rrymës nga ku buron shkarkimi i gazeve me efekt serrë që përfshin një nga elementet e mëposhtme:

a) Një lloj lënde djegëse specifike, lëndë e parë ose produkt që shkakton shkarkime të gazeve me efekt serrë nga një ose më shumë burime shkarkimi si rezultat i konsumit ose prodhimit të tij;

b) Në rastet kur në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje përdoret metodologjia e bilancit të masës, rrymë shkarkimi konsiderohet një nga elementet e mëposhtme:

i) një lloj lënde djegëse specifike, lëndë e parë ose produkt që përmban karbon;

ii) CO_2 që transferohet në përputhje me nenin 50 të kësaj rregulloreje;

3) "Burim shkarkimi" do të thotë një pjesë e një instalimi që mund të identifikohet si pjesë e veçantë ose një proces që kryhet brenda një instalimi, nga i cili shkarkohen gaze me efekt serrë, ose për aktivitetet e aviacionit, çdo avion;

4) "Pasiguri" është parametri që ka të bëjë me rezultatin e përcaktimit të një sasie specifike, që karakterizohet nga luhatja e vlerave të cilat mund t'i përkasin asaj sasie specifike në mënyrë të arsyeshme, përfshirë efektet e faktorëve sistematikë si dhe atyre të rastësishëm, që shprehet në përqindje dhe përshkruan një interval besueshmërie rreth vlerës mesatare që përmban 95% të vlerave të parashikuara

duke marrë parasysh çdo asimetri në shpërndarjen e vlerave;

5) "Faktor llogaritjeje" do të thotë vlera kalorifike neto, faktori i shkarkimit, faktori paraprak i shkarkimit, faktori i oksidimit, faktori i konvertimit, përmbajtja e karbonit, fraksioni fosil, fraksioni i biomasës, fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni i lëndëve djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike (RFNBO) ose fraksioni i lëndëve djegëse me karbon të ricikluar (RCF), fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero, fraksioni sintetik me shkarkim të ulët karboni, fraksioni sintetik me shkarkim të ulët karboni me normë zero, fraksioni me normë zero ose faktori i konvertimit të njësive;

6) "Shkallë metodologjike" do të thotë një metodë specifike që përdoret për të përcaktuar të dhënat e aktivitetit, faktorin e llogaritjes, shkarkimin vjetor dhe mesataren vjetore të shkarkimeve në çdo orë, sasinë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum dhe faktorin sektorial;

7) "Rrezik i brendshëm" është prirja e një parametri në raportin vjetor të shkarkimeve për të pasur pasaktësi që mund të jenë domethënëse kur konsiderohen individualisht apo së bashku me pasaktësi të tjera, përpara se të merret në konsideratë ndikimi i ndonjë aktiviteti kontrolli të lidhur me të.

8) "Kontrolli i rrezikut" është prirja e një parametri në raportin vjetor të shkarkimeve për të pasur pasaktësi që mund të jenë domethënëse kur konsiderohen individualisht apo së bashku me pasaktësi të tjera, të cilat nuk parandalohen ose zbulohen dhe nuk korrigjohen brenda një kohe të shkurtër nga sistemi i kontrollit;

9) "Shkarkimet nga djegia" janë shkarkimet e gazeve me efekt serrë që ndodhin gjatë reaksionit ekzotermik të një lënde djegëse me oksigjenin;

10) "Periudhë raportimi" është një vit kalendarik gjatë të cilit duhet të monitorohen dhe raportohen shkarkimet;

11) "Faktori i shkarkimit" është përqindja mesatare e shkarkimit të një gazi me efekt serrë në lidhje me të dhënat e aktivitetit të një rryme shkarkimi ose të një rryme lënde djegëse, duke presupozuar oksidimin e plotë në rastin e djegies dhe shndërrimin e plotë për të gjitha reaksionet e tjera kimike;

12) "Faktori i oksidimit" do të thotë raporti midis sasisë së karbonit që oksidohet në CO_2 si pasojë e djegies dhe sasisë totale të karbonit të përmbajtur në lëndën djegëse, i shprehur si fraksion, duke e konsideruar monoksidin e karbonit (CO) të shkarkuar në atmosferë si ekuivalent molar të sasisë së CO_2.

13) "Faktori i konvertimit" është raporti ndërmjet karbonit të shkarkuar si CO_2 dhe karbonit total që përmban rryma e shkarkimit përpara se të ndodhë procesi i shkarkimit, i shprehur si një fraksion, duke e konsideruar CO-në e shkarkuar në atmosferë si ekuivalentin molar të sasisë së CO_2. Në rastin e shkarkimeve të CO_2 që konsiderohen të lidhura kimikisht në mënyrë të përhershme në një produkt, faktori i konvertimit nënkupton raportin ndërmjet CO_2 të lidhur si karbon në një produkt gjatë një procesi, dhe përmbajtjen totale të CO_2 si karbon në produktin që del nga i njëjti proces.

14) "Saktësia" është grada e përputhshmërisë midis rezultatit të një matjeje dhe vlerës së vërtetë të sasisë së caktuar ose një vlere reference të përcaktuar në mënyrë empirike duke përdorur materiale kalibrimi të pranuara dhe të gjurmueshme ndërkombëtarisht dhe metoda standarde, duke marrë parasysh si faktorët e rastësishëm ashtu edhe faktorët sistematik;

15) "Kalibrimi" është tërësia e operacioneve që përcakton, në kushte të specifikuara, marrëdhëniet ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument matës ose sistem matës, ose vlerave të përfaqësuara nga një masë materiale ose material reference, dhe vlerave përkatëse të një madhësie të realizuar përmes një standardi reference.

16) "Fluturim" në kuptimin e kësaj rregulloreje do të thotë një segment fluturimi, që është një fluturim i vetëm ose një nga një seri fluturimesh, që fillon në një vend parkimi të avionit dhe përfundon në një vend tjetër parkimi të avionit.

17) "Pasagjerë" në kuptimin e kësaj rregulloreje personat që ndodhen në bordin e avionit gjatë një fluturimi, përjashtuar anëtarët e ekuipazhit që janë në kryerje të detyrës.

18) "Konservativ" është përcaktimi i një sërë supozimesh me qëllim që të garantohet që shkarkimet vjetore nuk vlerësohen më të ulëta sesa realiteti.

19) "Biomasa", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është masa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe tepricave me origjinë biologjike nga bujqësia, përfshirë substancat bimore dhe shtazore, nga pylltaria dhe industritë e ndërlidhura, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe pjesët e

biodegradueshme të mbetjeve, përfshirë mbetjet industriale dhe bashkiake me origjinë biologjike.

20) "Lëndët djegëse nga biomasa", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë karburantet e gazta dhe të ngurta të prodhuara nga biomasa.

21) "Biogaz", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse të gazta të prodhuara nga biomasa;

22) "Mbetje", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë mbetjet sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me përjashtim të substancave që janë ndryshuar apo ndotur me qëllimin për t'u klasifikuar si mbetje.

23) "Mbetje bashkiake" janë mbetjet sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

24) "Tepricë", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është një substancë që nuk është produkti (et) përfundimtar që synohet të prodhohet drejtpërdrejt nga një proces prodhimi; që nuk përbën qëllimin kryesor të procesit të prodhimit dhe për prodhimin e të cilit procesi nuk është modifikuar posaçërisht;

25) "Teprica nga bujqësia, akuakultura, peshkimi dhe pyjet", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë tepricat që krijohen drejtpërdrejt nga bujqësia, akuakultura, peshkimi dhe pyjet dhe që nuk përfshijnë teprica nga industritë e ndërlidhura ose nga përpunimi;

26) "Biolëngje", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse të lëngshme të prodhuara nga biomasa, që përdoren për qëllime energjetike të ndryshme nga transporti, duke përfshirë përdorimin për prodhimin e energjisë elektrike, përdorimin për ngrohje dhe ftohje;

27) "Biokarburante", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse të lëngshme të prodhuara nga biomasa që përdoren për transport;

28) "Lëndë djegëse e kualifikuar për aviacionin", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë llojet e lëndëve djegëse të kualifikuara për mbështetje, siç parashikohen në legjislacionin në fuqi;

29) "Lëndë djegëse alternative për aviacionin", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse të papërziera për aviacion, që përmbajnë karbon që nuk e kanë origjinën nga lëndët djegëse të papërziera fosile të radhitura në tabelën 1 të shtojcës III të kësaj rregulloreje.

30) "Vlerësim me normë zero" do të thotë mekanizmi me anë të të cilit faktori i shkarkimit i një lënde djegëse ose materiali zvogëlohet me qëllim që të konstatohet:

a) në rastin e biomasës, përputhshmëria e saj me kriteret e qëndrueshmërisë ose me kriteret e reduktimit të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, siç përcaktohet në pikat 5, 6 e 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje;

b) në rastin e RFNBO-së ose RCF-së, përputhshmërinë e tyre me kriteret e reduktimit të gazeve me efekt serrë për karburantet e rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe për karburantet e ricikluara me bazë karboni, në përputhje me legjislacionin në fuqi, siç përcaktohet në pikat 4 e 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

c) në rastin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, përputhshmërinë e tyre me kriteret e reduktimit të gazeve me efekt serrë, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për rregullat e përbashkëta të tregjeve të brendshme të gazit të rinovueshëm, gazit natyror dhe hidrogjenit; si dhe kryerjen paraprakisht të pagesës së detyrimeve për karbonin e kapur të nevojshëm për prodhimin e lëndëve sintetike me karbon të ulët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi ose, sipas rastit, kryerjen paraprakisht të detyrimeve të raportimit të shkarkimeve kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi, siç përcaktohet në pikat 6 e 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, përveçse nëse ky karbon i kapur është karbon i "vlerësuar me normë zero", siç përcaktohet në nenin 3, të pikës 57, të kësaj rregulloreje.

31) "Lëndë djegëse me normë zero", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë biokarburantet, biolëngjet, lëndët djegëse nga biomasa, lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët, RFNBO ose RCF ose fraksionet e lëndëve djegëse të përziera ose materialet që përputhen me kriteret e përcaktuara në nenin 38, pikat 5, 6 e 7, ose në nenin 40, pikat 4 e 5, ose në nenin 40, pikat 6 e 7, të kësaj rregulloreje, sipas rastit;

32) "Lëndë djegëse me karbon të ricikluar (RCF)", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse në formë të lëngshme ose të gaztë, që prodhohen nga rrymat e mbetjeve të lëngshme ose të ngurta me origjinë jo të rinovueshme, që nuk janë të përshtatshme për operacionin e rikuperimit të materialeve, sipas përkufizimit të ligjit nr. 57/2025, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ose nga

gazi që krijohet si pasojë e përpunimit të mbetjeve dhe nga gazet e shkarkimit me origjinë jo të rinovueshme, të cilat krijohen si pasojë e pashmangshme dhe e paqëllimshme e procesit të prodhimit në instalimet industriale.

33) "Lëndë djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike (RFNBO)", në kuptimin e kësaj rregulloreje, janë lëndët djegëse në formë të lëngshme ose të gaztë përmbajtja energjetike e të cilave rrjedh nga burime të rinovueshme, të ndryshme nga biomasa;

34) "Lëndë djegëse e papërzier" është një lëndë djegëse në formën e saj të pastër që përmban vetëm një nga fraksionet e mëposhtme:

a) fraksionin fosil;

b) fraksionin e biomasës me normë shkarkimi të ndryshme nga zero;

c) fraksionin e biomasës me normë shkarkimi zero;

ç) fraksionin RFNBO ose RCF me normë shkarkimi të ndryshme nga zero;

d) fraksionin RFNBO ose RCF me normë shkarkimi zero;

dh) fraksionin sintetik me shkarkim të ulët karboni me normë shkarkimi të ndryshme nga zero;

e) fraksionin sintetik me shkarkim të ulët karboni me normë shkarkimi zero;

ë) fraksionin e lëndëve djegëse që përmbajnë karbon që nuk e ka prejardhjen nga lëndët djegëse fosile të listuara në tabelën 1 të shtojcës III të kësaj rregulloreje dhe as nga biomasa, nga RFNBO-ja, RCF-ja ose lëndët djegëse sintetike me shkarkim të ulët karboni;

35) "Lëndë djegëse sintetike me përmbajtje të ulët karboni" janë lëndët djegëse në formë të gaztë ose të lëngshme, përmbajtja energjetike e të cilave rrjedh nga hidrogjeni me përmbajtje të ulët karboni, në përputhje me përkufizimin e legjislacionit në fuqi, që përmbushin pragun e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë prej 70% krahasuar me vlerën krahasuese të lëndëve djegëse fosile për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jo-biologjike, siç përcaktohet në metodologjinë e miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon kriteret për reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe lëndët djegëse me karbon të ricikluar, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që përcakton rregullat e certifikimit të gazit të rinovueshëm dhe lëndëve djegëse me karbon të ulët;

36) "Kontrolli metrologjik ligjor", në kuptimin e kësaj rregulloreje,, është kontrolli i funksioneve matëse, që lidhen me fushën e përdorimit të një instrumenti matës, për arsye të interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së mjedisit, mbledhjes së taksave dhe detyrimeve, mbrojtjes së konsumatorëve dhe barazisë së tregut.

37) "Gabimi maksimal i lejueshëm" nënkupton gabimin e lejuar të matjes, siç specifikohet në legjislacionin shqiptar për metrologjinë dhe në rregullat kombëtare për kontrollin metrologjik ligjor, sipas rastit;

38) "Aktivitetet e menaxhimit të të dhënave" janë veprimet që lidhen me mbledhjen, përpunimin dhe trajtimin e të dhënave që nevojiten për të hartuar raportin e shkarkimeve, duke u bazuar te të dhënat e mbledhura nga burimi kryesor;

39) "Ton CO_2(e) " janë ton metrikë CO_2 ose CO_2 (e);

40) "CO_2 (e) " është çdo gaz me efekt serrë i ndryshëm nga CO_2, i përfshirë në shtojcën I të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar që ka një potencial për të shkaktuar ngrohjen globale të barasvlershëm me CO_2;

41) "Sistem matës", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është një seri e plotë instrumentesh matëse dhe pajisjesh të tjera, të tilla si pajisjet e marrjes së mostrave dhe të përpunimit të të dhënave, që përdoren për të përcaktuar variabla të tillë, si: të dhënat e aktivitetit, përmbajtja e karbonit, vlera kalorifike ose faktori i shkarkimit të gazeve me efekt serrë.

42) "Vlera kalorifike neto" (NCV) është sasia specifike e energjisë së çliruar si nxehtësi kur një lëndë djegëse ose material i nënshtrohet djegies së plotë me oksigjen në kushte standarde, duke zbritur sasinë e nxehtësisë së nevojshme për avullimin e ujërave të formuar;

43) "Shkarkimet nga procesi" janë shkarkimet e gazeve me efekt serrë të ndryshme nga shkarkimet për shkak të djegies, që ndodhin si rezultat i reaksioneve të qëllimshme dhe jo të qëllimshme ndërmjet substancave ose nga transformimi i tyre, duke përfshirë reduktimin kimik ose elektrolitik të xeheve metalike, dekompozimin termik të substancave dhe formimin e substancave për përdorim si produkt ose si lëndë e parë;

44) "Lëndë djegëse komerciale standarde" janë lëndët djegëse komerciale të standardizuara

ndërkombëtarisht që paraqesin një interval besueshmërie prej 95% që nuk përbën më shumë se 1% të vlerës së tyre kalorifike specifike, duke përfshirë gaz-oilin, naftën e lehtë për djegie, benzinën, vajin e llambave, vajgurin, etanin, propanin, butanin, benzolin xhet (xhet A1 ose xhet A), benzinëxh (xhet B) dhe benzinën e aviacionit (AvGas);

45) "Ngarkesë" është një sasi një sasi lënde djegëse ose materiali, që merret në mënyrë përfaqësuese për mostër dhe ka të identifikuara karakteristika kryesore dhe që transferohet si një ngarkesë e vetme ose në mënyrë të vazhdueshme gjatë një periudhe të caktuar kohore".

1.46) "Djegie" është çdo proces oksidimi i lëndëve djegëse, pavarësisht nga mënyra se si përdoret nxehtësia, energjia elektrike ose mekanike e prodhuar nga ky proces, si dhe çdo aktivitet tjetër i lidhur drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e gazeve të mbetjeve.

47) "Lëndë djegëse e përzier" është lënda djegëse që përmban të paktën dy nga elementet e mëposhtme:

a) Karbon me origjinë nga biomasa;

b) Karbon me origjinë nga një RFNBO ose RCF:

i. karbon me origjinë nga lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët;

ii. karbon tjetër fosil; ose që përmban edhe karbon me normë zero, edhe karbon tjetër.

48) "Lëndë djegëse e përzier për aviacionin" është një lëndë djegëse, që përmban të paktën dy lëndë djegëse të ndryshme të papërziera;

49) "Material i përzier" nënkupton një material që përmban si biomasë, ashtu edhe karbon fosil;

50) "Faktor paraprak shkarkimi" është faktori total i shkarkimit i presupozuar i një lënde djegëse ose materiali, që llogaritet në bazë të përmbajtjes totale të karbonit të tij, llogari që bëhet përpara se të shumëzohet me fraksionin fosil që duhet për të nxjerrë faktorin e shkarkimeve;

51) "Fraksioni fosil" është shtojca e karbonit fosil në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse ose të një materiali, i shprehur në formën e një fraksioni;

52) "Fraksioni i biomasës" është shtojca e karbonit që ka origjinën nga biomasa në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse ose të një materiali, i shprehur si fraksion, pavarësisht nëse biomasa përputhet me kriteret e pikave 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje;

53) "Fraksioni i biomasës me normë zero" është shtojca e karbonit, që ka origjinën nga biomasa, që përputhet me kriteret e pikave 5, 6 e 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje, në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse ose të një materiali, i shprehur si fraksion;

54) "Fraksioni i RFNBO-së ose RCF-së" është shtojca e karbonit, që ka origjinën nga një RFNBO ose një RCF në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse, i shprehur si fraksion, pavarësisht nëse RFNBO-ja ose RCF-ja përputhen me kriteret e pikave 4 e 5, të nenit 40 të kësaj rregulloreje;

55) "Fraksioni i RFNBO-së ose RCF-së me normë zero" është shtojca e karbonit, që ka origjinën nga një RFNBO ose një RCF, që përputhet me kriteret e pikave 4 e 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse, i shprehur si fraksion.

56) "Fraksioni i karbonit me normë zero" është:

a) në rastin e një lënde djegëse, shuma e fraksionit të biomasës së tij me normë zero, e fraksionit sintetik të tij me nivel të ulët karboni me normë zero dhe e fraksionit të tij RFNBO ose RCF me normë zero, duke shmangur numërimin e karbonit disa herë;

b) në rastin e një materiali, fraksioni i biomasës së tij me normë zero.

57) "Karbon me normë zero" është karboni që i përket fraksionit të karbonit me normë zero që përmbahet në një lëndë djegëse ose në një material;

58) "Fraksioni sintetik me karbon të ulët" është shtojca e karbonit me origjinë nga lënda djegëse sintetike me karbon të ulët, në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse, e shprehur si fraksion, pavarësisht nëse lënda djegëse sintetike me karbon të ulët përputhet me kriteret e përcaktuara në pikat 6 e 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

59) "Fraksioni sintetik me karbon të ulët me normë zero" është shtojca e karbonit me origjinë nga lënda djegëse sintetike me karbon të ulët, që përputhet me kriteret e përcaktuara në pikat 6 e 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, në përmbajtjen totale të karbonit të një lënde djegëse.

60) "Metoda e bilancit energjetik" është metoda për të vlerësuar sasinë e energjisë të përdorur si lëndë djegëse në një kaldajë *(boiler),* që llogaritet si shuma e nxehtësisë së përdorur dhe e të gjitha humbjeve të energjisë, që ndodhin si pasojë e rrezatimit, transmetimit dhe nëpërmjet gazeve të çliruara nga djegia;

61) "Matje e vazhdueshme e shkarkimeve" janë një seri operacionesh që synojnë të përcaktojnë vlerën e një sasie, me anë të matjeve periodike, duke kryer matje në oxhak ose nëpërmjet procedurave të nxjerrjes për matje, me një instrument matës të vendosur afër oxhakut, duke përjashtuar metodologjitë e matjes bazuar në mbledhjen e mostrave individuale nga oxhaku;

62) "CO_2 i brendshëm" është CO_2 që është pjesë e një rryme shkarkimi;

63) "Karbon fosil" është karboni inorganik dhe organik që nuk është karbon me normë zero;

64) "Pikë matëse" do të thotë burimi i shkarkimit, për matjen e shkarkimeve të të cilit përdoren sistemet e matjes së vazhdueshme të shkarkimeve (CEMS) ose kryqëzimi i një rrjeti tubacionesh, në të cilin rrjedha e CO_2-së përcaktohet duke përdorur sisteme të matjes së vazhdueshme;

65) "Dokumentacioni i masës dhe balancës" është dokumentacioni i specifikuar në aktet zbatuese ndërkombëtare ose kombëtare të standardeve dhe praktikave të rekomanduara (SARPs) të përcaktuara në shtojcën 6 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944, ratifikuar nga Shqipëria me anë të dekretit nr. 7438, datë 1.12.1990, ose rregullat e barasvlershme ndërkombëtare të zbatueshme;

66) "Distanca", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është distanca ortodromike ndërmjet aerodromit të nisjes dhe atij të mbërritjes, së cilës i shtohet një faktor fiks prej 95 km;

67) "Aerodromi i nisjes" është aerodromi, në të cilin niset një fluturim, që përbën një aktivitet aviacioni të radhitur në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

68) "Aerodromi i mbërritjes" është aerodromi, në të cilin përfundon një fluturim, që përbën një aktivitet aviacioni të radhitur në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

69) "Shkarkimet e pakapshme" do të thotë shkarkime të parregullta ose shkarkime të paqëllimshme nga burime, që nuk janë të lokalizuara ose që janë shumë të ndryshme ose me përmasa tepër të vogla për t'u monitoruar individualisht;

70) "Aerodrom" ka kuptimin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 5, të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë;

71) "Çift aerodromi" është një çift aerodromesh, që përbëhet nga aerodromi i nisjes dhe aerodromi i mbërritjes;

72) "Kushte standarde" janë temperatura prej 273,15 K dhe kushtet e presionit prej 101 325 Pa, që përcakton metra kub normal (Nm^3);

73) "Vend depozitim", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është një zonë me vëllim të përcaktuar brenda një formacioni gjeologjik, e cila përdoret për depozitimin gjeologjik të CO_2, së bashku me objektet sipërfaqësore dhe ato të injektimit që lidhen me të.

74) "Kapja e CO2", në kuptim të kësaj rregulloreje, është aktiviteti i kapjes së CO_2 nga rrymat e gazit, që, përndryshe, do të shkarkoheshin, me qëllim transportimin e depozitimin gjeologjik në një venddepozitim gjeologjik të lejuar sipas legjislacionit në fuqi;

75) "Transport i CO_2" është transporti i CO_2, me qëllim ruajtjen gjeologjike të tij në një vend depozitimi të lejuar, sipas legjislacionit në fuqi;

76) "Depozitim gjeologjik i CO_2" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të pikës 10, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar .

77) "Shkarkime të përqendruara" do të thotë shkarkimet e çliruara qëllimisht nga një instalim, duke siguruar një pikë të caktuar shkarkimi;

78) "Rikuperim i asistuar i hidrokarbureve", në kuptimin e kësaj rregulloreje, është rikuperimi i mëtejshëm i hidrokarbureve, përtej atyre që janë nxjerrë nëpërmjet injektimit të ujit ose metodave të tjera.

79) "Të dhëna zëvendësuese" janë vlerat vjetore, që mbështeten nga të dhëna empirike ose nxirren nga burime të pranuara që operatori i instalimit ose subjekti i rregulluar, sipas përkufizimeve të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, i përdor për të zëvendësuar të dhënat e aktivitetit, sasinë e karburantit të hedhur për konsum ose faktorët e llogaritjes, me qëllim që të bëjnë një raportim të plotë, në rastet kur nuk është e mundur të gjenerohen të gjitha të dhënat e nevojshme të aktivitetit, sasitë e karburantit të hedhura për konsum ose faktorët e llogaritjes sipas metodologjisë përkatëse të monitorimit.

80) "Kolonë uji' është masa e vazhdueshme e ujit, që shtrihet vertikalisht ndërmjet sipërfaqes dhe sedimentet e poshtme të një trupi ujor.

81) "Rrjedhje" është shkarkimi i CO_2 nga kompleksi i depozitimit;

82) "Kompleks depozitimi" është vendi i depozitimit dhe zona gjeologjike përreth që mund të ndikojnë në integritetin dhe në sigurinë e përgjithshme të depozitimit, konkretisht, formacionet dytësore mbajtëse.

83) "Infrastruktura e transportit të CO_2" është rrjeti i tubacioneve, përfshirë stacionet përforcuese të lidhura me të, për transportin e CO_2 drejt vendit të depozitimit, si dhe çdo mjet tjetër transporti, si transporti me anije, transporti rrugor apo hekurudhor, përfshirë pajisjet për lëngëzimin dhe strukturat për depozitimin e përkohshëm, nëse është e nevojshme, për transportin e CO_2 drejt strukturave portuale dhe vendit të depozitimit.

84) "CO_2 tranzit" nënkupton çdo sasi CO_2 të transferuar në një infrastrukturë për transportin e CO_2, dhe që nuk është transferuar në një instalim tjetër ose në një infrastrukturë për transportin e CO_2 brenda së njëjtës periudhë raportuese gjatë së cilës është marrë;

85) "Rrymë lënde djegëse" është lënda djegëse sipas përkufizimit të pikës 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që hidhet për konsum me mjete të posaçme të tilla, si: tubacione, kamionë, hekurudha, anije ose stacione karburantesh dhe që shkakton shkarkimin e gazeve me efekt serrë si pasojë e konsumit nga kategoritë e konsumatorëve në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

86) "Rrymë lënde djegëse kombëtare" është tërësia e rrymave të lëndës djegëse të të gjitha subjekteve të rregulluara në territorin e një shteti e llogaritur sipas llojit të lëndës djegëse;

87) "Faktor sektorial" është faktori midis numrit zero dhe numrit një që përdoret për të përcaktuar përqindjen e një rryme të lëndës djegëse të përdorur për djegie në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

88) "Sasia e lëndës djegëse e hedhur për konsum" përfshin të dhënat për sasinë e lëndës djegëse sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që hidhet për konsum dhe shprehet si energji në njësitë matëse teraxhaul, masë në ton ose vëllim në metër kub normal ose, kur është e përshtatshme, ekuivalenti në litra, përpara aplikimit të një faktori sektorial;

89) "Faktori i konvertimit ndërmjet njësive" është faktori që konverton njësinë, në të cilën janë shprehur sasitë e karburantit të hedhura për konsum, në sasi të shprehura si energji në teraxhaul (TJ), si masë në tonë, ose si vëllim në metra kub normalë apo ekuivalenti i tyre në litra, sipas rastit. Ky faktor përfshin të gjithë faktorët përkatës, si p.sh. dendësinë, vlerën neto kalorifike ose (në rastin e gazeve) konvertimin nga vlera bruto kalorifike në vlerën neto kalorifike, sipas rastit.

90) "Konsumator fundor", në kuptim të këtij vendimi, është çdo person fizik ose juridik, që është konsumator i lëndës djegëse, konsumi vjetor i të cilit nuk e tejkalon sasinë prej 1 ton CO_2, që nuk përfshihet në përkufizimin e termit subjekt i rregulluar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

91) "Hedhje për konsum", për qëllim të kësaj rregulloreje, nënkupton momentin kur lind detyrimi i akcizës për një lëndë djegëse të përcaktuar në pikën 40, të neni 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e neneve 4 e 5, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

92) CO_2(e) për fluturim" efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 që ngrohin atmosferën, të shprehura si sasia ekuivalente e shkarkimeve të CO_2 të fluturimit specifik;

93) "Ndikim i jashtëm rrezatues" është ndryshimi i bilancit të energjisë së planetit i imponuar nga faktorë të jashtëm, i matur në vat për metër katror (W/m^2);

94) "Efikasiteti" është ndryshimi i temperaturës mesatare globale për njësi të ndikimit të jashtëm rrezatues të ushtruar nga agjenti klimatik, në raport me përgjigjen e gjeneruar nga një forcim standard i CO_2, duke filluar nga e njëjta gjendje klimatike fillestare;

95) "Modeli i llogaritjes së CO_2(e)" është modeli që përdoret për të llogaritur ndikimin total në klimë të të efekteve të aviacionit të palidhura me shkarkimet e CO_2, në përputhje me shtojcën IIIa, seksioni 4, të kësaj rregulloreje;

96) "Qasje e bazuar në kushtet meteorologjike" është metoda C, që përdor kryesisht të dhënat meteorologjike të përmirësuara, si dhe informacionet e fluturimit, trajektoren, vetitë e

mjetit ajror dhe vetitë e lëndës djegëse, siç përcaktohet në shtojcën IIIa, seksioni 4, i kësaj rregulloreje;

97) "Qasje e thjeshtuar bazuar te vendndodhja" është metoda D, që përdor kryesisht të dhëna të lidhura me vendndodhjen e mjetit ajror gjatë fluturimit, si informacionet e fluturimit, trajektorja, por edhe të dhënat meteorologjike bazë dhe vetitë karakteristike të mjetit ajror, siç parashikohet në shtojcën IIIa, seksioni 4, të kësaj rregulloreje;

98) "Sistemi i gjurmimit të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 (*NEATS*)" është një mjet i teknologjisë së informacionit (IT), që Komisioni Evropian u ofron operatorëve të avionit, verifikuesve të akredituar dhe autoriteteve kompetente, me qëllim lehtësimin dhe, për aq sa është e mundur, automatizimin e monitorimit, raportimit e verifikimit të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2.

99) "Karakteristikat e mjetit ajror" është kategoria e informacionit që, për çdo fluturim, përfshin të paktën llojin e mjetit ajror, identifikuesin(ët) e motorit(ve) dhe masën e mjetit ajror.

100) "Aeroplan", në kuptim të kësaj rregulloreje, është një mjet fluturues më i rëndë se ajri, i pajisur me motor shtytës, që gjeneron ngritjen gjatë fluturimit kryesisht përmes reaksioneve aerodinamike në sipërfaqe, që mbeten të palëvizshme në kushte të caktuara fluturimi.

2.101) "Pasaktësi domethënëse" është një pasaktësi që, sipas gjykimit të verifikuesit, veçmas ose bashkë me pasaktësi të tjera, tejkalon pragun e rëndësisë, ose mund të ndikojë në mënyrën se si autoriteti kompetent trajton raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit, apo raportin e subjektit të rregulluar;

SEKSIONI 2
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4
Detyrimet e operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit

Detyrimet e operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit në lidhje me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të efekteve të aviacionit të palidhura me shkarkimin e CO_2 kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me parimet e përcaktuara në nenet 5 deri në 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 5
Monitorim dhe raportim i plotë

1. Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve kryhen në mënyrë të plotë dhe mbulojnë të gjitha shkarkimet që shkaktohen nga proceset dhe nga djegiet, nga të gjitha burimet e shkarkimeve dhe rrymat e shkarkimeve, që rrjedhin nga aktivitetet e përcaktuara në shtojcën II, pjesët A dhe B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve përfshijnë dhe veprimtaritë shoqëruese, që kryhen brenda kufijve të instalimit dhe të gjitha gazet me efekt serrë, që janë specifike të këtyre aktiviteteve, duke shmangur llogaritjen e dyfishtë.

2. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për të shmangur çfarëdolloj mangësie te të dhënat gjatë periudhës së raportimit.

Neni 6
Koherenca, krahasueshmëria dhe transparenca

1. Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve duhet të jenë koherent dhe të krahasueshme në kohë. Për këtë qëllim, operatori i instalimit dhe operatori i avionit përdorin të njëjtat metodologji monitorimi dhe të njëjtat grupe të dhënash, përveçse kur AKM-ja miraton ndryshimet dhe përjashtimet.

2. Operatorët e instalimit dhe operatorët e avionit mbledhin, regjistrojnë, përpilojnë, analizojnë dhe dokumentojnë të dhënat e monitorimit, përfshirë supozimet, referencat, të dhënat e aktivitetit dhe faktorët e llogaritjes, me metoda transparente që i mundëson verifikuesit dhe AKM-së të riprodhojnë procesin e llogaritjes së shkarkimeve që është përdorur nga operatorët e instalimit dhe operatorët e avionit.

3. Operatorët e avionit mbledhin, regjistrojnë, përpilojnë, analizojnë dhe dokumentojnë të dhënat e monitorimit, përfshirë supozimet, referencat, të dhënat e aktivitetit dhe faktorët e llogaritjes, me metoda transparente, që i mundëson verifikuesit dhe AKM-së të riprodhojnë procesin e përcaktimit të

efekteve nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2, për çdo fluturim, që është përdorur nga operatorët e avionit.

Neni 7
Saktësia

1. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit sigurohen që vlerat e shkarkimeve nuk janë të pasakta në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme.

2. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit kanë detyrimin të identifikojnë e të kufizojnë sa më shumë që të jetë e mundur çdo burim pasaktësie.

3. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit kanë detyrimin të ushtrojnë kujdesin e duhur për të siguruar që llogaritja dhe matja e shkarkimeve të ketë saktësinë më të lartë të arritshme.

Neni 8
Integriteti i të dhënave dhe metodologjia

1. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit kanë detyrimin të garantojnë integritetin e të dhënave të raportuara në lidhje me shkarkimet GES dhe me efektet nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2, duke përdorur metodologjitë e duhura të monitorimit të përcaktuara në këtë rregullore për të llogaritur shkarkimet GES dhe efektet nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2.

2. Të dhënat e raportuara mbi shkarkimet GES dhe efektet nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2 dhe dokumentacioni i tyre shoqërues nuk duhet të përmbajnë pasaktësi domethënëse, duhet të shmangin manipulimin në zgjedhjen dhe paraqitjen e informacionit dhe duhet të japin një pasqyrë të besueshme dhe të ekuilibruar të shkarkimeve GES nga operatori i instalimit dhe të efekteve nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2 nga operatori i avionit.

3. Për zgjedhjen e metodologjisë së monitorimit duhet të bëhet një balancë ndërmjet përmirësimeve metodologjike, që ofrojnë një nivel më të lartë saktësie, dhe rritjes së kostove që sjellin këto përmirësime. Si rrjedhojë, monitorimi dhe raportimi duhet të synojnë saktësinë më të lartë të arritshme, përveç rasteve kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme ose sjell kosto të paarsyeshme.

Neni 9
Përmirësimi i vazhdueshëm

Operatori i instalimit dhe operatori i avionit, kur kryejnë monitorimin dhe raportimin e radhës janë të detyruar të marrin parasysh rekomandimet që verifikuesi i akredituar ka përfshirë në raportin e verifikimit të hartuar prej tij, në përputhje me nenet 8, pika 3, dhe 11, pika 4, tëligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

Neni 10
Koordinimi

Autoritetet kompetente për monitorimin dhe raportimin e GES-eve koordinohen sa herë që kjo është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre funksionale të përcaktuara nga ligji nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar dhe nga kjo rregullore.

KREU II
PLANI I MONITORIMIT

SEKSIONI 1
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 11
Detyrim i përgjithshëm

1. Çdo operator instalimi ose operator avioni ka detyrimin e monitorimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të efekteve nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2.

2. Monitorimi kryhet në bazë të planit të monitorimit, që hartohet nga operatori i instalimit ose operatori i avionit dhe miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), sipas parashikimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje, duke marrë parasysh natyrën dhe funksionimin e instalimit ose aktivitetin e aviacionit ndaj të cilit zbatohet.

3. Plani i monitorimit shoqërohet nga procedura të shkruara, që parashikohen, dokumentohen, zbatohen dhe ruhen në mënyrë të përshtatshme nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për veprimtaritë që mbulohen nga plani i monitorimit.

4. Plani i monitorimit i përmendur në pikën 2 të këtij neni përmban udhëzimet për operatorin e instalimit ose për operatorin e avionit, të cilat pasqyrohen në mënyrë logjike dhe të thjeshtë, duke

shmangur ripërsëritjen e veprimeve dhe duke marrë parasysh sistemet ekzistuese të vendosura në instalim ose të përdorura nga operatori i instalimit ose nga operatori i avionit.

Neni 12

Përmbajtja dhe dorëzimi i planit të monitorimit për miratim nga AKM

1. Çdo operator i instalimit ose operator i avionit harton planin e monitorimit në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje dhe dorëzon planin e monitorimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për miratim.

2. Plani i monitorimit përbëhet nga një përshkrim i detajuar, i plotë dhe transparent i metodologjisë së monitorimit të një instalimi ose të operatorit të avionit dhe duhet të përmbajë të paktën elementet e përcaktuara në shtojcën I të kësaj rregulloreje.

3. Operatori i instalimit ose operatori i avionit paraqet së bashku me planin e monitorimit, dokumentet mbështetëse të mëposhtme:

a) në rastin e instalimeve, për çdo rrymë shkarkimi të madhe apo të vogël, provën që tregon se respektohen pragjet e pasigurisë, që janë përcaktuar për të dhënat e aktivitetit dhe për faktorët e llogaritjes dhe, sipas rastit, për shkallën metodologjike të zbatuar, siç përcaktohet në shtojcat II dhe IV të kësaj rregulloreje dhe, për çdo burim shkarkimi, provën që dëshmon përputhshmërinë me pragjet e pasigurisë për shkallën metodologjike të zbatuar, siç përcaktohet në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje, kur kjo është e zbatueshme;

b) rezultatet e vlerësimit të rrezikut, që dëshmojnë se aktivitetet e kontrollit të propozuara dhe procedurat përkatëse janë në përpjesëtim me rreziqet e brendshme dhe me rreziqet e identifikuara nga kontrolli.

4. Në rastet kur shtojca I e kësaj rregulloreje i referohet procedurës, procedura do të përcaktohet, dokumentohet, zbatohet dhe ruhet nga operatori i instalimit ose nga operatori i avionit veçmas nga plani i monitorimit.

5. Operatori i instalimit ose operatori i avionit, brenda planit të monitorimit jep një përmbledhje të procedurave, duke ofruar informacionin e mëposhtëm:

a) titullin e procedurës;

b) një referencë të gjurmueshme dhe të verifikueshme, që mundëson identifikimin e procedurës;

c) identifikimin e profilit profesional përgjegjës ose të departamentit përgjegjës për zbatimin e procedurës dhe për të dhënat e krijuara ose të menaxhuara nga procedura;

ç) një përshkrim të shkurtër të procedurës, që i jep mundësinë operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, AKM-së dhe verifikuesit të akredituar të kuptojnë parametrat thelbësorë dhe operacionet e kryera;

d) vendin ku mbahen regjistrat e të dhënave dhe informacionet përkatëse;

dh) emrin e sistemit kompjuterik të përdorur, kur ka një të tillë;

e) një listë të standardeve evropiane (EN) ose të standardeve të tjera, që zbatohen, sipas rastit.

6. Operatori i instalimit ose operatori i avionit vendosin në dispozicion të AKM-së çdo dokument të shkruar në lidhje me procedurat, menjëherë kur kërkohen prej saj, si dhe i vendosin ato në dispozicion të verifikuesit të akredituar për qëllim të kryerjes së verifikimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

7. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit aplikojnë në sistemin *online* të AKM-së nëpërmjet portalit *"e-Albania",* sipas udhëzimeve të AKM-së, për miratimin e planit të monitorimit, dhe dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin e monitorimit të hartuar në përputhje me pikat 2 dhe 5, të këtij neni, dhe me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe sipas formatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 13, të kësaj rregulloreje;

b) Dokumentet mbështetëse në përputhje me pikën 3 të këtij neni;

c) Kërkesën për përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit, në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje, kur është rasti;

c) Mandatpagesën për tarifën prej 5000 (pesë mijë) lekë për procesin e shqyrtimit e të miratimit të planit të monitorimit;

8. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit për miratimin e planit të monitorimit, verifikon:

a) nëse dokumentacioni është depozituar i saktë dhe i plotë sipas pikës 7 të këtij neni;

b) nëse plani i monitorimit është hartuar në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

c) nëse janë përmbushur kushtet e nenit 13 për përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit;

9. Kur AKM-ja konstaton se dokumentacioni i depozituar nga operatori i instalimit dhe operatori i avionit nuk është i plotë, ka pasaktësi apo se plani i monitorimit nuk është hartuar në përputhje me këtë rregullore, njofton secilin prej tyre, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacion dhe të pasaktësive të konstatuara, ose korrigjimin e planit të monitorimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e njoftimit. Brenda të njëjtit afat, AKM-ja mund të kërkojë nga operatori i instalimit ose operatori i avionit edhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë, sipas pikës 6, të këtij neni, ose paraqitjen e vlerësimit të rrezikut për planin e thjeshtuar të monitorimit, sipas pikës 2, të nenit 13, të kësaj rregulloreje. Mosplotësimi i kërkesave të AKM-së brenda afatit të përcaktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Operatori i instalimit dhe operatori i avionit njoftohen për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.

10. AKM-ja, kur vlerëson se janë përmbushur kushtet e pikës 8 të këtij neni, nis procesin e shqyrtimit të kërkesës së miratimit të planit të monitorimit dhe vendos brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune nga paraqitja e aplikimit, sipas pikës 7 të këtij neni, ose nga plotësimi dhe korrigjimi i dokumentacionit, sipas pikës 8 të këtij neni:

a) miratimin e planit të monitorimit kur konstaton se është në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

b) refuzimin e miratimin kur konstaton se plani i monitorimit nuk është në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban, administron e përditëson të dhënat për planet e monitorimit të miratuara. Mënyra e administrimit dhe formati i të dhënave miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 13

Plani i monitorimit standard dhe i thjeshtuar

1. Operatori i instalimit dhe operatori avionit përdorin plane monitorimi të standardizuara, që bazohen në formatet dhe udhëzimet zyrtare të botuara nga Komisioni Evropian. Planet e monitorimit përmbajnë një përshkrim të fluksit të të dhënave dhe të procedurave të kontrollit të parashikuara në nenet 65 e 66 të kësaj rregulloreje.

2. Operatori i instalimit dhe operatori avionit përdorin plane monitorimi të thjeshtuara kur autorizohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me parashikimet e nenit 12 të kësaj rregulloreje. Para se të autorizojë përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit, AKM-ja kryen një vlerësim të thjeshtuar të rrezikut, me qëllim përcaktimin nëse aktivitetet e kontrollit të propozuara dhe procedurat përkatëse janë proporcionale me rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit të identifikuara, si dhe argumenton përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit. Nëse është e nevojshme, AKM-ja mund t'i kërkojë operatorit të instalimit ose operatorit të avionit të kryejë vetë vlerësimin e rrezikut dhe t'ia paraqesë AKM-së për shqyrtim.

3. Plani i thjeshtuar i monitorimit bazohet në formatet dhe udhëzimet zyrtare të botuara nga Komisioni Evropian.

4. AKM-ja vendos në dispozicion të operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit formatet e planit të monitorimit të standardizuar dhe të planit të monitorimit të thjeshtuar të botuara nga Komisioni Evropian, të përshtatura dhe të përkthyera në gjuhën shqipe.

Neni 14

Ndryshimi i planit të monitorimit

1. Çdo operator instalimi ose operator avioni verifikon rregullisht nëse plani i monitorimit pasqyron natyrën e funksionimin e instalimit ose të aktivitetit të aviacionit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe verifikon nëse metodologjia e monitorimit mund të përmirësohet.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit kanë detyrimin të ndryshojë planin e monitorimit, të paktën, në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur shkaktohen shkarkime të reja për shkak se kryhen aktivitete të reja ose për shkak të përdorimit të lëndëve djegëse ose materialeve të reja, që nuk janë përfshirë ende në planin e monitorimit;

b) kur për shkak të kryerjes së veprimtarive të reja shkaktohen efekte nga aviacioni të palidhura me shkarkimin e CO_2;

c) kur për shkak të përdorimit të instrumenteve të reja matëse, metodologjive të reja për marrjen e mostrave ose metodologjive të reja të analizimit, ose për arsye të tjera, ka ndryshime te të dhënat e disponueshme që sjellin në një saktësi më të lartë në përcaktimin e shkarkimeve;

ç) është konstatuar që të dhënat e nxjerra nga metodologjia e monitorimit e zbatuar më parë janë të pasakta;

d) kur ndryshimi i planit të monitorimit përmirëson saktësinë e të dhënave të raportuara, përveç rasteve kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme;

dh) kur AKM-ja i kërkon operatorit të instalimit ose operatorit të avionit ndryshimin e planit të monitorimit, pasi konstaton se plani i monitorimit i dorëzuar prej tyre nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

e) kur raporti i verifikimit të verifikuesit të akredituar sugjeron se është i nevojshme të përmirësohet plani i monitorimit;

ë) për instalimet, në rastet e parashikuara nga pika 1, e nenit 10, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

Neni 15
Miratimi i ndryshimeve të planit të monitorimit

1. Ndryshimet e planit të monitorimit të propozuara nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, që nuk konsiderohen si ndryshime të rëndësishme, sipas pikave 3 e 4, të këtij neni, i njoftohen AKM-së menjëherë nga operatori i instalimit ose operatori i avionit nëpërmjet aplikimit në AKM. Ndryshimet e parëndësishme të planit të monitorimit nuk kanë nevojë për një akt të ti miratimi nga AKM-ja dhe ato konsiderohen të pranuara nga AKM-ja me paraqitjen e njoftimit nga operatori i instalimit ose operatori i avionit. Kur AKM-ja konsideron se ndryshimi i propozuar dhe i njoftuar i planit të monitorimit përbën një ndryshim të rëndësishëm, informon menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e njoftimit, operatorin e instalimit ose operatorin e avionit, duke përcaktuar se ndryshimet e njoftuara do t'i nënshtrohen procedurës së miratimit të ndryshimeve, sipas pikës 5 më poshtë.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, që konsiderohet si ndryshim i rëndësishëm i planit të monitorimit, sipas pikave 3 dhe 4 ,të këtij neni, i njoftohet menjëherë AKM-së, me qëllim marrjen e miratimit prej saj. Për këtë qëllim, operatori i instalimit ose operatori i avionit aplikon menjëherë pranë AKM-së për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit të propozuara. Kur AKM-ja konsideron se ndryshimi i propozuar dhe i njoftuar i planit të monitorimit nuk përbën një ndryshim të rëndësishëm dhe nuk është i nevojshëm miratimi i ndryshimit, informon menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e njoftimit, operatorin e instalimit ose operatorin e avionit.

3. Konsiderohen ndryshime të rëndësishme të planit të monitorimit të një instalimi:

a) ndryshimet e kategorisë së instalimit, kur këto ndryshime kërkojnë një ndryshim të metodologjisë së monitorimit ose çojnë në një ndryshim të pragut të rëndësisë, siç përcaktohet në rregulloren për verifikimin nga verifikuesi i akredituar të shkarkimeve të GES-it, miratuar në përputhje me parashikimet e neneve 8 e 12, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

b) ndryshimet që kanë të bëjnë me kategorizimin e instalimit si "instalim me shkarkime të ulëta", pavarësisht parashikimeve të pikës 8, të nenit 48, të kësaj rregulloreje;

c) ndryshimet në burimet e shkarkimeve;

ç) ndryshimi i metodologjive të përdorura, nga metodologjia e bazuar në llogaritje në metodologjinë e bazuar në matje, ose anasjelltas, ose nga një metodologji alternative rezervë në një metodologji të bazuar në shkallë metodologjike për përcaktimin e shkarkimeve ose anasjelltas;

d) ndryshimi i shkallës metodologjike të zbatuar;

dh) përfshirja e rrymave të reja të shkarkimeve;

e) ndryshimi i kategorizimit të rrymave të shkarkimit, nga rryma shkarkimi madhore, në rryma shkarkimi të vogla ose rryma shkarkimi minimale, në rastet kur ky ndryshim kërkon edhe ndryshim të metodologjisë së monitorimit;

ë) ndryshimi i vlerës standarde të një faktori llogaritjeje, kur kjo vlerë duhet të përcaktohet në planin e monitorimit;

f) përdorimi i metodave të reja ose ndryshimi i metodave ekzistuese në lidhje me marrjen e mostrave, analizave ose kalibrimit, kur kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në saktësinë e të dhënave të shkarkimeve;

g) zbatimi ose përshtatja e një metodologjie të matjes sasiore për shkarkimet që shkaktohen nga rrjedhjet në vendet e depozitimit.

4. Konsiderohen ndryshime të rëndësishme të planit të monitorimit të operatorit të avionit:

a) në lidhje me shkarkimet GES:

i) ndryshimi i vlerave të faktorit të shkarkimit të përcaktuara në planin e monitorimit;

ii) ndryshimi midis metodave të llogaritjes, të përcaktuara në shtojcën III të kësaj rregulloreje, ose një ndryshim nga përdorimi i një metodologjie të bazuar në llogaritje në përdorimin e një metodologjie të bazuar në vlerësim, sipas pikës 2, të nenit 55, të kësaj rregulloreje, ose anasjelltas;

iii) përdorimi i rrymave të reja të shkarkimit;

iv) ndryshimi i statusit të operatorit të avionit si një shkarkues i vogël, në kuptim të pikës 1, të nenit 55, të kësaj rregulloreje;

b) në lidhje me efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2:

i) ndryshim në metodën e zgjedhur për llogaritjen e $CO_2(e)$, siç përcaktohet në pikat 4 e 5, të nenit 63, të kësaj rregulloreje, veçanërisht për sa u përket mjeteve të IT-së të përdorura për të zbatuar modelet e llogaritjes së $CO_2(e)$;

ii) ndryshimi i statusit të operatorit të avionit i konsideruar si një shkarkues i vogël, në kuptim të pikës 1, të nenit 55, të kësaj rregulloreje.

5. Pas aplikimit nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit sipas përkufizimit të pikave 3 e 4, të këtij neni, AKM-ja:

a) miraton ndryshimet e planit të monitorimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit;

b) Kur konstaton se ndryshimet e planit të monitorimit nuk janë të qarta, ose të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm, sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje ose të hartuara në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, AKM-ja njofton menjëherë operatorin e instalimit ose operatorin e avionit në mënyrë elektronike dhe kërkon plotësimin e korrigjimin e dokumentacionit brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i kërkesave të AKM-së brenda afatit të përcaktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast quhet se nuk është regjistruar;

c) miraton ndryshimet e planit të monitorimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së plotësimeve dhe korrigjimeve nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, të kërkuara sipas shkronjës "b" më sipër.

Neni 16

Zbatimi dhe regjistrimi i ndryshimeve të planit të monitorimit

1. Përpara marrjes së miratimit ose informacionit nga AKM-ja sipas pikës 2, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit mund të kryejë monitorimin e raportimin e shkarkimeve, duke përdorur planin e ndryshuar të monitorimit, me kusht që të ketë bindjen e arsyeshme që ndryshimet e propozuara nuk janë ndryshime domethënëse të planit të monitorimit, ose kur kryerja e monitorimit, duke përdorur planin origjinal të monitorimit, do të sillte mbledhjen e të dhënave të paplota të shkarkimeve.

2. Në rast se ka dyshime, operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet të përdorë paralelisht planin e monitorimit origjinal dhe planin e monitorimit të ndryshuar, duke kryer monitorimin dhe raportimin, në përputhje me të dy planet, dhe duhet të dokumentojë rezultatet e monitorimit, që rrjedhin nga të dy planet e monitorimit.

3. Pas marrjes së miratimit ose të informacionit nga AKM-ja, sipas pikës 2, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit përdor vetëm të dhënat e mbledhura, duke përdorur planin e ndryshuar të monitorimit. Që nga data kur AKM-ja miraton ndryshimet e planit të monitorimit ose informon sipas pikës 2, të nenit 15 , të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit kryen monitorimin e raportimin, duke përdorur vetëm planin e monitorimit të ndryshuar.

4. Operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet të regjistrojë të gjitha ndryshimet e planit të monitorimit. Çdo regjistrim duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të qartë të ndryshimit të planit të monitorimit;

b) arsyen e ndryshimit të planit të monitorimit;

c) datën kur AKM-ja është njoftuar për ndryshimin e planit të monitorimit, në përputhje me pikën 1, të nenit 15, të kësaj rregulloreje;

ç) datën, në të cilën AKM-ja konfirmoi marrjen e njoftimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 15, të

kësaj rregulloreje, kur është e mundur, dhe datën e miratimit ose të informacionit nga AKM-ja të parashikuar në pikën 1, të nenit 15, të kësaj rregulloreje;

d) datën kur nis zbatimi i planit të ndryshuar të monitorimit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

SEKSIONI 2
FIZIBILITETI TEKNIK DHE KOSTOT E PAARSYESHME

Neni 17
Fizibiliteti teknik

1. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit pretendon se përdorimi i një metodologjie specifike monitorimi nuk është teknikisht e zbatueshme, AKM-ja shqyrton këtë pretendim dhe vlerëson zbatueshmërinë teknike, duke marrë në konsideratë argumentet e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit argumenton mungesën e fizibilitetit teknik, duke paraqitur pranë AKM-së fakte që dëshmojnë mungesën e burimeve teknike, që i mundësojnë përmbushjen e nevojave të sistemit ose të kërkesave të propozuara, dhe pamundësinë që këto burime teknike të mund të aktivizohen brenda afatit të kërkuar për përmbushjen e qëllimeve të kësaj rregulloreje. Burimet teknike të përmendura më lart në këtë pikë përfshijnë disponueshmërinë e teknikave dhe të teknologjive të nevojshme.

Neni 18
Kostot e paarsyeshme

1. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit pretendon se përdorimi i një metodologjie specifike monitorimi do të shkaktonte kosto të paarsyeshme, AKM-ja vlerëson nëse kostot janë të paarsyeshme, duke marrë në konsideratë argumentet e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit.

2. AKM-ja i konsideron kostot të paarsyeshme kur kostot e pritshme tejkalojnë përfitimin. Për këtë qëllim, përfitimi llogaritet duke shumëzuar një faktor përmirësimi me çmimin e referencës prej 80000 lekësh për shkarkimin e 1 toni metrik CO_2 ose një sasi të çdo gazi tjetër serrë të renditur në shtojcën I të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që ka potencial ngrohjeje globale të barasvlershme. Kostot përfshijnë një periudhë të përshtatshme të amortizimit të pajisjeve bazuar në jetëgjatësinë ekonomike të pajisjeve.

3. Kur vlerëson nëse kostot janë të paarsyeshme, në lidhje me zgjedhjen e shkallës metodologjike për të dhënat e aktivitetit nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, AKM-ja përdor si faktor përmirësimi, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, diferencën ndërmjet pasigurisë ekzistuese dhe pragut të pasigurisë së shkallës metodologjike, që do të arrihej nëse do të zbatohej përmirësimi, të shumëzuar me shkarkimet mesatare vjetore të shkaktuara nga ajo rrymë shkarkimi gjatë tri viteve të fundit.

4. Në mungesë të të dhënave mbi shkarkimet mesatare vjetore të shkaktuara nga ajo rrymë shkarkimi gjatë tri viteve të fundit, operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet të paraqesë një vlerësim konservativ të shkarkimeve mesatare vjetore, duke përjashtuar CO_2, që buron nga karboni me normë zero, por pa zbritur sasinë e CO_2 të transferuar. Për instrumentet matëse, që i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor kombëtar, pasiguria aktualisht e arritur mund të zëvendësohet me gabimin maksimal të lejuar gjatë përdorimit, sipas legjislacionit përkatës. Për qëllimet e kësaj pike, do të zbatohet pika 5, e nenit 38, të kësaj rregulloreje, me kusht që operatori i instalimit ose operatori i avionit të ketë në dispozicion informacionin përkatës mbi kriteret e qëndrueshmërisë dhe kursimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa të përdorura për djegie.

5. Kur vlerësohet natyra e paarsyeshme e kostove për marrjen e masave, që rrisin cilësinë e të dhënave të raportuara shkarkimeve, por që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi saktësinë e të dhënave të aktivitetit, AKM-ja përdor një faktor përmirësimi prej 1% të shkarkimeve mesatare vjetore të rrymave të shkarkimit përkatëse në tri periudhat e fundit të raportimit. Masat që rrisin cilësinë e raportimit të shkarkimeve përfshijnë:

a) përdorimin e analizave në vend të vlerave standarde për të përcaktuar faktorët e llogaritjes;

b) rritjen e numrit të analizave të kryera për çdo rrymë shkarkimi;

c) zëvendësimin e instrumenteve matëse funksionet matëse specifike të të cilave nuk janë subjekt i kontrollit metrologjik ligjor të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, me instrumente që

plotësojnë kërkesat e kontrollit metrologjik ligjor të legjislacionit shqiptar që përdoren në procedura të ngjashme, ose me instrumente matëse, që përputhen me standardet e Bashkimit Evropian, të përcaktuara në direktivën 2014/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ose direktivën 2014/32/BE;

ç) kryerjen e kalibrimit e të mirëmbajtjes të instrumenteve matëse në intervale më të shpeshta;

d) përmirësimin e aktiviteteve të menaxhimit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit, që zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e brendshëm ose kontrollin e rrezikut.

6. Kostot e masave për përmirësimin e metodologjisë së monitorimit të një instalimi nuk do të konsiderohen si kosto të paarsyeshme, kur arrijnë një shumë maksimale prej 4 000 eurosh të grumbulluar gjatë një periudhe raportimi. Për instalimet me nivel të ulët shkarkimi, shuma maksimale do të jetë 1000 euro të grumbulluara gjatë një periudhe raportimi.

KREU III
MONITORIMI I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMET

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 19
Kategorizimi i instalimeve, i rrymave të shkarkimit dhe burimeve të shkarkimit

1. Për të monitoruar shkarkimet dhe për të përcaktuar kërkesat minimale për shkallët metodologjike, çdo operator instalimi përcakton kategorinë e instalimit të tij, në përputhje me pikën dy të këtij neni, dhe, kur është e nevojshme, të çdo rryme shkarkimi, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, dhe të çdo burimi shkarkimi, në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

2. Operatori i instalimit klasifikon çdo instalim në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) instalim i kategorisë A, një instalim që gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit ka shkarkimet mesatare të verifikuara të barabarta me ose më të ulëta se 50 000 ton CO2(e), duke përjashtuar nga llogaritja CO_2, që rrjedh nga karboni me normë zero dhe pa zbritur nga llogaritja sasinë e CO_2 të transferuar;

b) instalim i kategorisë B, një instalim që gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit ka shkarkimet mesatare të verifikuara më të larta se 50 000 ton CO_2(e) dhe të barabarta me ose më të ulëta se 500 000 ton CO_2(e), duke përjashtuar nga llogaritja CO_2, që rrjedh nga karboni me normë zero dhe pa zbritur nga llogaritja sasinë e CO_2-së së transferuar;

c) instalim i kategorisë C, një instalim që, gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit, ka shkarkimet mesatare të verifikuara më të larta se 500 000 ton CO_2(e), duke përjashtuar nga llogaritja CO_2, që rrjedh nga karboni me normë zero dhe pa zbritur nga llogaritja sasinë e CO_2 të transferuar;

3. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 2, të nenit 14, të kësaj rregulloreje, AKM-ja pranon që operatori i instalimit të mos ndryshojë planin e monitorimit, në rast se, duke u bazuar në shkarkimet e verifikuara, është kaluar pragu për klasifikimin e instalimit i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, por operatori i instalimit i jep AKM-së prova të mjaftueshme, që vërtetojnë se ky prag nuk është tejkaluar në pesë periudhat e fundit të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri në periudhat pasuese të raportimit.

4. Operatori klasifikon çdo rrymë shkarkimi në njërën nga kategoritë e mëposhtme, duke e krahasuar atë me shumën e të gjitha vlerave absolute të CO_2 fosil dhe të CO_2(e), që përkojnë me të gjitha rrymat e shkarkimit të përfshira në metodologjinë e bazuar në llogaritje dhe me të gjitha shkarkimet nga burimet e shkarkimit të monitoruara me metodologjinë e bazuar në matje, pa zbritur CO2-në e transferuar:

a) rryma shkarkimi të vogla, në rastin kur rrymat e shkarkimit të zgjedhur nga operatori i instalimit përbëjnë së bashku më pak se 5 000 ton CO_2 fosil në vit ose më pak se 10%, deri në një sasi totale maksimale prej 100 000 ton CO_2 fosil në vit, cilado nga vlerat qoftë më e madhja në vlerë absolute;

b) rryma shkarkimi minimale *(de minimis)* në rastin kur rrymat e shkarkimit të zgjedhur nga operatori i instalimit përbëjnë së bashku më pak se 1 000 ton CO_2 fosil në vit ose më pak se 2%, deri në një sasi totale maksimale prej 20 000 ton CO_2 fosil në vit, cilado nga vlerat qoftë më e madhja në vlerë absolute;

c) rryma shkarkimi të mëdha, në rastin kur rrymat e shkarkimit nuk përfshihen në kategoritë e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" më sipër.

5. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 2, të nenit 14, të kësaj rregulloreje, AKM-ja pranon që operatori i instalimit të mos ndryshojë planin e monitorimit, në rast se, duke u bazuar në shkarkimet e verifikuara, është kaluar pragu për klasifikimin e rrymës së shkarkimit si rrymë shkarkimi e vogël ose rrymë shkarkimi minimale (*de-minimis*), sipas pikës 4 më sipër, por operatori i instalimit i jep AKM-së prova të mjaftueshme, që vërtetojnë se ky prag nuk është tejkaluar në pesë periudhat e fundit të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri në periudhat pasuese të raportimit.

6. Operatori i instalimit klasifikon çdo burim shkarkimi, për të cilin zbatohet një metodologji e bazuar në matje, në njërën nga kategoritë e mëposhtme:

a) burime shkarkimi të vogla, në rastin kur burimi i shkarkimit shkarkon më pak se 5 000 ton CO_2(e) fosil në vit ose më pak se 10% të totalit të shkarkimeve fosile të instalimit, deri në një maksimum prej 100 000 ton CO_2(e) fosil në vit, cilado nga vlerat qoftë më e madhja në vlerë absolute;

b) burime shkarkimi të mëdha, në rastin kur burimi i shkarkimit nuk klasifikohet si burim shkarkimi i vogël, sipas shkronjës "a" më sipër.

7. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 2, të nenit 14, të kësaj rregulloreje, AKM-ja pranon që operatori i instalimit të mos ndryshojë planin e monitorimit, në rast se, duke u bazuar në shkarkimet e verifikuara, është kaluar pragu për klasifikimin e burimit të shkarkimit si burim i vogël shkarkimi, sipas pikës 6 më sipër, por operatori i instalimit i jep AKM-së prova të mjaftueshme që vërtetojnë se ky prag nuk është tejkaluar në pesë periudhat e fundit të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri në periudhat pasuese të raportimit.

8. Kur nuk janë të disponueshme të dhënat mbi shkarkimet mesatare vjetore të verifikuara të instalimit gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit ose nuk janë më përfaqësuese për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, operatori i instalimit, për të përcaktuar kategorinë e instalimit, përdor një vlerësim konservativ të shkarkimeve mesatare vjetore, duke përjashtuar nga llogaritja CO_2, që rrjedh nga karboni me normë zero, por pa zbritur CO_2 e transferuar.

Neni 20
Kufijtë e monitorimit

1. Operatori i instalimit përcakton kufijtë e monitorimit për çdo instalim. Brenda këtyre kufijve, operatori përfshin:

a) të gjitha shkarkimet e gazeve me efekt serrë përkatëse nga të gjithë burimet e shkarkimit dhe rrymat e shkarkimit, që shkaktohen nga veprimtaritë e kryera në instalim dhe që përfshihen në shtojcën II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

b) shkarkimet e shkaktuara si nga operacionet e zakonshme, ashtu edhe nga ngjarjet e jashtëzakonshme gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë fazën e vënies në punë të instalimit, fazën e ndërprerjes së funksionimit të instalimit dhe situatat emergjente, me përjashtim të shkarkimeve, që shkaktohen nga makineritë e lëvizshme për qëllime transporti.

2. Kur përcakton procesin e monitorimit e të raportimit, operatori i instalimit përfshin kërkesat specifike sektoriale të parashikuara në shtojcën IV të kësaj rregulloreje.

3. Kur rrjedhjet nga një kompleks depozitimi janë identifikuar dhe shkaktojnë shkarkime ose çlirimin e CO_2 në kolonën e ujit, ato konsiderohen si burime shkarkimi të instalimit përkatës dhe monitorohen, në përputhje me seksionin 23, të shtojcës IV, të kësaj rregulloreje.

4. AKM-ja mund të lejojë përjashtimin nga procesi i monitorimit dhe raportimit të një burimi shkarkimi, që ka origjinën nga rrjedhjet, pasi të jenë marrë masat për korrigjimin e rrjedhjeve apo të parregullsive domethënëse, sipas legjislacionit në fuqi, dhe kur nuk konstatohet më ekzistenca e shkarkimeve ose të çlirimit në kolonën e ujit nga kjo rrjedhje.

Neni 21
Zgjedhja e metodologjisë së monitorimit

1. Për të monitoruar shkarkimet e një instalimi, operatori i instalimit zgjedh të përdorë ose metodologjinë e bazuar në llogaritje ose metodologjinë e bazuar në matje, në përputhje me parashikimet e dispozitave specifike të kësaj rregulloreje.

2. Metodologjia e bazuar në llogaritje është një metodologji, që përcakton shkarkimet nga rrymat e

shkarkimeve, duke u bazuar te të dhënat e aktivitetit të mbledhura përmes sistemeve matëse dhe parametrave shtesë të mbledhura nga analizat laboratorike ose nga vlerat standarde. Metodologjia e bazuar në llogaritje mund të zbatohet sipas metodologjisë standarde të përcaktuar në nenin 24 të kësaj rregulloreje ose sipas metodologjisë së bilancit të masës përcaktuar në nenin 25 të kësaj rregulloreje.

3. Kur zbatohet metodologjia e bazuar në llogaritje, operatori i instalimit përcakton në planin e monitorimit për secilën rrymë shkarkimi, nëse përdoret metodologjia standarde apo metodologjia e bilancit të masës, duke përfshirë shkallën metodologjike përkatëse, në përputhje me shtojcën II të kësaj rregulloreje.

4. Metodologjia e bazuar në matje është një metodologji, që përcakton shkarkimet nga burimet e shkarkimit, duke matur në mënyrë të vazhdueshme përqendrimin e gazit specifik me efekt serrë në gazet çliruara nga djegia dhe në fluksin e gazeve të çliruara nga djegia, përfshirë edhe monitorimin e transferimeve të CO_2 ndërmjet instalimeve, ku matet përqendrimi i CO_2 dhe fluksi i gazit të transferuar.

5. Në rast se miratohet nga AKM-ja, operatori i instalimit, për burime të ndryshme shkarkimi dhe për rryma të ndryshme shkarkimi që i përkasin të njëjtit instalim, mund të përdorë metodologji të ndryshme si metodologjinë standarde, metodologjinë e bilancit të masës dhe metodologjinë e bazuar në matje, me kusht që të mos ketë as mangësi dhe as llogaritje të dyfishtë të shkarkimeve.

6. Kur kërkesat specifike sektoriale të përcaktuara në shtojcën IV të kësaj rregulloreje kërkojnë përdorimin e një metodologjie të caktuar monitorimi, operatori i instalimit përdor metodologjinë e kërkuar ose metodologjinë e bazuar në matje. Operatori i instalimit mund të zgjedhë një metodologji tjetër vetëm nëse i paraqet AKM-së prova që përdorimi i metodologjisë së kërkuar nuk është teknikisht i zbatueshëm, ose që shkakton kosto të paarsyeshme, ose që metodologjia alternative siguron përgjithësisht një nivel më të lartë saktësie të të dhënave të shkarkimit.

Neni 22

Metodologjia e monitorimit që nuk bazohet në shkallën metodologjike

1. Si përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit mund të përdorë një metodologji monitorimi, që nuk bazohet në shkallën metodologjike (në vijim, "metodologjia rezervë") për rryma shkarkimi ose burime shkarkimi të zgjedhura, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur zbatimi i shkallës metodologjike 1 në metodologjinë e bazuar në llogaritje për një ose më shumë rryma shkarkimi të mëdha ose rryma shkarkimi të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së bazuar në matje për të paktën një burim shkarkimi që lidhet me të njëjtën rrymë shkarkimi, nuk është teknikisht e mundur ose shkakton kosto të paarsyeshme;

b) kur operatori i instalimit vlerëson dhe përcakton në mënyrë të matshme çdo vit pasiguritë e të gjitha parametrave të përdorur për përcaktimin e shkarkimeve vjetore, në përputhje me udhëzuesin e ISO-s për shprehjen e pasigurisë në matje (JCGM 100:2008) ose me një standard tjetër të barasvlershëm të pranuar ndërkombëtarisht, dhe i përfshin rezultatet në raportin vjetor të shkarkimeve;

c) kur operatori i instalimit i jep AKM-së prova bindëse se, duke zbatuar një metodologji monitorimi rezervë, pragjet e përgjithshme të pasigurisë për nivelin vjetor të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për të gjithë instalimin nuk e tejkalojnë 7,5% për instalimet e kategorisë A, 5,0% për instalimet e kategorisë B dhe 2,5% për instalimet e kategorisë C.

Neni 23

Ndryshime të përkohshme të metodologjisë së monitorimit

1. Kur për arsye teknike është përkohësisht e pamundur të zbatohet plani i monitorimit, ashtu siç është miratuar nga AKM-ja, operatori i instalimit përdor shkallën metodologjike më të lartë të mundshme ose një qasje konservative pa shkallë metodologjike në rast se nuk është e mundur të përdoret asnjë shkallë metodologjike, derisa të rikthehen kushtet për përdorimin e shkallës metodologjike të miratuar në planin e monitorimit. Operatori i instalimit merr të gjitha masat e

nevojshme për të rinisur sa më shpejt përdorimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

2. Operatori i instalimit njofton menjëherë AKM-në për ndryshimin e përkohshëm të metodologjisë së monitorimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, duke specifikuar:

a) arsyet e devijimit nga plani i monitorimit i miratuar nga AKM-ja;

b) specifikat e metodologjisë së monitorimit të përkohshme që operatori i instalimit është duke përdorur për të përcaktuar shkarkimet, derisa të rivendosen kushtet për zbatimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) masat që po merr operatori i instalimit për të rivendosur kushtet për zbatimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

ç) momentin kur parashikohet të rifillojë zbatimi i planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

SEKSIONI 2
METODOLOGJIA E BAZUAR NË LLOGARITJE

NËNSEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 24
Llogaritja e shkarkimeve sipas metodologjisë standarde

1. Sipas metodologjisë standarde, operatori i instalimit llogarit shkarkimet e krijuara nga djegia për çdo rrymë shkarkimi, duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit, që tregojnë sasinë e lëndës djegëse që është djegur, të shprehur në teraxhaul bazuar në vlerën kalorifike neto (VKN), me faktorin përkatës të shkarkimit, të shprehur në ton CO_2 për teraxhaul (t CO_2/TJ), në përputhje me përdorimin e vlerës kalorifike neto dhe faktorin përkatës të oksidimit.

2. Për të bërë të mundur raportimin e të dhënave shtesë, operatori i instalimit, për çdo rrymë shkarkimi të djegur dhe për lëndët djegëse të përdorura si elemente hyrëse të një procesi, llogarit gjithashtu parametrat e mëposhtëm sipas metodës vijuese:

i) shkarkimet paraprake totale llogariten duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit në lidhje me sasinë e lëndës djegëse të djegur, të shprehur në ton ose në metër kub normal, me faktorin korrespondues preliminar të shkarkimit dhe faktorin përkatës të oksidimit;

ii) shkarkimet e biomasës llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale me fraksionin e biomasës;

iii) shkarkimet e biomasës me normë zero llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale me fraksionin e biomasës me normë zero;

iv) shkarkimet nga RFNBO, RCF ose lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale me fraksionin RFNBO ose RCF ose me fraksionin sintetik me karbon të ulët;

v) shkarkimet nga RFNBO, RCF me normë zero ose nga lëndët djegëse sintetike me nivel të ulët karboni me normë zero llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale me fraksionin RFNBO ose RFC me normë zero ose fraksionin sintetik me nivel të ulët karboni me normë zero.

3. Operatori i instalimit përcakton shkarkimet e krijuara nga procesi për çdo rrymë shkarkimi duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit në lidhje me konsumin e materialit, sasinë totale të materialit të përpunuar ose të produktit final të prodhuar, të shprehur në tonë ose metër kub normal, me faktorin përkatës të shkarkimit, të shprehur në t CO_2/t ose t CO_2/Nm^3, si dhe me dhe faktorin përkatës të konvertimit.

4. Për të bërë të mundur raportimin e të dhënave shtesë, operatori i instalimit llogarit gjithashtu për çdo rrymë shkarkimi që krijon shkarkime nga proceset parametrat e mëposhtëm sipas metodës vijuese:

i) Shkarkimet paraprake totale llogariten duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit në lidhje me konsumin e materialit, sasinë totale të materialit të përpunuar ose të produktit final të prodhuar, të shprehur në tonë ose metër kub normal, me faktorin përkatës të shkarkimit, të shprehur në t CO_2/t ose t CO_2/Nm^3, si dhe me dhe faktorin përkatës të konvertimit.

ii) Shkarkimet e biomasës llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale e me fraksionin përkatës të biomasës;

iii) Shkarkimet e biomasës me normë zero do të llogariten duke shumëzuar shkarkimet paraprake totale me fraksionin përkatës të biomasës me normë zero.

5. Kur një faktor shkarkimi, që i përket shkallës metodologjike 1 ose 2, e përfshin vetë efektin e reaksioneve kimike të paplota, faktori i oksidimit ose faktori i konvertimit do të jetë 1.

Neni 25
Llogaritja e shkarkimeve sipas metodologjisë së bilancit të masës

1. Kur përdor metodologjinë e bilancit të masës, operatori i instalimit llogarit sasinë e CO_2, që korrespondon me çdo rrymë shkarkimi, që përfshihet në bilancin e masës, duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit në lidhje me sasinë e lëndës djegëse, materialit ose CO_2 të transferuar që hyn ose del nga kufijtë e bilancit të masës, me përmbajtjen e karbonit të lëndës djegëse, materialit, ose të CO_2 të transferuar, të shumëzuar me fraksionin e tij fosil dhe me 3,664 t CO_2/t C, në përputhje me seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

2. Për të bërë të mundur raportimin e të dhënave shtesë, operatori i instalimit llogarit gjithashtu për çdo rrymë shkarkimi të përfshirë në bilancin e masës parametrat e mëposhtëm, sipas metodës vijuese:

i) Sasia paraprake totale e CO_2 llogaritet duke shumëzuar të dhënat e aktivitetit, që lidhen me sasinë e lëndës djegëse ose materialit që hyn ose del nga kufijtë e bilancit të masës, me përmbajtjen e karbonit të karburantit ose materialit dhe me koeficientin 3,664 t CO_2/t C.

ii) Sasia e CO_2 që i korrespondon biomasës llogaritet duke shumëzuar sasinë totale paraprake të CO_2 me fraksionin e biomasës.

iii) Sasia e CO_2 që i korrespondon biomasës me normë zero llogaritet duke shumëzuar sasinë paraprake totale të CO_2 me fraksionin e biomasës me normë zero.

iv) Kur është e zbatueshme, sasia e CO_2 që i korrespondon RFNBO-ve, RCF-ve ose karburanteve sintetike me përmbajtje të ulët karboni llogaritet duke shumëzuar sasinë paraprake totale të CO_2 me fraksionin e RFNBO-ve ose të RCF-ve, ose me fraksionin e karburanteve sintetike me përmbajtje të ulët karboni.

v) Kur është e zbatueshme, sasia e CO_2 që i korrespondon RFNBO-ve me normë zero, RCF-ve me normë zero ose karburanteve sintetike me përmbajtje të ulët karboni dhe me normë zero duhet të llogaritet duke shumëzuar sasinë paraprake totale të CO_2 me fraksionin e RFNBO-ve ose të RCF-ve me normë zero, ose me fraksionin e karburanteve sintetike me përmbajtje të ulët karboni dhe me normë zero.

3. Pavarësisht nga parashikimet e nenit 49 të kësaj rregulloreje, shkarkimet e të gjithë procesit të përfshira në bilancin e masës janë shuma e sasisë së CO_2, që përkon me të gjitha rrymat e shkarkimit, që përfshihen në bilancin e masës. CO i shkarkuar në atmosferë llogaritet në bilancin e masës si shkarkim i sasisë ekuivalente molare të CO_2.

4. Kur operatori i instalimit përdor bilancin e masës në përputhje me këtë nen, dhe në materialet ose karburantet hyrëse në procesin e prodhimit gjendet karboni me normë zero dhe kur materialet e prodhuara përmbajnë karbon, operatori i instalimit i paraqet AKM-së të dhëna mbi fraksionin me normë zero të përmbajtjes së karbonit në rrymat që dalin nga procesi i prodhimit. Si rrjedhojë operatori i instalimit paraqet prova se metodologjia e monitorimit e përdorur nuk nënvlerëson sistematikisht shkarkimet totale të instalimit dhe se masa totale e karbonit, që përkon me fraksionet e karbonit me normë zero, të karbonit që përmbahet në të gjitha materialet përkatëse që dalin nga procesi i prodhimit, nuk është më e vogël se masa totale e fraksioneve të karbonit me normë zero që përmbahet në materialet dhe lëndët djegëse, që hyjnë në procesin e prodhimit.

5. Për zbatimin e pikës 2 të këtij neni, në lidhje me fraksionin e biomasës me normë zero të biogazit dhe gazit natyror të përdorur si hyrëse në procesin e prodhimit, zbatohen pikat 4, 5, 6 dhe 7 , të nenit 39, të kësaj rregulloreje.

Neni 26
Shkallët metodologjike të zbatueshme

1. Kur operatori i instalimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, përcakton shkallën metodologjike përkatëse për rrymat e shkarkimit të mëdha dhe të vogla, me qëllim përcaktimin e të dhënave të aktivitetit dhe të çdo faktori llogaritës, ai duhet të zbatojë:

a) të paktën shkallët metodologjike të përcaktuara në shtojcën V të kësaj rregulloreje, për instalimet e kategorisë A, ose kur kërkohet një faktor llogaritës për një rrymë shkarkimi, që është një lëndë djegëse tregtare standarde;

b) në rastet e tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" më sipër, shkallën më të lartë metodologjike, në përputhje me parashikimet e shtojcës II të kësaj rregulloreje.

2. Megjithatë, për rrymat e mëdha të shkarkimit në instalimet e kategorisë C, operatori i instalimit mund të zbatojë një shkallë metodologjike një nivel më të ulët se ai i kërkuar në përputhje me pikën 1 më sipër, dhe për rrymat e mëdha të shkarkimit në instalimet e kategorive A dhe B mund të zbatojë një shkallë metodologjike deri në dy nivele më të ulëta, me kusht që të mos jetë më poshtë se shkalla metodologjike 1, kur i vërteton AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se shkalla metodologjike e kërkuar sipas pikës 1 më sipër nuk është teknikisht e zbatueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme.

3. AKM-ja mund të lejojë, për një periudhë kalimtare të rënë dakord me operatorin e instalimit, që ky i fundit të zbatojë për rrymat e mëdha të shkarkimit një shkallë metodologjike më të ulët se ato të përmendura pikën 2, të këtij neni, por jo më të ulët se shkalla metodologjike 1, me kusht që:

a) operatori i instalimit t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se shkalla metodologjike e kërkuar sipas pikës 2 më sipër nuk është teknikisht e zbatueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme;

b) operatori i instalimit paraqet një plan përmirësimi, ku tregohet se si dhe deri kur do të arrihet të përdoret paktën shkalla metodologjike e kërkuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Për rrymat e shkarkimit të vogla, operatori i instalimit lejohet të zbatojë një shkallë metodologjike më të ulët se ajo e kërkuar, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, por jo më poshtë se shkalla metodologjike 1, kur arrin t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se shkalla metodologjike e kërkuar sipas pikës 2 më sipër nuk është teknikisht e zbatueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme.

5. Për rrymat e shkarkimit minimale *(de minimis),* operatori i instalimit mund të përcaktojë të dhënat e aktivitetit dhe çdo faktor llogaritës, duke përdorur vlerësime konservative, në vend të përdorimit të shkallëve metodologjike, përveç rasteve kur një shkallë metodologjike specifike mund të arrihet nga operatori i instalimit pa bërë përpjekje shtesë.

6. Për faktorin e oksidimit dhe faktorin e konvertimit, operatori i instalimit duhet të zbatojë, si minimum, shkallët metodologjike më të ulëta të përcaktuara në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

7. Kur AKM-ja ka pranuar përdorimin e faktorëve të shkarkimit të shprehur në t CO_2/t ose t CO_2/Nm^3 për lëndët djegëse, dhe për lëndët djegëse të përdorura si lëndë hyrëse në një proces prodhimi ose në bilancin e masës, në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, vlera kalorifike neto mund të monitorohet duke përdorur një vlerësim konservativ, në vend të përdorimit të shkallëve metodologjike, përveç rasteve kur një shkallë metodologjike e përcaktuar mund të arrihet të përdoret pa përpjekje shtesë.

NËNSEKSIONI 2
TË DHËNAT E AKTIVITETIT

Neni 27
Përcaktimi i të dhënave të aktivitetit

1. Operatori i instalimit përcakton të dhënat e aktivitetit të një rryme shkarkimi me një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Duke kryer matje të vazhdueshme në vendin ku zhvillohet procesi që shkakton shkarkimet;

b) Duke bashkuar të dhënat e matjeve të paraqitura veçmas dhe duke marrë në konsideratë ndryshimet e mallrave ose lëndëve djegëse rezervë.

2. Për qëllimet e shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, sasia e karburantit ose e materialit të përpunuar gjatë periudhës së raportimit do të llogaritet si sasia e karburantit ose e materialit të marrë gjatë periudhës së raportimit, minus sasinë e karburantit ose e materialit të nxjerrë nga instalimi, plus sasinë e karburantit ose të materialit të magazinuar në fillim të periudhës së raportimit, minus sasinë e karburantit ose të materialit të magazinuar në fund të periudhës së raportimit.

3. Kur përcaktimi i sasive të magazinuara përmes matjes direkte nuk është teknikisht e mundshme ose kur sjell kosto të paarsyeshme, operatori i instalimit mund t'i vlerësojë këto sasi duke përdorur një prej metodave të mëposhtme:

a) të dhëna nga vitet e mëparshme, të krahasuara me prodhimin gjatë periudhës së raportimit;

b) procedura të dokumentuara dhe të dhënat përkatëse të përfshira në pasqyrat financiare të audituara për periudhën e raportimit.

4. Kur përcaktimi i të dhënave të aktivitetit për të gjithë vitin kalendarik nuk është teknikisht i zbatueshëm ose sjell kosto të paarsyeshme, operatori i instalimit mund të zgjedhë ditën tjetër më të përshtatshme për të ndarë një vit raportimi nga viti pasardhës, duke formuar në këtë mënyrë vitin e plotë kalendarik të kërkuar. Mospërputhjet në lidhje me një ose më shumë rryma shkarkimi duhet të

regjistrohen në mënyrë të qartë dhe shërbejnë si bazë për vlerën përfaqësuese të vitit kalendarik dhe vlerësohen në të njëjtën mënyrë në vitin pasardhës.

Neni 28
Sistemet matëse nën kontrollin e operatorit të instalimit

1. Për të përcaktuar të dhënat e aktivitetit në përputhje me nenin 27 të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit përdorë rezultatet e matura nga sistemet matëse të vendosura në instalim dhe që janë nën kontrollin e tij, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) operatori kryen vlerësimin e pasigurisë dhe garanton që respektohet pragu i pasigurisë së shkallës metodologjike përkatëse;

b) operatori i instalimit duhet të sigurojë, të paktën një herë në vit dhe pas çdo kalibrimi të një instrumenti matës, që rezultatet e kalibrimit, të shumëzuara me një faktor rregullues konservativ, të vlerësohen në raport me pragjet përkatëse të pasigurisë. Faktori rregullues konservativ bazohet në kalibrimet e mëparshme të të njëjtit instrument matës ose të instrumenteve të ngjashme, të kryera gjatë periudhave kohore të përshtatshme, me qëllim që të mbahet parasysh efekti i rritjes së pasigurisë gjatë përdorimit të instrumentit matës.

2. Kur tejkalohet pragu i shkallës metodologjike të përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje, ose kur vërtetohet se instrumenti nuk është në përputhje me kërkesat e tjera, operatori i instalimit pa vonesë merr masa për korrigjimin e mospërputhjes dhe njofton AKM-në.

3. Operatori i instalimit i paraqet AKM-së vlerësimin e pasigurisë të përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, kur jep njoftimin e përdorimit të një plan të ri monitorimi ose kur është me rëndësi për ndryshimin e planit të monitorimit të miratuar.

4. Vlerësimi i përmendur në pikën 3 më sipër përfshin pasigurinë specifike të instrumenteve matëse të përdorura, pasigurinë në lidhje me kalibrimin, si dhe çdo pasiguri tjetër, që lidhet me mënyrën se si instrumentet matëse përdoren në praktikë. Vlerësimi i pasigurisë përfshin edhe pasiguritë, që lidhen me ndryshimet në sasitë e magazinuara, kur kapaciteti i magazinave është të paktën 5% e sasisë vjetore të lëndës djegëse ose materialit përkatës. Gjatë kryerjes së vlerësimit, operatori i instalimit duhet të mbajë në konsideratë faktin se vlerat e deklaruara, që përdoren për përcaktimin e pragjeve të pasigurisë të shkallës metodologjike, sipas shtojcës II të kësaj rregulloreje, i referohen pasigurisë gjatë gjithë periudhës raportuese.

5. Operatori i instalimit lejohet ta thjeshtojë vlerësimin e pasigurisë të përmendur në këtë nen, me kusht që instrumentet matëse të jenë instaluar në një mjedis të përshtatshëm për përdorimin e tyre specifik. Operatori i instalimit thjeshton vlerësimin e pasigurisë, duke supozuar se gabimet maksimale të lejueshme, të përcaktuara për përdorimin e instrumentin matës, ose pasiguria nga kalibrimi, nëse është më e ulët, të shumëzuara me një faktor rregullues konservativ që mban në konsideratë efektin e pasigurisë gjatë përdorimit, konsiderohen si pasiguri për të gjithë periudhën e raportimit, në përputhje me shkallën metodologjike të përcaktuara në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

6. Pavarësisht parashikimeve të pikave 3, 4 e 5, të këtij neni, AKM-ja mund t'i lejojë operatorit të instalimit të përdorë rezultatet e matjeve të mbledhura nga sistemet matëse të vendosura në instalim dhe që janë nën kontrollin e tij, kur operatori i instalimit paraqet prova se instrumentet matëse të përdoruara i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor përkatës, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Në këtë rast, mund të përdoret si vlerë e pasigurisë, pa pasur nevojë për të paraqitur prova të tjera, gabimi maksimal i pranueshëm gjatë përdorimit për funksionin matës përkatës, i lejuar nga legjislacioni shqiptar specifik mbi kontrollin metrologjik ligjor.

Neni 29
Sistemet matëse jashtë kontrollit të operatorit të instalimit

1. Kur, mbi bazën e një vlerësimi të thjeshtuar të pasigurisë, përdorimi i sistemeve matëse jashtë kontrollit të vet të operatorit, krahasuar me përdorimin e atyre nën kontrollin e tij, sipas nenit 28 të kësaj rregulloreje, i mundëson operatorit të instalimit të përmbushë të paktën të njëjtën shkallë metodologjike, jep rezultate më të besueshme, dhe është më pak i ekspozuar ndaj rreziqeve të kontrollit, atëherë operatori i instalimit duhet t'i përcaktojë të dhënat e aktivitetit nga sistemet matëse jashtë kontrollit të tij.

2. Për të përcaktuar të dhënat e aktivitetit nga sistemet matëse jashtë kontrollit të tij sipas pikës 1 më sipër, operatori i instalimit mund të mbështetet në një nga burimet e mëposhtme të të dhënave:

a) sasitë nga faturat e lëshuara nga një partner tregtar, me kusht që transaksioni tregtar të zhvillohet ndërmjet dy partnerëve tregtarë të pavarur;

b) lexime të drejtpërdrejta nga sistemet matëse.

3. Operatori i instalimit duhet të sigurojë përputhjen me shkallën metodologjike të zbatueshme, në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje. Për këtë qëllim, mund të përdoret si vlera e pasigurisë pa paraqitur prova të tjera, gabimi maksimal i lejueshëm gjatë përdorimit, sipas legjislacionit shqiptar përkatës për kontrollin metrologjik ligjor, i zbatueshëm për transaksionin tregtar përkatës. Kur kërkesat e zbatueshme sipas legjislacioni shqiptar të kontrollit metrologjik ligjor, janë më pak të rrepta se shkalla metodologjike e zbatueshme sipas nenit 26 të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit duhet të sigurojë prova mbi pasigurinë e zbatueshme nga partneri tregtar përgjegjës për sistemin matës.

NËNSEKSIONI 3
FAKTORËT E LLOGARITJES

Neni 30
Përcaktimi i faktorëve të llogaritjes

1. Operatori i instalimit përcakton faktorët e llogaritjes ose si vlera standarde ose si vlera të bazuara në analizë, në varësi të shkallës metodologjike të zbatueshme.

2. Operatori i instalimit përcakton dhe raporton faktorët e llogaritjes gjithmonë duke iu referuar gjendjes së lëndës djegëse ose materialit të përdorur gjatë mbledhjes së të dhënave të aktivitetit, domethënë gjendjes në të cilën karburanti ose materiali ndodhet në momentin e blerjes ose të përdorimit në procesin që gjeneron shkarkimet, përpara se të thahet ose t'u nënshtrohet trajtimeve të tjera të nevojshme për analizat laboratorike. Kur kjo qasje shkakton kosto të paarsyeshme ose kur mund të arrihet saktësi më e lartë, operatori i instalimit mund të raportojë të dhënat e aktivitetit dhe faktorët e llogaritjes duke iu referuar gjendjes në të cilën kryhen analizat laboratorike dhe duke e zbatuar këtë metodologji në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha matjet në këtë kontekst.

3. Operatori i instalimit përcakton fraksionin e biomasës vetëm për lëndët djegëse ose materialet e përziera që përmbajnë biomasë. Për lëndët djegëse ose materialet e tjera, përdoret vlera standarde e barabartë me 0% për fraksionit e biomasës së lëndëve djegëse ose materialeve fosile, si dhe vlera standarde e barabartë me 100% për fraksionin e biomasës së lëndëve djegëse ose materialeve që përbëhen ekskluzivisht nga biomasa.

4. Operatori i instalimit përcakton fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët vetëm për lëndët djegëse të përziera që përmbajnë RFNBO, RCF ose për lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët. Për lëndët djegëse të tjera, përdoret vlera standarde e barabartë me 0% për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, si dhe vlera standarde e barabartë me 100% për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët për lëndët djegëse që përbëhen ekskluzivisht nga RFNBO, RCF ose nga lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët. Operatori i instalimit përcakton fraksionin e biomasës me normë zero, fraksionin RFNBO ose RCF me normë zero dhe fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, vetëm në rastet kur dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero.

5. Operatori i instalimit zbaton rregullat e mëposhtme në lidhje me ndërvarësinë ndërmjet faktorëve të llogaritjes, që lidhen me përbërjen:

i) Kur një lëndë djegëse ose një material përmban biomasë, operatori i instalimit përcakton fraksionin e biomasës në përputhje me nenin 39 të kësaj rregulloreje.

ii) Kur fraksioni i biomasës nuk është zero dhe kur operatori i instalimit dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, operatori i instalimit përcakton fraksionin e biomasës me normë zero në përputhje me nenin 38 pikën 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

iii) Kur një lëndë djegëse përmban një RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët, operatori i instalimit përcakton fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

iv) Kur fraksioni RFNBO ose RCF nuk është zero dhe kur operatori i instalimit dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, operatori i

instalimit përcakton fraksionin RFNBO ose RCF me normë zero, në përputhje me pikat 4 dhe 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

v) Kur fraksioni i lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët nuk është zero dhe kur operatori i instalimit dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, operatori i instalimit përcakton fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

vi) Kur fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero ose fraksioni i lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero nuk janë zero, operatori i instalimit llogarit fraksionin me normë zero si shumën e fraksionit të biomasës me normë zero, fraksionit RFNBO ose RCF me normë zero dhe fraksionit të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero. Fraksioni fosil është shuma e të gjithë fraksioneve që nuk kanë normë zero. Kur operatori i instalimit nuk llogarit fraksionin me normë zero, fraksioni fosil është 100%.

vii) Operatori i instalimit llogarit faktorin e shkarkimeve si faktor paraprak të shkarkimit, të shumëzuar me fraksionin fosil.

6. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 3 të këtij neni operatori i instalimit mund të zbatojë rregullat e mëposhtme:

i) të përcaktojë përqindjen e biomasës si të barabartë me përqindjen e biomasës me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

ii) të përcaktojë përqindjen e RFNBO ose RCF si të barabartë me përqindjen e RFNBO ose RCF me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

iii) të përcaktojë përqindjen e karburanteve sintetike me karbon të ulët si të barabartë me përqindjen e tyre me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Vlerat standarde për faktorët e llogaritjes

1. Kur operatori i instalimit përcakton faktorët e llogaritjes si vlera standarde, ai përdor një nga vlerat e mëposhtme, në përputhje me kërkesat e shkallës metodologjike të zbatueshme, siç përcaktohet në shtojcat II dhe VI të kësaj rregulloreje:

a) faktorët standard dhe faktorët stekiometrikë të renditur në shtojcën VI të kësaj rregulloreje;

b) faktorët standardë të përdorur nga Republika e Shqipërisë për paraqitjen e inventarit kombëtar në Sekretariatin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;

c) vlerat e literaturës së fushës për të cilat AKM-ja ka rënë dakord, duke përfshirë faktorët standard të publikuar nga AKM-ja, që janë në përputhje me faktorët e përmendur në pikën (b), por që përfaqësojnë rrymat e shkarkimit të lëndës djegëse të ndara në mënyrë më të hollësishme në kategori specifike;

ç) vlerat e përcaktuara dhe të garantuara nga furnizuesi i një lënde djegëse ose materiali, kur operatori i instalimit mund t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë bindëse, se përmbajtja e karbonit paraqet një interval besueshmërie prej 95% jo më të madh se 1%.

d) vlerat që bazohen në analizat e kryera më parë, kur operatori i instalimit i vërteton AKM-së në mënyrë bindëse se këto vlera janë përfaqësuese për kontingjentet e ardhshme të së njëjtës lëndë djegëse ose të të njëjtit material.

2. Operatori i instalimit specifikon të gjitha vlerat e standarde që përdoren në planin e monitorimit. Kur vlerat standarde ndryshojnë çdo vit, operatori i instalimit duhet të specifikojë në planin e monitorimit burimin zyrtar të zbatueshëm të asaj vlere.

3. AKM-ja mund të miratojë një ndryshim të vlerave standarde për një faktor llogaritës në planin e monitorimit në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, vetëm kur operatori i instalimit vërteton se vlera e re standarde çon në një përcaktim më të saktë të shkarkimeve.

4. Me kërkesë të operatorit të instalimit, AKM-ja mund të lejojë që vlera neto kalorifike dhe faktorët e shkarkimit të lëndëve djegëse të përcaktohen duke përdorur të njëjtat shkallë metodologjike që kërkohen për lëndët djegëse tregtare standarde, me kusht që operatori i instalimit të paraqesë, të paktën

një herë në tre vjet, prova se intervali prej 1% për vlerën kalorifike të specifikuar është respektuar gjatë tre vjetëve të fundit.

5. Me kërkesë të operatorit të instalimit, AKM-ja mund të pranojë që përmbajtja stekiometrike e karbonit e një substance kimike të pastër të konsiderohet se përmbush një shkallë metodologjike që përndryshe do të kërkonte kryerjen e analizave, në përputhje me nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje, nëse operatori i instalimit mund të vërtetojë në mënyrë bindëse për AKM-në, se përdorimi i analizave do të sillte kosto të pajustifikueshme dhe se përdorimi i vlerës stekiometrike nuk do të çojë në nënvlerësim e shkarkimeve.

Neni 32
Faktorët e llogaritjes bazuar tek analizat

1. Operatori i instalimit siguron që çdo analizë, marrje mostre, kalibrim dhe verifikim për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes kryhet duke zbatuar metoda të bazuara në standardet evropiane përkatëse (standarde EN). Kur këto standarde nuk janë të disponueshme, metodat duhet të bazohen në standardet përkatëse ISO ose në standarde kombëtare. Kur nuk ekzistojnë standarde të publikuara të zbatueshme, përdoren projektstandarde të përshtatshme (standarde që nuk janë ende të miratuara formalisht), udhëzime të industrisë mbi praktikat më të mira ose metodologji të tjera të provuara shkencërisht, të cilat kufizojnë kryerjen e gabimeve sistematike gjatë marrjes së mostrave dhe matjes.

2. Kur, për përcaktimin e shkarkimeve, përdoren pajisje të tilla si kromatografët e gazit *on-line* ose analizatorët me nxjerre të gazit (ku mostra e gazit nxirret jashtë tubacionit ose oxhakut dhe analizohet në një pajisje të veçantë) ose analizatorët pa nxjerre të gazit (ku analiza kryhet drejtpërdrejt brenda tubacionit ose oxhakut pa e nxjerrë gazin), operatori i instalimit duhet të marrë miratimin e AKM-së për përdorimin e pajisjeve të tilla. Pajisjet mund të përdoren vetëm për të dhënat e përbërjes së lëndëve djegëse dhe materialeve në gjendje të gaztë. Si masa minimale të sigurimit të cilësisë, operatori i instalimit siguron verifikimin e përshtatshmërisë dhe saktësisë së instrumentit, nëpërmjet verifikimit fillestar dhe verifikimit periodik çdo vit të instrumentit matës.

3. Rezultati i çdo analize përdoret vetëm për serinë (lotin) e lëndëve djegëse apo materialit, që janë furnizuar në një periudhë të caktuar, nga i cili janë marrë mostrat e analizuara, që përfaqësojnë vetëm atë seri (lot) lëndësh djegëse apo material të furnizuar në atë periudhë të caktuar. Për përcaktimin e një parametri specifik, operatori i instalimit përdor rezultatet e të gjitha analizave të kryera në lidhje me atë parametër.

Neni 33
Plani i marrjes së mostrave

1. Kur faktorët e llogaritjes përcaktohen përmes analizave, operatori i instalimit duhet të paraqesë për miratim nga AKM-ja për çdo lëndë djegëse ose material, planin e marrjes së mostrave, që ka formën e një procedure të shkruar, që përmban informacion mbi metodologjitë për përgatitjen e mostrave, përfshirë të dhëna mbi ndarjen e përgjegjësive, vendndodhjet e marrjes së mostrave, shpeshtësinë e marrjes së mostrave dhe sasinë e mostrave që merren, si dhe metodologjitë për ruajtjen dhe transportimin e mostrave.

2. Operatori i instalimit siguron që mostrat e marra janë përfaqësuese të serisë (lotit) përkatës ose të periudhës përkatëse të dorëzimit dhe nuk përmbajnë gabime sistematike. Elementet e vlefshme të planit të marrjes së mostrave përcaktohen në marrëveshje me laboratorin që kryen analizën për lëndën djegëse ose materialin përkatës, dhe provat e kësaj marrëveshjeje përfshihen në planin e marrjes së mostrave. Operatori i instalimit duhet të vërë në dispozicion të verifikuesit të akredituar planin e marrjes së mostrave për qëllime të verifikimit.

3 Operatori i instalimit, në marrëveshje me laboratorin që kryen analizën për lëndën djegëse ose materialin përkatës dhe me kusht marrjen e miratimit nga AKM-ja, përshtat elementet e planit të marrjes së mostrave, nëse rezultatet e analizave tregojnë se uniformiteti i lëndës djegëse ose materialit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga të dhënat e uniformitetit, mbi të cilat ishte hartuar plani fillestar i marrjes së mostrave për atë lëndë djegëse ose material specifik.

Neni 34
Përdorimi i laboratorëve

1. Operatori i instalimit siguron që laboratorët e përdorur për të kryer analizat për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes janë të akreditуar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025, për metodat analitike përkatëse.

2. Laboratorët që nuk janë të akreditуar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 mund të përdoren për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes vetëm kur operatori i instalimit mund t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se aksesi në laboratorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni është teknikisht i pamundur ose do të shkaktonte kosto të paarsyeshme dhe se laboratori i pa akreditуar plotëson kërkesat të barasvlershme me standardin EN ISO/IEC 17025.

3. AKM konsideron se një laborator plotëson kërkesat e barasvlershme me standardin EN ISO/IEC 17025 sipas kuptimit të pikës 2 të këtij neni, kur operatori i instalimit paraqet, për aq sa është e mundur, në të njëjtën formë dhe me një nivel hollësie të ngjashëm me atë të kërkuar për procedurat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, provat e mëposhtme:

a) Në lidhje me menaxhimin e cilësisë, operatori i instalimit paraqet certifikatën e akreditimit të laboratorit në përputhje me standardin EN ISO/IEC 9001, ose sisteme të tjera të menaxhimit të cilësisë të certifikuara të laboratorit. Në mungesë të këtyre sistemeve të certifikuara të menaxhimit të cilësisë, operatori i instalimit duhet të paraqesë prova të tjera të përshtatshme që vërtetojnë se laboratori është në gjendje të menaxhojë personelin, procedurat, dokumentet dhe detyrat e tij në mënyrë të besueshme.

b) Në lidhje me aftësinë teknike, operatori i instalimit paraqet prova që dëshmojnë se laboratori është i kualifikuar dhe i aftë të prodhojë rezultate teknikisht të vlefshme duke përdorur procedurat analitike përkatëse. Këto prova duhet të mbulojnë të paktën elementet e mëposhtme:

i) vërtetimin se personeli i laboratorit zotëron aftësitë, njohuritë dhe trajnimin e nevojshëm për detyrat specifike që u janë caktuar;

ii) përshtatshmërinë e hapësirave fizike dhe kushteve mjedisore;

iii) përshtatshmërinë e përzgjedhjes së metodave analitike dhe standardeve përkatëse;

iv) kur është e zbatueshme, menaxhimin e marrjes së mostrave dhe përgatitjen e mostrave, duke përfshirë kontrollin e integritetit të mostrës;

v) kur është e zbatueshme, zhvillimin dhe validimin e metodave të reja analitike ose zbatimin e metodave që nuk mbulohen nga standardet ndërkombëtare ose kombëtare;

vi) vlerësimin e pasigurisë;

vii) menaxhimin e pajisjeve, përfshirë procedurat për kalibrimin, përshtatjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve si dhe mbajtjen e regjistrave në lidhje me këto pajisje;

viii) menaxhimin dhe kontrollin e të dhënave, dokumenteve dhe programeve kompjuterike;

ix) menaxhimin e elementeve të kalibrimit dhe materialeve të referencës;

x) sigurimin e cilësisë së kalibrimit dhe rezultateve të testimit, përfshirë pjesëmarrjen e rregullt në skema të testimit të aftësisë, zbatimin e metodave analitike mbi materiale referente të certifikuara ose krahasimin ndërlaboratorik me një laborator të akreditуar;

xi) menaxhimin e proceseve të deleguara për t'u kryer nga të tretët;

xii) menaxhimin e detyrave të marrë përsipër, të ankesave të klientëve dhe garantimin e ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese në kohë të shpejtë.

Neni 35
Shpeshtësia e kryerjes së analizave

1. Operatori i instalimit kryen analizat e lëndëve djegëse dhe materialeve përkatëse, duke respektuar shpeshtësinë minimale të përcaktuar në shtojcën VII të kësaj rregulloreje.

2. AKM-ja mund t'i lejojë operatorit të instalimit të përdorë një shpeshtësi të ndryshme nga ajo e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në rastet kur shpeshtësitë minimale nuk janë të disponueshme ose kur operatori i instalimit dëshmon se është verifikuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur, duke u bazuar te të dhëna historike, përfshirë te vlerat analitike të lëndëve djegëse ose materialeve përkatëse në periudhën e raportimit paraardhëse të periudhës aktuale të raportimit, çdo ndryshim në vlerat analitike të lëndës djegëse ose materialit përkatës nuk tejkalon 1/3 e vlerës së pasigurisë, së cilës operatori i instalimit duhet t'i përmbahet për përcaktimin e të dhënave të aktivitetit për lëndën djegëse ose materialin përkatës;

b) kur përdorimi i shpeshtësisë së kërkuar do të shkaktonte kosto të paarsyeshme.

3. Kur një instalim funksionon vetëm një pjesë të vitit, ose kur lëndët djegëse ose materialet furnizohen në sasi (lote), që konsumohen përgjatë më shumë se një viti kalendarik, AKM-ja mund të bjerë dakord me operatorin e instalimit për përcaktimin e një kalendari më të përshtatshëm të analizave, me kusht që ai të sigurojë një nivel pasigurie të barasvlershme me atë të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni.

NËNSEKSIONI 4
FAKTORËT SPECIFIKË TË LLOGARITJES

Neni 36
Faktorët e shkarkimit për CO_2

1. Operatori i instalimit për shkarkimet e CO_2 përcakton faktorët specifikë të shkarkimit për aktivitetet e ndryshme.

2. Faktorët e shkarkimit të lëndëve djegëse, përfshirë ato që përdoren si lëndë hyrëse gjatë procesit, shprehen si t CO_2/TJ. Për shkarkimet e krijuara nga djegia, AKM-ja mund t'i lejojë operatorit të instalimit përdorimin e një faktori shkarkimi të ndryshëm për një lëndë djegëse, konkretisht të shprehur në t CO_2/t ose në t CO_2/Nm^3, kur përdorimi i një faktori shkarkimi të shprehur në t CO_2/TJ sjell kosto të paarsyeshme; ose kur përdorimi i faktorit të ndryshëm të shkarkimit lejon llogaritjen e shkarkimeve me një saktësi të paktën të barasvlershme me faktorin e shkarkimit të shprehur në t CO_2/TJ.

3. Për të kryer konvertimin e përmbajtjes së karbonit në vlerën përkatëse të faktorit të shkarkimit të CO_2 ose anasjelltas, operatori i instalimit përdorë faktorin 3,664 t CO_2/t C.

Neni 37
Faktorët e oksidimit dhe të konvertimit

1. Për të përcaktuar faktorët e oksidimit ose të konvertimit, operatori i instalimit përdor të paktën, shkallën metodologjike 1. Operatori i instalimit përdorë një vlerë të barabartë me 1 për faktorin e oksidimit ose për faktorin e konvertimit, kur faktori i shkarkimit përfshin efektin e oksidimit ose konvertimit të paplotë. Megjithatë, AKM-ja mund të kërkojë që operatorët e instalimit të përdorin gjithmonë shkallën metodologjike 1.

2. Kur brenda një instalimi përdoren disa lëndë djegëse dhe për faktorin specifikë të oksidimit kërkohet përdorimi i shkallës metodologjike 3, operatori i instalimit mund t'i kërkojë AKM-së miratimin e një ose dy nga alternative të mëposhtme:

a) përcaktimin e një faktori të oksidimit të përbashkët për të gjithë procesin e djegies dhe zbatimin e tij për të gjitha lëndët djegëse;

b) caktimin e oksidimit jo të plotë vetëm për një rrymë shkarkimi të madhe dhe përdorimi i vlerës 1 si faktor oksidimi për rrymat e tjera të shkarkimit.

3. Në rastet kur përdoren lëndë djegëse të përziera, operatori i instalimit duhet të vërtetojë se zbatimi i parashikimeve në shkronjat "a" ose "b", të pikës 2, të këtij neni, nuk sjell si pasojë nënvlerësim e shkarkimeve.

NËNSEKSIONI 5
TRAJTIMI I BIOMASËS, LËNDËVE DJEGËSE SINTETIKE ME KARBON TË ULËT, RFNBO-së DHE RCF-së

Neni 38
Rrymat e shkarkimit nga biomasa

1. Operatori i instalimit përcakton të dhënat e aktivitetit të një rryme shkarkimi nga karboni me normë zero, pa përdorur shkallët metodologjike dhe pa paraqitur prova analitike lidhur me përmbajtjen e karbonit me normë zero, nëse kjo rrymë shkarkimi përbëhet ekskluzivisht nga karbon me normë zero dhe operatori i instalimit garanton që ajo nuk është e ndotur nga materiale ose nga lëndë djegëse të tjera.

2. Faktori i shkarkimit i çdo lënde djegëse ose materiali llogaritet dhe raportohet si faktori paraprak i shkarkimit, i përcaktuar në përputhje me nenin 30 të kësaj rregulloreje, i shumëzuar me fraksionin fosil të lëndës djegëse ose të materialit.

3. Torfa, linjit drunor dhe fraksionet fosile të lëndëve djegëse ose të materialeve të përziera nuk konsiderohen si biomasë.

4. Kur fraksioni i biomasës me normë zero i lëndëve djegëse ose i materialeve të përziera është i barabartë ose më i lartë se 97%, ose kur, për shkak të nivelit të shkarkimeve të lidhura me fraksionin fosil të lëndës djegëse ose materialit, ai kualifikohet si një rrymë shkarkimi minimale, AKM-ja mund t'i

lejojë operatorit që, për përcaktimin e të dhënave të aktivitetit dhe faktorëve përkatës të llogaritjes, të zbatojë metodologji të ndryshme nga ato të parashikuara në shkallët metodologjike, përfshirë metodën e bilancit energjetik.

5. Në mënyrë që biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës të llogariten si pjesë e fraksionit të biomasës me normë zero të një rryme shkarkimi, ato duhet të përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtimet e mëposhtme:

a) biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa të prodhuara nga mbetjet dhe tepricat, të ndryshme nga tepricat bujqësore, të akuakulturës, të peshkimit dhe të pylltarisë, duhet të përmbushin vetëm kriteret specifike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Kjo vlen gjithashtu për mbetjet dhe tepricat që fillimisht përpunohen në një produkt, përpara se të përpunohen më tej në biokarburante, biolëngje ose lëndë djegëse nga biomasës.

b) energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja që prodhohen nga mbetjet e ngurta urbane nuk u nënshtrohen kritereve specifike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

6. Për zbatimin e kritereve specifike në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe të përmendura në pikën 5 më sipër, vlejnë parashikimet e mëposhtme:

a) instalimi, ndaj të cilit zbatohen kriteret specifike të përmendura në pikën 5 më sipër është instalimi i përkufizuar në pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

b) kriteret specifike të përmendura në pikën 5 më sipër zbatohen pavarësisht origjinës gjeografike të biomasës;

c) Përputhshmëria me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, vlerësohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë dhe me llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Kriteret mund të konsiderohen gjithashtu të përmbushura, nëse operatori i instalimit paraqet prova se ka blerë një sasi biokarburanti, biolëngu ose lëndë djegëse me bazë biomasën që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001 ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast të mosrespektimit të mëvonshëm lidhur me provën e qëndrueshmërisë së sasive të anuluara në bazat e të dhënave të përmendura, AKM-ja korrigjon shkarkimet e verifikuara në përputhje me rrethanat. Nëse biomasa e përdorur nuk përputhet me parashikimet e mësipërme, përmbajtja e saj e karbonit do të konsiderohet si karbon fosil.

7. Kur kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë me efekt për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi nuk zbatohen për biomasën, sipas përcaktimeve të pikave 5 e 6, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, fraksioni i biomasës me normë zero është i barasvlershëm me fraksionin e tij të biomasës.

Neni 39

Përcaktimi i fraksionit të biomasës dhe fraksionit fosil

1. Për lëndët djegëse ose materialet, që përmbajnë biomasë, operatori i instalimit mund të konsiderojë se shtojca e biomasës është 0 dhe të zbatojë një fraksion standard të biomasës prej 0%, ose të përcaktojë fraksionin e biomasës, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, duke zbatuar shkallën metodologjike të përcaktuara në seksionin 2.4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

2. Kur, në përputhje me shkallën metodologjike të zbatuar, operatorit të instalimit i duhet të kryejë

analiza për të përcaktuar përqindjen e biomasës, ai duhet t'i kryejë këto analiza mbi bazën e standardit të zbatueshëm dhe duke përdorur metodat analitike të përcaktuara brenda atij standardi, me kusht që përdorimi i atij standardi dhe i metodave analitike përkatëse të miratohen nga AKM-ja.

3. Kur, në përputhje me shkallën metodologjike të zbatuar, operatorit të instalimit i duhet të kryejë analiza për të përcaktuar përqindjen e biomasës, por zbatimi i pikës 2 të këtij neni është teknikisht i pazbatueshëm ose do të sillte kosto të paarsyeshme, operatori i instalimit duhet t'i paraqesë AKM-së për miratim një metodë alternative vlerësimi për përcaktimin e përqindjes së biomasës. Për lëndët djegëse ose për materialet që burojnë nga një proces prodhimi, ku është e mundur të përcaktohen dhe të gjurmohen rrymat që hyjnë në proces, operatori i instalimit mund ta bazojë vlerësimin mbi bilancin material të karbonit fosil dhe të karbonit të biomasës që hyn dhe del nga procesi.

4. Në përjashtim nga parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe të parashikimeve të nenit 30 të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit nuk duhet të përdorë analiza ose metoda vlerësimi në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni për të përcaktuar përqindjen e biomasës së gazit natyror të marrë nga një rrjet gazi në të cilin është shtuar biogaz. Përjashtimi i parashikuar në këtë nen nuk zbatohet në rastet kur zbatohet pika 10, e nenit 44, të kësaj rregulloreje.

5. Operatori i instalimit mund të vendosë që një sasi e caktuar e gazit natyror nga rrjeti i gazit të konsiderohet si biogaz me normë zero, duke përdorur metodologjinë e përcaktuar në pikën 6 të këtij neni. Në këtë rast, në përjashtim nga parashikimet e nenit 30(3) të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit duhet ta konsiderojë fraksionin e biomasës si të barabartë me fraksionin e biomasës me normë zero.

6. Operatori i instalimit mund të përcaktojë fraksionin e biomasës dhe shtojcën identike të biomasës me normë zero të biogazit, duke përdorur të dhënat e blerjes së biogazit me përmbajtje energjetike ekuivalente, me kusht që operatori i instalimit të paraqesë provat e mëposhtme, që konsiderohen të mjaftueshme nga AKM-ja:

a) provën se e njëjta sasi biogazi nuk numërohet dy herë, dhe veçanërisht se nuk ka pretendime që biogazi i blerë përdoret nga ndonjë palë tjetër, edhe nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së garancisë së origjinës, sipas përkufizimit të nenit 3(13) të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme";

b) provën se operatori i instalimit dhe prodhuesi i biogazit janë të lidhur në të njëjtin rrjet gazi.

7. Për të provuar përputhshmërinë me pikën 6 të këtij neni, operatori i instalimit mund të përdorë të dhënat e regjistruara në një bazë të dhënash shqiptare ose në një bazë të dhënash të ngritur nga një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, që mundëson gjurmimin e transferimeve të biogazit. Përputhshmëria me pikën 6 të këtij neni mund të konsiderohet e vërtetuar nëse operatori i instalimit paraqet prova për blerjen e një sasie biogazi që është regjistruar dhe shënuar si e përdorur (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian, për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001, ose në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara.

Neni 40

Përcaktimi i fraksionit të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët dhe të fraksionit të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët me normë zero

1. Për lëndët djegëse ose materialet që përmbajnë RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me përmbajtje të ulët karboni, për të cilat operatori i instalimit nuk është në gjendje të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së, e RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, operatori i instalimit konsidero se RFNBO, RFC ose lënda djegëse sintetike me karbon të ulët mungojnë dhe zbaton një fraksion standard të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët prej 0%.

2. Operatori i instalimit, përcakton faktorët e mëposhtëm të llogaritjes që lidhen me përbërjen e lëndëve djegëse, duke u bazuar në bilancin e masës,

që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi:

i) fraksionin me normë zero të RFNBO-së ose të RCF-së ose fraksionin me normë-zero të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët;

ii) fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së, ose fraksionin sintetik me karbon të ulët.

3. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 2 më sipër, nëse operatori i instalimit nuk dëshiron të përdorë normën zero, mund të përdoren metoda të tjera për fraksionin RFNBO ose RCF, apo për fraksionin sintetik me karbon të ulët, si p.sh. bilanci material i procesit të përzierjes ose i procesit të prodhimit nga i cili është nxjerrë lënda djegëse ose materiali.

4. Përmbajtja e karbonit e lëndëve djegëse që kategorizohen si RFNBO ose RCF, që janë në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jo biologjike dhe lëndët djegëse me bazë karboni të ricikluara të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, konsiderohen me normë zero.

5. Përputhshmëria me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi vlerësohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë dhe me llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Këto kritere mund të konsiderohen të përmbushura edhe nëse operatori i instalimit paraqet prova për blerjen e një sasie RFNBO ose RCF, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të Dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të Direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara. Kur RFNBO ose RCF nuk i përmbush kriteret e përmendura në pikën 4 më sipër, përmbajtja e karbonit e RFNBO ose RCF do të konsiderohet si karbon fosil.

6. Lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët do të trajtohen si me normë zero, kur përmbajtja e tyre e karbonit i është nënshtruar paraprakisht pagesës së detyrimeve për karbonin sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi ose sipas rastit, përmbajtja e karbonit i është nënshtruar paraprakisht detyrimeve të raportimit kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi , përveçse në rastet kur karboni i kapur konsiderohet si karbon me normë zero, sipas përkufizimit në nenin 3 (56) të kësaj rregulloreje.

7. Përputhshmëria me kriteret e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe për lëndët djegëse të ricikluara me bazë karboni vlerësohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe për llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Këto kritere mund të konsiderohen gjithashtu të përmbushura nëse operatori i instalimit paraqet prova për blerjen e një sasie të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara. Në të gjitha rastet e tjera, përmbajtja e karbonit e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët do të konsiderohet si karbon fosil.

8. Operatori i instalimit mund të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së duke e konsideruar si identike me fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së me normë zero të gazit natyror, kur këto fraksione janë injektuar në një rrjet të gazit natyror, duke përdorur të dhënat e blerjes së RFNBO-së ose RCF-së me përmbajtje energjetike ekuivalente, me kusht që operatori i instalimit të paraqesë provat e mëposhtme, që konsiderohen të mjaftueshme nga AKM-ja:

a) provën se e njëjta sasi RFNBO ose RFC nuk numërohet dy herë, dhe veçanërisht se nuk ka pretendime që RFNBO ose RFC e blerë përdoret nga ndonjë palë tjetër, edhe nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së garancisë së origjinës, sipas përkufizimit të nenit 3 (13) të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

b) provën se operatori i instalimit dhe prodhuesi i RFNBO-së ose RFC-së janë të lidhur në të njëjtin rrjet gazi.

9. Përputhshmëria me parashikimet e pikës 8 më sipër mund të konsiderohet e vërtetuar, nëse operatori i instalimit paraqet prova të blerjes së një sasie RFNBO ose RCF në formë të gaztë që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të dhënave të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara.

SEKSIONI 3
METODOLOGJIA E BAZUAR NË MATJE

Neni 41
Përdorimi i metodologjisë së monitorimit të bazuar në matje

1. Operatori i instalimit përdor metodologjinë e bazuar në matje për të gjitha shkarkimet e oksidit të azotit (N_2O), siç parashikohet në shtojcën IV të kësaj rregulloreje dhe për të përcaktuar sasinë e CO_2 të transferuar, në përputhje me nenin 50 të kësaj rregulloreje.

2. Për më tepër, operatori i instalimit mund të përdorë metodologjitë e bazuara në matje për burimet e shkarkimit të CO_2, në rast se vërteton se për secilin burim shkarkimi respektohen shkallët metodologjike të kërkuara sipas nenit 42.

Neni 42
Shkalla metodologjike e zbatueshme

1. Për çdo burim shkarkimi të madh, operatori i instalimit zbaton rregullat e mëposhtme:

a) në rastin e një instalimi të kategorisë A, zbaton të paktën shkallët metodologjike të përcaktuara në seksionin 2 të shtojcës VIII të kësaj rregulloreje;

b) në raste të tjera, zbaton shkallën metodologjike më të lartë të renditur në seksionin 1, të shtojcës VIII, të kësaj rregulloreje.

2. Megjithatë, operatori i instalimit, për instalimet e kategorisë C mund të zbatojë një shkallë metodologjike një nivel më të ulët se sa kërkohet në përputhje me pikën 1 të këtij neni dhe për instalimet e kategorisë A dhe B një shkallë metodologjike deri në dy nivele më të ulëta, por duke zbatuar minimalisht shkallën metodologjike 1, kur i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme, që vërtetojnë se shkalla metodologjike e kërkuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni nuk është teknikisht e realizueshme ose sjell kosto të pajustifikueshme.

3. Për shkarkimet nga burime shkarkimi të vogla, operatori i instalimit mund të zbatojë një shkallë metodologjike një nivel më të ulët se sa kërkohet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, por duke zbatuar minimalisht shkallën metodologjike 1, kur i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme, që vërtetojnë se shkalla metodologjike e kërkuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni nuk është teknikisht e realizueshme ose sjell kosto të pajustifikueshme.

Neni 43
Standardet dhe laboratorët e matjes

1. Të gjitha matjet do të kryhen duke zbatuar metoda e mëposhtme:

a) standardin EN 14181 (Shkarkimet nga burimet e palëvizshme - Sigurimi i cilësisë së sistemeve matëse të automatizuara);

b) standardin EN 15259 (Cilësia e ajrit - Matja e shkarkimeve nga burimet e palëvizshme - Kërkesat për seksionet dhe vendet e matjes si dhe për objektivin, planin dhe raportin e matjes;
c) standarde të tjera EN të nevojshme sipas rastit, në veçanti standardi EN ISO 16911-2 (Shkarkimet nga burimet e palëvizshme - Përcaktimi manual dhe automatik i shpejtësisë dhe të normës së vëllimit të fluksit të gazeve në tubacione).

2. Kur standardet e mësipërme nuk janë të disponueshme, metodat bazohen në standarde të përshtatshme ISO, në standarde të publikuara nga Komisioni Evropian ose në standarde kombëtare. Aty ku nuk ekzistojnë standarde të zbatueshme të publikuara, do të përdoren standarde të përshtatshme të hartuara që nuk janë miratuar ende, udhëzime të praktikave më të mira të industrisë ose metodologji të tjera të provuara shkencërisht, që zvogëlojnë mundësitë e gabimeve në marrjen e mostrave dhe kryerjen e matjeve.

3. Operatori i instalimit siguron funksionimin e saktë dhe të besueshëm të sistemit të matjes së vazhdueshme, duke përfshirë zgjedhjen e vendndodhjes së përshtatshme të pajisjeve, kryerjen e kalibrimit, zbatimin e procedurave të matjes dhe vendosjen e mekanizmave të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë.

4. Operatori i instalimit sigurohet që laboratorët që kryejnë matjet, kalibrimin dhe vlerësimin e pajisjeve përkatëse të sistemeve të matjes së vazhdueshme të shkarkimeve (CEMS) janë të akredituara në përputhje me EN ISO/IEC 17025 për metodat analitike ose aktivitetet e kalibrimit përkatëse. Kur laboratori nuk ka një akreditim të tillë, operatori i instalimit sigurohet që përmbushen kërkesat e barasvlershme të pikave 2 e 3, të nenit 34.

Neni 44
Përcaktimi i shkarkimeve

1. Operatori i instalimit llogarit shkarkimet vjetore nga një burim shkarkimi gjatë periudhës së raportimit, duke mbledhur të gjitha vlerat e përqendrimit të gazit me efekt serrë të matura në çdo orë për të gjithë periudhën e raportimit dhe duke i shumëzuar ato me vlerat e fluksit të gazeve të çliruara nga djegia të matura në çdo orë, ku vlerat për çdo orë do janë mesataret e të gjitha rezultateve të matjeve individuale të kryera gjatë orës përkatëse të funksionimit.

2. Në rastin e shkarkimeve të CO_2, operatori i instalimit përcakton shkarkimet vjetore bazuar në ekuacionin 1 të shtojcës VIII të kësaj rregulloreje. CO e shkarkuar në atmosferë do të trajtohet si masa molare e barasvlershme e CO_2. Në rastin e oksidit të azotit (N_2O), operatori i instalimit përcakton shkarkimet vjetore bazuar në ekuacionin e nënseksionit B.1 të seksionit 16 të shtojcës IV të kësaj rregulloreje.

3. Kur brenda një instalimi ka disa burime shkarkimesh dhe nuk mund të maten si një burim i vetëm shkarkimi, operatori i instalimit mat shkarkimet për çdo burim shkarkimi veçmas dhe mbledh rezultatet e secilës matje për të për të përftuar vlerën e shkarkimeve totale të gazit në fjalë gjatë periudhës së raportimit.

4. Operatori i instalimit përcakton përqendrimin e gazit me efekt serrë që gjendet në fluksin e gazeve të çliruara nga djegia, nëpërmjet matjeve të vazhdueshme të kryera në një pikë të përshtatshme për matjen, me një nga mënyrat e mëposhtme:

a) matje direkte;

b) në rast se në fluksin e gazeve të çliruara nga djegia ka një përqendrimit të lartë, përqendrimi llogaritet duke përdorur një matje indirekte të përqendrimit nëpërmjet ekuacionit 3 në Shtojcën VIII të kësaj rregulloreje dhe duke marrë parasysh vlerat e matura të përqendrimit të të gjithë përbërësve të tjerë të fluksit të gazit siç përcaktohet në planin e monitorimit të operatorit të instalimit.

5. Kur është e nevojshme, operatori i instalimit përcakton veçmas çdo sasi të CO_2 që buron nga biomasa dhe për këtë qëllim ai mund të përdorë metodat e mëposhtme:

a) një qasje të bazuar në llogaritje, përfshirë qasjet që përdorin analiza dhe marrjen e mostrave të bazuara në standardin EN ISO 13833 (Shkarkimet e burimeve të palëvizshme — Përcaktimi i raportit të biomasës (biogjenike) dhe dyoksidit të karbonit që rrjedh nga fosilet — Marrja dhe përcaktimi i mostrave të radiokarbonit);

b) një metodë tjetër të bazuar në standardin specifik përkatës, përfshirë standardin ISO 18466 (Shkarkimet e burimeve të palëvizshme - Përcaktimi i fraksionit biogjen në CO_2 në gazin e oxhakut duke përdorur metodën e bilancit);

c) një metodë vlerësimi të publikuar nga Komisioni Evropian.

6. Kur metoda e propozuar nga operatori i instalimit përfshin marrjen e vazhdueshme të

mostrave nga fluksi i gazeve të çliruara nga djegia, zbatohet standardi EN 15259 (Cilësia e ajrit - Matja e shkarkimeve të burimeve të palëvizshme - Kërkesat për seksionet dhe vendet e matjes si dhe për objektivin, planin dhe raportin e matjes). Plani i marrjes së mostrave sipas nenit 33 të kësaj rregulloreje duhet të jetë në përpjesëtim me shpeshtësinë e analizave në përputhje me Shtojcën VII të kësaj rregulloreje dhe të garantojë se është përfaqësuese për të mbuluar të gjithë vitin e raportimit. Për qëllimin e kësaj pike zbatohen pikat 5, 6 e 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje.

7. Kur metoda e propozuar nga operatori i instalimit përfshin marrjen e vazhdueshme të mostrave nga fluksi i gazeve të çliruara nga djegia dhe instalimi konsumon gaz natyror nga rrjeti i gazit, operatori i instalimit zbret shumën e CO_2 që krijohet nga çdo biogaz që përmban gazi natyror nga shkarkimet totale të matura të CO_2. Shtojca e biomasës së gazit natyror do të përcaktohet në përputhje me parashikimet e neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje.

8. Operatori i instalimit përdor fraksionin e biomasës të përcaktuar në përputhje me pikat 5, 6 dhe 7 të këtij neni, si fraksion të biomasës me normë zero, nëse për të gjitha lëndët djegëse ose materialet që krijojnë shkarkime për të cilat zbatohet metodologjia e bazuar në matje, plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) nuk zbatohen kriteret e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, sipas parashikimit të pikave 5 dhe 6, të nenit 38, të kësaj rregulloreje; ose

ii) 100% e fraksionit të biomasës së lëndës djegëse ose materialit të përdorur mbulohet nga provat e nevojshme sipas pikave 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje. Ky kusht konsiderohet i përmbushur kur biogazi monitorohet në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 39, të kësaj rregulloreje.

9. Kur kushtet e parashikuara në nënndarjet "i" dhe "ii", të pikës 8, të këtij neni, nuk plotësohen për lëndët djegëse ose materialet që çojnë në shkarkime për të cilat zbatohet metodologjia e bazuar në matje, operatori i instalimit për këto lëndë djegëse ose materiale përcakton fraksionin e biomasës me normë zero, duke përdorur një qasje të bazuar në llogaritje, në përputhje me nenet 24 deri në 40 të kësaj rregulloreje.

10. Operatori i instalimit mund të zbresë nga shuma totale e shkarkimeve të burimit të shkarkimit sasinë e shkarkimeve nga biomasa me normë zero, të përcaktuar në përputhje me pikën 8 dhe 9 të këtij neni. Në rast se metoda e propozuar nga operatori i instalimit për përcaktimin e fraksionit të biomasës me normë zero përfshin marrjen e vazhdueshme të mostrave nga fluksi i gazeve të çliruara nga djegia dhe kur instalimi konsumon gaz natyror nga rrjeti i gazit, operatori i instalimit duhet të përcaktojë sasinë fizike të CO_2 që krijohet nga përdorimi i biogazit, në përputhje me parashikimet e neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje, dhe të zbresë sasinë përkatëse të CO_2 nga CO_2 me normë zero, që përcaktohet në përputhje me pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

11. Kur operatori i instalimit përdor RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, në një proces për të cilin zbatohet metodologjia e bazuar në matje, operatori i instalimit mund të zbresë nga shkarkimet totale shkarkimet nga RFNBO, RCF ose nga lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero. Shkarkimet nga RFNBO, RCF ose nga lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero përcaktohen duke përdorur një qasje të bazuar në llogaritje në përputhje me parashikimet e neneve 24 deri në 40 të kësaj rregulloreje. Ato duhet të jenë të barabarta me të dhënat e aktivitetit të lëndës djegëse përkatëse të shumëzuar me faktorin paraprak të shkarkimit dhe me fraksionin RFNBO ose RCF me normë zero ose me fraksionin sintetik me nivel të ulët karboni me normë zero.

12. Me qëllim kryerjen e llogaritjes në përputhje me parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, operatori i instalimit përcakton fluksin e gazeve të çliruara nga djegia me një nga metodat e mëposhtme:

a) llogaritjen përmes një bilanci material të përshtatshëm, duke marrë parasysh të gjithë parametrat e rëndësishëm që hyjnë në proces, përfshirë, për shkarkimet e CO_2, të paktën sasitë e materialeve dhe sasinë e ajrit që hyjnë në proces dhe efikasitetin e procesit, ndërsa në dalje të procesit, duke përfshirë të paktën prodhimin e nxjerrë nga procesi dhe nivelet e përqendrimit të oksigjenit (O_2), dyoksidit të squfurit (SO_2) dhe oksideve të azotit (NO_x);

b) përcaktim përmes matjes së vazhdueshme të fluksit në një pikë të përshtatshme përfaqësuese.

Neni 45
Grumbullimi i të dhënave

1. Operatori i instalimit llogarit mesataret orare për çdo parametër, përfshirë përqendrimet dhe fluksin e gazeve të çliruara nga djegia, që janë të rëndësishme për përcaktimin e shkarkimeve ose të sasisë së CO_2 të transferuar, duke zbatuar një metodologji të bazuar në matje dhe duke përdorur të gjitha pikat e matjes së të dhënave të disponueshme gjatë asaj ore. Kur operatori i instalimit ka mundësi të gjenerojë të dhëna për periudha reference më të shkurtra pa kosto shtesë, operatori i instalimit i përdor këto periudha për të përcaktuar shkarkimet vjetore, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 44, të kësaj rregulloreje.

2. Kur pajisjet e matjes së vazhdueshme të një parametri janë jashtë kontrollit, jashtë diapazonit të matjes ose jashtë funksionimit për një pjesë të orës ose të periudhës së referencës të përmendur në pikën 1 të këtij neni, operatori i instalimit duhet të llogarisë mesataren orare përkatëse në mënyrë proporcionale, duke u mbështetur te pikët e mbetura të matjes së të dhënave për atë orë ose periudhë më të shkurtër reference, me kusht që të jenë të disponueshme të paktën 80% e numrit maksimal të pikëve të matjes së të dhënave për atë parametër. Parashikimet e pikave 2 deri në 4, të nenit 46 të kësaj rregulloreje, zbatohen nëse janë të disponueshme më pak se 80% e numrit maksimal të pikëve për matjen e të dhënave të një parametri.

Neni 46
Mungesa e të dhënave

1. Kur një pjesë e pajisjes matëse brenda një sistemi të matjes së vazhdueshme të shkarkimeve (CEMS) është jashtë funksionimit për më shumë se pesë ditë rresht të një viti kalendarik, operatori i instalimit duhet të informojë AKM-në pa vonesë dhe të propozojë masat e duhura për të përmirësuar cilësinë e CEMS-së në fjalë.

2. Kur, për një ose më shumë parametra të metodologjisë së bazuar në matje, nuk mund të sigurohen të dhëna të vlefshme gjatë një ore të plotë ose gjatë një periudhe më të shkurtër reference, në përputhje me pikën 1, të nenit 45, të kësaj rregulloreje, për shkak se pajisja ka dalë jashtë kontrollit, jashtë diapazonit të matjes ose jashtë funksionit, operatori i instalimit duhet të përcaktojë vlera zëvendësuese për çdo orë të munguar të të dhënave.

3. Kur për një parametër që matet drejtpërdrejt si përqendrim nuk mund të sigurohen të dhëna të vlefshme gjatë një ore të plotë ose gjatë një periudhe më të shkurtër reference, operatori i instalimit llogarit një vlerë zëvendësuese si shumën e një përqendrimi mesatar dhe dyfishit të devijimit standard të lidhur me atë mesatare, duke përdorur ekuacionin 4 të parashikuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje. Kur, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme teknike në instalim, nuk mund të përdoret periudha e raportimit për përcaktimin e këtyre vlerave zëvendësuese, operatori i instalimit duhet të bjerë dakord me AKM-në për të zgjedhur një periudhë kohore përfaqësuese për përcaktimin e mesatares dhe devijimit standard, mundësisht me kohëzgjatje njëvjeçare.

4. Kur për një parametër të ndryshëm nga përqendrimi nuk mund të sigurohen të dhëna të vlefshme gjatë një ore të plotë, operatori i instalimit përcakton vlerat zëvendësuese të atij parametri përmes një modeli të përshtatshëm të bilancit të masës ose të bilancit energjetik të procesit. Operatori i instalimit verifikon vlefshmërinë e rezultateve duke përdorur parametrat e tjerë të matur të metodologjisë së bazuar në matje dhe të dhënat e mbledhura në kushte të rregullta pune, duke marrë në konsideratë një periudhë kohe që ka të njëjtën kohëzgjatje si periudha kohës në të cilën u verifikua mungesa e të dhënave.

Neni 47
Konfirmimi i rezultateve përmes llogaritjes së shkarkimeve

Operatori i instalimit konfirmon rezultatet e shkarkimeve të përcaktuara përmes një metodologjie të bazuar në matje, duke llogaritur shkarkimet vjetore të secilit gaz me efekt serrë përkatës për të njëjtat burime shkarkimi dhe rryma shkarkimi, me përjashtim të shkarkimeve të N_2O nga prodhimi i acidit nitrik dhe të gazeve me efekt serrë të transferuara në një infrastrukturë transporti të CO_2 ose në një vend depozitim. Nuk është i detyrueshëm përdorimi i metodologjive, që bazohen te shkalla metodologjike.

SEKSIONI 4
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 48
Instalimet me shkarkime të ulëta

1. AKM-ja mund të lejojë operatorin e instalimit të paraqesë një plan monitorimi të thjeshtuar, në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje, me kusht që instalimi i operuar prej tij është një instalim me shkarkime të ulëta. Ky rregull nuk zbatohet për instalimet që kryejnë aktivitete në të cilat përfshihet N_2O, në përputhje me shtojcën II, pjesa A, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

2. Konsiderohet instalim me shkarkime të ulëta, për qëllimet e pikës 1 më sipër, një instalim që përmbush të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) shkarkimet mesatare vjetore të instalimit, të raportuara me anë të raporteve të shkarkimit të verifikuara, gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit , kanë qenë më pak se 25 000 tonë CO_2(e) në vit, llogari që kryhet duke përjashtuar CO_2, që krijohet nga karboni me normë zero por pa zbritur CO_2 e transferuar;

b) shkarkimet mesatare vjetore të përmendura në shkronjën "a" më sipër nuk janë të disponueshme ose nuk janë më të zbatueshme për shkak të ndryshimeve të kufijve të instalimit ose të ndryshimeve të kushteve të funksionimit të instalimit, por shkarkimet vjetore të atij instalimi për pesë vitet e ardhshme, bazuar në një metodë vlerësimi konservative, do të jenë më pak se 25 000 tonë CO_2(e) në vit, llogari që kryhet duke përjashtuar CO_2 që krijohet nga karboni me normë zero por para zbritjes së CO_2 të transferuar.

3. Operatori i një instalimi me shkarkime të ulëta nuk detyrohet të paraqesë dokumentet mbështetëse të përmendura në pikën 3, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, dhe përjashtohet nga detyrimi për paraqitjen e një raporti përmirësimi, siç parashikohet në pikat 7, 8 dhe 9, të nenit 76, të kësaj rregulloreje, në përgjigje të rekomandimeve për përmirësim të raportuara nga verifikuesi i akredituar në raportin e verifikimit.

4. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 27 të kësaj rregulloreje, operatori i një instalimi me shkarkime të ulëta mund të përcaktojë sasinë e lëndës djegëse ose të materialit, duke përdorur të dhënat e disponueshme dhe të dokumentuara të blerjeve dhe vlerësimet në lidhje me ndryshimet e stokut. Operatori i instalimit përjashtohet gjithashtu nga detyrimi për t'i paraqitur AKM-së vlerësimin e pasigurisë të përmendur në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 28, të kësaj rregulloreje.

5. Operatori i një instalimi me shkarkime çlirohet nga detyrimi i parashikuar në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 28, të kësaj rregulloreje, për të përfshirë në vlerësimin e pasigurisë, pasigurinë që lidhet me ndryshimet e stokut.

6. Si përjashtim nga rregullat e parashikuara në nenet 26, pikat 1, 2 dhe 3, dhe 42, pikat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, operatori i një instalimi me shkarkime të ulëta mund të zbatojë, të paktën shkallën metodologjike 1, për të përcaktuar të dhënat e aktivitetit dhe faktorët e llogaritjes të të gjitha rrymave të shkarkimit, si dhe për përcaktimin e shkarkimeve me metoda të bazuara në matje, përveçse kur arritja e një saktësie më të lartë është e mundur pa përpjekje shtesë për operatorin e instalimit, por pa pasur nevojë për paraqitjen e provave se zbatimi i shkallës metodologjike më të lartë është teknikisht e pazbatueshme ose sjell kosto të paarsyeshme.

7. Me qëllim përcaktimin e faktorëve të llogaritjes mbi bazën e analizave, në përputhje me nenin 32 të kësaj rregulloreje, operatori i një instalimi me shkarkime të ulëta mund të përdorë çdo laborator që është teknikisht i aftë dhe në gjendje të prodhojë rezultate teknikisht të vlefshme, duke përdorur procedurat analitike përkatëse, dhe që ofron prova që tregojnë marrjen e masave të sigurimit të cilësisë, siç parashikohet në pikën 3, të nenit 34, të kësaj rregulloreje.

8. Kur një instalim me shkarkime të ulëta, që i nënshtrohet monitorimit të thjeshtuar, tejkalon pragun e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni në një vit kalendarik, operatori i tij duhet të njoftojë menjëherë AKM-në. Në këtë rast operatori i instalimit duhet të paraqesë për miratim pranë AKM-së ndryshimin e rëndësishëm të planit të monitorimit, në kuptimin e shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 15, të kësaj rregulloreje. Megjithatë, AKM-ja lejon që operatori i instalimit të vazhdojë monitorimin e thjeshtuar, me kusht që operatori t'i japë AKM-së prova të mjaftueshme se pragu i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nuk është tejkaluar gjatë pesë periudhave të mëparshme të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri nga periudha e raportimit pasardhëse e në vijim.

Neni 49
CO_2 i brendshëm i lëndëve djegëse ose materialeve

1. CO_2 i brendshëm i lëndëve djegëse ose i materialeve që transferohet në një instalim, përfshirë atë që gjendet në gazin natyror, në gazin që krijohet nga mbetjet (përfshirë gazin e furrës së madhe metalurgjike ose të furrave të koksit) ose në lëndët hyrëse të procesit të prodhimit (përfshirë gazin e sintezës), përfshihet në faktorin e shkarkimit të asaj rryme shkarkimi.

2. Kur CO_2 i brendshëm e ka prejardhjen nga aktivitetet e parashikuara në shtojcën II, pjesa A, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe më pas transferohet jashtë instalimit si pjesë e një rryme shkarkimi te një instalim apo aktivitet tjetër i mbuluar gjithashtu nga aktivitetet e parashikuara në shtojcën II, pjesa A, të të njëjtit ligj, nuk llogaritet si shkarkim i instalimit nga i cili ka prejardhjen. Për përcaktimin e fraksionit të biomasës me normë zero, të fraksionit RFNBO ose RCF me normë zero, ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët me normë zero, të CO_2 të brendshëm në përputhje me nenin 39 të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit transferues garanton që metodologjia e zgjedhur e monitorimit nuk nënvlerëson sistematikisht shkarkimet totale të instalimit transferues. Megjithatë kur CO2 e brendshme shkarkohet ose transferohet jashtë instalimit te entitete që nuk mbulohen nga shtojca II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, do të llogaritet si shkarkime të instalimit nga i cili e ka prejardhjen.

3. Sasitë e CO_2 të brendshëm të transferuar jashtë instalimit mund të përcaktohen nga operatorët si në instalimin transferues ashtu edhe në instalimin pritës. Në këtë rast, sasitë e CO_2 të brendshëm të transferuara dhe të marra dhe fraksioni përkatës i biomasës me normë zero, fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero dhe fraksioni sintetik me karbon të ulët me normë zero janë identike.

4. Kur sasitë e CO_2 të brendshëm të transferuar dhe të marrë nuk janë identike, si instalimi transferues ashtu edhe instalimi pritës përdorin në raportin e shkarkimeve mesataren aritmetike të të dyja vlerave të llogaritura, kur devijimi midis vlerave mund të shpjegohet nga pasiguria e sistemeve të matjes ose e metodës së llogaritjes. Në këto raste, raporti i shkarkimeve duhet të përmbajë një referencë për nevojën e përafrimit të asaj vlere. Kur ndryshimi mes vlerave nuk mund të shpjegohet me diapazonin e miratuar të pasigurisë së sistemeve të matjes ose metodës së llogaritjes, operatorët e instalimeve transferuese dhe pritëse do të përafrojnë vlerat duke zbatuar rregullime konservatore të miratuara nga AKM-ja.

Neni 50
CO_2 i transferuar

1. Operatori i instalimit zbret nga shuma e shkarkimeve të instalimit çdo sasi CO_2 e cila e ka origjinën nga aktivitetet e radhitura në shtojcën II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar që nuk e ka prejardhjen nga karboni me normë zero dhe që nuk shkarkohet nga instalimi, por që transferohet jashtë instalimit në ndonjë nga instalimet e mëposhtme:

i) në një instalim kapjeje për qëllime transporti dhe magazinimi gjeologjik afatgjatë në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi;

ii) në një infrastrukturë për transportimin e CO_2, me qëllim të ruajtjes gjeologjike afatgjatë në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi;

iii) në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi për qëllime depozitimi gjeologjik afatgjatë;

2. Operatori i instalimit transferues, në raportin vjetor të shkarkimeve, paraqet kodin e identifikimit të instalimit pritës, nëse instalimi pritës mbulohet nga shtojca II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Ky rregull të zbatohet gjithashtu për instalimin pritës në lidhje me kodin e identifikimit të instalimit transferues. Në të gjitha rastet e tjera, operatori i instalimit transferues duhet të japë emrin, adresën dhe të dhënat e personit të kontaktit në instalimin pritës.

3. Për përcaktimin e sasisë së CO_2 të transferuar nga një instalim ose nga një infrastrukturë për transportin e CO_2 në një instalim tjetër ose në një infrastrukturë për transportin e CO_2 në përputhje me pikën 1 të këtij neni, operatori i instalimit, në varësi të dispozitave të mëtejshme të përcaktuara në shtojcën IV të kësaj rregulloreje, zbaton ose një metodologji të bazuar në llogaritje, ose një metodologji të bazuar në matje, në përputhje me nenet 44, 45 dhe 46 të kësaj rregulloreje. Kur zbatohet metodologjia e bazuar në matje, burimi i shkarkimit duhet të korrespondojë me pikën e

matjes dhe shkarkimet duhet të shprehen si sasia e CO_2 të transferuar.

4. Kur për përcaktimin e sasisë së CO_2 të transferuar nga një instalim ose nga një infrastrukturë e transportit të CO_2 në tjetrën, përdoret një metodologji e bazuar në matje, operatori i instalimit zbaton shkallën më të lartë metodologjike siç përcaktohet në seksionin 1 të Shtojcës VIII të kësaj rregulloreje. Megjithatë, operatori i instalimit mund të zbatojë një shkallë metodologjike më të ulët, që radhitet menjëherë pas shkallës metodologjike më të lartë, me kushtin që të vërtetojë se zbatimi i shkallës metodologjike më të lartë të përcaktuar në seksionin 1 të Shtojcës VIII të kësaj rregulloreje është teknikisht i pa realizueshëm ose çon në kosto të paarsyeshme.

5. Operatorët mund të përcaktojnë sasitë e CO_2 të transferuara jashtë instalimit si në instalimin transferues ashtu edhe në instalimin pritës, duke zbatuar në këto raste parashikimet e nenit 49 pika 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.

6. Nëse në një instalim kapës transferohet CO2 që rezulton nga materiale ose lëndë djegëse që përmbajnë një fraksion të karbonit me normë zero, instalimi transferues zbret nga shkarkimet e raportuara prej tij në përputhje me pikën 1 të këtij neni, vetëm sasinë e CO_2 që është në përpjesëtim me fraksionin e karbonit që nuk e ka prejardhjen nga karboni me normë zero.

7. Operatori i një infrastrukture transporti ose i një vend depozitimi të CO_2 monitoron shkarkimet nga rrjedhjet, shkarkimet e pakapshme dhe shkarkimet e përqendruara nga çdo lloj CO_2 që përmendet në pikën 6 të këtij neni, duke përfshirë CO_2 që krijohet nga subjektet që nuk kryejnë aktivitetet e renditura në shtojcën II, pjesa A të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe raporton shkarkimet sikur të ishin nga CO_2 fosile.

8. Operatori i një infrastrukture transporti CO_2 mund të përfshijë në shkarkimet e raportuara gjatë një periudhe të caktuar raportimi, çdo CO_2 në tranzit, që është transferuar në një instalim tjetër ose në një infrastrukturë transporti CO_2 jo më vonë se 31 janari i vitit pasardhës. Operatori i instalimit përpilon çdo vit një inventar të CO_2 që hyn dhe del nga infrastruktura e transportit të CO_2 dhe raporton veçmas çdo CO_2 në tranzit.

Neni 51

Shkarkimet e lidhura kimikisht në një produkt në mënyrë të përhershme

1. Operatori i instalimit zbret nga shkarkimet e instalimit çdo sasi të CO_2 që e ka prejardhjen nga karboni me normë jozero të aktiviteteve të mbuluara nga shtojca II, pjesa A e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që nuk shkarkohet nga instalimi, por që është i lidhur kimikisht në mënyrë të përhershme me mineralet karbonate të përdorura në produktet e mëposhtme ndërtimore:

a)bashkime të karbonatizuara të përdorura të lidhura apo të pa lidhura në produkte ndërtimore me bazë minerale;

b)përbërës të karbonatizuar të çimentos, gëlqeres ose lidhësve të tjerë hidraulikë të përdorur në produkte ndërtimore;

c)beton i karbonatizuar, përfshirë blloqe parafabrikat, pllaka shtrimi ose beton të ajrosur;

d)tulla, tjegulla ose elemente të tjera murature të karbonatizuara.

2. Në rastin kur CO_2 buron nga materiale ose lëndë djegëse që përmbajnë një fraksion të karbonit me normë zero, operatori i instalimit zbret nga shkarkimet e instalimit vetëm sasinë e CO_2 të lidhur kimikisht në mënyrë të përhershme në një produkt të përmendur në pikën 1 të këtij neni, që është në përpjesëtim me fraksionin e karbonit që nuk e ka origjinën nga karboni me normë zero.

3. Për përcaktimin e sasisë së CO_2 të lidhur kimikisht në mënyrë të përhershme në një produkt, që plotëson specifikimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori i instalimit ose zbaton metodologjinë standarde në përputhje me seksionet 2 dhe 4, të shtojcës II, të kësaj rregulloreje, ose zbaton bilancin e masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, duke përdorur lëndët djegëse dhe materialet që hyjnë dhe dalin nga procesi i prodhimit në të cilin CO_2 është i lidhur kimikisht, si rrymat e shkarkimit ku bazohet llogaritja, duke marrë ndërkohë parasysh çdo shkarkim nga djegia që lidhet me procesin. Për këtë qëllim, për aktivitetin nga i cili gjenerohet CO_2, zbatohet shkalla metodologjike më e lartë e përcaktuar në Shtojcën II të kësaj rregulloreje, sipas specifikimeve të parashikuara nga po ajo Shtojcë. Megjithatë, operatori i instalimit mund të zbatojë shkallën metodologjike më të ulët që është vjen menjëherë

pas, nëse arrin të dëshmojë, në mënyrë që të bindë AKM-në se zbatimi shkallës metodologjike më të lartë të përcaktuar në shtojcën II të kësaj rregulloreje nuk është teknikisht i realizueshëm ose shkakton kosto të paarsyeshme.

Neni 52
Përdorimi ose transferimi i N_2O

1. Kur N_2O e ka prejardhjen nga aktivitetet e mbuluara nga shtojca II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe shtojca specifikon N_2O-në si të lidhur me aktivitetin, dhe kur një instalim nuk lëshon N_2O-në por e transferon atë në një instalim tjetër që monitoron dhe raporton shkarkime në përputhje me këtë rregullore, N_2O nuk do të llogaritet si shkarkim i instalimit nga i cili ka prejardhjen.

2. Një instalim që merr N_2O nga një instalim tjetër dhe nga një aktivitet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, monitoron rrymat përkatëse të gazit duke përdorur të njëjtat metodologji të kërkuara nga kjo rregullore, që do të përdoreshin sikur N_2O të ishte krijuar brenda vetë instalimit që merr N_2O-në.

3. Megjithatë, kur N_2O futet në bombola ose përdoret si gaz në produkte në mënyrë që të shkarkohet jashtë instalimit, ose kur transferohet jashtë instalimit te subjekte që nuk mbulohen nga shtojca II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, N_2O do të konsiderohet si shkarkim i instalimit nga i cili e ka prejardhjen, përveç sasive të N_2O për të cilat operatori i instalimit nga i cili buron N_2O i dëshmon AKM-së se N_2O shkatërrohet duke përdorur pajisje të përshtatshme për pakësimin e shkarkimeve.

4. Operatori i instalimit transferues, në raportin vjetor të shkarkimeve, paraqet kodin e identifikimit të instalimit pritës, të njohur nga AKM-ja, kur është e zbatueshme. Ky rregull të zbatohet gjithashtu për instalimin pritës në lidhje me kodin e identifikimit të instalimit transferues

5. Për përcaktimin e sasisë së N_2O të transferuar nga një instalim në një instalim tjetër, operatori i instalimit zbaton ë metodologjinë e bazuar në matje, në përputhje me nenet 44, 45 dhe 46 të kësaj rregulloreje. Burimi i shkarkimit duhet të përkojë me pikën e matjes dhe shkarkimet duhet të shprehen si sasia e N_2O të transferuar.

6. Për përcaktimin e sasisë së N_2O të transferuar nga një instalim në një instalim tjetër, operatori i instalimit zbaton shkallën më të lartë metodologjike siç përcaktohet në seksionin 1 të Shtojcës VIII të kësaj rregulloreje për shkarkimet e NO_2. Megjithatë, operatori i instalimit mund të zbatojë një shkallë metodologjike më të ulët, që radhitet menjëherë pas shkallës metodologjike më të lartë, me kushtin që të vërtetojë se zbatimi i shkallës metodologjike më të lartë të përcaktuar në seksionin 1 të Shtojcës VIII të kësaj rregulloreje është teknikisht i pa realizueshëm ose çon në kosto të paarsyeshme.

7. Operatorët mund të përcaktojnë sasitë e N_2O të transferuara jashtë instalimit si në instalimin transferues ashtu edhe në instalimin pritës, duke zbatuar në këto raste parashikimet e pikave 3 dhe 4, të nenit 49, të kësaj rregulloreje, të përshtatura sipas nevojës.

KREU IV
MONITORIMI I SHKARKIMEVE NGA AVIACIONI DHE EFEKTET NGA AVIACIONI TË PALIDHURA ME CO_2

Neni 53
Dispozita të përgjithshme

1. Çdo operator avioni monitoron dhe raporton shkarkimet dhe efektet nga aviacioni të palidhura me CO_2 nga aktivitetet e aviacionit për të gjitha fluturimet e përfshira në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që kryhen nga operatori i avionit gjatë periudhës së raportimit dhe për të cilat operatori i avionit është përgjegjës.

2. Për të përcaktuar vitin kalendarik të cilit i përkasin fluturimet, operatori i avionit, për të gjitha fluturimet, i referohet orarit të nisjes të matur sipas Kohës Universale të Koordinuar.

3. Me qëllim identifikimin e operatorit unik të avionit që përcaktohet në pikën 23, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që është përgjegjës për fluturimin, përdoret sinjali i thirrjes për kontrollin e trafikut ajror siç përcaktohet në pikën 7 të planit të fluturimit. Sinjali i thirrjes përcakton operatorin e avionit si më poshtë:

a) kur në pikën 7 të planit të fluturimit përfshihet kodi ICAO i operatorit ajror, operatori unik i avionit

është operatori i avionit, të cilit i është caktuar ai kod ICAO;

b) nëse pika 7 e planit të fluturimit përfshin shenjën e kombësisë ose shenjën e operimit të përbashkët dhe shenjën e regjistrimit të avionit që është shprehimisht e përcaktuar në certifikatën e një operatori avioni (ose në një dokument të barasvlershëm), ose në një dokument të lëshuar nga një shtet dhe që identifikon operatorin e avionit, atëherë operatori unik i avionit është personi fizik ose juridik që zotëron certifikatën e operatorit të avionit (ose një dokument të barasvlershëm) ose personi fizik ose juridik, që është përcaktuar në dokument.

4. Kur operatori unik i avionit nuk mund të identifikohet nëpërmjet sinjalit të thirrjes sipas pikës 3 të këtij neni, operatori unik i avionit që përcaktohet në pikën 23, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që është përgjegjës për një fluturim, është personi fizik ose juridik që ka një punësimi ose një marrëdhënie tjetër kontraktore me kapitenin e fluturimit.

5. Kur nuk dihet identiteti i operatorit të avionit, AKM-ja konsideron pronarin e avionit si operatorin e avionit, përveçse kur pronari i avionit vërteton se cili është identiteti i operatorit të avionit që është përgjegjës i mjetit ajror.

Neni 54
Dorëzimi i planeve të monitorimit

1. Të paktën katër muaj përpara fillimit të aktiviteteve të aviacionit të parashikuara në shtojcën II, pjesa B, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, operatori i avionit dorëzon pranë AKM-së një plan monitorimi për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të efekteve nga aviacioni të palidhura me CO_2, në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

2. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, operatori i avionit, që kryen për herë të parë një aktivitet aviacioni të parashikuar në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, ose që monitoron dhe raporton efektet e palidhura me CO_2 që rrjedhin nga aktiviteti i aviacionit, dhe që nuk mund të parashikoheshin katër muaj përpara nisjes së aktivitetit, dorëzon pa vonesë në AKM planin e monitorimit, dhe në çdo rast jo më vonë se gjashtë javë pas kryerjes së atij aktiviteti. Operatorit i avionit i jep AKM-së argumente të përshtatshme që shpjegojnë arsyen pse plani i monitorimit nuk mund të ishte paraqitur katër muaj përpara nisjes së aktivitetit.

Neni 55
Metodologjia e monitorimit për shkarkimet nga aktivitetet e aviacionit

1. Çdo operator avioni përcakton shkarkimet vjetore të CO_2 nga aktivitetet e aviacionit duke shumëzuar konsumin vjetor të çdo lënde djegëse të papërzier (të shprehur në ton) me faktorin përkatës të shkarkimit. Për lëndët djegëse të përziera për aviacionin, operatori i avionit përcakton teorikisht cila është sasia e çdo lënde djegëse të papërzier, që përmbahet në sasinë totale të lëndës djegëse të përzier për aviacionin dhe të dhënat e përbërjes përkatëse, duke zbatuar rregullat e mëposhtme:

i) kur një lëndë djegëse përmban biomasë, operatori i avionit përcakton fraksionin e biomasës, në përputhje me nenin 57 të kësaj rregulloreje;

ii) kur një lëndë djegëse përmban RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët, operatori i avionit përcakton fraksionin e RFNBO-së, e RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, në përputhje me nenin 59 të kësaj rregulloreje;

iii) kur fraksioni i RFNBO-së, i RCF-së ose fraksioni sintetik me karbon të ulët nuk është zero dhe kur operatori i avionit dëshiron të përdorë normën zero, operatori i avionit përcakton fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së me normë zero ose fraksionin sintetik me karbon të ulët me normë zero, në përputhje me nenin 60;

iv) kur fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni i RFNBO-së ose i RCF-së me normë zero ose fraksioni sintetik me nivel të ulët të karbonit nuk janë zero, operatori i avionit llogarit fraksionin me normë zero si shumën e fraksionit të biomasës me normë zero, fraksionit të RFNBO-së ose i RCF-së me normë zero dhe fraksionit sintetik me karbon të ulët. Fraksioni fosil është shuma e të gjitha fraksioneve me normë jozero. Kur operatori i avionit nuk llogarit fraksionin me normë zero, fraksioni fosil është 100%.

v) operatori i avionit llogarit sasinë e çdo lënde djegëse të papërzier si sasia totale e lëndës djegëse të përzier për aviacionin të shumëzuar me fraksionin përkatës.

2. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1 më sipër, për qëllimin e vlerësimit të pragjeve të shkarkimeve të përcaktuara në nenet 61, pika 1, dhe 61, pika 2, të kësaj rregulloreje, dhe në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, operatori i avionit përcakton shkarkimet e CO_2, duke shumëzuar konsumin vjetor të çdo lënde djegëse me faktorin e tij paraprak të shkarkimit.

3. Çdo operator avioni përcakton konsumin e lëndës djegëse për çdo fluturim dhe për çdo lloj lënde djegëse, përfshirë lëndën djegëse, që konsumohet nga sistemi i furnizimit me energji ndihmëse. Për këtë qëllim, operatori i avionit përdor njërën nga metodat e përcaktuara në seksionin 1, të shtojcës III, të kësaj rregulloreje. Operatori i avioni zgjedh metodën, që garanton mbledhjen e të dhënave më të plota sa më shpejt dhe njëkohësisht pasigurinë më të ulët, pa shkaktuar kosto të paarsyeshme.

4. Çdo operator avioni përcakton sasinë e lëndës djegëse me të cilën është furnizuar avioni, të përmendur në seksionin 1, të shtojcës III, të kësaj rregulloreje, bazuar në një nga metodat e mëposhtme:

a) nëpërmjet matjes së lëndës djegëse nga furnizuesi, siç dokumentohet në shënimet ose faturat e dorëzimit të lëndës djegëse për çdo fluturim;

b) nëpërmjet të dhënave nga sistemet e matjes në bordin e avionit, të regjistruara në dokumentacionin e masës dhe bilancit, në regjistrin teknik të avionit ose të transmetuara në mënyrë elektronike nga avioni tek operatori i avionit.

5. Operatori i avionit përcakton lëndën djegëse që përmban serbatori, duke përdorur të dhënat nga sistemet e matjes në bordin e avionit dhe të regjistruara në dokumentacionin e masës dhe bilancit, në regjistrin teknik të avionit ose të transmetuara në mënyrë elektronike nga avioni tek operatori i avionit.

6. Kur sasia e lëndës djegëse, me të cilën është furnizuar avioni ose sasia e lëndës djegëse që mbetet në serbator, përcaktohet në njësi vëllimi, të shprehura në litra, operatori i avionit e konverton këtë sasi nga vëllimi në masë, duke përdorur vlerat e densitetit. Operatori i avionit përdor densitetin e lëndës djegëse (që mund të jetë një vlerë aktuale ose standarde prej 0,8 kg për litër), që përdoret për arsye operative dhe sigurie. Procedura e njoftimit të përdorimit të densitetit aktual ose densitetit standard përshkruhet në planin e monitorimit duke referuar edhe dokumentacionin përkatës të operatorit të avionit.

7. Për të kryer llogaritjet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori i avionit përdor faktorët standard të shkarkimit që përcaktohen në tabelën 1 të shtojcës III të kësaj rregulloreje. Faktorët standardë të shkarkimit, që përcaktohen në tabelën 1, të shtojcës III, të kësaj rregulloreje, përdoren nga operatorët e avionit si faktor paraprak të shkarkimeve.

8. Për lëndët djegëse alternative për aviacionin, të ndryshme nga biokarburanteve, RFNBO, RCF ose lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët, operatori i avionit përcakton faktorin e shkarkimit në përputhje me nenin 32 të kësaj rregulloreje. Për këto lëndë djegëse, vlera kalorifike neto përcaktohet dhe raportohet si informacion shtesë.

9. Në përjashtim nga parashikimet e pikave 7 dhe 8 të këtij neni, për lëndët djegëse për qëllime tregtare, operatori i avionit, me miratimin AKM-së, mund të llogarisë faktorin e shkarkimeve ose përmbajtjen e karbonit mbi të cilën bazohet faktori i shkarkimeve, ose vlerën kalorifike neto nga të dhënat e blerjes të lëndës djegëse në fjalë, të siguruara nga furnizuesi i lëndës djegëse, me kusht që këto të dhëna janë nxjerrë mbi bazën e standardeve ndërkombëtarisht të pranuara dhe të mos jetë i mundur zbatimi i faktorëve të shkarkimit të radhitur në tabelën 1 të shtojcës III të kësaj rregulloreje.

Neni 56

Rregullat e raportimit për përdorimin e lëndëve djegëse alternative për aviacionin

1. Operatori i avionit monitoron sasinë e lëndëve djegëse alternative për aviacionin, që është përdorur dhe e raporton këtë sasi të ndarë për çdo fluturim ose për çdo çift aerodromesh nisje-mbërritje.

2. Kur lëndët djegëse alternative për aviacionin dorëzohen tek avioni në ngarkesa fizikisht të identifikueshme, operatori i avionit i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme se lënda djegëse alternative për aviacionin i takon fluturimit që kryhet menjëherë pas furnizimit me karburant të avionit.

3. Në rastet kur kryhen disa fluturime të njëpasnjëshme pa u bërë furnizim me lëndë djegëse ndërmjet tyre, operatori i avionit ndan sasinë e lëndës djegëse alternative për secilin fluturim në

mënyrë proporcionale me shkarkimet nga secili fluturim, që llogariten duke përdorur faktorin paraprak të shkarkimeve.

4. Kur nuk është e mundur të identifikohet fizikisht se cilit fluturim specifik të një aerodromi i takojnë lëndët djegëse alternative të aviacionit, operatori i avionit duhet t'ua caktojë këto lëndë djegëse fluturimeve të kryera prej tij për të cilat duhet të raportohen shkarkimet GES në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në mënyrë proporcionale me shkarkimet që krijohen nga ato fluturime të nisura nga ai aerodrom, të llogaritura duke përdorur faktorët paraprakë të shkarkimit. Në këtë kontekst, operatori i avionit duhet t'i paraqesë AKM-së prova të mjaftueshme, se lënda djegëse alternative e aviacionit është dorëzuar në sistemin e furnizimit me lëndë djegëse të aerodromit të nisjes gjatë periudhës raportuese, ose 3 muaj para fillimit, ose 3 muaj pas përfundimit të asaj periudhe raportimi.

5. Për të mundësuar zbatimin e pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, operatori i avionit i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme se:

i) sasia totale e lëndës djegëse alternative të aviacionit të deklaruar nuk duhet të tejkalojë sasinë totale të lëndës djegëse të përdorur nga ai operator avionësh për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që nisen nga aerodromi ku është furnizuar lënda djegëse alternative e aviacionit;

ii) sasia e lëndës djegëse alternative të aviacionit për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11l të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar nuk duhet të tejkalojë sasinë totale të blerë të lëndës djegëse alternative të aviacionit, nga e cila është zbritur sasia totale e lëndës djegëse alternative të aviacionit, që u është shitur palëve të treta.

iii) raporti ndërmjet lëndëve djegëse alternative për aviacionin dhe lëndëve djegëse fosile, i llogaritur së bashku për fluturimet çift mes aerodromesh (nisje-mbërritje), nuk duhet të tejkalojë kufirin maksimal të përzierjes për atë lloj karburanti, siç është certifikuar në përputhje me një standard ndërkombëtar të njohur;

iv) e njëjta sasi lënde djegëse alternative për aviacionin nuk llogaritet dy herë, dhe veçanërisht nuk ka pretendime që lënda djegëse alternative për aviacionin që është blerë është përdorur në një raportim të mëparshëm ose nga një operator tjetër avioni, apo në kuadër të një sistemi tjetër për çmimin e karbonit. Për qëllimet e këtij paragrafi, çdo lëndë djegëse e mbetur në serbator pas një fluturimi dhe përpara një ngritjeje supozohet të jetë 100% lëndë djegëse fosile.

6. Për të vërtetuar zbatimin e kërkesave të përcaktuara në nënndarjen "ii", të pikës 4, të këtij neni, operatori i avionit mund të përdorë të dhënat e regjistruara në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001 ose në një bazë të dhënash kombëtare, që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian.

Neni 57

Përcaktimi i fraksionit të biomasës për biokarburantet

1. Operatori i avionit përcakton fraksionin e biomasës në lëndët djegëse të përziera të aviacionit që përmbajnë biokarburantet. Operatori i avionit mund ose të supozojë mungesën e biokarburantit dhe të zbatojë një fraksion standard fosil prej 100%, ose të përcaktojë fraksionin e biokarburantit në përputhje me pikat 2 ose 3 të këtij neni. Operatori i avionit përdor një vlerë standarde prej 100% të fraksionit të biomasës për biokarburantet e papërziera. Si përjashtim, operatori i avionit që përdor lëndë djegëse të përziera për aviacionin, që përmbajnë biokarburante, mund të zgjedhë të monitorojë përmbajtjen e biokarburantit dhe përmbajtjen e lëndës djegëse fosile të aviacionit si rryma shkarkimi të veçanta, nëse provat e paraqitura nga furnizuesit e lëndës djegëse e mundësojnë një qasje të tillë.

2. Kur biokarburantet përzihen fizikisht me lëndë djegëse fosile dhe i dorëzohen avionit në ngarkesa fizikisht të identifikueshme, operatori i avionit mund të kryejë analizat, në përputhje me parashikimet e neneve 32 deri 35, të kësaj rregulloreje, për të përcaktuar fraksionin e biomasës mbi bazën e një standardi specifik dhe metodave analitike të përcaktuara në ato nene, me kusht që përdorimi i atij standardi dhe i atyre metodave

analitike të jetë miratuar nga AKM-ja. Kur operatori i avionit i paraqet AKM-së prova se kryerja e këtyre analizave do të shkaktonte kosto të paarsyeshme ose nuk është teknikisht e realizueshme, operatori i avionit mund ta bazojë vlerësimin e përmbajtjes së biokarburantit mbi një bilanc material të përzierjes së lëndëve djegëse fosile dhe biokarburanteve të blera. Nëse fraksioni i biomasës është përcaktuar duke përdorur bilancin e masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, nuk kërkohet paraqitja e provave mbi kostot e paarsyeshme ose realizueshmërinë teknike.

3. Kur ngarkesat e biokarburantit të blera nuk i dorëzohen fizikisht një avioni të caktuar, operatori i avionit nuk duhet të përdorë analiza për të përcaktuar fraksionin e biomasës së karburanteve të përdorura. Operatori i avionit mund ta përcaktojë fraksionin e biomasës duke përdorur regjistrat e blerjes së biokarburantit me përmbajtje të barasvlershme energjie.

Neni 58

Dispozita të posaçme për lëndët djegëse të kualifikuara për aviacionin

1. Operatori i avionit harton, dokumenton, zbaton dhe mirëmban një procedurë të shkruar me qëllim monitorimin e çdo sasie lënde djegëse të papërzier të kualifikuar për aviacionin (në ton), të përdorur për fluturimet nënsonike dhe raporton sasitë e lëndëve djegëse të kualifikuar për aviacionin të deklaruara si një shënim të posaçëm në raportin e tij vjetor të shkarkimeve.

2. Në zbatim të pikës 1, të këtij neni, operatori i avionit siguron që çdo sasi e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin e deklaruar është e certifikuar në përputhje parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë ose sipas një skeme tjetër certifikimi të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për qëndrueshmërinë në sektorin e transportit ajror të qëndrueshëm. AKM mund t'i lejojë operatorit ajror përdorimin e të dhënave të regjistruara në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni, të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001 ose në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksionon në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas vërehet një mospërputhje në lidhje me provën e qëndrueshmërisë së sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM korrigjon përkatësisht sasitë e verifikuara të lëndëve djegëse të papërziera të kualifikuara për aviacionin.

3. Për lëndët djegëse të përziera të aviacionit, operatori i avionit mundet ose të supozojë mungesën e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin dhe të zbatojë një fraksion fosil standard prej 100%, ose të përcaktojë sasinë e lëndës djegëse të papërzier të kualifikuar për aviacionin në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

4. Operatori i avionit përcakton sasinë e lëndës djegëse të papërzier, të kualifikuara për aviacionin si shumën e lëndëve djegëse alternative të papërziera të kualifikuara për aviacionin, që janë lëndët djegëse të qëndrueshme për aviacionin dhe lëndët e tjera djegëse për aviacionin që nuk e kanë prejardhjen nga lëndët djegëse fosile, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 55, të kësaj rregulloreje. Lëndët djegëse të papërziera të kualifikuara për aviacionin llogariten për çdo çift fluturimi ose aerodromi në përputhje me pikat 5 ose 6 të këtij neni.

5. Kur lëndët djegëse të kualifikuara për aviacionin i dorëzohen avionit në ngarkesa fizikisht të identifikueshme, operatori i avionit i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme që lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin i përket fluturimit të parë që ngrihet menjëherë pas furnizimit të avionit me lëndë djegëse. Nëse kryhen disa fluturime të njëpasnjëshme pa furnizim me lëndë djegëse ndërmjet tyre, operatori i avionit ndan sasinë e lëndëve djegëse të kualifikuara për aviacionin dhe llogarit se cilit fluturim i përket në përpjesëtim me shkarkimet e fluturimeve, të llogaritura duke përdorur faktorin paraprak të shkarkimeve.

6. Kur nuk është e mundur të identifikohet fizikisht se cilit fluturim specifik të një aerodromi i takojnë lëndët djegëse të kualifikuara për aviacionin, operatori i avionit duhet t'ua caktojë këto lëndë djegëse fluturimeve të kryera prej tij për të cilat duhet të raportohen shkarkimet GES në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në mënyrë proporcionale me shkarkimet që krijohen nga ato fluturime të

nisura nga ai aerodrom, të llogaritura duke përdorur faktorët paraprakë të shkarkimit. Për këtë qëllim, operatori i avionit duhet t'i paraqesë AKM-së prova të mjaftueshme, se lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin është dorëzuar në sistemin e furnizimit me lëndë djegëse të aerodromit të nisjes gjatë periudhës raportuese, ose 3 muaj para fillimit, ose 3 muaj pas përfundimit të asaj periudhe raportimi.

7. Me qëllim zbatimin e pikave 4 dhe 5 të këtij neni, operatori i avionit i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme se:

a) sasia totale e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin të deklaruar nuk duhet të tejkalojë sasinë totale të lëndës djegëse të përdorur nga ai operator avionësh për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që nisen nga aerodromi ku është furnizuar lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin;

b) sasia e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar nuk duhet të tejkalojë sasinë totale të blerë të lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin, nga e cila është zbritur sasia totale e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin që u është shitur palëve të treta;

c) raporti ndërmjet lëndëve djegëse të kualifikuara për aviacionin dhe lëndëve djegëse fosile, i llogaritur së bashku për fluturimet çift mes aerodromesh (nisje-mbërritje), nuk tejkalon kufirin maksimal të përzierjes për atë lloj lënde djegëse, të certifikuar sipas një standardi ndërkombëtar të njohur;

ç) e njëjta sasi lënde djegëse e kualifikuar për aviacionin nuk llogaritet dy herë, dhe veçanërisht nuk ka pretendime që lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin që është blerë, është përdorur në një raportim të mëparshëm ose nga një operator tjetër avioni, apo në kuadër të një sistemi tjetër për çmimin e karbonit. Për qëllimet e këtij paragrafi, çdo lëndë djegëse e mbetur në serbator pas një fluturimi dhe përpara një ngritjeje supozohet të jetë 100% lëndë djegëse e pakualifikuar për aviacionin.

Në kuptim të shkronjave "a", "b" dhe "c", të kësaj pike, çdo lëndë djegëse që mbetet në depozitat e avionit pas një fluturimi dhe para furnizimit të radhës konsiderohet se është 100% lëndë djegëse e pa kualifikuar.

8. Për të vërtetuar zbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 6, të këtij neni, operatori i avionit mund të përdorë të dhënat e regjistruara në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni, të ngritur në përputhje me nenin 31a të direktivës (BE) 2018/2001 ose në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksionon në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian.

Neni 59

Përcaktimi i fraksionit të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët

1. Operatori i avionit përcakton fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së, ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, të lëndëve djegëse të përziera të aviacionit që përmbajnë RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët. Operatori i avionit mund ose të supozojë mungesën e RFNBO-së, të RCF-së ose të lëndës djegëse sintetike me karbon të ulët dhe të zbatojë një fraksion fosil standard prej 100%, ose të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët në përputhje me pikat 3 ose 4 të këtij neni. Operatori i avionit përdor një vlerë standarde prej 100% të fraksionit RFNBO ose RCF, ose 100% të fraksionit sintetik me karbon të ulët, sipas rastit, për RFNBO-në ose RCF-në e papërzier ose për lëndën djegëse sintetike me karbon të ulët të papërzier.

2. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, operatori i avionit që përdor lëndë djegëse për aviacionin të përziera, që përmbajnë RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët, mund të zgjedhë të monitorojë përmbajtjen e RFNBO-së ose të RCF-së ose përmbajtjen sintetike me karbon të ulët dhe përmbajtjet e lëndëve të tjera djegëse fosile të aviacionit, si rryma të veçanta shkarkimi, nëse provat e paraqitura nga furnizuesit e karburantit e lejojnë një qasje të tillë.

3. Kur RFNBO, RCF ose lënda djegëse sintetike me karbon të ulët përzihen fizikisht me lëndët djegëse fosile dhe i dorëzohen avionit në ngarkesa fizikisht të identifikueshme, operatori i avionit duhet ta bazojë vlerësimin e përmbajtjes së RFNBO-së ose të RCF-së ose të lëndës djegëse sintetike me karbon

të ulët te një bilanc mase, që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi , duke pasqyruar përzierjen e lëndëve djegëse fosile me RFNBO, RCF ose lëndën djegëse sintetike me karbon të ulët, të blera.

4. Kur ngarkesat e blera të RFNBO-së, RCF-së ose të lëndës djegëse sintetike me karbon të ulët nuk i dorëzohen fizikisht një avioni të caktuar, operatori i avionit mund të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët duke përdorur të dhënat e blerjes së RFNBO-së, RCF-së ose të lëndës djegëse sintetike me karbon të ulët me përmbajtje të barasvlershme energjie.

Neni 60

Kushtet për zbatimin e normës zero për biokarburantet, për RFNBO, RCF dhe lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët nga operatorët e avionit

1. Operatori i avionit mund të llogarisë fraksionin e biomasës të një lënde djegëse të përzier të aviacionit si pjesë të fraksionit të biomasës me normë zero vetëm për aq sa përmbajtja e biokarburantit përputhet me kriteret e përcaktuara në pikave 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje.

2. Operatori i avionit mund të llogarisë fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së të një lënde djegëse të përzier të aviacionit si pjesë të fraksionit RFNBO ose RCF me normë zero vetëm për aq sa përmbajtja e RFNBO-së ose e RCF-së përputhet me kriteret e përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

3. Operatori i avionit mund të llogarisë fraksionin sintetik me karbon të ulët të një lënde djegëse të përzier të aviacionit si pjesë të fraksionit sintetik me karbon të ulët me normë zero për aq sa përmbajtja sintetike me karbon të ulët përputhet me kriteret e përcaktuara në pikat 6 e 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

4. Operatori i avionit mund të deklarojë përdorimin e biokarburanteve me normë zero, RFNBO ose RCF me normë zero dhe lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero vetëm në masën që këto lëndë djegëse me normë zero përputhen me sasinë maksimale të përdorimit të lëndës djegëse të përcaktuar në përputhje me nenin 56 të kësaj rregulloreje, për fluturimet, për të cilat duhet të raportohen shkarkimet e GES-it.

Neni 61

Shkarkues të vegjël

1. Konsiderohen si shkarkues të vegjël, operatorët e avionit që kryejnë më pak se 243 fluturime për çdo periudhë katër mujore, gjatë tri periudhave të njëpasnjëshme katërmujore, dhe operatorët e avionit që kryejnë fluturime me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 25 000 ton CO_2 në vit.

2. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 55 të kësaj rregulloreje, shkarkuesit e vegjël dhe operatorët e avionit me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 3 000 ton CO_2 nga fluturimet mund të vlerësojnë konsumin e lëndës djegëse mbi bazën e distancës mes çifteve të aerodromeve (nisje-mbërritje) duke përdorur mjetet e zbatuara nga *Eurocontrol* ose nga një organizatë tjetër përkatëse, që arrin të përpunojë të gjitha të dhënat përkatëse të trafikut ajror duke shmangur çdo nënvlerësim të shkarkimeve. Preferohet përdorimi i mjeteve të zbatueshme të miratuara nga Komisioni Evropian, duke përfshirë zbatimin e faktorëve korrigjues për të kompensuar çdo pasaktësi në metodat e modelimit.

3. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 12, një shkarkues i vogël që synon të përdorë ndonjë nga mjetet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, lejohet të paraqesë vetëm informacionin e mëposhtëm në planin e monitorimit të shkarkimeve:

a) informacionin e kërkuar sipas pikës 1, të seksionit 2, të shtojcës I, të kësaj rregulloreje;

b) provat që tregojnë se janë respektuar pragjet për shkarkuesit e vegjël, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

c) emrin ose referencën e mjetit të përmendur në pikën 2, të këtij neni, që do të përdoret për vlerësimin e konsumit të lëndës djegëse.

4. Shkarkuesi i vogël përjashtohet nga kërkesa për të paraqitur dokumentet mbështetëse të përmendura në pikën 3, të nenit 12, të kësaj rregulloreje.

5. Kur operatori i avionit, gjatë një viti raportimi, përdor ndonjë nga mjetet e përmendura në pikën 2 të këtij neni dhe tejkalon pragjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, operatori i avionit njofton menjëherë AKM-në. Si rrjedhojë operatori i avionit paraqet pa vonesë pranë AKM-së për miratim

kërkesën për ndryshim të rëndësishëm të planit të monitorimit, në kuptimin e nënndarjes "iv", të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 15, të kësaj rregulloreje. Megjithatë, AKM-ja lejon që operatori ajror të vazhdojë të përdorë një mjet të përmendur në pikën 2 të këtij neni, me kusht që operatori i avionit t'i japë AKM-së prova të mjaftueshme se pragjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni nuk janë tejkaluar gjatë pesë periudhave të mëparshme të raportimit dhe se nuk do të tejkalohen më, duke filluar nga periudha pasuese e raportimit.

Neni 62
Burimet e pasigurisë

1. Operatori i avionit kur zgjedh metodologjinë e monitorimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 55, e kësaj rregulloreje merr në konsideratë burimet e pasigurisë dhe nivelet përkatëse të pasigurisë.

2. Operatori avionit duhet të kryejë rregullisht veprimtari të përshtatshme kontrolli, duke përfshirë verifikime të kryqëzuara midis sasisë së furnizimit me lëndë djegëse të pasqyruar në faturat përkatëse, dhe sasisë së furnizimit me lëndë djegëse të llogaritur nga pajisjet matëse në bordin e avionit, dhe të marrë masa korrigjuese nëse vërehen devijime të dukshme mes tyre.

Neni 63
Llogaritja e ekuivalentit të CO_2 për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2

1. Operatori i avionit monitoron efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 nga aktivitetet e tij, të kryera me avionë të pajisur me motorë reaktivë, duke përcaktuar një vlerë të CO_2 ekuivalent ($CO_{2(e)}$) për çdo fluturim.

2. Operatori i avionit llogarit CO_2(e) për çdo fluturim, duke përdorur metrikën e potencialit të ngrohjes globale (GËP), në veçanti GËP 20, GËP 50 dhe GËP 100, nga e cila për çdo fluturim të monitoruar llogaritet vlera e CO_2(e) për tri horizonte kohore (20, 50 dhe 100 vjet).

3. Me qëllim perfeksionimin e GËP-së të përmendur në pikën 2 të këtij neni, për të llogaritur $CO_{2(e)}$ për çdo fluturim, operatori i avionit përdor efikasitetin siç përcaktohet në këtë rregullore dhe në sistemin NEATS, përveç rasteve kur i vërteton AKM-së se nuk është e mundur të përdoret efikasiteti.

4. Për të llogaritur $CO_{2(e)}$ për çdo fluturim, çdo operator avioni zbaton metodën e llogaritjes të $CO_{2(e)}$ që mbulon elementet e mëposhtme:

a) modulin e konsumit të lëndës djegëse dhe modulin e vlerësimit të shkarkimeve, siç parashikohen në shtojcën IIIa, seksioni 3, i kësaj rregulloreje;

b) Metodën C, që është qasja e bazuar te kushtet atmosferike, dhe metodën D, që është qasja e thjeshtuar e bazuar te vendndodhja, siç përcaktohen në shtojcën IIIa, seksioni 4 i kësaj rregulloreje;
c) një qasje të bazuar te vlerat standarde, që përdoret në rast të mungesës së të dhënave, e përcaktuar në shtojcën IIIa, seksioni 5 dhe në shtojcën IIIb të kësaj rregulloreje.

5. Metodat C dhe D bazohen në të dhëna hyrëse të moduleve të përmendura në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni, në të dhënat e operatorit të avionit dhe në të dhënat përkatëse meteorologjike nga operatori i avionit ose nga burime të palëve të treta.

6. Çdo operator avioni përdor metodën C për të llogaritur CO_2(e) për çdo fluturim. Bëjnë përjashtim shkarkuesit e vegjël të përcaktuar në pikën 1, të nenit 61, të kësaj rregulloreje, të cilët mund të përdorin metodën D.

7. Për të zbatuar modelet e llogaritjes së $CO_{2(e)}$ për fluturimet e tyre, operatorët e avionit duhet të përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme, ose duke përdorur NEATS, në përputhje me Shtojcën IIIa, Seksioni 2 të kësaj rregulloreje, ose duke përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit (TIK) të tyre dhe të të tretëve, ose një kombinim mes NEATS dhe këtyre mjeteve:

a) mjetet e sipërpërmendura përputhen me kërkesat e përcaktuara në shtojcën IIIa të kësaj rregulloreje, në lidhje me modulin e vlerësimit të shkarkimeve të parashikuar në seksionet 3, 4 dhe 5, të po kësaj shtojce;

b) kur kërkohen të dhëna meteorologjike të përmirësuara, siç përcaktohen në shtojcën IIIa të kësaj rregulloreje, mjetet e sipërpërmendura përdorin të njëjtin model reference të përbashkët të Parashikimit Numerik të Motit (NWP) dhe të dhëna meteorologjike që përkojnë me të dhënat e ofruara përmes NEATS;

c) këto mjete lejojnë dhe lehtësojnë qasjen te të dhënat e monitoruara për qëllime verifikimi në përputhje me shtojcën IIIa, seksioni 4, të kësaj rregulloreje;

ç) këto mjete garantojnë që të dhënat e monitoruara të ruhen në mënyrë të sigurt për të paktën 2 vjet, dhe ofrojnë funksionet e ruajtjes dhe rikuperimit të të dhënave;

d) këto mjete përputhen me parimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 82, të kësaj rregulloreje.

8. Kur operatori i avionit planifikon të përdorë mjetet e përmendura në pikën 7 të këtij neni, me përjashtim të modulit të konsumit të lëndës djegëse, operatori i avionit duhet fillimisht t'i paraqesë AKM-së specifikimet teknike të këtyre mjeteve. AKM-ja vlerëson specifikimet e mjeteve dhe kur këto mjete përputhen me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, i miraton ato. Pas miratimit operatori i avionit në planin e monitorimit përshkruan specifikimet teknike dhe fluksin e punës së mjeteve.

Neni 64
Monitorimi i të dhënave

1. Operatori i avionit monitoron të dhënat e përmendura në shtojcën IIIa, seksionin 4, të kësaj rregulloreje.

2. Të dhënat e monitoruara, sipas pikës 1, të këtij neni, sigurohen nga vetë operatori i avionit, duke përfshirë të dhënat e siguruara nga pajisjet e regjistrimit të të dhënave të fluturimit të avionit, kur ato janë të disponueshme.

3. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 2 të këtij neni, operatori i avionit mund të zgjedhë të mbështetet, për monitorimin e disa ose të të gjitha të dhënave, mbi këto burime:
a) burime të pavarura të palëve të treta, si p.sh. *Eurocontrol*;
b) NEATS, siç përshkruhet në shtojcën IIIa, Seksionin 2 të kësaj rregulloreje.

4. Kur mungojnë të dhënat mungojnë dhe operatori i avionit provon se nuk është në gjendje t'i rikuperojë ato përmes NEATS ose metodave të tjera, operatori i avionit përdor vlerat standarde, të përcaktuara në shtojcën IIIa, seksioni 5, dhe në shtojcën IIIb, të kësaj rregulloreje.

5. Operatorët e avionit i sigurojnë verifikuesit të akredituar qasje tek të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për verifikimin, duke përfshirë edhe të dhënat konfidenciale. Me kërkesë të operatorit të avionit, AKM e trajton informacionin e paraqitur nga operatori i avionit si konfidencial.

6. Kur NEATS nuk është i disponueshëm dhe përdorimi i tij është i pamundur, operatori i avionit monitoron të paktën, informacionin mbi fluturimin dhe karakteristikat e avionit për çdo fluturim. Në këtë rast, llogaritja e CO_2(e) për çdo fluturim kryhet në një fazë të mëvonshme nga operatori i avionit, dhe jo më vonë se momenti kur NEATS bëhet i disponueshëm nga Komisioni Evropian.

7. Kur nuk është e mundur përdorimi i një modeli të përbashkët reference të NWP-së, për shkak se nuk është i disponueshëm në NEATS, operatori i avionit përdor metodën D, në përjashtim nga parashikimet e pikës 6, të nenit 63, të kësaj rregulloreje. Pasi modeli i përbashkët i referencës së NWP-së vihet në dispozicion, operatori i avionit duhet të përdorë metodën përkatëse në përputhje me pikën 6, të nenit 63, të kësaj rregulloreje.

KREU V
MENAXHIMI DHE KONTROLLI I TË DHËNAVE

Neni 65
Aktivitetet në lidhje me fluksin e të dhënave

1. Operatori i instalimit ose operatori i avionit krijon, dokumenton, zbaton dhe mirëmban procedura të shkruara për aktivitetet që kanë të bëjnë me fluksin e të dhënave që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit garanton që raporti vjetor i shkarkimeve, që hartohet në bazë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave, nuk përmban pasaktësi dhe është në përputhje me planin e monitorimit, me procedurat e shkruara të sipërpërmendura dhe me këtë rregullore.

2. Plani i monitorimit përmban përshkrimin e procedurave me shkrim për aktivitetet e fluksit të të dhënave, duke mbuluar të paktën elementet e mëposhtme:

a) elementet e informacionit të parashikuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 12, të kësaj rregulloreje;

b) identifikimin e burimeve parësore të të dhënave;

c) çdo hallkë në fluksin e të dhënave, duke nisur nga të dhënat parësore deri te shkarkimet vjetore dhe te efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, që pasqyron rendin dhe

ndërveprimin e aktiviteteve të fluksit të të dhënave, përfshirë formulat dhe hapat e zbatuara për bashkimin e të dhënave përkatëse;

ç) hapat përkatës të përpunimit të të dhënave që lidhen me çdo aktivitet specifik të fluksit të të dhënave, duke përfshirë formulat dhe të dhënat e përdorura për përcaktimin e shkarkimeve;

d) sistemet përkatëse elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të përdorura dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre sistemeve dhe format e tjera për futjen e të dhënave, duke përfshirë metodat manuale të futjes së të dhënave;

dh) mënyrën se si regjistrohen rezultatet e veprimtarive të fluksit të të dhënave.

Neni 66
Sistemi i kontrollit

1. Operatori i instalimit ose operatori i avionit krijon, dokumenton, zbaton dhe mban një sistem efektiv kontrolli për të siguruar që raporti vjetor i shkarkimeve si që hartohet në bazë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave nuk përmban pasaktësi dhe është në përputhje me planin e monitorimit dhe me këtë rregullore.

2. Sistemi i kontrollit i përmendur në pikën 1 të këtij neni përbëhet nga elementet e mëposhtme:

a) vlerësimi i rreziqeve të brendshme dhe i rreziqeve të kontrollit që kryhet nga operatori i instalimit ose operatori i avionit bazuar në një procedurë të shkruar për kryerjen e vlerësimit;

b) procedura të shkruara në lidhje me aktivitetet e kontrollit që kanë për qëllim zbutjen e rreziqeve të identifikuara.

3. Procedurat e shkruara në lidhje me aktivitetet e kontrollit, që parashikohen në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, përfshijnë të paktën:

a) sigurimin e cilësisë së pajisjeve matëse;

b) sigurimin e cilësisë së sistemit të teknologjisë së informacionit të përdorur për aktivitetet e fluksit të të dhënave, duke përfshirë teknologjitë informatike për kontrollin e procedurave;

c) ndarjen e detyrave në aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit, dhe menaxhimin e kompetencave të nevojshme;

ç) procedura të brendshme rishqyrtimi dhe vleftësimi të të dhënave;

d) korrigjimet dhe masat e korrigjimit;

dh) kontrollin e proceseve kryerja e të cilave u delegohet burimeve të jashtme;

e) mbajtjen e regjistrave dhe dokumentacionit duke përfshirë administrimin e versioneve të ndryshme të dokumenteve.

4. Operatori i instalimit ose operatori i avionit monitoron efikasitetin e sistemit të kontrollit, duke përfshirë kryerjen e rishikimeve të brendshme dhe duke marrë parasysh gjetjet e verifikuesit të akreditуar gjatë verifikimit të raporteve vjetore të shkarkimeve, të kryera në përputhje me nenet 8 e 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore zbatuese për verifikimin nga verifikuesi i akreditуar.

5. Kurdoherë që sistemi i kontrollit rezulton të jetë joefektiv ose jo në përpjesëtim me rreziqet e identifikuara, operatori i instalimit ose operatori i avionit angazhohet për përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe përditësimin e planit të monitorimit ose të procedurave të shkruara mbështetëse në lidhje me aktivitetet e fluksit të të dhënave, vlerësimet e rrezikut dhe aktivitetet e kontrollit sipas nevojës.

Neni 67
Sigurimi i cilësisë

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 66, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit siguron që të gjitha pajisjet matëse përkatëse të kalibrohen, rregullohen dhe kontrollohen periodikisht, përfshirë periudhën para përdorimit, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me standardet matëse që janë të lidhura me standardet ndërkombëtare të matjes, kur është e mundur, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe proporcionalisht me rreziqet e identifikuara.

2. Kur disa pjesë të sistemeve matëse nuk mund të kalibrohen, operatori i instalimit ose operatori i avionit i përmend ato në planin e monitorim dhe propozon aktivitete kontrolli alternative. Kur zbulohet se pajisja nuk është në përputhje me performancën e kërkuar, operatori i instalimit ose operatori i avionit ndërmerr menjëherë veprimet e nevojshme korrigjuese.

3. Në lidhje me sistemet e matjes së vazhdueshme të shkarkimeve, operatori i instalimit ose operatori i avionit zbaton sigurimin e cilësisë bazuar në standardin e sigurimit të cilësisë së sistemeve të matjes automatike (EN 14181), duke përfshirë matjet paralele me metoda standarde

referimi të paktën një herë në vit, të kryera nga personel i kualifikuar.

4. Kur sigurimi i cilësisë i përmendur në pikën 3 të këtij neni, kërkon përdorimin e vlerave limit të shkarkimeve (VLSh) si parametra të nevojshëm për kontrollin e kalibrimit dhe të performancës, si parametër zëvendësues i VLSh përdoret përqendrimi mesatar vjetor orar i gazit me efekt serrë. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit konstaton një mospërputhje me kërkesat e sigurimit të cilësisë, përfshirë nevojën për të kryer rikalibrimin, raporton këto rrethana tek AKM-ja dhe ndërmerr pa vonesë veprime korrigjuese.

Neni 68
Sigurimi i cilësisë së teknologjisë së informacionit

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 66, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit siguron që sistemi i teknologjisë së informacionit të projektohet, dokumentohet, testohet, zbatohet, kontrollohet dhe mirëmbahet në mënyrë të tillë që të përpunojë të dhëna të besueshme, të sakta dhe të përditësuara në kohë, në përputhje me rreziqet e identifikuara në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 66, të kësaj rregulloreje.

2. Kontrolli i sistemit të teknologjisë së informacionit përfshin kontrollin e aksesit, kontrollin e sistemit të ruajtjes së të dhënave *(back-up),* kontrollin e rikuperimit të të dhënave, të planifikimit të vazhdimësisë dhe të sigurisë.

Neni 69
Ndarja e detyrave

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 66, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit cakton personat përgjegjës për të gjitha aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe për të gjitha veprimtaritë e kontrollit, duke bërë ndarjen e detyrave në mënyrë të tillë që detyrat që krijojnë konflikt interesi të ndahen ndërmjet personave të ndryshëm. Në mungesë të veprimtarive të tjera të kontrollit, operatori i instalimit ose operatori i avionit, për të gjitha veprimtaritë e fluksit të të dhënave në përpjesëtim me rreziqet e brendshme të identifikuara, siguron që çdo informacion dhe e dhënë përkatëse konfirmohet nga të paktën një person që nuk ka qenë i përfshirë në përcaktimin dhe regjistrimin e atij informacioni ose asaj të dhëne.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit garanton që ekzistojnë aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duke përfshirë ndarjen e përshtatshëm të përgjegjësive, trajnimin dhe rishikimin e performancës të personelit.

Neni 70
Shqyrtim i brendshëm dhe vërtetimi i të dhënave

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 66, të kësaj rregulloreje, dhe bazuar te rreziqet e brendshme dhe te rreziqet e kontrollit të identifikuara në vlerësimin e rrezikut të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 66, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit rishikon e verifikon vlefshmërinë e të dhënave, që rezultojnë nga aktivitetet e fluksit të të dhënave të përmendura në nenin 65 të kësaj rregulloreje. Rishikimi dhe verifikimi i vlefshmërisë së të dhënave përfshin, të paktën, këto elemente:

a) kontrollin nëse të dhënat janë të plota;

b) krahasimin e të dhënave që operatori i instalimit ose operatori i avionit ka siguruar, monitoruar e raportuar gjatë disa viteve;

c) krahasimin e të dhënave dhe vlerave, që rezultojnë nga sisteme të ndryshme operative të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë krahasimet e mëposhtme, kur janë të zbatueshme:

i) krahasimin e të dhënave të blerjes së lëndës djegëse ose të materialit me të dhënat e ndryshimeve të stokut dhe me të dhënat e konsumit, të rrymave të shkarkimit përkatëse;

ii) krahasimin e faktorëve të llogaritjes, që janë përcaktuar me anë të analizës, janë llogaritur ose janë siguruar nga furnizuesi i lëndës djegëse ose materialit, me faktorët kombëtarë ose ndërkombëtarë të referencës për lëndët djegëse ose materialet e krahasueshme;

iii) krahasimin e shkarkimeve të llogaritura nga metodologjitë e bazuara në matje me rezultatet që mbështesin llogaritjen në përputhje me nenin 47 të kësaj rregulloreje;

iv) krahasimin e të dhënave të konsoliduara me të dhënat bruto.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit, për aq sa është e mundur, siguron që kriteret për refuzimin e të dhënave si pjesë e procesit të rishikimit dhe verifikimit të vlefshmërisë të jenë të njohura paraprakisht. Për këtë qëllim, kriteret për refuzimin e të dhënave duhet të përcaktohen në dokumentacionin e procedurave përkatëse të shkruara.

Neni 71
Korrigjimet dhe veprimet korrigjuese

1. Kur konstatohet se pjesë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave të përmendura në nenin 65 ose të veprimtarive të kontrollit të përmendura në nenin 66 të kësaj rregulloreje nuk funksionojnë në mënyrë efektive, ose funksionojnë jashtë kufijve të përcaktuar në dokumentacionin e procedurave për ato aktivitete të fluksit të të dhënave dhe ato veprimtari kontrolli, operatori i instalimit ose operatori i avionit bën korrigjimet e nevojshme dhe korrigjon të dhënat e refuzuara, duke shmangur nënvlerësimin e shkarkimeve.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet të kryejë, të paktën, të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) vlerëson vlefshmërinë e rezultateve të arritura nëpërmjet aktiviteteve të fluksit të të dhënave të përmendura në nenin 65 ose nëpërmjet veprimtarive të kontrollit të përmendura në nenin 66 të kësaj rregulloreje;

b) përcakton shkakun e mosfunksionimit ose gabimin përkatës;

c) zbaton masat korrigjuese të përshtatshme, duke përfshirë korrigjimin e çdo të dhëne të prekur në raportin e shkarkimeve, sipas rastit.

3. Operatori i instalimit ose operatori i avionit kryen korrigjimet dhe masat korrigjuese, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në mënyrë që ato t'i përgjigjen rreziqeve të brendshme dhe rreziqeve të kontrollit të identifikuara në vlerësimin e rrezikut të përmendur në nenin 66 të kësaj rregulloreje.

Neni 72
Proceset e deleguara te të tretët

1. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit delegon te një palë e tretë një ose më shumë aktivitete të fluksit të të dhënave të përmendura në nenin 65 ose veprimtari kontrolli të përmendura në nenin 66 të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit ose operatori i avionit kryen të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) verifikon nëse cilësia e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe e veprimtarive të kontrollit të deleguara te të tretët, është në përputhje me këtë rregullore;

b) përcakton parametra të përshtatshme për rezultatet e proceseve të deleguara te të tretët dhe për metodat e përdorura në ato procese;

c) verifikon cilësinë e rezultateve dhe metodave të përmendura në shkronjën "b" të këtij neni;

ç) siguron që aktivitetet e deleguara te të tretët kryhen në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen rreziqeve të brendshme dhe rreziqeve të kontrollit të identifikuara me vlerësimin e rrezikut të përmendur në nenin 66 të kësaj rregulloreje.

Neni 73
Trajtimi i mangësive të të dhënave për raportimin e shkarkimeve

1. Kur mungojnë të dhëna të rëndësishme për përcaktimin e shkarkimeve të një instalimi, operatori i instalimit duhet të përdorë një metodë të përshtatshme vlerësimi për të përcaktuar të dhëna zëvendësuese konservative për periudhën përkatëse kohore dhe për parametrin që mungon.

2. Kur operatori nuk e ka përcaktuar metodën e vlerësimit në një procedurë të shkruar, ai duhet të hartojë një procedurë të tillë të shkruar dhe të paraqesë tek AKM-ja për miratim ndryshimin e nevojshëm të planit të monitorimit, në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje.

3. Kur mungojnë të dhëna të rëndësishme për përcaktimin e shkarkimeve të operatorit të avionit për një ose më shumë fluturime, operatori i avionit përdor të dhëna zëvendësuese për periudhën përkatëse kohore, të llogaritura në përputhje me metodën alternative të përcaktuar në planin e monitorimit.

4. Kur të dhënat zëvendësuese nuk mund të përcaktohen në përputhje me pikën 3, të këtij neni, shkarkimet për atë fluturim ose për ato fluturime mund të vlerësohen nga operatori i avionit duke u bazuar te konsumi i lëndëve djegëse, që përcaktohet duke përdorur një mjet të përmendur në pikën 2, të nenit 61, të kësaj rregulloreje.

5. Kur numri i fluturimeve që kanë mungesa të dhënash, siç përcaktohet në pikat 3 dhe 4, të këtij

neni, tejkalon 5% të fluturimeve vjetore të raportuara, operatori i avionit duhet të informojë AKM-në pa vonesë dhe të ndërmarrë masa korrigjuese për përmirësimin e metodologjisë së monitorimit.

Neni 74
Regjistra dhe dokumente

1. Operatori i instalimit ose operatori i avionit mban regjistrat e të gjitha të dhënave dhe informacionit përkatës, duke përfshirë informacionin e radhitur në shtojcën IX të kësaj rregulloreje, për një periudhë prej jo më pak se 10 vjetësh.

2. Të dhënat e monitorimit të dokumentuara dhe të arkivuara duhet të mundësojnë verifikimin e raporteve vjetore të shkarkimeve nga verifikuesi i akredituar në përputhje me nenet 8 dhe 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Të dhënat e raportuara nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, që mbahen në një sistem elektronik të raportimit dhe menaxhimit të të dhënave të ngritur nga AKM-ja, mund të konsiderohen si të ruajtura nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, nëse këta të fundit kanë akses tek ato të dhëna.

3. Operatori i instalimit ose operatori i avionit garanton që të gjitha dokumentet e nevojshme janë të disponueshme kurdo që duhen për të kryer aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit.

4. Operatori i instalimit ose operatori i avionit i paraqet këto dokumente tek AKM-ja, sapo kërkohen prej saj dhe te verifikuesi i akredituar, që verifikon raportin e shkarkimeve në përputhje me nenet 8 dhe 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore zbatuese, sapo kërkohen prej tij.

KREU VI
KËRKESAT E RAPORTIMIT

Neni 75
Afatet dhe detyrimet e raportimit

1. Operatori i instalimit ose operatori i avionit brenda datës 31 mars të çdo viti, dorëzon në sistemin *on-line* të AKM-së, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" ose më format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së, raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve gjatë periudhës së raportimit (raporti vjetor i shkarkimeve), që është i verifikuar nga verifikuesi i akreditуar, në përputhje me nenet 8 e 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Megjithatë, AKM-ja mund t'i kërkojë operatorit të instalimit ose operatorit të avionit që të dorëzojnë raportin vjetor të shkarkimeve të verifikuar më herët se data 31 mars, por jo përpara datës 28 shkurt.

2. Raportet vjetore të shkarkimeve duhet të përmbajnë të paktën informacionin e parashikuar në shtojcën X të kësaj rregulloreje.

3. Operatori i avionit dorëzon tek AKM-ja, si shtojcë të raportit vjetor të shkarkimeve, një raport të posaçëm që mbulon efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 gjatë vitit të raportimit, në përmbushje të të njëjtave kushte të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Raporti i posaçëm mbi efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 përmban, të paktën, informacionin e përcaktuar në shtojcën X, seksioni 2a, të kësaj rregulloreje. Ky raport dorëzohet nëpërmjet portalit *"e-Albania"* dh /ose me format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së.

Neni 76
Raportimi mbi përmirësimet e metodologjisë së monitorimit

1. Çdo operator instalimi ose operator avionit kontrollon rregullisht nëse metodologjia e monitorimit që po zbaton mund të përmirësohet.

2. Operatori i instalimit duhet dorëzojë pranë AKM-së për miratim, një raport që përmban informacionin e përmendur në pikat 5 ose 6, të këtij neni, sipas rastit, brenda afateve të mëposhtme:

a) për instalimin e kategorisë A, çdo pesë vjet brenda datës 30 qershor;

b) për instalimin e kategorisë B, çdo tre vjet brenda datës 30 qershor;

c) për instalimin e kategorisë C, çdo dy vjet brenda datës 30 qershor.

3. Megjithatë, AKM mund të caktojë një datë tjetër alternative për dorëzimin e raportit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, por jo më vonë se 30 shtatori i po të njëjtit vit . Raporti dorëzohet

nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe/ose më format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së.

4. Në përjashtim nga parashikimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni, dhe pa cenuar pikën 1 të tij, AKM-ja mund të miratojë, së bashku me planin e monitorimit ose raportin e përmirësimit, një zgjatje të afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, nëse operatori i instalimit, kur dorëzon planin e monitorimit, në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje, ose kur kryen njoftimin e përditësimeve në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje, ose kur dorëzon raportin e përmirësimit në përputhje me këtë nen, i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme, që kostot për përmirësimin e metodologjisë janë paarsyeshme dhe masat për përmirësimin e metodologjisë janë teknikisht të pazbatueshme për një periudhë më të gjatë kohore se ajo e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Zgjatja merr parasysh numrin e viteve, për të cilat operatori i instalimit paraqet prova. Në çdo rast, periudha e përgjithshme kohore ndërmjet raporteve të përmirësimit nuk duhet të tejkalojë tre vjet për një instalim të kategorisë C, katër vjet për një instalim të kategorisë B ose pesë vjet për një instalim të kategorisë A. AKM-ja vendos në lidhje me miratimin ose refuzimin e zgjatjes së afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë nga paraqitja e provave nga operatori i instalimit.

5. Kur operatori i instalimit nuk zbaton të paktën shkallët metodologjike të kërkuara në përputhje me pikën 1, të nenit 26, të kësaj rregulloreje, për rrymat e shkarkimit të mëdha dhe të vogla, si dhe në përputhje me nenin 42 të kësaj rregulloreje për burimet e shkarkimeve, operatori i instalimit paraqet argumentet e tij pse përdorimi i këtyre shkallëve metodologjike është teknikisht i pazbatueshëm ose do të sillte kosto të paarsyeshme. Megjithatë, kur gjenden prova se masat e nevojshme për të realizuar përdorimin e shkallës metodologjike të kërkuar janë bërë teknikisht të zbatueshme dhe nuk sjellin më kosto të paarsyeshme, operatori i instalimit njofton AKM-në për ndryshimet e nevojshme të planit të monitorimit, në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje, si dhe paraqet tek AKM-ja propozimet për zbatimin e masave përkatëse dhe afatet e tyre.

6. Kur operatori i instalimit zbaton një metodologji monitorimi rezervë, siç përcaktohet në nenin 22 të kësaj rregulloreje, ai duhet të paraqesë një arsyetim se pse zbatimi i të paktën shkallës metodologjike 1 për një ose më shumë rryma shkarkimi të mëdha ose të vogla është teknikisht e pazbatueshme ose do të sillte kosto të paarsyeshme. Megjithatë, kur gjenden prova se masat e nevojshme për të realizuar përdorimin e të paktën shkallës metodologjike 1, janë bërë teknikisht të zbatueshme dhe nuk sjellin më kosto të paarsyeshme për ato rryma shkarkimi, operatori i instalimit njofton AKM-në për ndryshimet e nevojshme të planit të monitorimit, në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje, si dhe paraqet tek AKM-ja propozimet për zbatimin e masave përkatëse dhe afatet e tyre.

7. Kur raporti i verifikimit, i hartuar nga verifikuesi i akreditуar në përputhje me nenet 8 dhe 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, identifikon ekzistencën e mospërputhjeve të pazgjidhura ose paraqet rekomandime për përmirësime operatori i instalimit ose operatori i avionit dorëzon tek AKM-ja për miratim deri në datën 30 qershor të vitit, në të cilin është lëshuar raporti i verifikimit nga verifikuesi i akreditуar, një raport. Raporti përshkruan se si dhe kur operatori i instalimit ose operatori i avionit ka korrigjuar ose planifikon të korrigjojë mospërputhjet e identifikuara nga verifikuesi i akreditуar dhe të zbatojë përmirësimet e rekomanduara prej tij.

8. AKM-ja mund të caktojë një datë alternative për dorëzimin e raportit të përmendur në pikën 7, të këtij neni, por jo një datë më të vonë se 30 shtatori i të njëjtit vit. Kur është e zbatueshme, ky raport mund të bashkohet me raportin e përmendur në pikën 2 të këtij neni.

9. Kur përmirësimet e rekomanduara nuk sjellin një përmirësim të metodologjisë së monitorimit, operatori i instalimit ose operatori i avionit paraqesin argumentet e tyre në mbështetje të këtij pretendimi. Kur përmirësimet e rekomanduara do të sillnin kosto të paarsyeshme, operatori i instalimit ose operatori i avionit paraqesin prova mbi natyrën e paarsyeshme të këtyre kostove.

10. Pikat 7, 8 dhe 9, të këtij neni, nuk zbatohet kur operatori i instalimit ose operatori i avionit i ka zgjidhur tashmë të gjitha mospërputhjet dhe rekomandimet për përmirësim dhe ka dorëzuar ndryshimet përkatëse të planit të monitorimit tek AKM-ja për miratim, në përputhje me nenin 15 të

kësaj rregulloreje, përpara datave të përcaktuara në pikat 7 e 8, të këtij neni.

Neni 77
Përcaktimi i shkarkimeve nga AKM-ja

1. AKM-ja bën një vlerësim konservativ të shkarkimeve të një instalimi ose të operatorit të avionit dhe, kur është e zbatueshme, të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 të një operatori avioni, kur verifikohet një nga situatat e mëposhtme:

a) operatori i instalimit ose operatori ajror nuk ka dorëzuar raportin e shkarkimeve vjetore të verifikuar nga verifikuesi i akreditуar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 75, të kësaj rregulloreje;

b) raporti i shkarkimeve vjetore i verifikuar nga verifikuesi i akreditуar i përmendur në pikën 1, të nenit 75, të kësaj rregulloreje, nuk është në përputhje me dispozitat e saj;

c) raporti vjetor i shkarkimeve i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk është verifikuar nga verifikuesi i akreditуar, në përputhje me parashikimet e neneve 8 e 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore zbatuese.

2. Kur verifikuesi i akreditуar ka deklaruar, në raportin e verifikimit të hartuar në përputhje me parashikimet e neneve 8 e 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore zbatuese, ekzistencën e pasaktësive të parëndësishme, që nuk janë korrigjuar nga operatori i instalimit ose operatori i avionit përpara lëshimit të raportit të verifikimit, AKM-ja shqyrton këto pasaktësi dhe jep një vlerësim konservativ të shkarkimeve dhe, kur është rasti, të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 të instalimit ose operatorit të avionit. AKM-ja informon operatorin e instalimit ose operatorin e avionit, nëse është e nevojshme korrigjohet raporti vjetor i shkarkimeve dhe cilat korrigjime duhen kryer. Operatori i instalimit ose operatori i avionit vendos këtë informacion në dispozicion të verifikuesit të akreditуar.

Neni 78
Aksesi në informacion

1. Raportet vjetore të shkarkimeve që mbahen nga AKM vihen në dispozicion të publikut, përveç rasteve kur vënia në dispozicion e tyre kufizohet nga parashikimet e nenit 17, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. Operatori i instalimit ose operatori avionit mund të tregojnë në raportet e tyre cilin informacion e konsiderojnë si sekret tregtar ose si informacion që duhet ti nënshtrohet kufizimeve të tjera të parashikuara në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Neni 79
Rrumbullakosja e të dhënave

1. Shkarkimet totale vjetore të secilit prej gazeve me efekt serrë CO_2, N_2O dhe PFC-ve, si dhe efektet në aviacion, të palidhura me shkarkimin e CO_2, duhet të raportohen si ton të CO_2 ose CO_2(e) të rrumbullakosura. Shkarkimet totale vjetore të instalimit llogariten si shuma e vlerave të rrumbullakosura për CO_2, N_2O dhe PFC.

2. Të gjithë treguesit që përdoren për të llogaritur shkarkimet rrumbullakosen, që të përfshijnë të gjitha shifrat me rëndësi, për qëllim të llogaritjes dhe raportimit të shkarkimeve.

Neni 80
Përputhshmëria me raportimet e tjera

Çdo aktivitet i renditur në shtojcën II, pjesët A dhe B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që kryhet nga operatori i instalimit ose operatori avionit, duhet të etiketohet duke përdorur kodet nga skemat e mëposhtme të raportimit, kur kjo është e zbatueshme:

a) me formatin e përbashkët të raportimit për sistemet kombëtare të inventarit të gazeve serrë, siç është miratuar nga organet përkatëse të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;

b) me numrin e identifikimit të instalimit në regjistrin evropian të lëshimit dhe transferimit të ndotësve, në përputhje me rregulloren (KE) nr. 166/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

c) me veprimtaritë e shtojcës I, të rregullores (KE) nr. 166/2006;

ç) kodi NACE, në përputhje me rregulloren (KE) nr. 1893/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (2).

KREU VII
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Neni 81
Formatet e shkëmbimit të të dhënave elektronike

1. AKM-ja i kërkon operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit të përdorin modele elektronike ose formate të standardizuara për paraqitjen e planeve të monitorimit e të ndryshimeve në planin e monitorimit, si dhe për paraqitjen e raporteve vjetore të shkarkimeve, raporteve të verifikimit dhe të raporteve të përmirësimit.

2. Në zbatim të pikës 1, më sipër, AKM-ja vendos në dispozicion të operatorit të instalimit dhe të operatorit të avionit modelet elektronike ose formatet e standardizuara, sipas variantit më të përditësuar, të publikuar nga Komisioni Evropian, të përshtatura e të përkthyera në gjuhën shqipe.

3. Kur përcaktohen formatet elektronike ose specifikimet e dosjeve elektronike, që përdoren në përputhje me parashikimet e pikës 2, të këtij neni, AKM-ja mund të zgjedhë, në përputhje me risitë e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që miratohen në Republikën e Shqipërisë, një ose të dyja opsionet e mëposhtme:

a) Përdorimin e specifikimeve të formateve elektronike, të bazuara në XML, si p.sh. te gjuha e raportimit, e publikuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të procesit të monitorimit dhe të raportimit të shkarkimeve GES, që përdoret në lidhje me sistemet e automatizuara të përparuara;

b) Formate të publikuara nga AKM-ja në një formë që përdoret nga *software*-i, standard i AKM-së, përfshirë fletë elektronike me funksione llogaritëse (p.sh. *Microsoft Excel .xlsx, .xls* etj) dhe dokumentet e përpunimit të tekstit (*p.sh. Microsoft Word .docx, .doc* etj).

Neni 82
Përdorimi i sistemeve të automatizuara

1. Kur përdoren sisteme të automatizuara për shkëmbimin elektronik të të dhënave, të bazuara në specifikimet e formateve elektronike, në përputhje me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 81, të kësaj rregulloreje, këto sisteme, nëpërmjet përdorimit të masave teknologjike, që përputhen me arritjet aktuale të teknologjisë dhe duke u kujdesur që të jenë kosto-efikase, sigurojnë plotësimin e standardeve të mëposhtme:

a) Integritetin e të dhënave, duke parandaluar ndryshimin e mesazheve elektronike gjatë transmetimit;
b) Konfidencialitetin e të dhënave, përmes përdorimit të teknikave të sigurisë, përfshirë teknikave të enkriptimit, në mënyrë që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm nga pala, për të cilën janë destinuar dhe që asnjë e dhënë të mos mund të përgjohet nga palë të paautorizuara;
c) Autenticitetin e të dhënave, në mënyrë që identiteti, si i dërguesit ashtu edhe i marrësit të të dhënave, të njihet dhe të verifikohet;

ç) Pamundësinë për të mohuar të dhënat, në mënyrë që njëra palë e një transaksioni të mos ketë mundësi të mohojë se e ka marrë transaksionin dhe pala tjetër të mos ketë mundësi të mohojë se e ka dërguar atë, duke zbatuar metoda të tilla, si teknikat e nënshkrimit ose auditimi i pavarur i masave mbrojtëse të sistemit.

2. Çdo sistem i automatizuar i përdorur, i bazuar në specifikimet e formateve elektronike, në përputhje me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 81, të kësaj rregulloreje, për komunikimin ndërmjet AKM-së, operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit, si dhe verifikuesit të akredituar dhe drejtorisë së përgjithshme të akredimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore zbatuese, përdor masat teknologjike, që përputhen me arritjet aktuale të teknologjisë dhe plotëson kërkesat jofunksionale të mëposhtme:

a) Kontrollin e aksesit, në mënyrë që sistemi të jetë i aksesueshëm vetëm nga palët e autorizuara dhe asnjë e dhënë të mos mund të lexohet, shkruhet ose përditësohet nga palë të paautorizuara, përmes zbatimit të masave teknologjike për të arritur zbatimin e masave të mëposhtme:
i) Kufizimin e aksesit fizik të *hardware*-ve, te të cilët bazohen sistemet e automatizuara, duke vendosur barriera fizike;

ii) Kufizimin e aksesit logjik te sistemet e automatizuara, përmes përdorimit të teknologjive për identifikimin, autentifikimin dhe autorizimin;

b) Disponueshmërinë e të dhënave, në mënyrë që të sigurohet aksesueshmëria e të dhënave edhe pas kalimit të një periudhe të konsiderueshme kohe dhe përdorimit të *softwere*-ve të rinj të mundshëm;

c) Gjurmueshmërinë e auditimit, në mënyrë që të sigurohet që ndryshimet te të dhënat të mund të identifikohen dhe të analizohen gjithmonë në retrospektivë.

KREU VIII
MONITORIMI I SHKARKIMEVE TË SUBJEKTIT TË RREGULLUAR

SEKSIONI 1
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 83
Detyrimet e subjektit të rregulluar

Detyrimet e subjektit të rregulluar në lidhje me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me parimet e përcaktuara në nenet 5 deri në 9, të kësaj rregulloreje.

Neni 84
Monitorim dhe raportim i plotë

1. Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve kryhen në mënyrë të plotë dhe mbulojnë të gjitha shkarkimet që shkaktohen nga të rrymat e lëndëve djegëse, që u përkasin aktiviteteve të përcaktuara në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, si dhe të gjitha gazet me efekt serrë të specifikuara në lidhje me sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, duke shmangur llogaritjen e dyfishtë.

2. Subjekti i rregulluar ka detyrimin të marrë masat e nevojshme për të shmangur, që gjatë periudhës së raportimit, të ketë çfarëdolloj mangësie te të dhënat.

3. Çdo referencë ndaj lëndës djegëse ose materialeve në lidhje me subjektin e rregulluar, që përmenden në këtë kre, përkon me përkufizimin e termit "lëndë djegëse", të parashikuar në pikën 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

Neni 85
Koherenca, krahasueshmëria dhe transparenca

1. Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve duhet të jenë koherentë dhe të krahasueshëm në kohë. Për këtë qëllim, subjekti i rregulluar përdor të njëjtat metodologji monitorimi dhe të njëjtat grupe të dhënash, përveçse kur AKM-ja miraton ndryshimet dhe përjashtimet.

2. Subjekti i rregulluar mbledh, regjistron, përpilon, analizon dhe dokumenton të dhënat e monitorimit, përfshirë supozimet, referencat, sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum, faktorët e llogaritjes dhe faktorin sektorial, me metoda transparente, që i mundëson verifikuesit dhe AKM-së të riprodhojnë procesin e llogaritjes së shkarkimeve, që është përdorur nga subjekti i rregulluar.

Neni 86
Saktësia

1. Subjekti i rregulluar sigurohet që vlerat e shkarkimeve nuk janë të pasakta, në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme.

2. Subjekti i rregulluar ka detyrimin të identifikojnë dhe të kufizojnë sa më shumë që të jetë e mundur çdo burim pasaktësie.

3. Subjekti i rregulluar ka detyrimin të ushtrojnë kujdesin e duhur për të siguruar që llogaritja dhe matja e shkarkimeve të ketë saktësinë më të lartë të arritshme.

Neni 87
Integriteti i të dhënave dhe metodologjia

1. Subjekti i rregulluar ka detyrimin të garantojë integritetin e të dhënave të raportuara në lidhje me shkarkimet GES, duke përdorur metodologjitë e duhura të monitorimit për llogaritjen e shkarkimeve GES, të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Të dhënat e raportuara mbi shkarkimet GES dhe dokumentacioni i tyre shoqërues nuk duhet të përmbajnë pasaktësi domethënëse, duhet të shmangin manipulimin në zgjedhjen e në paraqitjen e informacionit dhe duhet të japin një pasqyrë të besueshme e të ekuilibruar të shkarkimeve GES nga subjekti i rregulluar.

3. Për zgjedhjen e metodologjisë së monitorimit duhet të bëhet një balancë mes përmirësimeve metodologjike, që ofrojnë një nivel më të lartë saktësie, dhe rritjes së kostove që këto përmirësime sjellin. Si rrjedhojë, monitorimi dhe raportimi duhet të synojnë saktësinë më të lartë të arritshme, përveç

rasteve kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme ose sjell kosto të paarsyeshme.

Neni 88
Përmirësimi i vazhdueshëm

Subjekti i rregulluar, kur kryen monitorimin dhe raportimin e rradhës, është i detyruar të marrë parasysh rekomandimet, që verifikuesi i akreditуar ka përfshirë në raportin e verifikimit të hartuar prej tij, në përputhje me paragrafin 3, të nenit 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

Neni 89
Koordinimi

Autoritetet kompetente për monitorimin dhe raportimin e GES-it koordinohen sa herë që kjo është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre funksionale, të përcaktuara nga ligji nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe nga kjo rregullore.

SEKSIONI 2
PLANET E MONITORIMIT

Neni 90
Detyrim i përgjithshëm

1. Çdo subjekt i rregulluar ka detyrimin e monitorimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë. Monitorimi kryhet në bazë të planit të monitorimit, që hartohet nga subjekti i rregulluar dhe miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), sipas parashikimeve të nenit 91, të kësaj rregulloreje, duke marrë parasysh natyrën dhe funksionimin e aktivitetit të subjektit të rregulluar, ndaj të cilit zbatohet.

2. Plani i monitorimit shoqërohet nga procedura të shkruara, që parashikohen, dokumentohen, zbatohen dhe ruhen në mënyrë të përshtatshme nga subjekti i rregulluar, në lidhje me veprimtaritë, që mbulohen nga plani i monitorimit.

3. Plani i monitorimit, i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmban udhëzimet për subjektin e rregulluar, të cilat pasqyrohen në mënyrë logjike dhe të thjeshtë, duke shmangur ripërsëritjen e veprimeve e duke marrë parasysh sistemet ekzistuese të përdorura nga subjekti i rregulluar.

Neni 91
Përmbajtja dhe dorëzimi i planit të monitorimit për miratim nga AKM-ja

1. Çdo subjekt i rregulluar harton planin e monitorimit, në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, dhe dorëzon atë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për miratim.

2. Në rastin e subjekteve të rregulluara, që nisin për herë të parë ushtrimin e aktiviteteve, të parashikuara në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, ato dorëzojnë planin e monitorimit pranë AKM-së për miratim, të paktën 4 (katër) muaj përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit, përveç rasteve kur AKM-ja përcakton një afat kohor tjetër.

3. Plani i monitorimit përbëhet nga një përshkrim i detajuar, i plotë dhe transparent i metodologjisë së monitorimit të subjektit të rregulluar dhe duhet të përmbajë të paktën elementet e përcaktuara në shtojcën I, të kësaj rregulloreje. Subjekti i rregulluar paraqet, së bashku me planin e monitorimit, rezultatet e vlerësimit të rrezikut, që dëshmojnë se aktivitetet e kontrollit të propozuara dhe procedurat përkatëse janë në përpjesëtim me rreziqet e brendshme dhe me rreziqet e identifikuara nga kontrolli.

4. Në rastet kur shtojca I, e kësaj rregulloreje, i referohet procedurës, procedura do të përcaktohet, do të dokumentohet, do të zbatohet dhe do të ruhet nga subjekti i rregulluar veçmas nga plani i monitorimit.

5. Subjekti i rregulluar brenda planit të monitorimit jep një përmbledhje të procedurave, duke ofruar informacionin e mëposhtëm:

a) Titullin e procedurës;

b) Një referencë të gjurmueshme dhe të verifikueshme, që mundëson identifikimin e procedurës;

c) Identifikimin e profilit profesional përgjegjës ose të departamentit përgjegjës për zbatimin e procedurës dhe për të dhënat e krijuara ose të menaxhuara nga procedura;

ç) Një përshkrim të shkurtër të procedurës, që i jep mundësinë subjektit të rregulluar, AKM-së dhe verifikuesit të akreditуar, të kuptojnë parametrat thelbësorë dhe operacionet e kryera;

d) Vendin ku mbahen regjistrat e të dhënave dhe informacionet përkatëse;

dh) Emrin e sistemit kompjuterik të përdorur, kur ka një të tillë;

e) Një listë të standardeve evropiane (EN) ose të standardeve të tjera që zbatohen, sipas rastit.

6. Subjekti i rregulluar vendos në dizpozicion të AKM-së çdo dokument të shkruar në lidhje me procedurat, menjëherë kur kërkohen prej saj, si dhe i vendos ato në dispozicion të verifikuesit të akreditуar, për qëllim të kryerjes së verifikimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

7. Subjekti i rregulluar aplikon në sistemin *on-line* të AKM-së, nëpërmjet portalit "*e-Albania*", sipas udhëzimeve të AKM-së për miratimin e planit të monitorimit dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin e monitorimit të hartuar në përputhje me pikën 1, 3 dhe 5 të këtij neni, dhe me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe sipas formatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 92, të kësaj rregulloreje;

b) Rezultatet e vlerësimit të rrezikut në përputhje me pikën 3, të këtij neni;

c) Kërkesën për përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit në përputhje me nenin 92 të kësaj rregulloreje, kur është rasti;

ç) Mandatpagesën për tarifën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh për procesin e shqyrtimit dhe miratimit të planit të monitorimit;

8. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit, për miratimin e planit të monitorimit verifikon nëse:

a) dokumentacioni është depozituar i saktë dhe i plotë, sipas pikës 7, të këtij neni;

b) plani i monitorimit është hartuar në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

c) janë përmbushur kushtet e nenit 92 për përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit;

9. Kur AKM-ja konstaton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rregulluar nuk është i plotë, ka pasaktësi apo se plani i monitorimit nuk është hartuar në përputhje me këtë rregullore, njofton subjektin e rregulluar, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara ose korrigjimin e planit të monitorimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e njoftimit. Brenda të njëjtit afat, AKM-ja mund të kërkojë nga subjekti i rregulluar edhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë, sipas pikës 6, të këtij neni, ose paraqitjen e vlerësimit të rrezikut për planin e thjeshtuar të monitorimit, sipas pikës 2, të nenit 92, të kësaj rregulloreje. Mosplotësimi i kërkesave të AKM-së, brenda afatit të përcaktuar, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Subjekti i rregulluar njoftohet për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.

10. AKM-ja, kur vlerëson se janë përmbushur kushtet e pikës 8, të këtij neni, nis procesin e shqyrtimit të kërkesës së miratimit të planit të monitorimit dhe vendos, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh punë nga paraqitja e aplikimit, sipas pikës 7, të këtij neni, ose nga plotësimi dhe korrigjimi i dokumentacionit, sipas pikës 8, të këtij neni:

a) miratimin e planit të monitorimit, kur konstaton se është në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

b) refuzimin e miratimin, kur konstaton se plani i monitorimit nuk është në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban, administron dhe përditëson të dhënat e planeve të monitorimit të miratuara dhe siguron ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave. Mënyra e administrimit dhe formati i të dhënave miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 92

Plani i monitorimit standard dhe i thjeshtuar

1. Subjekti i rregulluar përdor plane monitorimi të standardizuara, që bazohen në formatet dhe udhëzimet zyrtare, të botuara nga Komisioni Evropian. Planet e monitorimit përmbajnë një përshkrim të fluksit të të dhënave e të procedurave të kontrollit, të parashikuara në nenet 65 dhe 66, të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti i rregulluar përdor plane monitorimi të thjeshtuar kur autorizohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me parashikimet e nenit 91, të kësaj rregulloreje. Para se të autorizojë përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit, AKM-ja kryen një vlerësim të thjeshtuar të rrezikut, me qëllim përcaktimin nëse aktivitetet e kontrollit të propozuara dhe procedurat përkatëse janë proporcionale me rreziqet e brendshme dhe me rreziqet e kontrollit të identifikuara, si dhe argumenton përdorimin e planit të thjeshtuar të monitorimit. Nëse është e nevojshme, AKM-ja mund t'i kërkojë subjektit të

rregulluar të kryejë vetë vlerësimin e rrezikut dhe t'ia paraqesë AKM-së për shqyrtim.

3. Plani i thjeshtuar i monitorimit bazohet në formatet dhe udhëzimet zyrtare të botuara nga Komisioni Evropian.

4. AKM-ja vendos në dispozicion të subjektit të rregulluar formatet e planit të monitorimit të standardizuar dhe të planit të monitorimit të thjeshtuar, të botuara nga Komisioni Evropian, të përshtatura e të përkthyera në gjuhën shqipe.

Neni 93
Ndryshimi i planit të monitorimit

1. Çdo subjekt i rregulluar verifikon rregullisht nëse plani i monitorimit pasqyron natyrën dhe funksionimin e aktivitetit të subjektit të rregulluar, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe verifikon nëse metodologjia e monitorimit mund të përmirësohet.

2. Subjekti i rregulluar ka detyrimin të ndryshojë planin e monitorimit, të paktën në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur shkaktohen shkarkime të reja për shkak se kryhen aktivitete të reja ose për shkak të përdorimit të lëndëve djegëse ose të materialeve të reja, që nuk janë përfshirë ende në planin e monitorimit;

b) Kur për shkak të përdorimit të instrumenteve të reja matëse, metodologjive të reja për marrjen e mostrave ose metodologjive të reja të analizimit apo për arsye të tjera, ka ndryshime te të dhënat e disponueshme, që sjellin në një saktësi më të lartë në përcaktimin e shkarkimeve;

c) Është konstatuar, që të dhënat e nxjerra nga metodologjia e monitorimit, e zbatuar më parë, janë të pasakta;

ç) Kur ndryshimi i planit të monitorimit përmirëson saktësinë e të dhënave të raportuara, përveç rasteve kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme;

d) Kur AKM-ja i kërkon subjektit të rregulluar ndryshimin e planit të monitorimit, pasi konstaton se plani i monitorimit i dorëzuar nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

dh) Kur raporti i verifikimit të verifikuesit të akredituar sugjeron se është e nevojshme të përmirësohet plani i monitorimit.

Neni 94
Miratimi i ndryshimeve të planit të monitorimit

1. Ndryshimet e planit të monitorimit, të propozuara nga subjekti i rregulluar, që nuk konsiderohen si ndryshime të rëndësishme, sipas paragrafit 3, të këtij neni, i njoftohen AKM-së menjëherë nga subjekti i rregulluar nëpërmjet aplikimit elektronik. Ndryshimet e parëndësishme të planit të monitorimit nuk kanë nevojë për një akt miratimi nga AKM-ja dhe ato konsiderohen të pranuara nga AKM-ja me paraqitjen e njoftimit nga subjekti i rregulluar. Kur AKM-ja konsideron se ndryshimi i propozuar dhe i njoftuar i planit të monitorimit përbën një ndryshim të rëndësishëm, informon menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e njoftimit, subjektin e rregulluar, duke përcaktuar se ndryshimet e njoftuara do t'i nënshtrohen procedurës së miratimit të ndryshimeve, sipas pikës 4, më poshtë.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga subjekti i rregulluar, që konsiderohet si ndryshim i rëndësishëm i planit të monitorimit, sipas pikës 3, të këtij neni, i njoftohen menjëherë AKM-së me qëllim marrjen e miratimit prej saj. Për këtë qëllim, subjekti i rregulluar aplikon menjëherë pranë AKM-së për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit të propozuara. Kur AKM-ja konsideron se ndryshimi i propozuar dhe i njoftuar i planit të monitorimit nuk përbën një ndryshim të rëndësishëm dhe nuk është i nevojshëm miratimi i ndryshimit, informon menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e njoftimit, subjektin e rregulluar.

3. Konsiderohen ndryshime të rëndësishme të planit të monitorimit të subjektit të rregulluar:

a) ndryshime të kategorisë së subjektit të rregulluar, kur këto ndryshime kërkojnë një ndryshim të metodologjisë së monitorimit ose çojnë në një ndryshim të pragut të rëndësisë, siç përcaktohet në rregulloren për verifikimin e shkarkimeve të GES-it nga verifikuesi i akredituar, miratuar në përputhje me parashikimet e nenit 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

b) ndryshimet që kanë të bëjnë me kategorizimin e subjektit të rregulluar si "subjekt i rregulluar me shkarkime të ulëta", pavarësisht parashikimeve të nenit 114, të kësaj rregulloreje;

c) ndryshimi i shkallës metodologjike të zbatuar;

ç) përfshirja e rrymave të reja të lëndëve djegëse;

d) ndryshim i kategorizimit të lëndëve djegëse, nga rryma madhore lëndësh djegëse në rryma minimale (*de minimis*) lëndësh djegëse, në rastet kur ky ndryshim kërkon edhe ndryshim të metodologjisë së monitorimit;

dh) ndryshimi i vlerës standarde të një faktori llogaritjeje, kur kjo vlerë duhet të përcaktohet në planin e monitorimit;

e) ndryshimi i vlerës standarde të faktorit sektorial;

ë) përdorimi i metodave të reja ose ndryshimi i metodave ekzistuese në lidhje me marrjen e mostrave, analizave ose kalibrimit, kur kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në saktësinë e të dhënave të shkarkimeve;

4. Pas aplikimit nga subjekti i rregulluar, për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit, sipas përkufizimit të pikës 3, të këtij neni, AKM-ja:

a) miraton ndryshimet e planit të monitorimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit për miratimin e ndryshimeve të rëndësishme të planit të monitorimit.

b) kur konstaton se ndryshimet e planit të monitorimit nuk janë të qarta ose të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm, sipas nenit 91, të kësaj rregulloreje, ose të hartuara në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, AKM-ja njofton menjëherë subjektin e rregulluar dhe kërkon plotësimin dhe korrigjimin e dokumentacionit, brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i kërkesave të AKM-së, brenda afatit të përcaktuar, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar;

c) miraton ndryshimet e planit të monitorimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së plotësimeve dhe korrigjimeve nga subjekti i rregulluar, të kërkuara sipas shkronjës "b", më sipër.

Neni 95
Zbatimi dhe regjistrimi i ndryshimeve të planit të monitorimit

1. Përpara marrjes së miratimit ose informacionit nga AKM-ja, sipas pikës 2, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar mund të kryejë monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, duke përdorur planin e ndryshuar të monitorimit, me kusht që të ketë bindjen e arsyeshme që ndryshimet e propozuara nuk janë ndryshime domethënëse të planit të monitorimit ose kur kryerja e monitorimit, duke përdorur planin origjinal të monitorimit, do të sillte mbledhjen e të dhënave të paplota të shkarkimeve.

2. Në rast se ka dyshime, subjekti i rregulluar duhet të përdorë paralelisht planin e monitorimit origjinal dhe planin e monitorimit të ndryshuar, duke kryer monitorimin dhe raportimin, në përputhje me të dyja planet, dhe duhet të dokumentojë rezultatet e monitorimit, që rrjedhin nga të dyja planet e monitorimit.

3. Pas marrjes së miratimit ose informacionit nga AKM-ja, sipas pikës 2, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar përdor vetëm të dhënat e mbledhura, duke përdorur planin e ndryshuar të monitorimit. Që nga data kur AKM-ja miraton ndryshimet e planit të monitorimit ose informon sipas pikës 2, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar kryen monitorimin dhe raportimin, duke përdorur vetëm planin e monitorimit të ndryshuar.

4. Subjekti i rregulluar duhet të regjistrojë të gjitha ndryshimet e planit të monitorimit. Çdo regjistrim duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të qartë të ndryshimit të planit të monitorimit;

b) arsyen e ndryshimit të planit të monitorimit;

c) datën kur AKM-ja është njoftuar për ndryshimin e planit të monitorimit, në përputhje me pikën 1, të nenit 94, të kësaj rregulloreje;

ç) datën në të cilën AKM-ja konfirmoi marrjen e njoftimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, kur është e mundur, dhe datën e miratimit ose të informacionit nga AKM-ja, të parashikuar pikën 1, të nenit 94, të kësaj rregulloreje;

d) datën kur nis zbatimi i planit të ndryshuar të monitorimit, në përputhje me pikën 3, të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI 3
MONITORIMI I SHKARKIMEVE

Neni 96
Fizibiliteti teknik

1. Kur subjekti i rregulluar pretendon se përdorimi i një metodologjie specifike monitorimi

nuk është teknikisht e zbatueshme, AKM-ja shqyrton këtë pretendim dhe vlerëson zbatueshmërinë teknike, duke marrë në konsideratë argumentet e subjektit të rregulluar.

2. Subjekti i rregulluar argumenton mungesën e fizibilitetit teknik duke paraqitur pranë AKM-së fakte që dëshmojnë mungesën e burimeve teknike që i mundësojnë përmbushjen e nevojave të sistemit ose të kërkesave të propozuara, dhe pamundësinë që këto burimet teknike të mund të aktivizohen brenda afatit të kërkuar për përmbushjen e qëllimeve të kësaj rregulloreje. Burimet teknike të përmendura më lart, përfshijnë disponueshmërinë e teknikave dhe teknologjive të nevojshme.

Neni 97
Kostot e paarsyeshme

1. Kur subjekti i rregulluar pretendon se përdorimi i një metodologjie specifike monitorimi do të shkaktonte kosto të paarsyeshme, AKM-ja vlerëson nëse kostot janë të paarsyeshme, duke marrë në konsideratë argumentet e subjektit të rregulluar.

2. AKM-ja i konsideron kostot të paarsyeshme kur kostot e pritshme tejkalojnë përfitimin. Për këtë qëllim, përfitimi llogaritet duke shumëzuar një faktor përmirësimi me çmimin e referencës prej 60 eurosh për shkarkimin e 1 toni metrik CO_2. Kostot përfshijnë një periudhë të përshtatshme të amortizimit të pajisjeve, bazuar në jetëgjatësinë ekonomike të pajisjeve.

3. Pavarësisht parashikimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, subjekti i rregulluar merr në konsideratë kostot e zbatimit të një metodologjie specifike monitorimi, që përballohen nga konsumatorët e rrymave të lëndëve djegëse të hedhura për konsum, përfshirë edhe kostot që përballohen nga konsumatorët fundor. Për qëllimet e kësaj pike, subjekti i rregulluar mund të zbatojë vlerësime konservatore të kostove.

4. Kur vlerëson nëse kostot janë të paarsyeshme, në lidhje me zgjedhjen e shkallëve metodologjike për sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum nga subjekti i rregulluar, AKM-ja përdor si faktor përmirësimi të përmendur në pikën 2, të këtij neni, diferencën ndërmjet pasigurisë ekzistuese dhe pragut të pasigurisë së shkallës metodologjike, që do të arrihej nëse do të zbatohej përmirësimi, të shumëzuar me shkarkimet mesatare vjetore të shkaktuara nga ajo rrymë lënde djegëse gjatë tri viteve të fundit.

5. Në mungesë të të dhënave për shkarkimet mesatare vjetore të shkaktuara nga ajo rrymë lënde djegëse gjatë tri viteve të fundit, subjekti i rregulluar duhet të paraqesë një vlerësim konservativ të shkarkimeve mesatare vjetore, duke përjashtuar CO_2, që buron nga lëndët djegëse me normë zero. Për instrumentet matëse, që i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor kombëtar, pasiguria aktualisht e arritur mund të zëvendësohet me gabimin maksimal të lejuar gjatë përdorimit, sipas legjislacionit përkatës. Për qëllimet e këtij paragrafi, do të zbatohen pika 5, e nenit 38, dhe pikat 4 e 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, me kusht që subjekti i rregulluar të ketë në dispozicion informacionin përkatës për kriteret e qëndrueshmërisë dhe kursimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse me normë zero të përdorura për djegie.

6. Kur vlerësohet natyra e paarsyeshme e kostove në lidhje me zgjedhjen e shkallëve metodologjike për përcaktimin e faktorit sektorial të subjektit të rregulluar dhe në lidhje me masat që rrisin cilësinë e të dhënave të raportuara shkarkimeve, por që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë për saktësinë e të dhënave të sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum, AKM-ja përdor një faktor përmirësimi prej 1% të shkarkimeve mesatare vjetore të rrymave të lëndës djegëse përkatëse në tri periudhat e fundit të raportimit. Masat që rrisin cilësinë e raportimit të shkarkimeve, por që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë për saktësinë e të dhënave të sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum përfshijnë:

a) përdorimin e analizave në vend të vlerave standarde për të përcaktuar faktorët e llogaritjes;

b) rritjen e numrit të analizave të kryera për çdo rrymë lënde djegëse;

c) zëvendësimin e instrumenteve matëse, funksionet matëse specifike të të cilave nuk janë subjekt i kontrollit metrologjik ligjor, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, me instrumente që plotësojnë kërkesat e kontrollit metrologjik ligjor të legjislacionit shqiptar, që përdoren në procedura të ngjashme, ose me instrumente matëse, që përputhen me standardet e BE-së të përcaktuara në direktivën 2014/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ose direktivën 2014/32/BE;

ç) kryerjen e kalibrimit dhe mirëmbajtjes të instrumenteve matëse në intervale më të shpeshta;

d) përmirësimin e aktiviteteve të menaxhimit të të dhënave dhe aktiviteteve të kontrollit që zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e brendshëm ose kontrollin e rrezikut;

dh) përdorimin nga subjekti i rregulluar i një identifikimi më të saktë të faktorit sektorial.

7. Kostot e masave për përmirësimin e metodologjisë së monitorimit të një subjekti të rregulluar nuk do të konsiderohen si kosto të paarsyeshme kur arrijnë një shumë maksimale prej 4 000 eurosh, të grumbulluar gjatë një periudhe raportimi. Për subjektet e rregulluara me nivel të ulët shkarkimesh, shuma maksimale do të jetë 1 000 euro, të grumbulluara gjatë një periudhe raportimi.

Neni 98

Kategorizimi i subjekteve të rregulluara dhe rrymave të lëndëve djegëse

1. Me qëllim monitorimin e shkarkimeve dhe përcaktimin e kërkesave minimale për shkallët metodologjike për faktorët përkatës të llogaritjes, çdo subjekt i rregulluar përcakton kategorinë e tij, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe, kur është e zbatueshme, për çdo rrymë lënde djegëse, sipas pikës 5, të këtij neni.

2. Subjekti i rregulluar klasifikohet në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) Subjekti i kategorisë A, kur për periudhën 2027–2030, mesatarja e shkarkimeve vjetore të verifikuara në 2 vitet, që i paraprijnë periudhës së raportimit përpara zbatimit të faktorit sektorial, me përjashtim të CO_2, që rrjedh nga lëndët djegëse me normë zero, është e barabartë ose më e vogël se 50 000 tonë CO_2(e);

b) Subjekti i kategorisë B, kur për periudhën 2027–2030, mesatarja e shkarkimeve vjetore e verifikuara në 2 vitet, që i paraprijnë periudhës së raportimit përpara zbatimit të faktorit sektorial, me përjashtim të CO_2, që rrjedh nga lëndët djegëse me normë zero, është më e madhe se 50 000 tonë CO_2(e).

3. Nga viti 2035 e në vijim, subjektet e kategorive A dhe B, të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, përcaktohen mbi bazën e mesatares së shkarkimeve vjetore të verifikuara gjatë 5 viteve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit.

4. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 2, të nenit 93, e kësaj rregulloreje, AKM-ja mund të lejojë që subjekti i rregulluar të mos e ndryshojë planin e monitorimit kur, mbi bazën e shkarkimeve të verifikuara, tejkalohet pragu për klasifikimin e subjektit të rregulluar të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, por subjekti i rregulluar i dëshmon AKM-së, në mënyrë të mjaftueshme, se ky prag nuk është tejkaluar gjatë pesë periudhave të mëparshme të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri në periudhat pasuese të raportimit.

5. Subjekti i rregulluar e klasifikon çdo rrymë lënde djegëse në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) Rryma lëndësh djegëse minimale (*de minimis)*, kur rrymat e lëndës djegëse të përzgjedhura nga subjekti i rregulluar, të llogaritura së bashku, përbëjnë më pak se 1 000 tonë CO_2 fosil në vit, përpara zbatimit të faktorit sektorial;

b) Rryma madhore lëndësh djegëse, kur rrymat e lëndës djegëse nuk bëjnë pjesë në kategorinë e përmendur në shkronjën "a" më sipër.

6. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 2, të nenit 93, të kësaj rregulloreje, AKM-ja mund të lejojë që subjekti i rregulluar të mos e ndryshojë planin e monitorimit kur, mbi bazën e shkarkimeve të verifikuara, tejkalohet pragu për klasifikimin e rrymës së lëndës djegëse, si rrymë lënde djegëse minimale (*de minimis*), sipas pikës 5, të këtij neni, por subjekti i rregulluar i dëshmon AKM-së, në mënyrë të mjaftueshme, se ky prag nuk është tejkaluar gjatë pesë periudhave të mëparshme të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri në periudhat pasuese të raportimit

7. Kur shkarkimet mesatare vjetore të verifikuara që, sipas pikës 2, të këtij neni, përdoren për të përcaktuar kategorinë e subjektit të rregulluar, nuk janë të disponueshme ose nuk janë më përfaqësuese, për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, subjekti i rregulluar për të përcaktuar kategorinë e tij, përdor një vlerësim konservativ të shkarkimeve mesatare vjetore, të llogaritura përpara zbatimit të faktorit sektorial, duke përjashtuar CO_2, që rrjedh nga lëndët djegëse me normë zero.

Neni 99

Metodologjia e monitorimit

1. Çdo subjekt i rregulluar përcakton shkarkimet vjetore të CO_2 nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II, pjesa D, të, ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, duke shumëzuar, për secilën rrymë lënde djegëse, sasinë e

lëndës djegëse të hedhur për konsum me faktorin përkatës të konvertimit të njësisë, faktorin përkatës sektorial dhe faktorin përkatës të shkarkimit.

2. Faktori i shkarkimit shprehet si ton CO_2 për teraxhaul (t CO_2/TJ), në përputhje me përdorimin e faktorit të konvertimit të njësisë.

3. AKM-ja mund të lejojë përdorimin e faktorëve të shkarkimit për lëndët djegëse të shprehur si tCO_2/t ose tCO_2/Nm³. Në raste të tilla, subjekti i rregulluar përcakton shkarkimet, duke shumëzuar sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, të shprehur në ton ose metër kub normal, me faktorin përkatës sektorial dhe faktorin përkatës të shkarkimit.

Neni 100
Ndryshime të përkohshme të metodologjisë së monitorimit

1. Kur për arsye teknike është përkohësisht e pamundur të zbatohet plani i monitorimit, ashtu siç është miratuar nga AKM-ja, subjekti i rregulluar përdor shkallën metodologjike më të lartë të mundshme ose, përveç faktorit sektorial, një qasje konservative pa shkallë metodologjike në rast se nuk është e mundur të përdoret asnjë shkallë metodologjike, derisa të rikthehen kushtet për përdorimin e shkallës metodologjike të miratuar në planin e monitorimit. Subjekti i rregulluar merr të gjitha masat e nevojshme për të rinisur sa më shpejt përdorimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

2. Subjekti i rregulluar njofton menjëherë AKM-në për ndryshimin e përkohshëm të metodologjisë së monitorimit, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duke specifikuar:

a) arsyet e devijimit nga plani i monitorimit i miratuar nga AKM-ja;

b) specifikat e metodologjisë së monitorimit të përkohshme, që subjekti i rregulluar është duke përdorur për të përcaktuar shkarkimet, derisa të rivendosen kushtet për zbatimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) masat që po merr subjekti i rregulluar për të rivendosur kushtet për zbatimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

ç) momentin kur parashikohet të rifillojë zbatimi i planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

SEKSIONI 4
METODOLOGJIA E BAZUAR NË LLOGARITJE

NËNSEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 101
Shkallët metodologjike të zbatueshme për lëndët djegëse dhe faktorët e llogaritjes

1. Kur subjekti i rregulluar përcakton shkallët metodologjike përkatëse për rrymat e mëdha të lëndëve djegëse, me qëllim përcaktimin e sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe të çdo faktori llogaritës, ai duhet të zbatojë:

a) të paktën shkallët metodologjike të përcaktuara në shtojcën V, të kësaj rregulloreje, për subjektet e kategorisë A, ose kur kërkohet një faktor llogaritës për një rrymë lënde djegëse që është një lëndë djegëse tregtare standarde;

b) në rastet e tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" më sipër, shkallën më të lartë metodologjike, në përputhje me parashikimet e shtojcës IIa, të kësaj rregulloreje.

2. Megjithatë, për sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe për faktorët e llogaritjes të rrymave të mëdha të lëndës djegëse, subjekti i rregulluar mund të zbatojë një shkallë metedologjike deri në dy nivele më të ulët se ai i kërkuar në përputhje me pikën 1, më sipër, me kusht që të mos jetë më poshtë se shkalla metodologjike 1, kur i vërteton AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se shkalla metodologjie e kërkuar, sipas pikës 1 më sipër, ose shkalla metodologjike e një niveli më të lartë se ajo e zbatuar, nuk është teknikisht e zbatueshme ose shkakton kosto të paarsyeshme.

3. Për rrymat e lëndës djegëse minimale *(de minimis),* subjekti i rregulluar mund të përcaktojë sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum dhe çdo faktor llogaritës, duke përdorur vlerësime konservative, në vend të përdorimit të shkallëve metodologjike, përveç rasteve kur një shkallë metodologjike specifike mund të arrihet nga subjekti i rregulluar pa bërë përpjekje shtesë. Subjekti i rregulluar mund të përcaktojë sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, bazuar te faturat ose regjistrimet e blerjeve, përveç rasteve kur një shkallë metodoligjike e përcaktuar është e arritshme pa përpjekje shtesë.

4. Kur AKM-ja ka lejuar përdorimin e faktorëve të shkarkimeve të shprehur si tCO_2/t ose tCO_2/Nm^3 për lëndët djegëse, faktori i konvertimit të njësive mund të monitorohet, duke përdorur një vlerësim konservativ, në vend të zbatimit të shkallëve metodologjike, përveç rasteve kur një shkallë metodoligjike e përcaktuar mund të arrihet pa përpjekje shtesë.

Neni 102
Shkallët metodologjike të zbatueshme për faktorin sektorial

1. Për përcaktimin e shkallëve metodologjike përkatëse për rrymat e lëndëve djegëse, me qëllim përcaktimin e faktorit sektorial, çdo subjekt i rregulluar zbaton shkallën metodologjike më të lartë, siç përcaktohet në shtojcën Iia, të kësaj rregulloreje.

2. Megjithatë, subjekti i rregulluar mund të zbatojë një shkallë metodoligjike një nivel më të ulët se ai që kërkohet në pikën 1, të këtij neni, kur i vërteton AKM-së në mënyrë të mjaftueshme, se shkalla metodologjike e kërkuar sipas pikës 1, të këtij neni, nuk është teknikisht e realizueshme, shkakton kosto të paarsyeshme, ose se metodat e renditura në shkronjat "a" deri në "d", të pikës 4, nenin 110, të kësaj rregulloreje, nuk janë të disponueshme.

3. Kur parashikimi i pikës 2, të këtij neni, është i pa zbatueshëm, subjekti i rregulluar mund të zbatojë një shkallë metodologjike dy nivele më të ulëta se ai që kërkohet sipas pikës 1, të këtij neni, me kusht që të mos jetë më poshtë se shkalla metodologjike 1, kur i vërteton AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se shkalla metodologjie e kërkuar, sipas pikës 1 më sipër nuk është teknikisht e realizueshme, shkakton kosto të paarsyeshme, ose se, mbi bazën e një vlerësimi të thjeshtuar të pasigurisë, metodat e parashikuara në shkallët metodologjike më të ulëta çojnë në një përcaktim më të saktë nëse lënda djegëse përdoret për djegie në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

4. Kur, subjekti i rregulluar përdor më shumë se një metodë nga ato të renditura në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 110, të kësaj rregulloreje, për një rrymë lënde djegëse, ai duhet të vërtetojë se kushtet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni, përmbushen vetëm në lidhje me atë pjesë të sasisë së lëndës djegëse të hedhur për konsum, për të cilën kërkohet zbatimi i shkallës metodologjike më të ulët.

5. Për rrymat e lëndës djegëse minimale (*de minimis)*, subjekti i rregulluar nuk është i detyruar të vërtetojë se plotësohen kushtet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, përveç rasteve kur një shkallë metodologjike e përcaktuar është e arritshme pa përpjekje shtesë.

NËNSEKSIONI 2
SASITË E LËNDËVE DJEGËSE TË HEDHURA PËR KONSUM

Neni 103
Përcaktimi i sasive të lëndëve djegëse të hedhura për konsum

1. Subjekti i rregulluar përcakton sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum të një rryme lënde djegëse në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

a) Kur subjektet e rregulluara dhe rrymat e lëndës djegëse të mbuluara u përkasin subjekteve që kanë detyrime raportimi, në kuadër të legjislacionit në fuqi për produktet energjetike, përcaktimi bëhet mbi bazën e metodave të matjes të përdorura në atë kontekst, kur këto metoda janë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kontrollin metrologjik;

b) Nëpërmjet konsolidimit të rezultateve të matjeve të sasive në pikën ku rrymat e lëndës djegëse hidhen për konsum;

c) nëpërmjet matjes së vazhdueshme në pikën ku rrymat e lëndës djegëse hidhen për konsum.

2. AKM-ja mund t'u kërkojnë subjekteve të rregulluara që, kur është e zbatueshme, të përdorin vetëm metodën e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni.

3. Kur përcaktimi i sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum për të gjithë vitin kalendarik nuk është teknikisht i realizueshëm ose sjell kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar, me miratimin e AKM-së, për të bërë ndarjen të një viti monitorimi nga viti pasardhës, mund të zgjedhë ditën pasardhëse më të përshtatshme dhe në këtë mënyrë të ndërtojë vitin kalendarik përkatës. Devijimet për një ose më shumë rryma lënde djegëse dokumentohen në planin e monitorimit dhe regjistrohen në mënyrë të qartë dhe përbëjnë bazën për një vlerë përfaqësuese të vitit kalendarik dhe merren në konsideratë në të njëjtën mënyrë për vitin pasardhës.

4. Gjatë përcaktimit të sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum, në përputhje me shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni, zbatohen nenet 28 dhe 29, të kësaj rregulloreje, me përjashtim të fjalisë së dytë, të pikës 4, të nenit 28, dhe të pikës 5, të nenit 28. Për këtë qëllim, çdo referencë ndaj operatorit të instalimit ose instalimit lexohet sikur të ishte një referencë ndaj subjektit të rregulluar.

5. Subjekti i rregulluar mund të thjeshtojë vlerësimin e pasigurisë duke supozuar se gabimet maksimale të lejuara të përcaktuara për instrumentin matës në përdorim konsiderohen si pasiguria që mbulon të gjithë periudhën e raportimit, në përputhje me përcaktimin e shkallëve metodologjike në shtojcën IIa, të kësaj rregulloreje.

6. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 101, të kësaj rregulloreje, kur përdoret metoda e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, subjekti i rregulluar mund të përcaktojë sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, pa përdorur shkallët metodologjike.

NËNSEKSIONI 3
FAKTORËT E LLOGARITJES

Neni 104
Përcaktimi i faktorëve të llogaritjes

1. Subjekti i rregulluar përcakton faktorët e llogaritjes ose si vlera standarde ose si vlera të bazuara në analizë, në varësi të shkallës metodologjike të zbatueshme.

2. Subjekti i rregulluar përcakton dhe raporton faktorët e llogaritjes, në përputhje me gjendjen në të cilën ndodhet lënda djegëse ose materiali i përdorur gjatë mbledhjes së të dhënave në lidhje me sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, domethënë gjendjes në të cilën lënda djegëse ose materiali ndodhet në momentin e blerjes ose të përdorimit në procesin që gjeneron shkarkimet, përpara se të thahet ose t'i nënshtrohet trajtimeve të tjera të nevojshme për analizat laboratorike. Kur kjo qasje shkakton kosto të paarsyeshme ose kur mund të arrihet saktësi më e lartë, subjekti i rregulluar mund të raportojë të dhënat e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe faktorët e llogaritjes, duke iu referuar gjendjes në të cilën kryhen analizat laboratorike e duke e zbatuar këtë metodologji në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha matjet në këtë kontekst.

3. Subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e biomasës vetëm për lëndët djegëse ose materialet e përziera që përmbajnë biomasë. Për lëndët djegëse ose materialet e tjera, përdoret vlera standarde e barabartë me 0% për fraksionit e biomasës së lëndëve djegëse ose materialeve fosile, si dhe vlera standarde e barabartë me 100% për fraksionin e biomasës së lëndëve djegëse ose materialeve, që përbëhen ekskluzivisht nga biomasa.

4. Subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët vetëm për lëndët djegëse të përziera që përmbajnë RFNBO, RCF ose për lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët. Për lëndët djegëse të tjera përdoret vlera standarde e barabartë me 0 % për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, si dhe vlera standarde e barabartë me 100% për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët për lëndët djegëse, që përbëhen ekskluzivisht nga RFNBO-ja, RCF-ja ose nga lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët. Subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e biomasës me normë zero, fraksionin RFNBO ose RCF, me normë zero dhe fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, vetëm në rastet kur dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero.

5. Subjekti i rregulluar zbaton rregullat e mëposhtme në lidhje me ndërvarësinë mes faktorëve të llogaritjes, që lidhen me përbërjen:

i) kur një lëndë djegëse ose një material përmban biomasë, subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e biomasës, në përputhje me nenin 39, të kësaj rregulloreje;

ii) kur fraksioni i biomasës nuk është zero dhe kur subjekti i rregulluar dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e biomasës me normë zero, në përputhje me pikat 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje;

iii) kur një lëndë djegëse përmban një RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët, subjekti i rregulluar përcakton fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

iv) kur fraksioni RFNBO ose RCF nuk është zero dhe kur subjekti i rregulluar dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, subjekti i

rregulluar përcakton fraksionin RFNBO ose RCF me normë zero, në përputhje me pikat 4 dhe 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

v) kur fraksioni i lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët nuk është zero dhe kur subjekti i rregulluar dëshiron të përfitojë nga aplikimi i normës zero, subjekti i rregulluar përcakton fraksionin e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

vi) kur fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero ose fraksioni i lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero nuk janë zero, subjekti i rregulluar llogarit fraksionin me normë zero, si shumën e fraksionit të biomasës me normë zero, fraksionit RFNBO ose RCF me normë zero dhe fraksionit të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero. Fraksioni fosil është shuma e të gjithë fraksioneve që nuk kanë normë zero. Kur subjekti i rregulluar nuk llogarit fraksionin me normë zero, fraksioni fosil është 100 %;

vii) Subjekti i rregulluar llogarit faktorin e shkarkimeve si faktor paraprak të shkarkimit, të shumëzuar me fraksionin fosil.

6. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 3, të këtij neni, subjekti i rregulluar mund të zbatojë rregullat e mëposhtme:

i) Të përcaktojë përqindjen e biomasës si të barabartë me përqindjen e biomasës me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

ii) Të përcaktojë përqindjen e RFNBO-së ose RCF-së si të barabartë me përqindjen e RFNBO-së ose RCF-së me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

iii) Të përcaktojë përqindjen e karburanteve sintetike me karbon të ulët si të barabartë me përqindjen e tyre me normë zero, nëse kjo e fundit përcaktohet mbi bazën e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

7. AKM-ja mund t'i kërkojë subjektit të rregulluar që të përcaktojë faktorin e konvertimit të njësisë dhe faktorin e shkarkimit të lëndëve djegëse të përkufizuara sipas pikës 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, duke përdorur të njëjtat shkallë metodologjike, siç kërkohen për karburantet standarde tregtare, me kusht që, në nivel kombëtar ose rajonal, cilido nga parametrat e mëposhtëm të shfaqë një interval besueshmërie prej 95%:
a) më pak se 2% për vlerën kalorifike neto;

b) më pak se 2% për faktorin e shkarkimit, kur sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum shprehen si përmbajtje energjie.

Neni 105
Vlerat standarde për faktorët e llogaritjes

1. Kur subjekti i rregulluar përcakton faktorët e llogaritjes si vlera standarde, ai përdor një nga vlerat e mëposhtme, në përputhje me kërkesat e shkallës metodologjike të zbatueshme, siç përcaktohet në shtojcat IIa dhe VI, të kësaj rregulloreje:

a) faktorët standard dhe faktorët stoikiometrikë të renditur në shtojcën VI, të kësaj rregulloreje;

b) faktorët standard të përdorur nga Republika e Shqipërisë për paraqitjen e inventarit kombëtar në sekretariatin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;

c) vlerat e literaturës së fushës, për të cilat AKM-ja ka rënë dakord, duke përfshirë faktorët standard të publikuar nga AKM-ja, që janë në përputhje me faktorët e përmendur në shkronjën "b", por që përfaqësojnë rrymat e shkarkimit të lëndës djegëse të ndara në mënyrë më të hollësishme në kategori specifike;

ç) vlerat e përcaktuara dhe të garantuara nga furnizuesi i një lënde djegëse ose materiali, kur subjekti i rregulluar mund t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë bindëse, se përmbajtja e karbonit paraqet një interval besueshmërie prej 95% jo më të madh se 1%;

d) vlerat që bazohen në analizat e kryera më parë, kur subjekti i rregulluar i vërteton AKM-së në mënyrë bindëse se këto vlera janë përfaqësuese për kontingjentet e ardhshme të së njëjtës lëndë djegëse ose të të njëjtit material.

2. Subjekti i rregulluar specifikon të gjitha vlerat e standarde që përdoren në planin e monitorimit. Kur vlerat standarde ndryshojnë çdo vit, subjekti i rregulluar duhet të specifikojë në planin e monitorimit burimin zyrtar të zbatueshëm të asaj vlere.

3. AKM-ja mund të miratojë një ndryshim të vlerave standarde për një faktor llogaritës në planin e monitorimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, vetëm kur subjekti i rregulluar vërteton se vlera e re standarde çon në një përcaktim më të saktë të shkarkimeve.

Neni 106
Faktorët e llogaritjes bazuar tek analizat

1. Subjekti i rregulluar siguron që çdo analizë, marrje mostre, kalibrim dhe verifikim për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes kryhet duke zbatuar metoda të bazuara në standardet evropiane përkatëse (standarde EN). Kur këto standarde nuk janë të disponueshme, metodat duhet të bazohen në standardet përkatëse ISO ose në standarde kombëtare. Kur nuk ekzistojnë standarde të publikuara të zbatueshme, përdoren projektstandarde të përshtatshme (standarde që nuk janë ende të miratuara formalisht), udhëzime të industrisë mbi praktikat më të mira ose metodologji të tjera të provuara shkencërisht, të cilat kufizojnë kryerjen e gabimeve sistematike gjatë marrjes së mostrave dhe matjes.

2. Kur për përcaktimin e shkarkimeve përdoren pajisje të tilla si kromatografët e gazit *on-line* ose analizatorët me nxjerre të gazit (ku mostra e gazit nxirret jashtë tubacionit ose oxhakut dhe analizohet në një pajisje të veçantë) ose analizatorët pa nxjerre të gazit (ku analiza kryhet drejtpërdrejt brenda tubacionit ose oxhakut pa e nxjerrë gazin), subjekti i rregulluar duhet të marrë miratimin e AKM-së për përdorimin e pajisjeve të tilla. Pajisjet mund të përdoren vetëm për të dhënat e përbërjes së lëndëve djegëse dhe materialeve në gjendje të gaztë. Si masa minimale të sigurimit të cilësisë, subjekti i rregulluar siguron verifikimin e përshtatshmërisë dhe saktësisë së instrumentit, nëpërmjet verifikimit fillestar dhe verifikimit periodik çdo vit të instrumentit matës.

3. Rezultati i çdo analize përdoret vetëm për serinë (lotin) e lëndëve djegëse apo materialit që janë furnizuar në një periudhë të caktuar, nga i cili janë marrë mostrat e analizuara që përfaqësojnë vetëm atë seri (lot) lëndësh djegëse apo material të furnizuar në atë periudhë të caktuar. Për përcaktimin e një parametri specifik, subjekti i rregulluar përdor rezultatet e të gjitha analizave të kryera në lidhje me atë parametër.

Neni 107
Plani i marrjes së mostrave

1. Kur faktorët e llogaritjes përcaktohen përmes analizave, subjekti i rregulluar duhet të paraqesë për miratim nga AKM-ja për çdo lëndë djegëse ose material, planin e marrjes së mostrave që ka formën e një procedure të shkruar, që përmban informacion mbi metodologjitë për përgatitjen e mostrave, përfshirë të dhëna mbi ndarjen e përgjegjësive, vendndodhjet e marrjes së mostrave, shpeshtësinë e marrjes së mostrave dhe sasinë e mostrave që merren, si dhe metodologjitë për ruajtjen dhe transportimin e mostrave.

2. Subjekti i rregulluar siguron që mostrat e marra janë përfaqësuese të serisë (lotit) përkatës ose të periudhës përkatëse të dorëzimit dhe nuk përmbajnë gabime sistematike. Elementet e vlefshme të planit të marrjes së mostrave përcaktohen në marrëveshje me laboratorin që kryen analizën për lëndën djegëse ose materialin përkatës, dhe provat e kësaj marrëveshjeje përfshihen në planin e marrjes së mostrave. Subjekti i rregulluar duhet të vërë në dispozicion të verifikuesit të akredituar planin e marrjes së mostrave për qëllime të verifikimit.

3 Subjekti i rregulluar, në marrëveshje me laboratorin që kryen analizën për lëndën djegëse ose materialin përkatës dhe me kusht marrjen e miratimit nga AKM-ja, përshtat elementet e planit të marrjes së mostrave nëse rezultatet e analizave tregojnë se uniformiteti i lëndës djegëse ose materialit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga të dhënat e uniformitetit mbi të cilat ishte hartuar plani fillestar i marrjes së mostrave për atë lëndë djegëse ose material specifik.

Neni 108
Përdorimi i laboratorëve

1. Subjekti i rregulluar siguron që laboratorët e përdorur për të kryer analizat për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes janë të akreditуar, në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025, për metodat analitike përkatëse.

2. Laboratorët që nuk janë të akreditуar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 mund të përdoren për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes vetëm kur subjekti i rregulluar mund t'i vërtetojë AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se aksesi në laboratorët e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është teknikisht i pamundur ose do të shkaktonte kosto të paarsyeshme dhe se laboratori i pa akreditуar plotëson kërkesat të barasvlershme me standardin EN ISO/IEC 17025.

3. AKM-ja konsideron se një laborator plotëson kërkesat e barasvlershme me standardin EN ISO/IEC 17025, sipas kuptimit të pikës 2, të këtij neni, kur subjekti i rregulluar paraqet, për aq sa është e mundur, në të njëjtën formë dhe me një nivel hollësie të ngjashëm me atë të kërkuar për procedurat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 91, të kësaj rregulloreje, provat e mëposhtme:

a) Në lidhje me menaxhimin e cilësisë, subjekti i rregulluar paraqet certifikatën e akreditimit të laboratorit, në përputhje me standardin EN ISO/IEC 9001, ose sisteme të tjera të menaxhimit të cilësisë të certifikuara të laboratorit. Në mungesë të këtyre sistemeve të certifikuara të menaxhimit të cilësisë, subjekti i rregulluar duhet të paraqesë prova të tjera të përshtatshme që vërtetojnë se laboratori është në gjendje të menaxhojë personelin, procedurat, dokumentet dhe detyrat e tij në mënyrë të besueshme.

b) Në lidhje me aftësinë teknike, subjekti i rregulluar paraqet prova që dëshmojnë se laboratori është i kualifikuar dhe i aftë të prodhojë rezultate teknikisht të vlefshme, duke përdorur procedurat analitike përkatëse. Këto prova duhet të mbulojnë të paktën elementet e mëposhtme:

i) Vërtetimin se personeli i laboratorit zotëron aftësitë, njohuritë dhe trajnimin e nevojshëm për detyrat specifike, që u janë caktuar;

ii) Përshtatshmërinë e hapësirave fizike dhe kushteve mjedisore;

iii) Përshtatshmërinë e përzgjedhjes së metodave analitike dhe standardeve përkatëse;

iv) Kur është e zbatueshme, menaxhimin e marrjes së mostrave dhe përgatitjen e mostrave, duke përfshirë kontrollin e integritetit të mostrës;

v) Kur është e zbatueshme, zhvillimin dhe validimin e metodave të reja analitike ose zbatimin e metodave, që nuk mbulohen nga standardet ndërkombëtare ose kombëtare;

vi) Vlerësimin e pasigurisë;

vii) Menaxhimin e pajisjeve, përfshirë procedurat për kalibrimin, përshtatjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve, si dhe mbajtjen e regjistrave në lidhje me këto pajisje;

viii) Menaxhimin dhe kontrollin e të dhënave, dokumenteve dhe programeve kompjuterike;

ix) Menaxhimin e elementeve të kalibrimit dhe materialeve të referencës;

x) Sigurimin e cilësisë të kalibrimiu dhe rezultateve të testimit, përfshirë pjesëmarrjen e rregullt në skema të testimit të aftësisë, zbatimin e metodave analitike për materiale referente të certifikuara ose krahasimin ndërlaboratorik me një laborator të akreditуar;

xi) Menaxhimin e proceseve të deleguara për t'u kryer nga të tretët;

xii) Menaxhimin e detyrave të marrë përsipër, të ankesave të klientëve dhe garantimin e ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese në kohë të shpejtë.

Neni 109

Shpeshtësia e kryerjes së analizave

1. Subjekti i rregulluar kryen analizat e lëndëve djegëse dhe materialeve përkatëse, duke respektuar shpeshtësinë minimale të përcaktuar në shtojcën VII, të kësaj rregulloreje.

2. AKM-ja mund t'i lejojë subjektit të rregulluar të përdorë një shpeshtësi të ndryshme nga ajo e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, në rastet kur shpeshtësitë minimale nuk janë të disponueshme ose kur subjekti i rregulluar dëshmon se është verifikuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) Kur, duke u bazuar te të dhënat historike, përfshirë te vlerat analitike të lëndëve djegëse ose materialeve përkatëse në periudhën e raportimit paraardhëse të periudhës aktuale të raportimit, çdo ndryshim në vlerat analitike të lëndës djegëse ose materialit përkatës nuk tejkalon 1/3 e vlerës së pasigurisë, së cilës subjekti i rregulluar duhet t'i përmbahet për përcaktimin e të dhënave të lëndës djegëse të hedhur për konsum në lidhje me lëndën djegëse ose materialin përkatës;

b) Kur përdorimi i shpeshtësisë së kërkuar do të shkaktonte kosto të paarsyeshme.

3. Kur subjekti i rregulluar funksionon vetëm një pjesë të vitit, ose kur lëndët djegëse ose materialet furnizohen në sasi (lote), që konsumohen përgjatë më shumë se një viti kalendarik, AKM-ja mund të bjerë dakord me subjektin e rregulluar për

përcaktimin e një kalendari më të përshtatshëm të analizave, me kusht që ai të sigurojë një nivel pasigurie të barasvlershme me atë të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni.

Neni 110
Përcaktimi i faktorit sektorial

1. Kur sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum të një rryme lënde djegëse përdoren për djegie vetëm në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, faktori i sektorial përcaktohet të jetë 1.

2. Kur sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum të një rryme lënde djegëse përdoren për djegie vetëm në sektorët e aviacioni civil, transportit detar dhe instalimeve që kryejnë aktivitetet e mbuluara nga shtojca II, pjesët A, B dhe C, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, faktori sektorial përcaktohet të jetë zero, me kusht që subjekti i rregulluar të provojë se të njëjtat shkarkime nuk janë llogaritur në mënyrë të dyfishtë si në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, ashtu dhe në sektorët e aviacioni civil, transportit detar dhe instalimeve që kryejnë aktivitetet e mbuluara nga shtojca II, pjesët A, B dhe C, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar.

3. Subjekti i rregulluar përcakton një faktor sektorial për çdo rrymë lënde djegëse ose duke zbatuar metodat e përmendura në pikën 4, të këtij neni, ose duke përdorur një vlerë standarde sipas pikës 5, të këtij neni, në varësi të shkallës metodologjike të zbatueshme.

4. Subjekti i rregulluar përcakton faktorin sektorial mbi bazën e një ose më shumë prej metodave të mëposhtme, në përputhje me kërkesat e shkallëve metodologjike të zbatueshëm, siç përcaktohen në shtojcën IIa, të kësaj rregulloreje:

a) metodave të bazuara në dallimin fizik të rrymave të lëndës djegëse, përfshirë metodat e bazuara në dallimin, sipas rajonit gjeografik ose në përdorimin e instrumenteve matëse të posaçme;

b) metodave të bazuara në vetitë kimike të lëndëve djegëse, të cilat u lejojnë subjekteve të rregulluara të provojnë se lënda djegëse përkatëse mund të përdoret vetëm për djegie në sektorë të caktuar, për arsye ligjore, teknike ose ekonomike;

c) përdorimit të shënjuesit fiskal, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) përdorimit të raportit vjetor të verifikuar të shkarkimeve, të përmendur në pikën 1, të nenit 75, e kësaj rregulloreje;

d) zinxhirit të marrëveshjeve kontraktore dhe faturave të gjurmueshme ("zinxhiri i kujdestarisë"), që përfaqëson të gjithë zinxhirin e furnizimit nga subjekti i rregulluar deri te konsumatorët, përfshirë konsumatorët fundorë;

dh) përdorimit të shënjuesve ose ngjyruesve (bojërave) kombëtarë për lëndët djegëse, bazuar në legjislacionin kombëtar;

e) metodave indirekte që lejojnë të dallohet në mënyrë të saktë përdorimi përfundimtar i lëndëve në momentin kur hidhen për konsum, siç janë karakteristikat specifike të konsumit për çdo sektor, gamat karakteristike të nivelit të konsumit të lëndës djegëse, sipas madhësisë (kapacitetit) të konsumatorëve, si dhe nivelet e presionit, si ato të lëndëve djegëse të gazta, me kusht, që përdorimi i kësaj metode të miratohet, nga AKM-ja.

5. Kur, në përputhje me shkallët metodologjike të kërkuara, zbatimi i metodave të renditura në pikën 4 më sipër, nuk është teknikisht i realizueshëm ose do të sillte kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar mund të përdorë një vlerë standarde prej 1.

6. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 5, të këtij neni, subjekti i rregulluar mund të zbatojë një vlerë standarde më të ulët se 1, me kusht që për qëllime të raportimit të shkarkimeve për vitet e raportimit, duke filluar nga 1 janari 2028, subjekti i rregulluar t'i provojë, në mënyrë të kënaqshme AKM-së, se përdorimi i vlerave standarde më të ulëta se 1 çon në një përcaktim më të saktë të shkarkimeve dhe se përmbushet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

i) Rryma e lëndës djegëse është një rrymë lënde djegëse *de minimis*;

ii) Vlera standarde për rrymën e lëndës djegëse nuk është më e ulët se 0,95 për përdorimet e lëndës djegëse në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, ose nuk është më e lartë se 0,05 për përdorimet e lëndës djegëse në sektorët, që nuk mbulohen nga kjo shtojcë.

7. Kur, për një rrymë lënde djegëse, subjekti i rregulluar përdor më shumë se një nga metodat e renditura në pikat 4, 5 dhe 6, të këtij neni, ai përcakton faktorin sektorial si mesataren e

ponderuar të faktorëve të ndryshëm sektorial, që rezultojnë nga përdorimi i secilës metodë. Për çdo metodë të përdorur, subjekti i rregulluar paraqet informacion për llojin e metodës, faktorin sektorial përkatës, sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe kodin nga formati i përbashkët i raportimit për sistemet kombëtare të inventarit të gazeve serrë, siç miratohet nga organet përkatëse të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (kodi i *Common Reporting Format* (CRF)), në nivelin e disponueshëm të detajimit.

8. Në përjashtim nga parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, dhe parashikimeve të nenit 102, të kësaj rregulloreje, AKM-ja mund t'u kërkojë subjekteve të rregulluara të përdorin një metodë të caktuar të përmendur në pikën 4, të këtij neni, ose një vlerë standarde për një lloj të caktuar lënde djegëse ose në një rajon të caktuar brenda territorit të tij. Çdo vlerë standarde e përdorur, sipas kësaj pike, për rrymën kombëtare të lëndës djegëse, nuk duhet të jetë më e ulët se 0,95 për lëndën djegëse që përdoret në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, të e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, ose nuk duhet të jetë më e lartë se 0,05 për lëndën djegëse, që përdoret në sektorët që nuk mbulohen nga kjo shtojcë.

9. Subjekti i rregulluar përcakton në planin e monitorimit metodat e zbatuara ose vlerat standarde të përdorura.

NËNSEKSIONI 4
TRAJTIMI I BIOMASËS, LËNDËVE DJEGËSE SINTETIKE ME KARBON TË ULËT, RFNBO-së DHE RCF-së

Neni 111
Rrymat e lëndës djegëse nga biomasa

1. Subjekti i rregulluar përcakton të dhënat në lidhje me sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum të një rryme lënde djegëse nga karboni me normë zero, pa përdorur shkallët metodologjike dhe pa paraqitur prova analitike lidhur me përmbajtjen e karbonit me normë zero, nëse kjo rrymë lënde djegëse përbëhet ekskluzivisht nga karbon me normë zero dhe subjekti i rregulluar garanton që ajo nuk është e ndotur nga materiale ose nga lëndë djegëse të tjera.

2. Faktori i shkarkimit i çdo lënde djegëse ose materiali llogaritet dhe raportohet si faktori paraprak i shkarkimit, i përcaktuar në përputhje me nenin 30, të kësaj rregulloreje, i shumëzuar me fraksionin fosil të lëndës djegëse ose të materialit.

3. Torfa, linjit drunor dhe fraksionet fosile të lëndëve djegëse ose të materialeve të përziera nuk konsiderohen si biomasë.

4. Kur fraksioni i biomasës me normë zero i lëndëve djegëse ose materialeve të përziera është i barabartë ose më i lartë se 97%, ose kur, për shkak të nivelit të shkarkimeve të lidhura me fraksionin fosil të lëndës djegëse ose materialit, ai kualifikohet si një rrymë lënde djegëse minimale (*de minimis*), AKM-ja mund t'i lejojë subjektit të rregulluar që për përcaktimin e sasisë së lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe faktorëve përkatës të llogaritjes të zbatojë metodologji të ndryshme nga ato të parashikuara në shkallët metodologjike, përfshirë metodën e bilancit energjetik.

5. Në mënyrë që biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës të llogariten si pjesë e fraksionit të biomasës me normë zero të një rryme lënde djegëse, ato duhet të përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtimet e mëposhtme:

a) Biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa të prodhuara nga mbetjet dhe tepricat, të ndryshme nga tepricat bujqësore, të akuakulturës, të peshkimit dhe të pylltarisë, duhet të përmbushin vetëm kriteret specifike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Kjo vlen gjithashtu për mbetjet dhe tepricat, që fillimisht përpunohen në një produkt, përpara se të përpunohen më tej në biokarburante, biolëngje ose lëndë djegëse nga biomasës.

b) Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja që prodhohen nga mbetjet e ngurta urbane nuk i nënshtrohen kritereve specifike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

6. Për zbatimin e kritereve specifike në lidhje me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën të përcaktuara në legjislacionin në

fuqi dhe të përmendura në pikën 5 më sipër, vlejnë parashikimet e mëposhtme:

a) Subjekti i rregulluar, ndaj të cilit zbatohen kriteret specifike të përmendura në pikën 5 më sipër, është subjekti i përkufizuar në pikën 42, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

b) Kriteret specifike, të përmendura në pikën 5 më sipër, zbatohen, pavarësisht origjinës gjeografike të biomasës;

c) Përputhshmëria me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, vlerësohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë dhe me llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Kriteret mund të konsiderohen gjithashtu të përmbushura, nëse subjekti i rregulluar paraqet prova se ka blerë një sasi biokarburanti, biolëngu ose lëndë djegëse me bazë biomasën, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur, në përputhje me nenin 31a, të direktivës (BE) 2018/2001 ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare, që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast të mosrespektimit të mëvonshëm lidhur me provën e qëndrueshmërisë së sasive të anuluara në bazat e të dhënave të përmendura, AKM-ja korrigjon shkarkimet e verifikuara në përputhje me rrethanat. Nëse biomasa e përdorur nuk përputhet me parashikimet e mësipërme, përmbajtja e saj e karbonit do të konsiderohet si karbon fosil.

7. Kur kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë me efekt për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi nuk zbatohen për biomasën, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 5, dhe të pikës 6, të këtij neni, fraksioni i biomasës me normë zero është i barasvlershëm me fraksionin e tij të biomasës.

Neni 112

Përcaktimi i fraksionit të biomasës dhe fraksionit fosil

1. Për lëndët djegëse ose materialet që përmbajnë biomasë, operatori i instalimit mund të konsiderojë se shtojca e biomasës është 0 dhe të zbatojë një fraksion standard të biomasës prej 0 %, ose të përcaktojë fraksionin e biomasës, në përputhje me pikën 2, të këtij neni, duke zbatuar shkallën metodologjike të përcaktuara në seksionin 2.4, të shtojcës II, të kësaj rregulloreje.

2. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, dhe të parashikimeve të nenit 30, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar nuk duhet të përdorë analiza për të përcaktuar përqindjen e biomasës së gazit natyror të marrë nga një rrjet gazi, në të cilin është shtuar biogaz. Përjashtimi i parashikuar në këtë nen, nuk zbatohet në rastet kur zbatohet pika 10, e nenit 44, të kësaj rregulloreje.

3. Subjekti i rregulluar mund të vendosë që një sasi e caktuar e gazit natyror nga rrjeti i gazit të konsiderohet si biogaz me normë zero, duke përdorur metodologjinë e përcaktuar në pikën 4, të këtij neni. Në këtë rast, në përjashtim nga parashikimet e pikës 3, të nenit 30, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar duhet ta konsiderojë fraksionin e biomasës si të barabartë me fraksionin e biomasës me normë zero.

4. Subjekti i rregulluar mund të përcaktojë fraksionin e biomasës dhe shtojcën identike të biomasës me normë zero të biogazit, duke përdorur të dhënat e blerjes së biogazit me përmbajtje energjetike ekuivalente, me kusht që subjekti i rregulluar të paraqesë provat e mëposhtme, që konsiderohen të mjaftueshme nga AKM-ja:

a) Provën se e njëjta sasi biogazi nuk numërohet dy herë, dhe, veçanërisht se nuk ka pretendime që biogazi i blerë përdoret nga ndonjë palë tjetër, edhe nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së garancisë së origjinës, sipas përkufizimit të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

b) Provën se subjekti i rregulluar dhe prodhuesi i biogazit janë të lidhur në të njëjtin rrjet gazi.

5. Për të provuar përputhshmërinë me pikën 4 të këtij neni, subjekti i rregulluar mund të përdorë të dhënat e regjistruara në një bazë të dhënash

shqiptare ose në një bazë të dhënash të ngritur nga një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, që mundëson gjurmimin e transferimeve të biogazit. Përputhshmëria me pikën 4, të këtij neni, mund të konsiderohet e vërtetuar nëse subjekti i rregulluar paraqet prova për blerjen e një sasie biogazi që është regjistruar dhe shënuar si e përdorur (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian, për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur në përputhje me nenin 31a, të direktivës (BE) 2018/2001, ose në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara.

6. Kur, në varësi të shkallës metodologjike të kërkuar, subjekti i rregulluar duhet të kryejë analiza për të përcaktuar fraksionin e karbonit me normë zero ai e bën këtë mbi bazën e një standardi përkatës dhe të metodave analitike të përcaktuara në të, me kusht që përdorimi i atij standardi dhe i asaj metode analitike të miratohet nga AKM-ja. Kur kryerja e analizave nuk është teknikisht e realizueshme ose do të sillte kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar i paraqet AKM-së, për miratim, një metodë alternative vlerësimi për përcaktimin e fraksionit të biomasës.

Neni 113

Përcaktimi i fraksionit të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët dhe të fraksionit të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët me normë zero

1. Për lëndët djegëse ose materialet që përmbajnë RFNBO, RCF ose lëndë djegëse sintetike me përmbajtje të ulët karboni, për të cilat subjekti i rregulluar nuk është në gjendje të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së, e RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, në përputhje me pikën 2, të këtij neni, subjekti i rregulluar konsideron se RFNBO-ja, RFC-ja ose lënda djegëse sintetike me karbon të ulët mungojnë dhe zbaton një fraksion standard të RFNBO-së, RCF-së ose të fraksionit sintetik me karbon të ulët prej 0%.

2. Subjekti i rregulluar përcakton faktorët e mëposhtëm të llogaritjes, që lidhen me përbërjen e lëndëve djegëse, duke u bazuar në bilancin e masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi:

i) fraksionin me normë zero të RFNBO-së ose të RCF-së ose fraksionin me normë-zero të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët;

ii) fraksionin e RFNBO-së ose të RCF-së, ose fraksionin sintetik me karbon të ulët.

3. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 2 më sipër, nëse subjekti i rregulluar nuk dëshiron të përdorë normën zero, mund të përdoren metoda të tjera për fraksionin RFNBO ose RCF, apo për fraksionin sintetik me karbon të ulët, si p.sh. bilanci material i procesit të përzierjes ose i procesit të prodhimit, nga i cili është nxjerrë lënda djegëse ose materiali.

4. Përmbajtja e karbonit e lëndëve djegëse, që kategorizohen si RFNBO ose RCF, që janë në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe lëndët djegëse me bazë karboni të ricikluara, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, konsiderohen me normë zero.

5. Përputhshmëria me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi vlerësohet, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë dhe me llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Këto kritere mund të konsiderohen të përmbushura edhe nëse subjekti i rregulluar paraqet prova për blerjen e një sasie RFNBO ose RCF, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur, në përputhje me nenin 31a, të direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë

shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara. Kur RFNBO-ja ose RCF-ja nuk i përmbush kriteret e përmendura në pikën 4 më sipër, përmbajtja e karbonit e RFNBO ose RCF do të konsiderohet si karbon fosil.

6. Lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët do të trajtohen si me normë zero, kur përmbajtja e tyre e karbonit i është nënshtruar paraprakisht pagesës së detyrimeve për karbonin sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi ose sipas rastit, përmbajtja e karbonit i është nënshtruar paraprakisht detyrimeve të raportimit kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi, përveçse në rastet kur karboni i kapur konsiderohet si karbon me normë zero, sipas përkufizimit në pikën 56, të nenit 3, të kësaj rregulloreje.

7. Përputhshmëria me kriteret e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe për lëndët djegëse të ricikluara me bazë karboni vlerësohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe për llogaritjen e ndikimit të gazeve me efekt serrë nga biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën. Këto kritere mund të konsiderohen gjithashtu të përmbushura nëse subjekti i rregulluar paraqet prova për blerjen e një sasie të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur, në përputhje me nenin 31a, të direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare, që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM-ja bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara. Në të gjitha rastet e tjera, përmbajtja e karbonit e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët do të konsiderohet si karbon fosil.

8. Subjekti i rregulluar mund të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së, duke e konsideruar si identike me fraksionin e e RFNBO-së ose RCF-së me normë zero të gazit natyror, kur këto fraksione janë injektuar në një rrjet të gazit natyror, duke përdorur të dhënat e blerjes së RFNBO-së ose RCF-së, me përmbajtje energjetike ekuivalente, me kusht që subjekti i rregulluar të paraqesë provat e mëposhtme, që konsiderohen të mjaftueshme nga AKM-ja:

a) provën se e njëjta sasi RFNBO ose RFC nuk numërohet dy herë, dhe veçanërisht se nuk ka pretendime që RFNBO ose RFC e blerë përdoret nga ndonjë palë tjetër, edhe nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së garancisë së origjinës, sipas përkufizimit të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

b) provën se subjekti i rregulluar dhe prodhuesi i RFNBO-së ose RFC-së janë të lidhur në të njëjtin rrjet gazi.

9. Përputhshmëria me parashikimet e pikës 8 më sipër mund të konsiderohet e vërtetuar nëse subjekti i rregulluar paraqet prova të blerjes së një sasie RFNBO ose RCF në formë të gaztë, që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për gjurmimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të lëngëta dhe të gazta, si dhe të lëndëve djegëse të ricikluara me bazë karboni të ngritur, në përputhje me nenin 31a, të Direktivës (BE) 2018/2001, ose që janë regjistruar dhe janë shënuar si të përdorura (anuluar) në një bazë të dhënash kombëtare, që është ngritur dhe funksion në mënyrë të ngjashme me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Në rast se më pas konstatohet mospërputhje në lidhje me provat e qëndrueshmërisë të sasive të anuluara në bazat e të dhënave të sipërpërmendura, AKM bën korrigjimin përkatës të shkarkimeve të verifikuara.

SEKSIONI 5
SHKARKIMET E SUBJEKTIT TË RREGULLUAR

Neni 114
Subjekti i rregulluar me shkarkime të ulëta

1. AKM-ja mund ta konsiderojë subjektin e rregulluar si subjekt të rregulluar me shkarkime të ulëta, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) Nga viti 2027 deri në vitin 2030, shkarkimet mesatare vjetore të verifikuara në 2 vjetët, që i paraprijnë periudhës së raportimit, të llogaritura përpara zbatimit të faktorit sektorial dhe me përjashtim të CO_2, që rrjedh nga karburantet me normë zero, kanë qenë më pak se 1 000 ton CO_2 në vit;

b) Nga viti 2031, shkarkimet mesatare vjetore të subjektit të rregulluar të raportuara në raportet e verifikuara të shkarkimeve gjatë 5 vjetëve pararendëse të periudhës aktuale të raportimit, të llogaritura përpara zbatimit të faktorit sektorial dhe me përjashtim të CO_2, që rrjedh nga karburantet me normë zero, ishin më pak se 1 000 ton CO_2 në vit;

c) Kur shkarkimet mesatare vjetore të përmendura në shkronjën "a" nuk janë të disponueshme ose nuk janë më përfaqësuese për qëllimet e shkronjës "a", por shkarkimet vjetore të atij subjekti të rregulluar për 5 vitet e ardhshme, të llogaritura përpara zbatimit të faktorit sektorial dhe me përjashtim të CO_2, që rrjedh nga karburantet me normë zero, llogaritet të jenë mbi bazën e një metode konservatore vlerësimi, më pak se 1 000 ton CO_2(e) në vit.

2. Subjekti i rregulluar me shkarkime të ulëta nuk është i detyruar të paraqesë dokumentet mbështetëse të përmendura në pikën 3, të nenit 91, të kësaj rregulloreje.

3. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 103, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar me shkarkime të ulëta mund të përcaktojë sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, duke përdorur regjistrat e disponueshme dhe të dokumentuara të blerjeve dhe vlerësimin e ndryshimit të gjendjes së rezervave (stokut).

4. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 101, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar me shkarkime të ulëta mund të zbatojë, si minimum, shkallën metodologjike 1 për qëllime të përcaktimit të sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe të faktorëve të llogaritjes për të gjitha rrymat e lëndës djegëse, përveç rasteve kur arrihet një saktësi më e lartë pa përpjekje shtesë për subjektin e rregulluar.

5. Për qëllim të përcaktimit të faktorëve të llogaritjes mbi bazën e analizave, në përputhje me nenin 106, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar me shkarkime të ulëta mund të përdorë çdo laborator që është teknikisht kompetent dhe i aftë të gjenerojë rezultate teknikisht të vlefshme duke përdorur procedurat përkatëse analitike, si dhe që siguron prova për masat e sigurimit të cilësisë, siç parashikohet në pikën 3, të nenit 108, e kësaj rregulloreje.

6. Kur një subjekt i rregulluar me shkarkime të ulëta, që i nënshtrohet monitorimit të thjeshtuar, e tejkalon pragun e përmendur në pikën 1, të këtij neni në cilindo vit kalendarik, subjekti i rregulluar njofton menjëherë AKM-në. Në këtë rast subjekti i rregulluar paraqet pranë AKM-së, pa vonesë, një aplikim për ndryshim të rëndësishëm të planit të monitorimit, në përputhje me parashikimet e shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 94, të kësaj rregulloreje, për marrjen e miratimit nga AKM-ja.

7. Megjithatë, AKM-ja lejon që subjekti i rregulluar të vazhdojë monitorimin e thjeshtuar, me kusht që subjekti i rregulluar t'i demonstrojë AKM-së, në mënyrë të mjaftueshme, se pragu i përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk është tejkaluar gjatë pesë periudhave të fundit të raportimit dhe nuk do të tejkalohet përsëri duke filluar nga periudha pasuese e raportimit.

SEKSIONI 6
MENAXHIMI DHE KONTROLLI I TË DHËNAVE

Neni 115
Aktivitetet në lidhje me fluksin e të dhënave

1. Subjekti i rregulluar krijon, dokumenton, zbaton dhe mirëmban procedura të shkruara për aktivitetet, që kanë të bëjnë me fluksin e të dhënave, që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë. Subjekti i rregulluar garanton që raporti vjetor i shkarkimeve, që hartohet në bazë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave, nuk përmban pasaktësi dhe është në përputhje me planin e monitorimit, me procedurat e shkruara të sipërpërmendura dhe me këtë rregullore.

2. Plani i monitorimit përmban përshkrimin e procedurave me shkrim për aktivitetet e fluksit të të dhënave, duke mbuluar të paktën elementet e mëposhtme:

a) Elementet e informacionit të parashikuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 91, të kësaj rregulloreje;

b) Identifikimin e burimeve parësore të të dhënave;

c) Çdo hallkë në fluksin e të dhënave, duke nisur nga të dhënat parësore deri te shkarkimet vjetore, që pasqyron rendin dhe ndërveprimin e aktiviteteve të fluksit të të dhënave, përfshirë formulat dhe hapat e zbatuar për bashkimin e të dhënave përkatëse;

ç) Hapat përkatës të përpunimit të të dhënave, që lidhen me çdo aktivitet specifik të fluksit të të dhënave, duke përfshirë formulat dhe të dhënat e përdorura për përcaktimin e shkarkimeve;
d) Sistemet përkatëse elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të përdorura dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre sistemeve dhe format e tjera për futjen e të dhënave, duke përfshirë metodat manuale të futjes së të dhënave;

dh) Mënyrën se si regjistrohen rezultatet e veprimtarive të fluksit të të dhënave.

Neni 116
Sistemi i kontrollit

1. Subjekti i rregulluar krijon, dokumenton, zbaton dhe mban një sistem efektiv kontrolli për të siguruar, që raporti vjetor i shkarkimeve, që hartohet në bazë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave nuk përmban pasaktësi dhe është në përputhje me planin e monitorimit dhe me këtë rregullore.

2. Sistemi i kontrollit, i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përbëhet nga elementet e mëposhtme:

a) Vlerësimi i rreziqeve të brendshme dhe i rreziqeve të kontrollit, që kryhet nga subjekti i rregulluar, bazuar në një procedurë të shkruar për kryerjen e vlerësimit;

b) Procedura të shkruara në lidhje me aktivitetet e kontrollit, që kanë për qëllim zbutjen e rreziqeve të identifikuara.

3. Procedurat e shkruara në lidhje me aktivitetet e kontrollit, që parashikohen në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, përfshijnë të paktën:

a) sigurimin e cilësisë së pajisjeve matëse;

b) sigurimin e cilësisë së sistemit të teknologjisë së informacionit të përdorur për aktivitetet e fluksit të të dhënave, duke përfshirë teknologjitë informatike për kontrollin e procedurave;

c) ndarjen e detyrave në aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit dhe menaxhimin e kompetencave të nevojshme;

ç) procedurën e brendshme rishqyrtimi dhe vleftësimin e të dhënave;

d) korrigjimet dhe masat e korrigjimit;

dh) kontrollin e proceseve, kryerja e të cilave u delegohet burimeve të jashtme;

e) mbajtjen e regjistrave dhe dokumentacionit, duke përfshirë administrimin e versioneve të ndryshme të dokumenteve.

4. Subjekti i rregulluar monitoron efikasitetin e sistemit të kontrollit, duke përfshirë kryerjen e rishikimeve të brendshme dhe duke marrë parasysh gjetjet e verifikuesit të akredituar gjatë verifikimit të raporteve vjetore të shkarkimeve, të kryera në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore zbatuese për verifikimin nga verifikuesi i akredituar.

5. Kurdoherë që sistemi i kontrollit rezulton të jetë joefektiv ose jo në përpjesëtim me rreziqet e identifikuara, subjekti i rregulluar angazhohet për përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe përditësimin e planit të monitorimit ose të procedurave të shkruara mbështetëse në lidhje me aktivitetet e fluksit të të dhënave, vlerësimet e rrezikut dhe aktivitetet e kontrollit sipas nevojës.

Neni 117
Sigurimi i cilësisë

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 116, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar siguron që të gjitha pajisjet matëse përkatëse të kalibrohen, rregullohen dhe kontrollohen periodikisht, përfshirë periudhën para përdorimit, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me standardet matëse që janë të lidhura me standardet ndërkombëtare të matjes, kur është e mundur, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe proporcionalisht me rreziqet e identifikuara.

2. Kur disa pjesë të sistemeve matëse nuk mund të kalibrohen, subjekti i rregulluar i përmend ato në planin e monitorimit dhe propozon aktivitete kontrolli alternative. Kur zbulohet se pajisja nuk është në përputhje me performancën e kërkuar,

subjekti i rregulluar ndërmerr menjëherë veprimet e nevojshme korrigjuese.

3. Në lidhje me sistemet e matjes së vazhdueshme të shkarkimeve, subjekti i rregulluar zbaton sigurimin e cilësisë, bazuar në standardin e sigurimit të cilësisë së sistemeve të matjes automatike (EN 14181), duke përfshirë matjet paralele me metoda standarde referimi të paktën një herë në vit, të kryera nga personel i kualifikuar.

4. Kur sigurimi i cilësisë i përmendur në pikën 3, të këtij neni, kërkon përdorimin e vlerave limit të shkarkimeve (VLSH), si parametra të nevojshëm për kontrollin e kalibrimit dhe të performancës, si parametër zëvendësues i VLSH përdoret përqendrimi mesatar vjetor orar i gazit me efekt serrë. Kur subjekti i rregulluar konstaton një mospërputhje me kërkesat e sigurimit të cilësisë, përfshirë nevojën për të kryer rikalibrimin, raporton këto rrethana tek AKM-ja dhe ndërmerr pa vonesë veprime korrigjuese.

Neni 118
Sigurimi i cilësisë së teknologjisë së informacionit

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 116, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar siguron që sistemi i teknologjisë së informacionit të projektohet, të dokumentohet, të testohet, të zbatohet, të kontrollohet dhe të mirëmbahet në mënyrë të tillë që të përpunojë të dhëna të besueshme, të sakta dhe të përditësuara në kohë, në përputhje me rreziqet e identifikuara në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 116, të kësaj rregulloreje.

2. Kontrolli i sistemit të teknologjisë së informacionit përfshin kontrollin e aksesit, kontrollin e sistemit të ruajtjes së të dhënave *(back-up*), kontrollin e rikuperimit të të dhënave, të planifikimit të vazhdimësisë dhe të sigurisë.

Neni 119
Ndarja e detyrave

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 116, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar cakton personat përgjegjës për të gjitha aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe për të gjitha veprimtaritë e kontrollit, duke bërë ndarjen e detyrave në mënyrë të tillë, që detyrat që krijojnë konflikt interesi, të ndahen ndërmjet personave të ndryshëm. Në mungesë të veprimtarive të tjera të kontrollit, subjekti i rregulluar, për të gjitha veprimtaritë e fluksit të të dhënave, në përpjesëtim me rreziqet e brendshme të identifikuara, siguron që çdo informacion dhe e dhënë përkatëse konfirmohet nga të paktën një person, që nuk ka qenë i përfshirë në përcaktimin dhe regjistrimin e atij informacioni ose asaj të dhëne.

2. Subjekti i rregulluar garanton që ekzistojnë aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, duke përfshirë ndarjen e përshtatshëm të përgjegjësive, trajnimin dhe rishikimin e performancës të personelit.

Neni 120
Shqyrtim i brendshëm dhe vërtetimi i të dhënave

1. Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 116, të kësaj rregulloreje, dhe bazuar te rreziqet e brendshme dhe te rreziqet e kontrollit të identifikuara në vlerësimin e rrezikut, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 116, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar rishikon dhe verifikon vlefshmërinë e të dhënave që rezultojnë nga aktivitetet e fluksit të të dhënave, të përmendura në nenin 115, të kësaj rregulloreje. Rishikimi dhe verifikimi i vlefshmërisë së të dhënave përfshin, të paktën, këto elemente:

a) Kontrollin, nëse të dhënat janë të plota;

b) Krahasimin e të dhënave, që subjekti i rregulluar ka siguruar, ka monitoruar dhe ka raportuar gjatë disa vjetëve;

c) Krahasimin e të dhënave dhe vlerave, që rezultojnë nga sisteme të ndryshme operative të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë krahasimet e mëposhtme, kur janë të zbatueshme:

i) krahasimin e të dhënave të blerjes së lëndës djegëse ose të materialit me të dhënat e ndryshimeve të stokut dhe me të dhënat e konsumit, të rrymave të lëndës djegëse përkatëse;

ii) krahasimin e faktorëve të llogaritjes, që janë përcaktuar me anë të analizës, janë llogaritur ose janë siguruar nga furnizuesi i lëndës djegëse ose materialit, me faktorët kombëtarë ose ndërkombëtarë të referencës për lëndët djegëse ose materialet e krahasueshme;

iii) krahasimin e shkarkimeve të llogaritura nga metodologjitë e bazuara në matje me rezultatet që mbështesin llogaritjen, në përputhje me nenin 47, të kësaj rregulloreje;

iv) krahasimin e të dhënave të konsoliduara me të dhënat bruto.

2. Subjekti i rregulluar për aq sa është e mundur, siguron që kriteret për refuzimin e të dhënave, si pjesë e procesit të rishikimit dhe verifikimit të vlefshmërisë të jenë të njohura paraprakisht. Për këtë qëllim, kriteret për refuzimin e të dhënave duhet të përcaktohen në dokumentacionin e procedurave përkatëse të shkruara.

Neni 121
Korrigjimet dhe veprimet korrigjuese

1. Kur konstatohet se pjesë të aktiviteteve të fluksit të të dhënave, të përmendura në nenin 115, të kësaj rregulloreje, ose të veprimtarive të kontrollit të përmendura në nenin 116, të kësaj rregulloreje, nuk funksionojnë në mënyrë efektive, ose funksionojnë jashtë kufijve të përcaktuar në dokumentacionin e procedurave për ato aktivitete të fluksit të të dhënave dhe ato veprimtari kontrolli, subjekti i rregulluar bën korrigjimet e nevojshme dhe korrigjon të dhënat e refuzuara, duke shmangur nënvlerësimin e shkarkimeve.

2. Për qëllimet e pikës 1, të këtij neni, subjekti i rregulluar duhet të kryejë, të paktën, të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) Vlerëson vlefshmërinë e rezultateve të arritura nëpërmjet aktiviteteve të fluksit të të dhënave, të përmendura në nenin 115, të kësaj rregulloreje, ose nëpërmjet veprimtarive të kontrollit të përmendura në nenin 116, të kësaj rregulloreje;

b) Përcakton shkakun e mosfunksionimit ose gabimin përkatës;

c) Zbaton masat korrigjuese të përshtatshme, duke përfshirë korrigjimin e çdo të dhëne të prekur në raportin e shkarkimeve, sipas rastit.

3. Subjekti i rregulluar kryen korrigjimet dhe masat korrigjuese, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, në mënyrë që ato t'i përgjigjen rreziqeve të brendshme dhe rreziqeve të kontrollit të identifikuara në vlerësimin e rrezikut, të përmendur në nenin 116, të kësaj rregulloreje.

Neni 122
Proceset e deleguara te të tretët

1. Kur subjekti i rregulluar delegon te një palë e tretë një ose më shumë aktivitete të fluksit të të dhënave të përmendura në nenin 115, të kësaj rregulloreje, ose veprimtari kontrolli të përmendura në nenin 116, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar kryen të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon nëse cilësia e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe e veprimtarive të kontrollit të deleguara te të tretët, është në përputhje me këtë rregullore;

b) Përcakton parametra të përshtatshme për rezultatet e proceseve të deleguara te të tretët dhe për metodat e përdorura në ato procese;

c) Verifikon cilësinë e rezultateve dhe metodave të përmendura në shkronjën "b", të këtij neni;

ç) Siguron që aktivitetet e deleguara te të tretët kryhen në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen rreziqeve të brendshme dhe rreziqeve të kontrollit të identifikuara me vlerësimin e rrezikut, të përmendur në nenin 116, të kësaj rregulloreje.

Neni 123
Trajtimi i mangësive të të dhënave për raportimin e shkarkimeve

1. Kur mungojnë të dhëna të rëndësishme për përcaktimin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar, ky i fundit duhet të përdorë një metodë të përshtatshme vlerësimi për të përcaktuar të dhëna zëvendësuese konservative për periudhën përkatëse kohore dhe për parametrin që mungon.

2. Kur subjekti i rregulluar nuk e ka përcaktuar metodën e vlerësimit në një procedurë të shkruar, ai duhet të hartojë një procedurë të tillë të shkruar dhe të paraqesë tek AKM-ja për miratim ndryshimin e nevojshëm të planit të monitorimit, në përputhje me nenin 94, të kësaj rregulloreje.

Neni 124
Regjistra dhe dokumente

1. Subjekti i rregulluar mban regjistrat e të gjitha të dhënave dhe informacionit përkatës, duke përfshirë informacionin e radhitur në shtojcën IX, të kësaj rregulloreje, për një periudhë prej jo më pak se 10 vjetësh.

2. Të dhënat e monitorimit të dokumentuara dhe të arkivuara duhet të mundësojnë verifikimin e raporteve vjetore të shkarkimeve nga verifikuesi i akreditуar, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Të dhënat e raportuara nga subjekti i rregulluar, që mbahen në një sistem elektronik të raportimit dhe menaxhimit të të dhënave të ngritur nga AKM-ja, mund të konsiderohen si të ruajtura nga subjekti i rregulluar, nëse ky i fundit ka akses tek ato të dhëna.

3. Subjekti i rregulluar garanton që të gjitha dokumentet e nevojshme janë të disponueshme kurdo që duhen për të kryer aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit.

4. Subjekti i rregulluar i paraqet këto dokumente tek AKM-ja sapo kërkohen prej saj dhe te verifikuesi i akreditуar, që verifikon raportin e shkarkimeve, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore zbatuese, sapo kërkohen prej tij.

SEKSIONI 7
KËRKESAT E RAPORTIMIT

Neni 125
Raportet vjetore të shkarkimeve

1. Duke filluar nga viti 2028, deri më 30 prill të çdo viti, subjekti i rregulluar dorëzon në sistemin *on-line* të AKM-së nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe / ose më format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së, raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-it gjatë periudhës së raportimit (raporti vjetor i shkarkimeve), që është i verifikuar nga verifikuesi i akreditуar, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Dorëzimi kryhet nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe / ose më format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së.

2. AKM-ja mund t'i kërkojë subjekteve të rregulluara që të dorëzojnë raportin vjetor të shkarkimeve, të përmendur në pikën 1 më sipër, përpara datës 30 prill, por jo përpara datës 30 mars.

3. Raportet vjetore të shkarkimeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përmbajnë të paktën informacionin e renditura në aneksin X, të kësaj rregulloreje.

Neni 126
Raportimi për përmirësimet e metodologjisë së monitorimit

1. Çdo subjekt i rregulluar kontrollon rregullisht nëse metodologjia e monitorimit që po zbaton mund të përmirësohet.

2. Subjekti i rregulluar duhet dorëzojë pranë AKM-së për miratim, një raport që përmban informacionin e përmendur në pikat 4 ose 5, të këtij neni, sipas rastit, brenda afateve të mëposhtme:

a) Për subjektet e kategorisë A, çdo pesë vjet, brenda datës 31 korrik;

b) Për subjektet e kategorisë B, çdo tre vjet, brenda datës 31 korrik;

c) Për subjektin e rregulluar, që përdor faktorin sektorial standard të parashikuar në pikat 5 dhe 6, të nenit 110, të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 korrik 2028.

3. Megjithatë, AKM-ja mund të caktojë një datë alternative për dorëzimin e raportit, të përmendur në pikën 2, të këtij neni, por jo më vonë se 30 shtatori i po të njëjtit vit, dhe mund të miratojë, së bashku me planin e monitorimit ose raportin e përmirësimit, një shtyrje të afatit të zbatueshëm, sipas pikës 2, të këtij neni. AKM-ja jep miratimin nëse subjekti i rregulluar, gjatë dorëzimit të planit të monitorimit, në përputhje me nenin 91, të kësaj rregulloreje, ose gjatë njoftimit të përditësimeve, në përputhje me nenin 94, të kësaj rregulloreje, ose gjatë paraqitjes së një raporti përmirësimi, në përputhje me këtë nen, i paraqet AKM-së prova të mjaftueshme se kushtet që shkaktojnë kostot e paarsyeshme ose pamundësinë teknike për marrjen e masave për përmirësimin e raportit të shkarkimit do të mbeten të vlefshme për një periudhë më të gjatë kohore. Shtyrja merr në konsideratë numrin e viteve për të cilat subjekti i rregulluar paraqet prova. Periudha totale kohore ndërmjet raporteve të përmirësimit nuk duhet të tejkalojë 4 vjet për një subjekt të rregulluar të kategorisë B ose 5 vjet për një subjekt të rregulluar të kategorisë A. Raporti dorëzohet nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe / ose më format shkresor pranë institucionit, sipas kërkesës së AKM-së.

4. Kur subjekti i rregulluar nuk zbaton të paktën shkallët metodologjike të kërkuara për rrymat e mëdha të lëndës djegëse, sipas pikës 1, të nenit 101, dhe të pikave 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 102, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar jep një arsyetim se

përse zbatimi i shkallëve metodologjike të kërkuara nuk është teknikisht i realizueshëm ose do të sillte kosto të paarsyeshme. Megjithatë, kur gjenden prova se masat e nevojshme për arritjen e këtyre shkallëve metodologjike janë bërë teknikisht të realizueshme dhe nuk sjellin më kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar njofton AKM-në për ndryshimet e përshtatshme të planit të monitorimit, në përputhje me nenet 93 dhe 94, të kësaj rregulloreje dhe paraqet propozime për zbatimin e masave përkatëse dhe afatet e tyre.

5. Kur subjekti i rregulluar zbaton një faktor sektorial standard, siç përcaktohet në pikat 5 dhe 6, të nenit 110, të kësaj rregulloreje, subjekti i rregulluar jep një arsyetim se përse nuk është teknikisht e realizueshme ose do të sillte kosto të paarsyeshme zbatimi i ndonjë metode tjetër nga ato të përmendura në pikën 4, të nenit 110, të kësaj rregulloreje, për një ose më shumë rryma lëndësh djegëse madhore ose *de minimis*. Megjithatë, kur gjenden prova se, për këto rryma lëndësh djegëse, zbatimi i ndonjë metode tjetër nga ato të përmendura në pikën 4, të nenit 110, të kësaj rregulloreje, është bërë teknikisht e realizueshme dhe nuk sjell më kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar njofton AKM-në për ndryshimet e përshtatshme të planit të monitorimit, në përputhje me nenet 93 dhe 94, të kësaj rregulloreje, dhe paraqet propozime për zbatimin e masave përkatëse dhe afatet e tyre.

6. Kur raporti i verifikimit, i hartuar nga verifikuesi i akredituar, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore zbatuese, identifikon ekzistencën e mospërputhjeve të pazgjidhura ose paraqet rekomandime për përmirësime, subjekti i rregulluar dorëzon tek AKM-ja për miratim deri në datën 31 korrik të vitit, në të cilin është lëshuar raporti i verifikimit nga verifikuesi i akredituar, një raport. Raporti përshkruan se si dhe kur subjekti i rregulluar ka korrigjuar ose planifikon të korrigjojë mospërputhjet e identifikuara nga verifikuesi i akredituar dhe të zbatojë përmirësimet e rekomanduara prej tij.

7. AKM-ja mund të caktojë një datë alternative për dorëzimin e raportit, të përmendur në pikën 6, të këtij neni, por jo një datë më të vonë se 30 shtatori i të njëjtit vit. Kur është e zbatueshme, ky raport mund të bashkohet me raportin e përmendur në pikën 2, të këtij neni.

8. Kur përmirësimet e rekomanduara nuk sjellin një përmirësim të metodologjisë së monitorimit, subjekti i rregulluar paraqet argumentet e tij në mbështetje të këtij pretendimi. Kur përmirësimet e rekomanduara do të sillnin kosto të paarsyeshme, subjekti i rregulluar paraqet prova për natyrën e paarsyeshme të këtyre kostove.

9. Pikat 6, 7 dhe 8, të këtij neni, nuk zbatohen kur subjekti i rregulluar i ka zgjidhur tashmë të gjitha mospërputhjet dhe rekomandimet për përmirësim dhe ka dorëzuar ndryshimet përkatëse të planit të monitorimit tek AKM-ja për miratim, në përputhje me nenin 94, të kësaj rregulloreje, përpara datave të përcaktuar në pikat 6 dhe 7, të këtij neni.

Neni 127

Përcaktimi i shkarkimeve nga AKM-ja

1. AKM-ja bën një vlerësim konservativ të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar, duke marrë parasysh pasojat e transferimit të kostove te konsumatorët, kur verifikohet një nga situatat e mëposhtme:

a) Subjekti i rregulluar nuk ka dorëzuar raportin e shkarkimeve vjetore të verifikuar nga verifikuesi i akredituar, brenda afatit të përcaktuar në nenin 125, të kësaj rregulloreje;

b) Raporti i shkarkimeve vjetore i verifikuar nga verifikuesi i akredituar, i përmendur në nenin 125, të kësaj rregulloreje, nuk është në përputhje me dispozitat e saj;

c) Raporti vjetor i shkarkimeve i subjektit të rregulluar nuk është verifikuar nga verifikuesi i akredituar, në përputhje me parashikimet e nenit 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore zbatuese.

2. Kur verifikuesi i akredituar ka deklaruar, në raportin e verifikimit të hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore zbatuese, ekzistencën e pasaktësive të parëndësishme, që nuk janë korrigjuar nga subjekti i rregulluar përpara lëshimit të raportit të verifikimit, AKM-ja shqyrton këto pasaktësi dhe jep një vlerësim konservativ të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, duke marrë parasysh pasojat e transferimit të kostove te konsumatorët. AKM-ja informon subjektin e rregulluar nëse është e

nevojshme korrigjohet raporti vjetor i shkarkimeve dhe cilat korrigjime duhen kryer. Subjekti i rregulluar vendos këtë informacion në dispozicion të verifikuesit të akredituar.

Neni 128
Aksesi në informacion dhe rrumbullakosja e të dhënave

1. Raportet vjetore të shkarkimeve që mbahen nga AKM-ja vihen në dispozicion të publikut përveç rasteve kur vënia në dispozicion e tyre kufizohet nga parashikimet e nenit 17, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. Subjektet e rregulluara mund të tregojnë në raportet e tyre cilin informacion e konsiderojnë si sekret tregtar ose si informacion që duhet t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera të parashikuara në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

2. Shkarkimet totale vjetore të secilit prej gazeve me efekt serrë CO_2, N_2O dhe PFC-së, duhet të raportohen si ton të CO_2 ose CO_2(e) të rrumbullakosura.

3. Të gjithë treguesit, që përdoren për të llogaritur shkarkimet, rrumbullakosen që të përfshijnë të gjitha shifrat me rëndësi, për qëllim të llogaritjes dhe raportimit të shkarkimeve.

Neni 129
Përputhshmëria me raportimet e tjera

Me qëllim raportimin e shkarkimeve të aktiviteteve të renditura në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që kryhet nga subjekti i rregulluar:

a) sektorët në të cilët hidhen për konsum dhe digjen lëndët djegëse të përkufizuara, sipas pikës 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, etiketohen duke përdorur kodet nga formati i përbashkët i raportimit për sistemet kombëtare të inventarit të gazeve serrë, siç miratohen nga organet përkatëse të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (kodi i *Common Reporting Format* (CRF));

b) lëndët djegëse të përkufizuara sipas pikës 40, të nenit 3, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, etiketohen duke përdorur kodet e nomenklaturës të kombinuar të mallrave, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;

c) për të garantuar koherencë me raportimin për qëllime tatimore, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, subjekti i rregulluar, gjatë raportimit të të dhënave të kontaktit në planin e monitorimit dhe në raportin e shkarkimeve, përdor, kur është e zbatueshme, numrin e regjistrimit dhe identifikimit të operatorit ekonomik, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, numrin e akcizës ose numrin kombëtar të regjistrimit dhe identifikimit të akcizës, të lëshuar nga autoriteti përkatës sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për akcizat.

SEKSIONI 8
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Neni 130
Formatet e shkëmbimit të të dhënave elektronike

1. AKM-ja i kërkon subjekteve të rregulluara të përdorin modele elektronike ose formate të standardizuara për paraqitjen e planeve të monitorimit dhe ndryshimeve në planin e monitorimit, si dhe për paraqitjen e raporteve vjetore të shkarkimeve, raporteve të verifikimit dhe raporteve të përmirësimit.

2. Në zbatim të pikës 1 më sipër, AKM-ja vendos në dispozicion të subjektit të rregulluar modelet elektronike ose formatet e standardizuara, sipas variantit më të përditësuar të publikuar nga Komisioni Evropian, të përshtatura dhe të përkthyera në gjuhën shqipe.

3. Kur përcaktohen formatet elektronike ose specifikimet e dosjeve elektronike që përdoren në përputhje me parashikimet e pikës 2, të këtij neni, AKM-ja mund të zgjedhë, në përputhje me risitë e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që miratohen në Republikën e Shqipërisë, një ose të dyja opsionet e mëposhtme:

a) Përdorimin e specifikimeve të formateve elektronike të bazuara në XML, si p.sh. te gjuha e raportimit e publikuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të procesit të monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve GES, që përdoret në lidhje me sistemet e automatizuara të përparuara;

b) Formate të publikuara nga AKM-ja në një formë që përdoret nga *software*-i standard i AKM-së, përfshirë fletë elektronike me funksione llogaritëse (p.sh., *Microsoft Excel* .xlsx, .xls etj.) dhe dokumentet

e përpunimit të tekstit (p.sh., *Microsoft Word* .docx, .doc etj).

Neni 131
Përdorimi i sistemeve të automatizuara

1. Kur përdoren sisteme të automatizuara për shkëmbimin elektronik të të dhënave, të bazuara në specifikimet e formateve elektronike, në përputhje me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 130, të kësaj rregulloreje, këto sisteme nëpërmjet përdorimit të masave teknologjike, që përputhen me arritjet aktuale të teknologjisë dhe duke u kujdesur që të jenë kosto-efikase, sigurojnë plotësimin e standardeve të mëposhtme:

a) Integritetin e të dhënave, duke parandaluar ndryshimin e mesazheve elektronike gjatë transmetimit;

b) Konfidencialitetin e të dhënave, përmes përdorimit të teknikave të sigurisë, përfshirë teknikave të enkriptimit, në mënyrë që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm nga pala për të cilën janë destinuar dhe që asnjë e dhënë të mos mund të përgjohet nga palë të paautorizuara;

c) Autenticitetin e të dhënave, në mënyrë që identiteti si i dërguesit ashtu edhe i marrësit të të dhënave të njihet dhe verifikohet;

ç) Pamundësinë për të mohuar të dhënat, në mënyrë që njëra palë e një transaksioni të mos ketë mundësi të mohojë se e ka marrë transaksionin dhe pala tjetër të mos ketë mundësi të mohojë se e ka dërguar atë, duke zbatuar metoda të tilla, si teknikat e nënshkrimit ose auditimi i pavarur i masave mbrojtëse të sistemit.

2. Çdo sistem i automatizuar i përdorur, i bazuar në specifikimet e formateve elektronike në përputhje me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 130, të kësaj rregulloreje, për komunikimin ndërmjet AKM-së, subjektit të rregulluar, si dhe verifikuesit të akredituar dhe drejtorisë së përgjithshme të akreditimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore zbatuese, përdor masat teknologjike, që përputhen me arritjet aktuale të teknologjisë dhe plotëson kërkesat jofunksionale të mëposhtme:

a) Kontrollin e aksesit, në mënyrë që sistemi të jetë i aksesueshëm vetëm nga palët e autorizuara dhe asnjë e dhënë të mos mund të lexohet, shkruhet ose përditësohet nga palë të paautorizuara, përmes zbatimit të masave teknologjike për të arritur zbatimin e masave të mëposhtme:
i) Kufizimin e aksesit fizik të *hardware*-ve, të cilët bazohen në sistemet e automatizuara, duke vendosur barriera fizike;

ii) Kufizimin e aksesit logjik te sistemet e automatizuara, përmes përdorimit të teknologjive për identifikimin, autentifikimin dhe autorizimin;

b) Disponueshmërinë e të dhënave, në mënyrë që të sigurohet aksesueshmëria e të dhënave edhe pas kalimit të një periudhe të konsiderueshme kohe dhe përdorimit të *software*-ve të rinj të mundshëm;

c) Gjurmueshmërinë e auditimit, në mënyrë që të sigurohet që ndryshimet te të dhënat të mund të identifikohen dhe analizohen gjithmonë në retrospektivë.

SEKSIONI 9
DISPOZITA HORIZONTALE LIDHUR ME MONITORIMIN E SHKARKIMEVE NGA SUBJEKTET E RREGULLUARA

Neni 132
Shmangia e numërimit të dyfishtë përmes monitorimit dhe raportimit

1. Subjektet e parashikuara në pikën 5, të nenit 8, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, subjektet e ngarkuara me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it, sipas kësaj rregulloreje dhe shoqëritë e transportit detar lehtësojnë shkëmbimet efikase të informacionit, që u mundësojnë subjekteve të rregulluara të përcaktojnë përdorimin përfundimtar të lëndës djegëse të hedhur për konsum.

2. Çdo operator instalimi ose operator avioni, së bashku me raportin e verifikuar të shkarkimeve sipas pikës 1, të nenit 75, të kësaj rregulloreje, paraqet informacion, në përputhje me aneksin Xa, të kësaj rregulloreje. AKM-ja mund të kërkojnë që operatorët e sipërpërmendur t'i vënë në dispozicion subjektit të rregulluar informacionin përkatës, të renditur në aneksin Xa, të kësaj rregulloreje, më herët se data 31 mars e vitit të raportimit.

3. Çdo subjekt i rregulluar, së bashku me raportin e verifikuar të shkarkimeve, sipas pikë 1, të nenit 125, të kësaj rregulloreje, paraqet informacionin e renditur në shtojcën Xb, të kësaj rregulloreje, për konsumatorët e lëndës djegëse që ka hedhur për konsum.

4. Çdo subjekt i rregulluar që hedh për konsum lëndë djegëse për djegie në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, përcakton shkarkimet e tij të raportuara në raportin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 125, të kësaj rregulloreje, duke përdorur informacionin e marrë nga raportet e operatorëve të instalimeve ose të operatorëve të avionit, të paraqitura në përputhje me shtojcën Xa, të kësaj rregulloreje dhe duke zbritur sasitë përkatëse të lëndëve djegëse, të përmendura në këto raporte. Sasitë e lëndëve djegëse të blera, por të papërdorura në vitin e blerjes, mund të zbriten vetëm nëse raporti i verifikuar i shkarkimeve i operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit për vitin që vjen pas vitit të raportimit, konfirmon se ato janë përdorur për veprimtaritë e përmendura në shtojcën II, pjesët A dhe B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Në të kundërt, diferenca përkatëse pasqyrohet në raportin e verifikuar të shkarkimeve të subjektit të rregulluar për atë vit.

5. Kur sasitë e lëndëve djegëse të përdorura zbriten në vitin pasardhës të vitit të raportimit, zbritja përcaktohet në formën e reduktimeve absolute të shkarkimeve, të nxjerra duke shumëzuar sasinë e lëndëve djegëse të përdorura nga operatori i instalimit ose operatori i avionit me faktorin përkatës të shkarkimit të përcaktuar në planin e monitorimit të subjektit të rregulluar.

6. Kur subjekti i rregulluar nuk mund të vërtetojë se lëndët djegëse të hedhura për konsum përdoren për djegie në sektorë, që i mbulohen nga shtojca II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, pikat 4 dhe 5, të këtij neni, nuk zbatohen.

Neni 133

Parandalimi i mashtrimit dhe detyrimi për bashkëpunim

1. Për të siguruar monitorimin dhe raportimin e saktë të shkarkimeve të subjektit të rregulluar për aktivitetet e mbuluara nga shtojca II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, zbatohen kundërvajtjet e parashikuara në ligjin nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, kundërvajtjet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për lëndët djegëse, si dhe veprat penale në fushën e doganave, taksave dhe tatimeve, të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

2. Autoritetet kompetente për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, sipas ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, e të kësaj rregulloreje, si dhe autoritetet që ushtrojnë kompetenca të tjera, sektoriale mbi operatorin e instalimit, subjektin e rregulluar ose operatorin e avionit, kanë detyrimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve mes tyre për të zbuluar shkeljet dhe për të vendosur sanksionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni.

SHTOJCA I

ELEMENTET E DETYRUESHME TË PLANIT TË MONITORIMIT

(Pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 12, të rregullores)

1. ELEMENTET E DETYRUESHME TË PLANIT TË MONITORIMIT PËR INSTALIMET

Plani i monitorimit i një instalimi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

1) Informacion të përgjithshëm për instalimin dhe konkretisht:

a) Një përshkrim të instalimit dhe aktiviteteve që kryhen brenda instalimit, të cilat janë subjekt i monitorimit, duke përfshirë listën e burimeve të shkarkimeve dhe rrymave të shkarkimeve, që monitorohen për çdo aktivitet të kryer brenda instalimit. Përshkrimi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

i) Përshkrimi duhet të jetë mjaftueshëm i plotë që të dëshmojë se nuk ka mungesë të të dhënave dhe as llogaritje të dyfishtë të shkarkimeve;

ii) Përshkrimi duhet të përmbajë një skicë të thjeshtë të burimeve të shkarkimit, rrymave të shkarkimit, pikave të marrjes së mostrave dhe pajisjeve matëse kur kërkohet nga AKM-ja ose kur një skicë e tillë e bën më të qartë përshkrimin e instalimit apo referimin e burimeve të shkarkimit, rrymave të shkarkimit, instrumenteve matëse dhe çdo pjese tjetër të instalimit që është e rëndësishme për metodologjinë e monitorimit, përfshirë aktivitetet në lidhje me fluksin e të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit.

b) Përshkrimin e procedurës për organizimin dhe menaxhimin e ndarjes së përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin brenda instalimit, si

dhe për administrimin e kompetencave të personelit përgjegjës;

c) Përshkrimin e procedurës për vlerësimin periodik të përshtatshmërisë së planit të monitorimit që duhet të përfshijë të paktën elementet vijuese:

i) Verifikimin e listës së burimeve të shkarkimit dhe rrymave të shkarkimit, duke siguruar që ato të jenë të plota dhe përfshirjen në planin e monitorimit të çdo ndryshimi përkatës në natyrën dhe funksionimin e instalimit;

ii) Vlerësimin e përputhshmërisë me pragjet e pasigurisë të të dhënave të aktivitetit dhe parametrave të tjerë, sipas rastit, për shkallët metodologjike, që zbatohen për secilën rrymë shkarkimi dhe burim shkarkimi;

iii) Vlerësimin e masave që mund të ndërmerren për të përmirësuar metodologjinë e monitorimit që po zbatohet.

ç) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet në lidhje me fluksin e të dhënave, në përputhje me nenin 65, të kësaj rregulloreje, duke përfshirë një skicë shpjeguese, kur është e nevojshme për qartësim;

d) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet e kontrollit të vendosura, në përputhje me nenin 66;

dh) Kur është e zbatueshme, informacion për lidhjet përkatëse me aktivitetet e ndërmarra në kuadër të skemës së Bashkimit Evropian për ekomenaxhimin dhe auditimin (EMAS), të themeluar në përputhje me rregulloren (KE) nr. 1221/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, informacion për sistemet e mbuluara nga standardi i harmonizuar ISO 14001:2015 dhe për sistemet e tjera të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë informacionin për procedurat dhe kontrollet, që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

e) Numrin e variantit të planit të monitorimit që po zbatohet dhe datën nga e cila ky version i planit të monitorimit është i zbatueshëm;

ë) Kategorinë e instalimit.

2) Një përshkrim të hollësishme të metodologjive të bazuara në llogaritje, kur janë të zbatueshme, që përmban elementet e mëposhtme:

a) Përshkrimin e hollësishëm të metodologjisë, të bazuar në llogaritje, që zbatohet, duke përfshirë një listë të të dhënave hyrëse dhe formulave të përdorura për llogaritje, një listë të shkallëve metodologjike të zbatuara për të dhënat e aktivitetit dhe të gjithë faktorët përkatës të llogaritjes për çdo rrymë shkarkimi që është objekt monitorimit;

b) Kur është e zbatueshme dhe kur operatori i instalimit synon të përdorë thjeshtimin për rrymat e vogla të shkarkimit dhe rrymat minimale *(de minimis)* të shkarkimit, kategorizimin e rrymave të shkarkimit në rryma të mëdha, rryma të vogla dhe rryma minimale *(de minimis)* shkarkimi;

c) Përshkrimin e sistemeve matëse të përdorura dhe diapazonit të tyre matës, pasigurisë së specifikuar dhe të vendndodhjes së saktë të instrumenteve matëse që përdoren për secilën nga rrymat e shkarkimit objekt monitorimi;

ç) Kur është e zbatueshme, për secilën nga rrymat e shkarkimit, vlerat standarde të përdorura për faktorët e llogaritjes, duke treguar burimin e faktorit ose burimin përkatës nga i cili faktori standard do të nxirret periodikisht;

d) Kur është e zbatueshme, një listë të metodave analitike që do të përdoren për përcaktimin e të gjithë faktorëve përkatës të llogaritjes për secilën nga rrymat e shkarkimit dhe një përshkrim të procedurave të shkruara për këto metoda analitike;

dh) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të procedurës që mbështet planin e marrjes së mostrave për marrjen e mostrave të lëndëve djegëse dhe materialeve që do të analizohen, si dhe procedurën e përdorur për rishikimin e përshtatshmërisë së planit të marrjes së mostrave;

e) Kur është e zbatueshme, një listë të laboratorëve të angazhuar për kryerjen e procedurave përkatëse analitike dhe, kur laboratori nuk është i akreditуar, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 34, të kësaj rregulloreje, një përshkrim të procedurës së përdorur për të dëshmuar përputhshmërinë me kërkesat ekuivalente në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 34, të kësaj rregulloreje.

3) Kur zbatohet një metodologji alternative monitorimi, në përputhje me nenin 22, të kësaj rregulloreje, një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë së monitorimit, që zbatohet për të gjitha rrymat e shkarkimit ose burimet e shkarkimit, për të cilat nuk përdoret një shkallë metodologjike e përcaktuar, si dhe një përshkrim të procedurës së shkruar që përdoret për kryerjen e analizës përkatëse të pasigurisë;

4) Përshkrimin e hollësishëm të metodologjive të bazuara në matje, kur zbatohen, duke përfshirë elementet e mëposhtme:

a) Përshkrimin e metodës së matjes, përfshirë përshkrimin e të gjitha procedurave të shkruara, që lidhen me matjen dhe me elementet e mëposhtme:

i) Çdo formulë llogaritjeje, që përdoret për grumbullimin e të dhënave dhe për përcaktimin e shkarkimeve vjetore çdo burimi shkarkimi;

ii) Metoda të përdorura për të përcaktuar nëse është e mundur, që për çdo parametër të llogariten oraret e vlefshme ose periudha reference më të shkurtra, si dhe për zëvendësimin e të dhënave, që mungojnë në përputhje me nenin 46, të kësaj rregulloreje;

b) Listën e të gjitha pikave përkatëse të shkarkimeve gjatë operacioneve të zakonshme, si dhe gjatë fazave të funksionimit të kufizuar ose fazave të tranzicionit, duke përfshirë periudhat e ndërprerjes ose fazat e vënies në punë, shoqëruar me një diagram të procesit kur kërkohet nga AKM-ja;

c) Kur fluksi i gazeve të të çliruara nga djegia përcaktohet me anë të llogaritjes, një përshkrim të procedurës së shkruar të kësaj llogaritjeje për çdo burim shkarkimi, që monitorohet duke përdorur një metodologji të bazuar në matje;

ç) Listën e të gjithë pajisjeve përkatëse, që ilustron shpeshtësinë e matjes, diapazonin e funksionimit dhe pasigurinë e tyre;

d) Listën e standardeve të zbatuara dhe të çdo devijimi nga këto standarde;

dh) Përshkrimin e procedurës së shkruar për kryerjen e llogaritjeve mbështetëse, në përputhje me nenin 47, të kësaj rregulloreje, kur është e zbatueshme;

e) Përshkrimin e metodës që zbatohet për përcaktuar dhe zbritur nga shkarkimet CO_2 të matura, atë CO_2, që e ka prejardhjen nga lëndët djegëse me normë zero, si dhe të procedurës së shkruar të përdorur për këtë qëllim, kur është e zbatueshme;

ë) Kur është e zbatueshme dhe kur operatori i instalimit ka për qëllim të përdorë metodën e thjeshtuar për burimet e vogla të shkarkimeve, kategorizimin e burimeve të shkarkimeve në burime të mëdha dhe burime të vogla shkarkimesh.

5) Përveç elementeve të përmendura në pikën 4 më sipër, një përshkrim të detajuar të metodologjisë së monitorimit, kur monitorohen shkarkimet e N_2O, sipas rastit me anë të përshkrimit të procedurave të shkruara që zbatohen, duke përfshirë përshkrimin e elementeve të mëposhtme:

a) Metodave dhe parametrave të përdorur për të përcaktuar sasinë e materialeve, që përdoren në procesin e prodhimit dhe sasinë maksimale të materialit që përdoret në procesin e prodhimit me kapacitet të plotë;

b) Metodave dhe parametrave të përdorur për të përcaktuar sasinë e produktit të prodhuar në orë, të shprehur si acid nitrik (100 %), acid adipik (100 %), kaprolaktam, glioksal dhe acid glioksilik përkatësisht në orë;

c) Metodave dhe parametrave të përdorur për të përcaktuar përqendrimin e N_2O në gazet e çliruara nga djegia nga çdo burim shkarkimi, diapazoni i funksionimit dhe pasiguria përkatëse, si dhe hollësitë për çdo metodë alternative, që zbatohet kur përqendrimet bien jashtë diapazonit të funksionimit dhe rastet kur mund të ndodhë një situatë e tillë;

ç) Metodën e llogaritjes së përdorur për të përcaktuar shkarkimet e N_2O nga burimet periodike, që nuk i nënshtrohen trajtimit të zvogëlimit të shkarkimeve gjatë prodhimit të acidit nitrik, acidit adipik, kaprolaktamit, glioksalit dhe acidit glioksilik;

d) Përshkrimin se në çfarë mënyre dhe deri në çfarë shkalle instalimi funksionon me ngarkesa të ndryshueshme, si dhe përshkrimin e mënyrës sesi menaxhohen operacionet gjatë këtyre kushteve;

dh) Metodën dhe çdo formulë llogaritjeje të përdorur për të përcaktuar shkarkimet vjetore të N_2O dhe vlerat përkatëse të CO_2(e) për çdo burim shkarkimi;

e) Informacionin për kushtet e procesit që devijojnë nga zhvillimi normal i aktivitetit, përshkrimin e shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së mundshme të këtyre kushteve, si dhe përshkrimin e vëllimit të shkarkimeve të N_2O-së gjatë kushteve devijuese të procesit, si për shembull në rast të mosfunksionimit të pajisjeve të zvogëlimit të shkarkimeve.

6) Një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë së monitorimit të perfluorokarboneve (PFC) nga prodhimi i aluminit nga lënda e parë, kur është e nevojshme nëpërmjet përshkrimit të procedurave të shkruara të zbatuara, duke përfshirë elementet e mëposhtme:

a) Kur është e zbatueshme, datat e matjeve për përcaktimin e faktorëve specifikë të shkarkimit të instalimit SEFCF4 ose OVC dhe FC2F6, si dhe një plan për përsëritjen e ardhshme të këtyre përcaktimeve;

b) Kur është e zbatueshme, protokollin që përshkruan procedurën e përdorur për përcaktimin e faktorëve specifikë të shkarkimit të instalimit për CF4 dhe C2F6, duke treguar gjithashtu se matjet janë kryer dhe do të kryhen për një kohë mjaftueshmërisht të gjatë që vlerat e matura të përputhen të paktën për 72 orë;

c) Kur është e zbatueshme, metodologjinë për përcaktimin e efikasitetit të grumbullimit të shkarkimeve të pakapshme në instalimet e prodhimit të aluminit nga lënda e parë;

ç) Një përshkrim të llojit të qelizës elektrolitike dhe llojit të anodës.

7) përshkrimin e hollësishëm të metodologjisë së monitorimit kur kryhet transferimi i CO_2 së brendshme, si pjesë e një rryme shkarkimi, në përputhje me nenin 49, të kësaj rregulloreje, transferimi i CO_2, në përputhje me nenin 50, të kësaj rregulloreje, ose transferimi i N_2O në përputhje me nenin 52, të kësaj rregulloreje, sipas rastit, nëpërmjet përshkrimit të procedurave të shkruara të zbatuara, duke përfshirë elementet e mëposhtme:

a) Kur është e zbatueshme, vendndodhjen e pajisjeve për matjen e temperaturës dhe presionit në një infrastrukturë transporti të CO_2;

b) Kur është e zbatueshme, procedurat për parandalimin, zbulimin dhe përcaktimin sasior të rrjedhjeve në rastet kur verifikohen rrjedhje nga infrastruktura e transportit të CO_2;

c) Në rastin e infrastrukturës së transportit të CO_2, procedurat që sigurojnë në mënyrë efektive që CO_2 të transferohet vetëm drejt instalimeve, që kanë një autorizim të vlefshëm për shkarkimet e gazeve me efekt serrë, ose ku çdo CO_2 i shkarkuar monitorohet dhe llogaritet në mënyrë efektive, në përputhje me nenin 50, të kësaj rregulloreje;

ç) Identifikimin e instalimeve pritëse dhe atyre transferuese nëpërmjet kodit të identifikimit të instalimit të përcaktuar dhe të njohur, në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje;

d) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të sistemeve të matjes së vazhdueshme të përdorura në pikat e transferimit të CO_2 ose N_2O ndërmjet instalimeve, që transferojnë CO_2 ose N_2O, ose të metodës së përcaktimit, në përputhje me nenet 49, 50 ose 52, të kësaj rregulloreje;

dh) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të metodës konservative të vlerësimit të përdorur për përcaktimin e fraksionit me normë zero dhe fraksionit RFNBO ose RCF me normë zero të CO_2 së brendshme ose të transferuar, në përputhje me nenet 49, 50 ose 51, të kësaj rregulloreje;

e) Kur është e zbatueshme, metodologjitë e përcaktimit sasior të shkarkimeve ose të CO_2 të lëshuar në shtresën ujore nga rrjedhjet e mundshme, si dhe metodologjitë e zbatuara dhe, sipas rastit, të përshtatura për përcaktimin sasior të shkarkimeve reale ose të CO_2 të lëshuar në shtresën ujore nga rrjedhjet, siç përcaktohet në seksionin 23, të shtojcës IV, të kësaj rregulloreje.

8) një përshkrim i hollësishëm i metodologjisë së monitorimit kur CO_2 lidhet në mënyrë kimike në përputhje me nenin 51 të kësaj rregulloreje, sipas rastit nëpërmjet përshkrimit të procedurave të shkruara të zbatuara, duke përfshirë elementet e mëposhtme:

a) Procedurat për përcaktimin nëse një produkt, në të cilin CO_2 është i lidhur në mënyrë të përhershme kimikisht, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 51, të kësaj rregulloreje, plotëson kërkesat e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 51, të kësaj rregulloreje, dhe të llojeve të përdorimeve të atyre produkteve;

b) Një përshkrim të metodologjisë së llogaritjes për përcaktimin e sasive të CO_2 të lidhura në mënyrë të përhershme kimikisht, në përputhje me pikën 3, të nenit 51, të kësaj rregulloreje.

9) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të procedurës së përdorur për të vlerësuar nëse rrymat e shkarkimit me normë zero janë në përputhje me pikat 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje, ose me pikat 4 dhe 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, ose me pikat 6 dhe 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

10) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të përcaktuar sasinë e biogazit me normë zero, bazuar te të dhënat e blerjes në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 39, të kësaj rregulloreje, ose sasitë RFNBO ose RCF me normë zero, në përputhje me pikat 8 dhe 9, të nenit 40, të kësaj rregulloreje;

11) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të procedurës së përdorur për të paraqitur informacionin e përshkruar në shtojcën Xa, të kësaj rregulloreje, dhe vënien në dispozicion të subjektit të rregulluar.

2. ELEMENTET E DETYRUESHME TË PLANIT TË MONITORIMIT PËR AVIACIONIN

1. Të gjithë operatorët e avionit duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm në planin e monitorimit:

a) Identifikimin e operatorit të avionit, sinjalin e thirrjes ose çdo shenjues unik tjetër të përdorur për qëllime të kontrollit të trafikut ajror, të dhënat e kontaktit të operatorit të avionit dhe të një personi përgjegjës pranë operatorit të avionit, adresën e kontaktit, shtetin anëtar përgjegjës për administrimin, autoritetin kompetent administrues;

b) Një listë fillestare të llojeve të avionëve në flotën e operatorit të avionit që janë operative në kohën e paraqitjes së planit të monitorimit dhe numrin e avionëve për çdo lloj, si dhe një listë orientuese të llojeve të tjera të avionëve që pritet të përdoren, duke përfshirë, kur është e disponueshme, vlerësimin e numrit të mundshëm të avionëve për çdo lloj, si dhe rrymat e shkarkimit (llojet e lëndëve djegëse) të lidhura me secilin lloj avioni;

c) Përshkrimin e procedurave, sistemeve dhe përgjegjësive që zbatohen për të përditësuar listën e plotë të burimeve të shkarkimit gjatë vitit të monitorimit, me qëllim garantimin e monitorimit dhe raportimit të plotë të shkarkimeve dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 të avionëve në pronësi, si dhe të avionëve të marrë me qira;

ç) Përshkrimin e procedurave të përdorura për të monitoruar që lista e fluturimeve të kryera nën kodin unik, sipas çifteve të aerodromeve është e plotë, dhe të procedurave të përdorura për të përcaktuar nëse fluturimet mbulohen nga shtojca II pjesa B, e të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, me qëllim garantimin e identifikimit të plotë të fluturimeve dhe të shmangies së numërimit të dyfishtë;

d) Përshkrimin e procedurës për menaxhimin dhe ndarjen e përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin, si dhe për menaxhimin e kompetencave të personelit përgjegjës;

dh) Përshkrimin e procedurës për vlerësimin periodik të përshtatshmërisë së planit të monitorimit, duke përfshirë çdo masë të mundshme për përmirësimin e metodologjisë së monitorimit dhe të procedurave të lidhura që zbatohen;

e) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet e fluksit të të dhënave, siç kërkohet nga neni 65, të kësaj rregulloreje, duke përfshirë një diagram, kur kjo është e përshtatshme për qartësim;

ë) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet e kontrollit të përcaktuara në nenin 66, të kësaj rregulloreje;

f) Kur është e zbatueshme, informacion për lidhjet përkatëse me aktivitetet e ndërmarra në kuadër të skemës së Bashkimit Evropian për ekomenaxhimin dhe auditimin EMAS, informacion për sistemet e mbuluara nga standardi i harmonizuar ISO 14001:2015 dhe për sistemet e tjera të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë informacionin për procedurat dhe kontrollet që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;

g) Numrin e versionit të planit të monitorimit dhe datën, nga e cila ky version i planit të monitorimit është i zbatueshëm;

gj) Konfirmimin nëse operatori i avionit ka ndërmend të përdorë ndonjë nga mjetet e përmendura në pikën 2, të nenit 61, të kësaj rregulloreje;

h) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të vlerësuar nëse biokarburanti me normë zero, RFNBO me normë zero, RCF me normë zero ose lënda djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero janë, në përputhje me nenin 60, të kësaj rregulloreje;

i) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të përcaktuar sasinë e karburanteve alternative të aviacionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 55, të kësaj rregulloreje, dhe për të siguruar që lëndët djegëse të papërziera që janë raportuar janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 56, të kësaj rregulloreje;

j) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të vlerësuar nëse lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin është në përputhje me pikën 2, të nenit 58, të kësaj rregulloreje;

k) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të përcaktuar sasitë e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin në përputhje me pikën 3, të nenit 58, të kësaj rregulloreje, dhe për të siguruar që lëndët djegëse të raportuara janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 58, të kësaj rregulloreje;

l) Konfirmimin nëse operatori i avionit kryen ndonjë fluturim sipas pikës 1, të nenit 63, të kësaj rregulloreje;

ll) Konfirmimin nëse operatori i avionit ka ndërmend të përdorë vetëm NEATS për të përcaktuar efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 apo nëse ka ndërmend të përdorë, për të gjitha ose për një pjesë të të dhënave të monitoruara, mjetet e veta të teknologjisë së informacionit ose mjetet TIK të palëve të treta, siç përcaktohet në pikën 7, të nenit 63, të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllim monitorimin e shkarkimeve, plani i monitorimit i operatorëve të avionit që nuk janë shkarkues të vegjël, sipas pikës 1, të nenit 61, të kësaj rregulloreje, ose të cilët nuk kanë në plan të përdorin mjetet e shkarkuesve të vegjël sipas pikës 2, të nenit 61, të kësaj rregulloreje, përmban informacionet e mëposhtme:

a) Përshkrimin e procedurës së shkruar që do të përdoret për përcaktimin e metodologjisë së monitorimit për llojet e tjera të avionëve që është e pritshme të përdoren nga një operator avioni

b) Përshkrimin e procedurave të shkruara për monitorimin e konsumit të lëndës djegëse në çdo avion, duke përfshirë:

i) Informacion për metodologjinë e zgjedhur (metodat A ose B) për llogaritjen e konsumit të lëndës djegëse; dhe, kur nuk zbatohet e njëjta metodë për të gjitha llojet e avionëve, argumentimin për metodologjinë e zgjedhur, si dhe një listë që përcakton se cila metodologji përdoret në kushtet të caktuara;

ii) Informacion për procedurat për matjen e furnizimit me lëndë djegëse dhe matjen e lëndës djegëse, që ndodhet në depozitën e avionit, një përshkrim të instrumenteve matëse të përdorura dhe procedurat për regjistrimin, rikuperimin, transmetimin dhe ruajtjen e informacionit lidhur me matjet, sipas rastit;

iii) Informacion për metodën për përcaktimin e densitetit, kur është e zbatueshme;

iv) Argumentimin në lidhje me metodologjinë e monitorimit, që është zgjedhur të zbatohet, me qëllim sigurimin e niveleve më të ulëta të pasigurisë, në përputhje me pikën 1, të nenit 62, të kësaj rregulloreje;

c) Listën e devijimeve nga metodologjia e përgjithshme e monitorimit të aerodromeve specifike, siç përshkruhet në shkronjën "b" më sipër, kur operatori i avionit, për shkak të rrethanave të veçanta, nuk është në gjendje të sigurojë të gjitha të dhënat e kërkuara nga metodologjia e përcaktuar e monitorimit;

ç) Faktorët e shkarkimit të përdorur për çdo lloj lënde djegëse, ose, në rastin e lëndëve djegëse alternative, metodologjitë për përcaktimin e faktorëve të shkarkimit, duke përfshirë metodologjinë e marrjes së mostrave, metodat e analizës, përshkrimin e laboratorëve të përdorur dhe të akreditimit të tyre dhe/ose të procedurave të tyre të sigurimit të cilësisë;

d) Përshkrimin e procedurave dhe sistemeve për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e mangësive të të dhënave, në përputhje me pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 73, të kësaj rregulloreje.

3. Me qëllim monitorimin e efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, plani i monitorimit i operatorëve të avionit, që nuk përdorin vetëm NEATS për të përcaktuar efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, duhet të përmbajë, sipas rastit, informacionin e mëposhtëm:

a) Përshkrimin e modulit të djegies së lëndës djegëse dhe të modulit të vlerësimit të shkarkimeve, modelit të llogaritjes së CO_2(e) dhe të mjeteve përkatëse të teknologjisë së informacionit, që operatori i avionit ka ndërmend të përdorë;

b) Përshkrimin dhe diagramin e fluksit të procesit të monitorimit të të dhënave, që lidhen me modelin e llogaritjes së CO_2(e), siç përshkruhet në shtojcën IIIa, seksioni 4, të kësaj rregulloreje;

c) Përshkrimin e procedurës së shkruar, që garanton se të dhënat që merren për bazë në modelet e llogaritjes së CO_2(e) janë të dhënat e përshtatshme, në përputhje me shtojcën IIIa, të kësaj rregulloreje, dhe që merren parasysh efektet klimatike të të gjithë agjentëve jo-CO_2, për çdo fluturim;

ç) Përshkrimin e procedurës së shkruar për identifikimin dhe vlerësimin e mangësive të të dhënave dhe për zbatimin e vlerave standarde të përshkruara në shtojcën IIIa, seksioni 5, dhe në shtojcën IIIb, të kësaj rregulloreje, që përdoren për të plotësuar mangësitë e të dhënave.

3. ELEMENTET E DETYRUESHME TË PLANIT TË MONITORIMIT PËR SUBJEKTET E RREGULLUAR

Plani i monitorimit i subjekteve të rregulluar duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

1) Informacion të përgjithshëm për subjektin e rregulluar dhe konkretisht:

a) Identifikimin e subjektit të rregulluar, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, dhe, kur është e zbatueshme, numrin e regjistrimit dhe identifikimit të operatorit ekonomik sipas legjislacionit në fuqi, numrin e akcizës ose numrin kombëtar të regjistrimit dhe identifikimit të akcizës, i lëshuar nga autoriteti përkatës i përdorur për raportim për qëllime tatimore sipas legjislacionit në fuqi;

b) Një përshkrim të subjektit të rregulluar, që përmban një listë të rrymave të lëndës djegëse që do të monitorohen, mjetet nëpërmjet të cilave rrymat e lëndës djegëse hidhen për konsum, përdorimin/përdorimet fundore të rrymës së lëndës djegëse të hedhur për konsum, përfshirë kodin CRF, në nivelin e disponueshëm të konsolidimit (agregimit), dhe që plotëson kriteret e mëposhtme:

i) Përshkrimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të provuar se nuk ka as mangësi në të dhëna dhe as numërim të dyfishtë të shkarkimeve;

ii) Një diagram i thjeshtë i informacionit të përmendur në shkronjën "b" më sipër, që përshkruan subjektin e rregulluar, rrymat e lëndës djegëse, mjetet përmes të cilave lëndët djegëse të përkufizuara në pikën 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, hidhen për konsum, instrumentet matëse dhe çdo pjesë tjetër të subjektit të rregulluar që është me vlerë për metodologjinë e monitorimit, përfshirë aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit;

iii) Kur subjektet e rregulluara dhe rrymat e lëndës djegëse të mbuluara përkojnë me subjekte me detyrime raportimi dhe me lëndë djegëse që i nënshtrohen legjislacionit shqiptar në lidhje me taksimin e produkteve të energjisë ose legjislacionit specifik për këto lëndë djegëse, një diagram të thjeshtë të metodave të matjes të përdorura në kuadër të këtij legjislacioni;

iv) Kur është e zbatueshme, një përshkrim i çdo devijimi nga fillimi dhe përfundimi i vitit të monitorimit në përputhje me pikat, 3, 4 dhe 5, të nenit 103, të kësaj rregulloreje.

c) Përshkrimin e procedurës për organizimin dhe menaxhimin e ndarjes së përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin, brenda subjektit të rregulluar, si dhe për administrimin e kompetencave të personelit përgjegjës;

ç) Përshkrimin e procedurës për vlerësimin periodik të përshtatshmërisë së planit të monitorimit që duhet të përfshijë, të paktën, elementet vijuese:

i) Verifikimin e listës së rrymave të lëndës djegëse, duke siguruar që ato të jenë të plota dhe përfshirjen në planin e monitorimit të çdo ndryshimi përkatës në natyrën dhe funksionimin e subjektit të rregulluar;

ii) Vlerësimin e përputhshmërisë me pragjet e pasigurisë në lidhje me sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe parametrave të tjerë, sipas rastit, për shkallët metodologjike që zbatohen për secilën rrymë lënde djegëse;

iii) Vlerësimin e masave që mund të ndërmerren për të përmirësuar metodologjinë e monitorimit, që po zbatohet dhe veçanërisht metodën e përcaktimit të faktorit sektorial.

d) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet në lidhje me fluksin e të dhënave, në përputhje me nenin 65, duke përfshirë një skicë shpjeguese, kur është e nevojshme për qartësim;

dh) Përshkrimin e procedurave të shkruara për aktivitetet e kontrollit të vendosura, në përputhje me nenin 66, të kësaj rregulloreje;

e) kur është e zbatueshme, informacion mbi lidhjet përkatëse ndërmjet veprimtarisë së subjektit të rregulluar të renditur në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", i ndryshuar dhe raportimit për qëllime tatimore sipas legjislacionit kombëtar në fuqi për taksimin e produkteve të energjisë dhe akcizën;

ë) numrin e variantit të planit të monitorimit që po zbatohet dhe datën nga e cila ky version i planit të monitorimit është i zbatueshëm;

f) kategorinë e subjektit të rregulluar.

2) Një përshkrim të hollësishme të metodologjive, të bazuara në llogaritje që përmban elementet e mëposhtme:

a) Për çdo rrymë lënde djegëse, që do të monitorohet, një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë së zbatuar, të bazuar në llogaritje, përfshirë një listë të të dhënave hyrëse dhe formulave të llogaritjes të përdorura, metodat për përcaktimin e faktorit sektorial, një listë të shkallëve metodologjike të zbatuara për sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum, të gjithë faktorët përkatës të llogaritjes, faktorin sektorial dhe, në nivelin e njohur të konsolidimit (agregimit), kodet CRF të përdorimit/përdorimeve fundore të rrymës së lëndës djegëse të hedhur për konsum;

b) Kur subjekti i rregulluar synon të përdorë thjeshtimin për rrymat minimale *(de minimis)* të lëndës djegëse, kategorizimin e rrymave të lëndës djegëse në rryma të mëdha dhe rryma minimale (*de minimis*) lëndësh djegëse;

c) Përshkrimin e sistemeve matëse të përdorura dhe diapazonit të tyre matës, pasigurisë së specifikuar dhe të vendndodhjes së saktë të instrumenteve matëse që përdoren për secilën nga rrymat e lëndës djegëse objekt monitorimi;

ç) Kur është e zbatueshme, për secilën nga rrymat e lëndës djegëse, vlerat standarde të përdorura për faktorët e llogaritjes, duke treguar burimin e faktorit ose burimin përkatës, nga i cili faktori standard do të nxirret periodikisht;

d) Kur është e zbatueshme, një listë të metodave analitike që do të përdoren për përcaktimin e të gjithë faktorëve përkatës të llogaritjes për secilën nga rrymat e lëndës djegëse, dhe një përshkrim të procedurave të shkruara për këto metoda analitike;

dh) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të procedurës që mbështet planin e marrjes së mostrave për marrjen e mostrave të lëndëve djegëse që do të analizohen, si dhe procedurën e përdorur për rishikimin e përshtatshmërisë së planit të marrjes së mostrave;

e) Kur është e zbatueshme, një listë të laboratorëve të angazhuar për kryerjen e procedurave përkatëse analitike dhe, kur laboratori nuk është i akreditуar, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 34, të kësaj rregulloreje, një përshkrim të procedurës së përdorur për të dëshmuar përputhshmërinë me kërkesat ekuivalente në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 34, të kësaj rregulloreje.

3) Kur është e zbatueshme, një përshkrim të procedurës së përdorur për të vlerësuar nëse rrymat e lëndës djegëse me normë zero janë në përputhje me pikat 5, 6 dhe 7, të nenit 38, të kësaj rregulloreje, ose me pikat 4 dhe 5, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, ose me pikat 6 dhe 7, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, dhe kur është e zbatueshme pika 2, e nenit 113, të kësaj rregulloreje.

4) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të përcaktuar sasinë e biogazit, bazuar te të dhënat e blerjes, në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 39, të kësaj rregulloreje.

5) Kur është e zbatueshme, përshkrimin e procedurës së përdorur për të paraqitur informacionin e përshkruar në pikën 3, të nenit 132, dhe për të marrë informacionin e përshkruar në pikën 2, të nenit 132, të e kësaj rregulloreje.

SHTOJCA II
PËRCAKTIMI I SHKALLËS METODOLOGJIKE PËR METODOLOGJITË E BAZUARA NË LLOGARITJE NË LIDHJE ME INSTALIMET
(Pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 12, të rregullores)

1. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR TË DHËNAT E AKTIVITETIT

Pragjet e pasigurisë të përcaktuara në tabelën 1 zbatohen për shkallët metodologjike që kanë të bëjnë me kërkesat e të dhënave të aktivitetit, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 28, me fjalinë e parë pikës 2, të nenit 29, si dhe me shtojcën IV, të kësaj rregulloreje. Pragjet e pasigurisë interpretohen si pasiguritë maksimale të lejueshme për përcaktimin e rrymave të shkarkimit gjatë një periudhe raportimi.

Kur tabela 1 nuk përfshin aktivitetet e radhitura në shtojcën II, pjesa A, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe kur nuk zbatohet bilanci i masës i përcaktuar në nenin 25, të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit për ato aktivitete duhet të përdorë shkallët metodologjike të radhitura në tabelën 1, nën zërin "Djegia e lëndëve djegëse dhe lëndët djegëse të përdorura si *input* në proces".

Tabela 1*. Shkallët metodologjike për të dhënat e aktivitetit (pasiguria maksimale e lejuar për çdo shkallë)*

Aktiviteti/lloji i rrymës së shkarkimit	Parametri ndaj të cilit zbatohet pasiguria	Shkalla metodologjike 1	Shkalla metodologjike 2	Shkalla metodologjike 3	Shkalla metodologjike 4
Djegia e lëndëve djegëse dhe lëndëve djegëse të përdorura si elemente hyrëse në proces					
Lëndët djegëse standarde komerciale	Sasia e lëndës djegëse [t] ose [Nm^3]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Lëndë djegëse të tjera të gazta dhe të lëngëta	Sasia e lëndës djegëse [t] ose [Nm^3]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Lëndët djegëse të ngurta, duke përjashtuar mbetjet	Sasia e lëndës djegëse [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Mbetjet	Sasia e lëndës djegëse [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Flakëruese	Sasia e gazit flakërues [Nm^3]	± 17,5 %	± 12,5 %	± 7,5 %	
Procesi i pastrimit (scrubbing) të gazeve me tretësirë karbonatesh (Metoda A)	Sasia e karbonatit të konsumuar [t]	± 7,5 %			
Procesi i pastrimit të gazeve me gips (Metoda B)	Sasia e gipsit të prodhuar [t]	± 7,5 %			
Procesi i pastrimit të gazeve me ure (tretësirë ureje)	Sasia e uresë së konsumuar [t]	± 7,5 %			
Rafinimi i naftës					
Rigjenerimi katalitik me djegie (*[1])	Kërkesat e pasigurisë zbatohen veçmas për çdo burim shkarkimi	± 10 %	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %
Prodhimi i koksit					
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Pjekja dhe sinterizimi i mineralit të metalit					
Karbonatet hyrëse dhe tepricat e procesit	Materiali hyrës karbonat dhe tepricat e procesit [t]	± 5 %	± 2,5 %		
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi i hekurit dhe çelikut					
Lënda djegëse si material hyrës i procesit	Çdo fluks mase drejt dhe prej instalimit [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi i klinkerit të çimentos					

Elementet hyrëse në furrë (Metoda A)	Çdo element që hyn në furrë [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	
Sasia e prodhuar e klinkerit (Metoda B)	Klinkeri i prodhuar [t]	± 5 %	± 2,5 %		
Pluhuri i furrës së çimentos (CKD)	CKD ose pluhuri i devijuar (*bypass*) i furrës së çimentos [t]	na (*2)	± 7,5 %		
Karboni jokarbonat	Çdo lëndë e parë [t]	± 15 %	± 7,5 %		
Prodhimi i gëlqeres dhe kalcinimi i dolomitit dhe magnezitit					
Karbonatet dhe materialet e tjera të procesit (Metoda A)	Çdo element që hyn në furrë [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	
Oksid Alkalin Tokësor (Metoda B)	Gëlqere e prodhuar [t]	± 5 %	± 2,5 %		
Pluhuri i furrës (Metoda B)	Pluhuri i furrës [t]	Na (*2)	± 7,5 %		
Prodhimi i xhamit dhe leshit mineral					
Karbonatet dhe materialet e tjera të procesit (në hyrje)	Çdo lëndë e parë karbonate ose çdo lëndë e shtuar që lidhet me shkarkimet e CO_2 [t]	± 2,5 %	± 1,5 %		
Prodhimi i produkteve qeramike					
Hyrjet e karbonit (Metoda A)	Çdo lëndë e parë karbonate ose çdo lëndë e shtuar që lidhet me shkarkimet e CO_2 [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	
Oksid alkali (Metoda B)	Prodhimi bruto, duke përfshirë produktet e skartuara dhe skrapin e xhamit (cullet) nga furrat dhe nga dërgesat [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	
Pastrim (*scrubbing*)	Sasia e $CaCO_3$ të thatë e konsumuar [t]	± 7,5 %			
Prodhimi i celulozës dhe letrës					
Kimikate plotësuese	Sasia e $CaCO_3$ dhe Na_2CO_3 [t]	± 2,5 %	± 1,5 %		
Prodhimi i karbonit të zi					
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi i amoniakut					
Lënda djegëse si material hyrës në proces	Sasia e lëndës djegëse e përdorur si material hyrës në proces [t] ose [Nm^3]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi i hidrogjenit dhe gazit të sintetizuar					
Lënda djegëse si material hyrës në proces	Sasia e lëndës djegëse të përdorur si *input* i procesit	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %

	për prodhimin e hidrogjenit [t] ose [Nm3]				
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi në shkallë të gjerë i kimikateve organike					
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi ose përpunimi i metaleve ferrore dhe joferrore, përfshirë aluminin dytësor					
Shkarkimet e procesit	Çdo material hyrës ose tepricë e procesit të përdorur si material hyrës në proces [t]	± 5 %	± 2,5 %		
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Prodhimi parësor i aluminit ose i aluminës					
Metodologjia e bilancit të masës	Çdo material hyrës dhe dalës [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Shkarkimet e PFC (metoda e pjerrësisë (slope))	Prodhimi i aluminit parësor në [t], minutat e efekteve të anodës në [numër efektesh anode/qelizë në ditë] dhe [në minuta efekti anode/shpeshtësia]	± 2,5 %	± 1,5 %		
Shkarkimet e PFC (metoda e mbitensionit)	Prodhimi i aluminit parësor [në ton], mbitensioni i efektit të anodës në [mV] dhe efikasiteti i rrymës [-]	± 2,5 %	± 1,5 %		
Kapja, transferimi dhe magazinimi gjeologjik i CO_2 në vendin e depozitimit të lejuar					
Bilanci i masës i CO_2 të transferuar	CO_2 i transferuar brenda ose jashtë një instalimi, infrastrukture transporti ose vend-depozitimi, që është çliruar qëllimisht (*vented*), që ka rrjedhur (*leaked*) ose që buron nga shkarkime të pakapshme [t]	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %	± 1,5 %
Çlirim i CO_2, rrjedhje dhe shkarkime të pakapshme	CO_2 i çliruar qëllimisht, i rrjedhur ose nga shkarkimet e pakapshme [t]	± 17,5 %	± 12,5 %	± 7,5 %'	

(*1) Për monitorimin e shkarkimeve nga rigjenerimi katalitik me djegie (rigjenerimi i katalizatorëve të tjerë dhe fleksikokerët) në rafineritë e naftës bruto, pasiguria e kërkuar lidhet me pasigurinë totale të të gjitha shkarkimeve nga ai burim.

(**) *Amount [t] of CKD or bypass dust (where relevant) leaving the kiln system over a reporting period estimated using industry best practice guidelines.*

(*2) Sasia [t] e pluhurit të furrës së çimentos (CKD) ose pluhurit të devijuar (aty ku është e nevojshme) që del nga sistemi i furrës gjatë një periudhe raportimi, i vlerësuar, duke përdorur udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë.

2. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR FAKTORËT LLOGARITËS TË SHKARKIMEVE NGA PROCESET E DJEGIES

Operatori i instalimit monitoron shkarkimet CO_2 nga të gjitha llojet e proceseve me djegie që kryhen gjatë zhvillimit të aktiviteteve të radhitura në shtojcën II, pjesa A, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, duke përdorur përcaktimet e shkallëve metodologjike të parashikuara në këtë seksion. Kur përdoren lëndë djegëse ose materiale të djegshme, që shkaktojnë shkarkime CO_2, si elemente hyrëse në proces, zbatohet seksioni 4, i kësaj shtojce. Kur lëndët djegëse janë pjesë e një bilanci të masës, në përputhje me pikën 1, të nenit 25, të kësaj rregulloreje, zbatohen përcaktimet e shkallës metodologjike për bilancet e masës të parashikuara në seksionin 3, të kësaj shtojce.

Për shkarkimet, që krijohen nga pastrimit të gazeve të shkarkimit të lidhura me procesin, do të përdoren, sipas rastit, përcaktimet e shkallës metodologjike në përputhje me seksionet 4 dhe 5, të kësaj shtojce.

2.1 Shkallët metodologjike për faktorët e shkarkimit

Kur për një karburant ose material të përzier përcaktohet një fraksion biomase ose një fraksion RFNBO ose RCF, ose një fraksion sintetik me karbon të ulët, shkallët metodologjike të përcaktuara do t'i referohen faktorit paraprak të shkarkimit. Për lëndët djegëse dhe materialet fosile, shkallët metodologjike do t'i referohen faktorit të shkarkimit.

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Faktorët standard të renditur në seksionin 1, të shtojcës VI;

b) Vlera të tjera konstante, në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur seksioni 1, i shtojcës VI, nuk përmban asnjë vlerë të zbatueshme.

Shkalla metodologjike 2a: Operatori i instalimit do të zbatojë faktorë specifikë kombëtarë të shkarkimit për lëndët djegëse ose për materialin përkatës në përputhje me shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, ose vlerat e parashikuara në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2b: Operatori i instalimit nxjerr faktorin e shkarkimit për lëndët djegëse bazuar në një nga vlerat e përafërta të pranuara së bashku me një ndërlidhje empirike që përcaktohet të paktën një herë në vit, në përputhje me nenet 32 deri 35 dhe 39, të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

a) Matja e densitetit të naftës ose gazrave specifikë, duke përfshirë ata që janë të zakonshëm në industrinë e rafinerisë ose të çelikut;

b) Vlera kalorifike neto për llojet specifike të qymyrit.

Operatori i instalimit sigurohet që ndërlidhja plotëson kërkesat e praktikës së mirë inxhinierike dhe se kjo ndërlidhje zbatohet vetëm për vlerat e përafërta, që bien brenda diapazonit për të cilin është krijuar.

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Përcaktimin e faktorit të shkarkimit, në përputhje me dispozitat përkatëse të neneve 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje;

b) Ndërlidhjen empirike të përcaktuar për shkallën metodologjike 2b, nëse operatori i instalimit i ofron AKM-së prova të mjaftueshme, që pasiguria e ndërlidhjes empirike nuk është më e madhe se 1/3 e vlerës së pasigurisë së cilës operatori i instalimit duhet t'i përmbahet në lidhje me përcaktimin e të dhënave të aktivitetit të lëndës djegëse ose materialit përkatës.

2.2 Shkallët metodologjike për vlerën kalorifike neto (NCV)

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Faktorët standard të renditur në seksionin 1, të shtojcës VI;

b) Vlera të tjera konstante në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur seksioni 1, i shtojcës VI, nuk përmban asnjë vlerë të zbatueshme.

Shkalla metodologjike 2a: Operatori i instalimit do të zbatojë faktorë specifikë kombëtarë të shkarkimit për lëndën djegëse përkatëse, në përputhje me shkronjat "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, ose vlerat e parashikuara, në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2b: Për lëndët djegëse, që tregtohen në mënyrë komerciale, do të përdoret vlera kalorifike neto e nxjerrë nga të dhënat e blerjes

së lëndës djegëse përkatëse, të siguruara nga furnizuesi i lëndës djegëse, me kusht që vlera kalorifike neto të jetë përcaktuar mbi bazën e standardeve të pranuara kombëtare ose ndërkombëtare.

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit përcakton vlerën kalorifike neto, në përputhje me parashikimet e neneve 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

2.3 Shkallët metodologjike për faktorët e oksidimit

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një faktor oksidimi të barabartë me 1.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit zbaton faktorët e oksidimit në lidhje me lëndën djegëse përkatëse, në përputhje me shkronjat "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje

Shkalla metodologjike 3: Për lëndët djegëse, operatori i instalimit llogarit faktorët specifik të aktivitetit në bazë të përmbajtjes së karbonit të hirit, të efluentëve dhe të mbetjeve dhe nënprodukteve të tjera, si dhe të formave të tjera të gazta të karbonit të paoksiduar plotësisht që janë shkarkuar, me përjashtim të CO-së. Të dhënat për përbërjen do të përcaktohen, në përputhje me parashikimet e neneve 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

2.4. Shkallët metodologjike për fraksionin e biomasës

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit përdor një vlerë të zbatueshme që botohet nga AKM ose vlerat në përputhje me pikën 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit përdor një metodë vlerësimi, në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 39, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3a: Operatori i instalimit përdor analizat në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të kësaj rregulloreje, dhe në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3b: Për lëndët djegëse që burojnë nga një proces prodhimi me rryma hyrëse të përcaktuara dhe të gjurmueshme, operatori i instalimit mund ta bazojë vlerësimin e tij mbi një bilanc të materialit të karbonit me origjinë fosile dhe të karbonit, që rrjedh nga biomasa, që hyn dhe del nga procesi, siç është sistemi i bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Kur operatori instalimit supozon një fraksion fosil prej 100%, në përputhje me pikën 1, të nenit 39, të kësaj rregulloreje, nuk do të caktohet asnjë shkallë metodologjike për fraksionin e biomasës.

2.5. Shkallët metodologjike për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin sintetik me karbon të ulët

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit përcakton fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, në bazë të sistemit të bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Kur operatori instalimit supozon një fraksion fosil prej 100 %, në përputhje me pikën 1, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, nuk do të caktohet asnjë shkallë metodologjike për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin sintetik me karbon të ulët.

3. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR FAKTORËT E LLOGARITJES TË BILANCEVE TË MASËS

Kur operatori i instalimit përdor një bilanc të masës, në përputhje me nenin 25, të kësaj rregulloreje, ai do të përdorë përcaktimet e këtij seksioni në lidhje me shkallën metodologjike.

3.1. Shkallët metodologjike për përmbajtjen e karbonit

Operatori i instalimit përdor një nga shkallët metodologjike të renditura në këtë pikë. Për të nxjerrë përmbajtjen e karbonit nga një faktor shkarkimi, operatori i instalimit përdor ekuacionet e mëposhtme:

a) Për faktorët e shkarkimit të shprehur si t CO_2/TJ : C = (EF × NCV) / f;

b) Për faktorët e shkarkimit të shprehur si t CO_2/t : C = EF / f.

Në formulat e mësipërme, C është përmbajtja e karbonit e shprehus si fraksion (tonelata karboni për tonelata produkti) EF-ja është faktori i shkarkimit, NCV është vlera kalorifike neto dhe f është faktori i parashikuar në pikën 3, të nenit 36, të kësaj rregulloreje.

Kur për një lëndë djegëse ose material të përzier përcaktohet një fraksion biomase ose fraksion RFNBO ose RCF, ose fraksion sintetik me karbon të ulët, shkallët metodologjike të përcaktuara do të lidhen me përmbajtjen totale të karbonit. Fraksioni i

biomasës së karbonit do të përcaktohet, duke përdorur shkallët metodologjike të përcaktuara në seksionin 2.4, të kësaj shtojce. Fraksioni RFNBO ose RCF, ose fraksionit sintetik me karbon të ulët, që i përket karbonit do të përcaktohet, duke përdorur shkallët metodologjike, të përcaktuara në seksionin 2.5, të kësaj shtojce.

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Përmbajtjen e karbonit të nxjerrë nga faktorët standard, të rradhitur në seksionet 1 dhe 2, të shtojcës VI;

b) Vlerat e tjera konstante, në përputhje me shkronjën "d" të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur seksionet 1 dhe 2, të shtojcës VI, nuk përmbajnë një vlerë të zbatueshme.

Shkalla metodologjike 2a: Operatori i instalimit nxjerr përmbajtjen e karbonit nga faktorët specifikë kombëtarë të shkarkimit për lëndën djegëse ose materialin përkatëse, në përputhje me shkronjave "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, ose vlerat e parashikuara në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2b: Operatori i instalimit nxjerr përmbajtjen e karbonit nga faktorët e shkarkimit për lëndën djegëse, bazuar në një nga vlerat e përafërta të përcaktuara, së bashku me një ndërlidhje empirike, që përcaktohet të paktën një herë në vit, në përputhje me nenet 32 deri në 35, kësaj rregulloreje, si më poshtë:

a) Nga matja e densitetit të naftës ose gazrave specifikë që janë të zakonshëm, për shembull në industrinë e rafinerisë ose të çelikut;

b) Nga vlera kalorifike neto për llojet specifike të qymyrit.

Operatori i instalimit sigurohet që ndërlidhja plotëson kërkesat e praktikës së mirë inxhinierike dhe se kjo ndërlidhje zbatohet vetëm për vlerat e përafërta, që bien brenda diapazonit për të cilin është krijuar.

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a)Përcaktimin e përmbajtjes së karbonit, në përputhje me dispozitat përkatëse të neneve 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje;

b) Ndërlidhjen empirike të përcaktuar për shkallën metodologjike 2b më sipër, nëse operatori i instalimit i ofron AKM-së prova të mjaftueshme, që pasiguria e ndërlidhjes empirike nuk është më e madhe se 1/3 e vlerës së pasigurisë së cilës operatori i instalimit duhet t'i përmbahet në lidhje me përcaktimin e të dhënave të aktivitetit të lëndës djegëse ose materialit përkatës.

3.2 Shkallët metodologjike për vlerën kalorifike neto

Përdoren shkallët metodologjike të përcaktuara në seksionin 2.2, të kësaj shtojce.

3.3. Shkallët metodologjike për fraksionin e biomasës

Përdoren shkallët metodologjike, të përcaktuara në seksionin 2.4, të kësaj shtojce.

3.3. Shkallët metodologjike për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin sintetik me karbon të ulët

Përdoren shkallët metodologjike të përcaktuara në seksionin 2.5, të kësaj shtojce.

4. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR FAKTORËT E LLOGARITJES PËR SHKARKIMET E PROCESIT TË CO_2

Për të gjitha shkarkimet e CO_2 nga proceset, në veçanti për shkarkimet, që rrjedhin nga dekompozimi i karbonateve dhe nga materialet e procesit që përmbajnë karbon në forma të tjera të ndryshme nga karbonatet, duke përfshirë urenë, koksin dhe grafitin, kur monitorohen, duke përdorur metodologjinë standarde në përputhje me pikën 3, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, do të zbatohen shkallët metodologjike të përcaktuara në këtë seksion për faktorët përkatës të llogaritjes.

Në rastin e materialeve të përziera që përmbajnë si forma inorganike, ashtu edhe forma organike të karbonit, operatori i instalimit mund të zgjedhë:

— të përcaktojë një faktor paraprak të përgjithshëm të shkarkimit për materialin e përzier, duke analizuar përmbajtjen totale të karbonit dhe duke përdorur një faktor konvertimi dhe, nëse është e zbatueshme, fraksionin e biomasës dhe vlerën kalorifike neto, që lidhet me atë përmbajtje totale të karbonit; ose

— të përcaktojë veçmas përmbajtjen organike dhe atë inorganike dhe t'i trajtojë ato si dy rryma shkarkimi të ndara.

Për shkarkimet nga dekompozimi i karbonateve, operatori i instalimit mund të zgjedhë për secilën rrymë shkarkimi një nga metodat e mëposhtme:

(a) Metodën A (bazuar në elementet hyrëse): faktori i shkarkimit, faktori i konvertimit dhe të

dhënat e aktivitetit lidhen me sasinë e materialit të futur në proces.

(b) Metodën B (bazuar në elementet në dalje): faktori i shkarkimit, faktori i konvertimit dhe të dhënat e aktivitetit lidhen me sasinë e materialit që del nga procesi.

Për shkarkimet e tjera të CO_2 nga proceset, operatori i instalimit duhet të zbatojë vetëm metodën A.

Në përjashtim nga dispozitat e këtij seksioni dhe të nënseksioneve vijuese, operatorët e instalimit mund t'i vlerësojnë si zero shkarkimet e procesit nga materialet, me kusht që këto materiale të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

i) Nuk përfshihen në përkufizimet RFNBO ose RCF ose lëndë djegëse sintetike me karbon të ulët;

ii) Janë prodhuar në një instalim tjetër të mbuluar nga shtojca II, pjesa A, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

iii) CO_2 ishte lidhur kimikisht për të prodhuar materialet;

iv) Instalimi që ka shkarkuar CO_2, e përmendur në nënndarjen "iii", të kësaj shkronje, e ka përfshirë këtë CO_2 në raportin e vjetor të shkarkimeve;

v) nuk përmbushin specifikimet e një prej produkteve të renditura në pikën 1, të nenit 51, të kësaj rregulloreje.

4.1. Shkallët metodologjike për faktorin e shkarkimit kur përdoret Metoda A

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Faktorët standard të renditur në shtojcën VI, seksioni 2, tabela 2, në rastin e dekompozimit të karbonatit ose në tabelat 1, 4 ose 5, për materialet e tjera të procesit;

b) Vlera të tjera konstante në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenin 31, të kësaj rregulloreje, kur shtojca VI nuk përmban asnjë vlerë të zbatueshme.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit zbaton një faktor shkarkimi kombëtar specifik në përputhje me shkronjave "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje ose vlerat e parashikuara në përputhje me shkronjën "ç", pikën 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit përcakton faktorin e shkarkimit, në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje. Raportet stekiometrike, të renditura në seksionin 2, të shtojcës VI, do të përdoren aty ku është e nevojshme për të konvertuar të dhënat e përbërjes në faktorë shkarkimi.

4.2. Shkallët metodologjike për faktorin e konvertimit kur përdoret metoda A

Shkalla metodologjike 1: Përdoret faktori i konvertimit i barabartë me 1.

Shkalla metodologjike 2: Karbonatet dhe karbonet e tjera që dalin nga procesi merren në konsideratë me anë të një faktori konvertimi me një vlerë ndërmjet 0 dhe 1. Operatori i instalimit mund të supozojë një konvertim të plotë për një ose disa materiale hyrëse dhe t'ia ngarkojë materialet e pakonvertuara ose karbonin tjetër materialeve hyrëse të mbetura. Përcaktimi i mëtejshëm i parametrave kimikë përkatës të produkteve do të kryhet, në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

4.3. Shkallët metodologjike për faktorin e shkarkimit kur përdoret metoda B

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një nga opsionet e mëposhtme:

a) Faktorët standard të renditur në shtojcën VI, seksioni 2, tabela 3;

b) Vlera të tjera konstante në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur shtojca VI nuk përmban asnjë vlerë të zbatueshme.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit zbaton një faktor shkarkimi kombëtar specifik në përputhje me shkronjave "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje ose vlerat e parashikuara në përputhje me shkronjën "ç" të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit përcakton faktorin e shkarkimit në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje. Raportet stekiometrike, të referuara në shtojcën VI, seksionin 2, tabela 3, do të përdoren për të konvertuar të dhënat e përbërjes në faktorë shkarkimi duke supozuar se të gjitha oksidet metalike përkatëse kanë ardhur nga karbonatet përkatëse. Për këtë qëllim operatori i instalimit do të marrë parasysh të paktën CaO dhe MgO dhe duhet t'i japë AKM-së provën, që qartëson se cilat okside të tjera metalike janë të lidhura me karbonatet që përmbahen te lëndët e para.

4.4. Shkallët metodologjike për faktorin e konvertimit kur përdoret metoda B

Shkalla metodologjike 1: Përdoret faktori i konvertimit i barabartë me 1.

Shkalla metodologjike 2: Sasia e përbërësve kimikë jokarbonate të metaleve përkatëse që përmbahen te lëndët e para, duke përfshirë pluhurin e rikthyer në proces ose hirin fluturues ose materiale të tjera tashmë të kalcinuara, do të pasqyrohet përmes faktorëve të konvertimit me një vlerë ndërmjet 0 dhe 1, ku vlera 1 korrespondon me një shndërrim të plotë të karbonateve të lëndës së parë në okside. Përcaktimet e mëtejshme të parametrave kimikë që kanë të bëjnë me elementet hyrëse të procesit do të kryhet, në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

4.5. Shkallët metodologjike për vlerën kalorifike neto (NCV)

Kur është e zbatueshme, operatori i instalimit përcakton vlerën kalorifike neto të materialit të procesit duke përdorur shkallët metodoligjike, të përcaktuara në seksionin 2.2, të kësaj shtojce. NCV konsiderohet jo i zbatueshëm për rrymat e vogla të shkarkimit *(de minimis)* ose kur materiali nuk është i djegshëm në vetvete pa shtuar lëndë djegëse të tjera. Në rast dyshimi, operatori i instalimit duhet të kërkojë konfirmim nga AKM-ja nëse NCV duhet të monitorohet dhe raportohet.

4.6. Shkallët metodologjike për fraksionin e biomasës

Kur është e zbatueshme, operatori i instalimit do të përcaktojë fraksionin e biomasës të karbonit, që përmbahet në materialet e procesit, duke përdorur shkallët metodologjike, të përcaktuar në seksionin 2.4, të kësaj shtojce.

4.7. Shkallët metodologjike për fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët

Përdoren shkallët metodologjike, të përcaktuara në seksionin 2.5, të kësaj shtojce.

SHTOJCA IIa
PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR METODOLOGJITË E BAZUARA NË LLOGARITJE QË LIDHEN ME SUBJEKTET E RREGULLUARA

1. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR SASITË E LËNDËS DJEGËSE TË HEDHUR PËR KONSUM

Pragjet e pasigurisë të përcaktuara në tabelën 1 më poshtë do të zbatohen për shkallët metodologjike, që lidhen me sasitë e të lëndës djegëse të hedhur për konsum, në përputhje me shkronja "a", të pikës 1, të nenit 28, dhe me pikën 3, të nenit 29. Pragjet e pasigurisë do të interpretohen si pasiguri maksimale të lejueshme për përcaktimin e rrymave të lëndës djegëse gjatë një periudhe raportimi.

Tabela 1. *Shkallët metodologjike për sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum (pasiguria maksimale e lejuar për çdo shkallë metodologjike)*

Lloji i rrymës së lëndës djegëse	Parametri në të cilin aplikohet pasiguria	Shkalla metodologjike 1	Shkalla metodologjike 2	Shkalla metodologjike 3	Shkalla metodologjike 4
Djegia e lëndëve djegëse					
Lëndët djegëse standarde tregtare	Sasia e lëndës djegëse [t] ose [Nm3] ose [TJ]	±7,5 %	±5 %	±2,5 %	±1,5 %
Lëndë djegëse të tjera të gazta dhe të lëngëta	Sasia e lëndës djegëse [t] ose [Nm3] ose [TJ]	±7,5 %	±5 %	±2,5 %	±1,5 %
Lëndët djegëse të ngurta	Sasia e lëndës djegëse [t] ose [TJ]	±7,5 %	±5 %	±2,5 %	±1,5 %

2. PËRCAKTIMI I SHKALLËVE METODOLOGJIKE PËR FAKTORËT E LLOGARITJES DHE FAKTORIN SEKTORIAL

Subjektet e rregulluara duhet të monitorojnë shkarkimet e CO_2 nga të gjitha llojet e lëndëve djegëse të hedhura për konsum në sektorët e renditur në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, duke përdorur shkallët metodologjike të përcaktuara në këtë seksion.

2.1. Shkallët metodologjike për faktorët e shkarkimeve

Kur përcaktohet fraksioni i biomasës për një lëndë djegëse të përzier, shkallët metodologjike të përcaktuara duhet të lidhen me faktorin paraprak të shkarkimeve. Për lëndët djegëse fosile, shkallët metodologjike duhet të lidhen me faktorin e shkarkimeve.

Kur përcaktohet fraksioni RFNBO ose RFC ose fraksioni sintetik me karbon të ulët për një lëndë djegëse të përzier, shkallët metodologjike të përcaktuara duhet të lidhen me faktorin paraprak të shkarkimeve.

Shkalla metodologjike 1: Subjekti i rregulluar do të zbatojë një nga sa vijon:

a) faktorët standard të renditur në seksionin 1, të shtojcës VI, të kësaj rregulloreje;

b) vlera të tjera konstante në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur asnjë vlerë e zbatueshme nuk gjendet në seksionin 1, të shtojcës VI, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2a: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë faktorët specifikë të shkarkimeve të përdorura brenda Shqipërisë për lëndën djegëse përkatëse, në përputhje me shkronjave "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2b: Subjekti i rregulluar duhet të nxjerrë faktorët e shkarkimeve për lëndën djegëse bazuar në vlerën kalorifike neto të llojeve specifike të qymyrit, e kombinuar me një marrëdhënie empirike, që bazohet te të dhënat e mbledhura të përcaktuar të paktën një herë në vit, në përputhje me nenet 32 deri në 35, dhe me nenet 111, 112 dhe 113, të kësaj rregulloreje.

Subjekti i rregulluar siguron që marrëdhënia empirike të përmbushë kërkesat e praktikës së mirë inxhinierike dhe që ajo të zbatohet vetëm për vlera të treguesit zëvendësues, që bien brenda diapazonit për të cilin është përcaktuar.

Shkalla metodologjike 3: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë njërin nga opsionet e mëposhtme:

a) Përcaktimin e faktorit të shkarkimeve në përputhje me dispozitat përkatëse të neneve 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje;

b) Marrëdhënia empirike siç përcaktohet në shkallën metodologjike 2b, kur subjekti i rregulluar i provon AKM-së në mënyrë të mjaftueshme se pasaktësia e marrëdhënies empirike nuk e tejkalon 1/3 e vlerës së pasaktësisë, që duhet të zbatohet nga subjekti i rregulluar për përcaktimin e sasisë së lëndës djegëse të hedhur për konsum për lëndën djegëse përkatëse.

2.2. Shkallët metodologjike për faktorin e konvertimit të njësisë

Shkalla metodologjike 1: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë njërin nga opsionet e mëposhtme:

a) Faktorët standardë të renditur në seksionin 1, të shtojcës VI, të kësaj rregulloreje;

b) Vlera të tjera konstante në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, kur nuk ka një vlerë të zbatueshme të përfshirë në seksionin 1, të shtojcës VI, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2a: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë faktorë specifikë të përdorur brenda Shqipërisë për lëndën djegëse përkatëse, në përputhje me shkronjave "b" ose "c", të pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2b: Për lëndët djegëse që tregtohen në mënyrë komerciale, duhet të përdoret faktori i konvertimit të njësisë i nxjerrë nga të dhënat e blerjeve të lëndës djegëse përkatëse, me kusht që të jetë nxjerrë bazuar në standarde kombëtare ose ndërkombëtare të pranuara.

Shkalla metodologjike 3: Subjekti i rregulluar duhet të përcaktojë faktorin e konvertimit të njësisë, në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

2.3. Shkallët metodologjike për fraksionin e biomasës

Shkalla metodologjike 1: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë një vlerë të zbatueshme të publikuar nga AKM-ja, ose vlerat në përputhje me pikën 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë një metodë vlerësimi të miratuar, në

përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 6, të nenit 112, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3a: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë analizat në përputhje me paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 112, dhe në përputhje me nenet 32 deri në 35, të kësaj rregulloreje.

Kur një subjekt i rregulluar supozon një fraksion fosil prej 100%, në përputhje me pikën 1, të nenit 39, e kësaj rregulloreje, nuk do të caktohet asnjë shkallë metodologjike për fraksionin e biomasës.

Shkalla metodologjike 3b: Për lëndët djegëse që burojnë nga një proces prodhimi me rryma hyrëse, të përcaktuara dhe të gjurmueshme, subjekti i rregulluar mund ta bazojë vlerësimin në një bilanc të masës të karbonit fosil dhe biomasës, që hyn dhe del nga procesi, siç është sistemi i bilancit të masës, që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2.3a Shkallët metodologjike për fraksionin e RFNBO-së ose RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët

Shkalla metodologjike 1: Subjekti i rregulluar duhet të përcaktojë fraksionin e RFNBO-së, RCF-së ose fraksionin sintetik me karbon të ulët, bazuar në sistemin e bilancit të masës që garanton përputhshmërinë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Kur subjekti i rregulluar supozon një fraksion fosil prej 100 %, në përputhje me pikën 1, të nenit 40, të kësaj rregulloreje, nuk do të caktohet asnjë shkallë metodologjike për fraksionin RFNBO ose RCF ose fraksionin sintetik me karbon të ulët.

2.4. Shkallët metodologjike për faktorin sektorial

Shkalla metodologjike 1: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë një vlerë standarde, në përputhje me pikat 5 dhe 6, të nenit 110, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë metodat, në përputhje me shkronjat "d"' deri "e", të pikës 4, të nenit 110, të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 3: Subjekti i rregulluar duhet të zbatojë metodat, në përputhje me shkronjat "a" deri "ç", të pikës 2, të nenit 110, të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA III
METODOLOGJIA E MONITORIMIT PËR SHKARKIMET NGA AVIACIONI
(Neni 55 i rregullores)

1. METODOLOGJITË E LLOGARITJES PËR PËRCAKTIMIN E GES-ve NË SEKTORIN E AVIACIONIT

Metoda A:

Operatori i avionit përdor formulën e mëposhtme:

Konsumi aktual i lëndës djegëse për çdo fluturim [t] = Sasia e lëndës djegëse që ndodhet në depozitat e avionit pas furnizimit me lëndë djegëse për fluturimin [t] – Sasia e lëndës djegëse që ndodhet në depozitat e avionit pasi përfundon furnizimi me lëndë djegëse për fluturimin pasardhës [t] + Furnizimi me lëndë djegëse për atë fluturim pasardhës [t]

Kur nuk kryhet furnizimi me lëndë djegëse për fluturimin ose për fluturimin pasues, sasia e lëndës djegëse të përmbajtur në depozitat e avionit përcaktohet në momentin e heqjes së blloqeve nga rrotat e avionit përpara fluturimit *(block-off)* për kryerjen e fluturimit ose fluturimit pasues. Në rastin e jashtëzakonshëm kur një avion kryen veprimtari të tjera përveç një fluturimi, përfshirë kryerjen e mirëmbajtjeve të mëdha që përfshijnë zbrazjen e depozitave, pas fluturimit për të cilin po monitorohet konsumi i lëndës djegëse, operatori i avionit mund të zëvendësojë sasinë 'Sasia e lëndës djegëse që ndodhet në depozitat e avionit pas furnizimit me lëndë djegëse për fluturimin pasues + Furnizimi me lëndë djegëse për atë fluturim pasues' me 'Sasinë e lëndës djegëse të mbetur në depozita në nisje të veprimtarisë pasardhëse të avionit', siç regjistrohet në ditarët teknikë.

Metoda B:

Operatori i avionit përdor formulën e mëposhtme:

Konsumi aktual i lëndës djegëse për çdo fluturim [t] = Sasia e lëndës djegëse që mbetet në depozitat e avionit pas vendosjes së blloqeve të rrotave të avionit (*block-on*) në fund të fluturimit të mëparshëm [t] + Furnizimi me lëndë djegëse për fluturimin [t] – Sasinë e lëndës djegëse që ndodhet në depozitat e avionit në momentin e vendosjes së blloqeve të rrotave të avionit *(block-on)* në fund të fluturimit [t].

Momenti i *block-on* mund të konsiderohet i barasvlershëm me momentin e fikjes së motorëve.

Kur një avion nuk ka kryer një fluturim përpara fluturimit për të cilin po monitorohet konsumi i lëndës djegëse, operatori i avionit mund të zëvendësojë sasinë 'Sasia e karburantit të mbetur në depozitat e avionit pas vendosjes së blloqeve të rrotave të avionit (*block-on)* në fund të fluturimit të mëparshëm' me 'Sasinë e lëndës djegëse të mbetur në depozitat e avionit në fund të veprimtarisë së mëparshme të avionit', siç regjistrohet në ditarët teknikë.

2. FAKTORËT E SHKARKIMIT PËR LËNDËT DJEGËSE STANDARDE

Tabela 1. *Faktorët e shkarkimit të CO_2 të lëndëve djegëse fosile të aviacionit (faktorët e shkarkimit paraprak)*

Lënda djegëse	***Faktori i shkarkimit (t CO_2/t lëndë djegëse)***
Benzina e aviacionit (AvGas)	*3,10*
Benzina reaktiv (Jet B)	*3,10*
Benzoil reaktiv (Jet A1 ose Jet A)	*3,16*

3. LLOGARITJA E DISTANCËS ORTODROMIKE

Distanca [km] = Distanca ortodromike [km] + 95 km

Distanca ortodromike është distanca më e shkurtër ndërmjet dy pikave të çfarëdoshme në sipërfaqen e tokës, që do të përfarohen duke përdorur sistemin e referuar në Nenin 3.7.1.1 të Shtojcës 15 të Konventës së Çikagos (ËGS 84). Sipas Nenit 5 të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë Konventa e Çikagos është pranuar ligjërisht nga Republika e Shqipërisë së bashku me ndryshimet dhe shtojcat e saj.

Gjerësia dhe gjatësia gjeografike e aerodromeve duhet të merren ose nga të dhënat e vendndodhjes së aerodromeve të publikuara në Botimet e Informacionit Aeronautik (AIP), në përputhje me Shtojcën 15 të Konventës së Çikagos, ose nga një burim që përdor të dhëna të AIP-it.

Mund të përdoren gjithashtu distancat e llogaritura nga programe kompjuterike ose nga një palë e tretë, me kusht që metodologjia e llogaritjes të bazohet në formulën e përcaktuar në këtë seksion, te të dhënat e AIP-it dhe te kërkesat e ËGS 84.

SHTOJCA IIIa
METODOLOGJITË E MONITORIMIT PËR EFEKTET NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2
(Neni 63 i Rregullores)

1. PËRKUFIZIMET PËR EFEKTET NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2

1. "Informacion fluturimi" përfshin të paktën sinjalin e thirrjes, siç parashikohet në nenin 53, të kësaj rregulloreje, ditën dhe orën e nisjes dhe të mbërritjes së fluturimit, të shprehura në kohën universale të koordinuar (UTC), si dhe kodet e ICAO-s dhe/ose identifikuesit e vendndodhjes së Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) për aeroportin e origjinës dhe atë të mbërritjes, që mundësojnë identifikimin unik të fluturimit përkatës.

2. "Informacion për fazat e fluturimit" nënkupton ndarjen e të dhënave (p.sh. pozicioni 4D i avionit, fluksi i lëndës djegëse), sipas fazave operacionale të fluturimit (nisja, ngjitja, lundrimi ajror, etj.);

3. "Kufijtë operativ të fluturimit" nënkupton kufijtë e lartësisë, shpejtësisë së avionit dhe koeficientit të ngarkesës për çdo fazë të fluturimit;

4. "Shpejtësia e vërtetë" nënkupton shpejtësinë e avionit në raport me masën e ajrit, në të cilën ai fluturon në metra për sekondë (m/s);

5. "Pozicioni 4D i avionit" nënkupton pozicionin katërdimensional të një avioni, të përcaktuar nga gjerësia gjeografike, në shkallë dhjetore; gjatësia gjeografike, në shkallë dhjetore; dhe lartësia, në lartësi presioni, në çdo moment të caktuar kohe ndërmjet fillimit dhe mbarimit të fluturimit;

6. "Etiketa kohore" nënkupton një pasqyrë të të dhënave (p.sh. pozicioni 4D i avionit, fluksi i lëndës djegëse), që përkon me një moment të caktuar në kohë gjatë fluturimit, të pasqyruar në sekonda, dhe që duhet të merret në konsideratë së bashku me intervalin kohor;

7. "Interval kohor" nënkupton kohën, në sekonda, ndërmjet dy etiketave kohore gjatë fluturimit, që nuk e tejkalon periudhën prej 60 sekondash.

8. "Plani i përditësuar i fluturimit" nënkupton planin më të fundit të fluturimit të një fluturimi të caktuar, që i është vendosur në dispozicion

shërbimeve përkatëse të lundrimit ajror dhe që njihet prej tyre përpara se fluturimi të kryhet. Plani i përditësuar i fluturimit mund të jetë modeli i fluturimit taktik i rregulluar (RTFM) i *Eurocontrol*-it ose, në mënyrë alternative, modeli i i fluturimit taktik i depozituar (FTFM) i *Eurocontrol*-it ose një model i barasvlershëm në aspektin e saktësisë së të dhënave.

9. "Trajektorja e avionit gjatë fluturimit" nënkupton trajektoren e ndjekur nga avioni nga pika e origjinës (nisja) deri në destinacionin e tij (mbërritja), e përbërë nga të gjitha etiketat kohore, të regjistruara gjatë fluturimit. Trajektorja e avionit e kryer gjatë fluturimit mund të nxirret nga pajisja e regjistrimit të të dhënave të fluturimit ose nga një palë e tretë. Saktësia e saj duhet të jetë e barasvlershme, për aq sa është e mundur, me modelin e fluturimit taktik të përditësuar (CTFM) të *Eurocontrol*-it.

10. "Pajisja e regjistrimit të të dhënave të fluturimit" është një pajisje elektronike e specializuar e instaluar në avion me qëllim regjistrimin e parametrave dhe ngjarjeve të ndryshme gjatë operacioneve të fluturimit. Këta parametra mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në komandat e kontrollit të fluturimit, informacionin për performancën e avionit, të dhënat e motorit dhe informacionin e lundrimit ajror.

11. "Variablat rrezatuese tredimensionale" nënkupton një sërë variablash, si dendësia e fluksit rrezatues, shkallët e ngrohjes rrezatuese, që përshkruajnë se si ndryshon rrezatimi në hapësirë, përfshirë në sipërfaqen e tokës dhe në atmosferë, si dhe se si ndryshon rrezatimi me kalimin e kohës.

12. "Presion" nënkupton forcën, të shprehur në paskal (Pa), që ushtrohet nga pesha e ajrit në atmosferë mbi një pikë të caktuar ku ndodhet avioni, në çfarëdo momenti specifik gjatë fluturimit duke marrë parasysh variablat rrezatues tredimensionale;

13. "Temperatura e ajrit të ambientit" do të thotë temperatura e ajrit, e shprehur në kelvin (K), që rrethon një avion në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

14. "Lagështia specifike" nënkupton raportin e avullit të ujit për kilogram të masës totale të ajrit (kg/kg), që rrethon një avion në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatuese tredimensionale;

15. "Atmosferë standarde ndërkombëtare (ISA)" nënkupton një standard, kundrejt të cilit krahasohet atmosfera aktuale në çdo pikë dhe moment të caktuar, bazuar në vlerat specifike të presionit, dendësisë dhe temperaturës në nivelin mesatar të detit, vlera të cilat zvogëlohen me rritjen e lartësisë;

16. "Të dhënat meteorologjike bazë" do të thotë kategoria e informacionit që për çdo fluturim përfshin, të paktën informacion mbi presionin, temperaturën e ajrit të ambientit dhe lagështinë specifike, që përdoren në modulet e djegies të lëndës djegëse dhe të vlerësimit të shkarkimit. Në këtë rast, këto vlera mund të vlerësohen, minimalisht, nëpërmjet korrigjimit të standardizuar të varur nga lartësia dhe/ose të bazohen në vëzhgimet e palëve të treta pasi është kryer fluturimi;

17. "Lagështia relative mbi akullin" nënkupton përqendrimin e shprehur në përqindje të avullit të ujit të pranishëm në ajër të krahasuar me përqendrimin e tij në pikën e ngopjes së akullit;

18. "Era nga lindja dhe nga veriu" nënkupton shpejtësinë horizontale të lëvizjes së ajrit drejt lindjes ose veriut, në metra për sekondë, në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

19. "Shpejtësia vertikale" nënkupton shpejtësinë e lëvizjes së ajrit në drejtimin lart ose poshtë (në Pa/s), ku vlerat negative të shpejtësisë vertikale tregojnë lëvizjen në drejtimin lart. Kjo është e domosdoshme për të llogaritur, p.sh., transportin horizontal të masave ajrore dhe vetive të tyre (*advection*) dhe ndryshimin e shpejtësisë/drejtimit të erës (*wind-shear*).

20. "Përmbajtja specifike e kristaleve të akullit në re" nënkupton masën e grimcave të akullit në re për kilogram të masës totale të ajrit të lagësht (kg/kg), që rrethon një avion në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

21. "Gjeopotenciali" nënkupton forcën e gravitetit që ndesh avioni në lartësi të ndryshme, në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit, e shprehur në metra katrorë për sekondë katror (m^2/s^2) dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

22. "Rrezatimi dalës me valë të gjata" nënkupton rrezatimin total të çliruar në hapësirë nga sistemi atmosferik i tokës, në W/m^2, në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

23. "Rrezatimi diellor i reflektuar" nënkupton shtojcën e dritës së diellit që reflektohet përsëri në

hapësirë nga sipërfaqja e Tokës, retë, aerosolat dhe grimcat e tjera atmosferike, e shprehur në W/m², në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

24. "Rrezatimi diellor direkt" nënkupton shtojcën e dritës së diellit, që arrin drejtpërdrejt në sipërfaqen e tokës nga dielli, pa u shpërndarë ose reflektuar nga atmosfera ose retë, e shprehur në W/m², në çfarëdo momenti të caktuar gjatë fluturimit dhe që jepet si parametër për variablat rrezatues tredimensionalë;

25. "Modeli numerik i parashikimit meteorologjik (NWP) që përdoret si referencë e përbashkët" i referohet një sistemi llogaritës të kompjuterizuar që përdoret në meteorologji, që përfshin algoritme dhe formulime matematikore të zbatuara në softuer, i projektuar për të simuluar dhe për të parashikuar kushtet atmosferike mbi një hapësirë dhe periudhë të caktuar kohore (rrjet hapësinor). Në rastin e të dhënave të avancuara të motit, modeli i përbashkët NWP i referencës sigurohet nga Komisioni Evropian përmes NEATS-së;

26. "Të dhëna të avancuara të motit" nënkupton kategorinë e informacionit që për çdo fluturim përfshin presionin, temperaturën e ajrit të ambientit, lagështinë specifike, lagështinë relative mbi akullin, erën nga lindja dhe nga veriu, shpejtësinë vertikale, përmbajtjen specifike të kristaleve të akullit në re, gjeopotencialin, rrezatimin dalës me valë të gjata, rrezatimin diellor të reflektuar dhe rrezatimin diellor direkt, të marra si *input* nga një model numerik i parashikimit meteorologjik (NWP), që përdoret si referencë e përbashkët, i siguruar nga Komisioni Evropian përmes NEATS-së;

27. "Identifikuesi i motorit" nënkupton numrin unik të identifikimit të motorit të avionit, siç përcaktohet në bankën e të dhënave të ICAO-s për shkarkimet e motorit, ose në një bankë të dhënash të barasvlershme, që mundëson identifikimin e qartë të motorëve të montuar në avion, nëpërmjet listave të standardizuara të njohura ndërkombëtarisht;

28. "Masa e avionit" nënkupton masën e avionit të shprehur në kilogramë përgjatë trajektores, që llogaritet duke zbritur nga masa e avionit gjatë ngritjes lëndën djegëse që është konsumuar gjatë fluturimit në çfarëdo momenti të caktuar. Nëse masa e avionit nuk është e disponueshme, ajo mund të llogaritet me përafërsi duke u bazuar ose në masën në ngritje ose në koeficientin e ngarkesës dhe mbi bazën ose të fluksit të lëndës djegëse të njohur ose të fluksit të lëndës djegëse, të llogaritur nëpërmjet simulimit të performancës së avionit, duke përdorur modulin e djegies së lëndës djegëse;

29. "Masa në ngritje" nënkupton masën e avionit në fillim të lëvizjes në pistë për të kryer ngritjen, duke përfshirë gjithçka dhe këdo që transportohet në atë moment, e shprehur në kilogramë. Ajo përdoret për të llogaritur përafërsisht masën e avionit nëse kjo e fundit nuk jepet. Nëse masa në ngritje nuk është e disponueshme, ajo mund të llogaritet përafërsisht duke u bazuar në koeficientin e ngarkesës;

30. "Masa maksimale e ngritjes" është masa maksimale, e shprehur në kilogram, në të cilën piloti i një avioni lejohet të ngrihet, siç specifikohet nga prodhuesi i avionit;

31. "Masa maksimale e ngarkesës" është masa maksimale e pasagjerëve dhe bagazheve përkatëse, masa e ngarkesës, duke përfshirë postën dhe bagazhet e dorës, që mund të transportohen nga një avion. Vlerat e ngarkesës maksimale mund të nxirren nëpërmjet modulit të llogaritjes së djegies së lëndës djegëse;

32. "Faktori i ngarkesës" nënkupton peshën e pasagjerëve, ngarkesës dhe bagazheve, duke përfshirë postën dhe bagazhin e dorës, e shprehur si një fraksion e masës maksimale të ngarkesës. Faktori i ngarkesës përdoret për të llogaritur përafërsisht masën e ngritjes nëse kjo e fundit nuk është dhënë. Nëse faktori i ngarkesës nuk është i disponueshëm, përdoret një vlerë standarde konservatore, në përputhje me seksionin 5, të shtojcës IIIa;

33. "Fluksi i lëndës djegëse" nënkupton masën e lëndës djegëse të shprehur në kilogram që gjatë fluturimit kalon përmes sistemit të lëndës djegëse të avionit dhe hyn në motorët e tij, për sekondë. Ajo mund të parashikohet përmes përdorimit të modeleve llogaritëse gjatë planifikimit të fluturimit, të matet gjatë fluturimit ose të vlerësohet përmes modulit të djegies së lëndës djegëse;

34. "Eficenca e motorit të avionit" nënkupton përqindjen e shtytjes së dobishme të gjeneruar nga një motor avioni në raport me energjinë e marrë nga lënda djegëse;

35. "Performanca e avionit" nënkupton kategorinë e informacionit, që përfshin fluksin e lëndës djegëse dhe eficiencën e motorit të avionit gjatë të gjitha etiketave kohore;

36. "Raporti hidrogjen për karbon (H/C) i lëndës djegëse për fluturim" nënkupton numrin e atomeve të hidrogjenit (H) për një atom karbon (C) për çdo molekulë të lëndës djegëse të përdorur në një fluturim;

37. "Përmbajtja aromatike e lëndës djegëse për fluturim" nënkupton përqindjen e hidrokarbureve aromatike të pranishme në lëndën djegëse të përdorur në një fluturim;

38. "Vetitë e lëndës djegëse të fluturimit" do të thotë kategoria e informacionit, që përfshin për çdo fluturim raportin hidrogjen për karbon, përmbajtjen aromatike dhe vlerën kalorifike neto të lëndës djegëse që ndodhet në bordin e avionit.

2. SISTEMI I GJURMIMIT TË EFEKTEVE NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2 (NEATS)

Operatorët e avionit, verifikuesit e akreditуar dhe autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, i kërkojnë Komisionit Evropian të vendosë në dispozicion të tyre, sistemin NEATS, me qëllim lehtësimin dhe, sa të jetë e mundur, automatizimin e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, në mënyrë që të minimizohet çdo barrë administrative.

Sistemi NEATS është në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 82 pikën 1 të kësaj rregulloreje dhe ofron një ndërfaqe të dedikuar dhe të sigurt të përdoruesit për operatorin e avionit, verifikuesin e akreditуar dhe autoritetin kompetent të Republikës së Shqipërisë.

Monitorimi:

NEATS-ja thjeshton procesin e monitorimit, pasi përfshin drejtpërdrejt ose jep akses te trajektoret e fluturimit dhe te të dhënat meteorologjike, të mbledhura nga palët e treta, duke bërë të mundur që monitorimi nga operatorët e avionit të jetë minimal, dhe, konkretisht që operatorët e avionit të monitorojnë thjesht karakteristikat e avionit dhe të lëndës djegëse, kur është e nevojshme, siç përcaktohet në seksionin 1, të shtojcën IIIa, të kësaj rregulloreje, ose ta bëjë monitorimin plotësisht automatik në varësi të përdorimit të vlerave standarde.

NEATS-ja përfshin metodën e llogaritjes së CO_2(e), siç përcaktohet në pikat 4 dhe 5, të nenit 63, të kësaj rregulloreje, dhe siguron një model të përbashkët referues të parashikimit numerik të motit (NWP), kur kërkohen të dhëna të avancuara të motit (metoda C). Kjo sjell si rezultat llogaritjen e CO_2(e) për çdo fluturim si pjesë e të dhënave të monitoruara.

Raportimi:

NEATS-ja thjeshton procesin e raportimit të përmendur në pikën 3, të nenit 75, të kësaj rregulloreje. Ky instrument gjeneron automatikisht në fund të çdo viti raportues tabelën XML, të përmendur në pikën 9, të seksionit 2a, të shtojcës X, të kësaj rregulloreje, duke minimizuar barrën administrative të lidhur me raportimin.

Verifikimi:

NEATS-ja thjeshton procesin e verifikimit dhe të kryqëzimit të të dhënave që kryhen përkatësisht nga verifikuesi i akreditуar dhe nga AKM-ja. Ai siguron instrumentet për të verifikuar vlerën e CO_2(e) për çdo fluturim dhe njëkohësisht mbron të dhënat konfidenciale.

Ruajtja e të dhënave:

NEATS-ja mundëson ruajtjen e të gjitha të dhënave (nga operatorët e avionëve dhe nga palët e treta), duke i koduar ato në mënyrë të sigurt dhe duke mbrojtur të dhënat konfidenciale nga publikimi, kur këto të dhëna ngarkohen në NEATS, nga operatori i avionit dhe janë identifikuar nga vetë operatori i avionit si konfidenciale.

Transparenca:

NEATS-ja për të llogaritur vlerën e CO_2(e) të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, mbështetet në modelet bashkëkohore. Operatorët e avionëve mund të zhvillojnë instrumentet e tyre ose të përdorin instrumentet e palëve të treta, me kusht që ato të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë.

NEATS-ja do të furnizojë një faqe interneti publike, që përmbledh të dhënat jokonfidenciale dhe vlerat e CO_2(e) për çdo fluturim dhe për çdo operator avioni.

3. MODULET E VLERËSIMIT TË DJEGIES SË LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMEVE TË EFEKTEVE NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2

Moduli i djegies së lëndës djegëse:

Moduli i djegies së lëndës djegëse bazohet në një qasje kinetike të modelimit të performancës së avionit, e cila mundëson parashikimin me saktësi të trajektoreve të avionit dhe të konsumit përkatës të lëndës djegëse përgjatë gjithë kufirit operacional të fluturimit dhe në të gjitha fazat e tij. Modeli përpunon bazat teorike për të llogaritur parametrat e performancës së avionit, duke përfshirë

informacionin për rezistencën aerodinamike, ngritjen, peshën, shtytjen, konsumimin e lëndës djegëse, si edhe shpejtësitë për fazat e ngjitjes, lundrimit dhe zbritjes të një avioni, duke supozuar funksionim normal të tij. Për më tepër, koeficientët specifikë për çdo avion janë të dhënat e tjera kryesore hyrëse, që përdoren për llogaritjen e planifikimit të trajektores së fluturimit të llojeve specifike të avionëve.

Moduli i vlerësimit të shkarkimeve:

Moduli i vlerësimit të shkarkimeve mundëson llogaritjen e shkarkimeve të motorëve të avionit për NOx, HC dhe CO, nëpërmjet ekuacioneve të korrelacionit, pa përdorur modele të performancës së avionit dhe motorit që janë të kufizuara nga pronësia intelektuale, si edhe karakteristikat e shkarkimeve të motorëve të kufizuara nga pronësia intelektuale. Ky modul përdor indekset e shkarkimeve të gazeve të djegies (EIs) nga certifikimi i tipit të motorëve sipas ICAO, nën kushte të paracaktuara referuese në tokë, dhe vlerëson indeksin përkatës të shkarkimeve gjatë fluturimit duke supozuar kushte të atmosferës standarde ndërkombëtare (ISA), duke zbatuar faktorë korrigjues për ndryshimet në temperaturë, presion dhe lagështi për ndryshimet me kushtet ISA.

4. MODELET LLOGARITJES SË CO_2 (e) PËR EFEKTET NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN CO_2

Kriteret e përgjithshme:

Në modelet e llogaritjes së CO_2(e), operatori i avionit duhet të marrë në konsideratë efektet klimatike të të gjithë agjentëve jo–CO_2 për çdo fluturim, duke përfshirë trajektoret e fluturimit (planin e fluturimit dhe trajektoren e realizuar të fluturimit), si edhe karakteristikat e avionit dhe të lëndës djegëse të përdorur gjatë fluturimit. Shkarkimet nga çdo fluturim duhet të llogariten si shkarkime impulsive (të menjëhershme). Kur zbatohen modelet e llogaritjes së CO_2(e), të dhënat e shkarkimeve të avionit që varen nga trajektorja e fluturimit duhet të përdoren për të llogaritur të gjitha elementet e mëposhtme:

a) Ndryshimet në përbërje;

b) Evolucioni kohor i forcës rrezatuese të shkaktuar nga ndryshimet e përbërjes;

c) Ndryshimet e temperaturës pranë sipërfaqes së tokës të shkaktuara nga shkarkimet e avionit që varen nga trajektorja e fluturimit.

Përdorimi i modeleve nuk duhet të kërkojë sforcime të konsiderueshme administrative ose llogaritëse në mënyrë që të jenë të zbatueshme për të gjitha palët e interesuara. Modeli ose modelet duhet të jenë transparente dhe të përshtatshme për përdorim operacional.

Në varësi të modelit, ekzistojnë dy lloje listash me kritere:

Metoda C:

Qasja e bazuar në kushtet meteorologjike, merr në konsideratë efektet klimatike të detajuara të të gjitha shkarkimeve jo–CO_2 të avionëve në një vendndodhje dhe kohë të caktuar, duke u bazuar në informacionet aktuale të motit, me qëllim llogaritjen e trajektoreve katërdimensionale të optimizuara nga pikëpamja klimatike, për planifikimin individual të fluturimeve. Për të mundësuar llogaritjen e detajuar të efekteve klimatike në raport me kushtet atmosferike aktuale, modelet duhet të marrin shprehimisht në konsideratë llojet e ndryshme të avionëve, llojet e shtytjes (propulsionit), si edhe karakteristikat e lëndës djegëse. Është e nevojshme të përfshihen vlerësimet në lidhje me efektet në klimë që vijnë si pasojë e formimit, ciklit jetësor të vijave të avullit *(contrail)* të çdo fluturimi, si edhe kohëzgjatjen e qëndrimit në atmosferë të shkarkimeve të H_2O dhe Nox dhe ndikimin e tyre në përbërjen atmosferike. Për të mundësuar nxjerrjen e informacionit të avancuar për përdorim në planifikimin e përditshëm të fluturimeve, modeli ose modelet duhet të jenë efikase nga pikëpamja e llogaritjes.

Çdo operator avioni duhet të monitorojë të dhënat e mëposhtme për çdo fluturim:

a) Informacion për fluturimin;

b) Trajektoren e fluturimit, që përkon të paktën me planin e fundit të fluturimit;

c) Të dhëna të avancuara të motit;

ç) Karakteristikat e avionit;

d) Informacion për performancën e avionit (opsionale). Preferohet përdorimi i fluksit të planifikuar të lëndës djegëse, në mënyrë që të ndiqet e njëjta linjë me të dhënat më të fundit të disponueshme të planit të fluturimit;

dh) Vetitë e lëndës djegëse të fluturimit.

Metoda D:

Për qasjen e thjeshtuar të bazuar në vendndodhje, operatori i avionit duhet të përdorë modelin ose modelet e reagimit klimatik për të vlerësuar ndikimin e të gjitha efekteve jo–CO_2 për

çdo fluturim, mbi një bazë klimatologjike. Mjeti ose mjetet duhet të përdoren për të vlerësuar përfitimin klimatik të opsioneve të përgjithshme të korridoreve të fluturimit, duke marrë në konsideratë dallimet e përgjithshme ndërmjet avionëve, llojeve të shtytjes dhe karakteristikave të lëndës djegëse, përmes përcaktimit të parametrave të tyre fizike. Vlera e CO_2(e) e llogaritur me qasjen e thjeshtuar të bazuar në vendndodhje duhet të kompensojë dhe të paraqesë si mesatare devijimet e mëdha të fluturimeve individuale gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Modeli ose modelet duhet të sigurojnë zvogëlimin e përpjekjeve që lidhen me mbledhjen, llogaritjen dhe trajtimin e të dhënave, në krahasim me model(et) që përdorin qasjen e bazuar në kushtet meteorologjike.

Në përjashtim nga përcaktimet e metodës C, shkarkuesit e vegjël, siç përcaktohet në pikën 1, nenit 61, të kësaj rregulloreje, mund të monitorojnë të dhënat e mëposhtme për çdo fluturim:

a) Informacion për fluturimin;

b) Trajektoren e fluturimit, e përcaktuara nga trajektorja e fluturimit që ka ndjekur avioni gjatë fluturimit;

c) Të dhënat bazë të motit;

ç) Karakteristikat e avionit;

d) Informacionin për performancën e avionit gjatë fluturimit (opsionale);

dh) Vetitë e lëndës djegëse të fluturimit (opsionale).

5. PËRDORIMI I VLERAVE STANDARDE PËR NDIKIMET NË AVIACION TË PALIDHURA ME CO_2

Përdorimi i vlerave standarde duhet të rezultojë gjithmonë në një vlerë më të lartë të CO_2(e) për fluturim, krahasuar me atë që mund të përfitohet nga të dhënat e monitoruara, me përjashtim të shqyrtimeve të mëtejshme nga autoriteti kompetent dhe nga Komisioni Evropian.

1. Trajektorja e fluturimit:

a) Për zbatimin e metodës C, duhet të paraqitet plani më i fundit i fluturimit. Nëse RTFM-ja, ose ekuivalenti i tij, nuk është i disponueshëm, përdoret si vlerë standarde FTFM, ose ekuivalenti i tij. Në këtë rast, kur nuk janë të disponueshme të dhënat e etiketës kohore, trajektorja mund të llogaritet përmes interpolimit linear të të dhënave të matura që burojnë nga dy momentet e matjes më të afërta para dhe pas etiketës kohore përkatëse, brenda së njëjtës fazë fluturimi, me kusht që kjo të rezultojë në një trajektore homogjene të fluturimit për fazën përkatëse, veçanërisht për fazën e lundrimit të avionit.

b) Për zbatimin e metodës D:

(i) duhet të jepet gjithmonë trajektorja e fluturimit. Nëse CTFM-ja ose ekuivalenti i tij nuk është i disponueshëm, mund të përdoren RTFM ose FTFM.

(ii) Në rastet kur nuk janë të disponueshme të dhënat sipas etiketës kohore, trajektorja mund të llogaritet përmes interpolimit linear të të dhënave të matura që burojnë nga dyja momentet e matjes më të afërta para dhe pas etiketës kohore përkatëse, brenda së njëjtës fazë të fluturimit, me kusht që kjo të rezultojë në një trajektore të njëtrajtshme të fluturimit për fazën përkatëse, veçanërisht për fazën e lundrimit të avionit.

2. Karakteristikat e avionit:

a) Identifikuesi i motorit: nëse nuk jepet një identifikues motori, ose ekuivalenti i tij, përdoren vlera standarde konservative për çdo lloj avioni, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën IIIb të kësaj rregulloreje.

b) Masa e avionit: nëse nuk jepet masa e avionit operatori i avionit mund ta simulojë atë duke përdorur masën e ngritjes së avionit (*take-off*). Nëse nuk janë të disponueshme as masa e avionit dhe as masa e ngritjes, mund të përdoret faktori i ngarkesës për të llogaritur përafërsisht masën e ngritjes. Nëse nuk jepet asnjë faktor ngarkese, përdoret një vlerë standarde në shumën 1.

3. Performanca e avionit:

Fluksi i lëndës djegëse: nëse fluksi i lëndës djegëse nuk sigurohet nga pajisja e regjistrimit të të dhënave të fluturimit, operatori i avionit mund të përdorë mjete të tjera për të nxjerrë fluksin e lëndës djegëse, në përputhje me seksionin 1, të shtojcës IIIa, të kësaj rregulloreje, që përcakton fluksin e lëndës djegëse, duke marrë në konsideratë shtytjen, e cila varet nga masa e avionit dhe shpejtësia e tij reale në ajër.

4. Karakteristikat e lëndës djegëse të fluturimit:

Nëse nuk jepen karakteristikat e lëndës djegëse të fluturimit, presupozohen kufijtë e sipërm të lëndës djegëse Jet A-1, në përputhje me standardin specifik ASTM (specifikim standard për lëndën djegëse të turbinës së aviacionit), si më poshtë:

a) Përmbajtja aromatike: 25 % të vëllimit;

b) Squfur: 0,3 % të masës;

c) Naftalinë: 3,0 % të vëllimit.

SHTOJCA IIIb
IDENTIFIKUESIT STANDARDË
KONSERVATORË TË MOTORËVE SIPAS
LLOJIT TË AVIONIT

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)	Identifikuesi i Parë Unik (UID)
A148	13ZM003
A19N	01P22PW163
A20N	01P22PW163
A21N	01P20CM132
A306	1PW048
A30B	1GE007
A310	1PW027
A318	7CM049
A319	1IA001
A320	1IA001
A321	3IA008
A332	4PW067
A333	4PW067
A337	3RR029
A338	04P24RR146
A339	02P23RR141
A343	2CM015
A346	8RR045
A358	01P18RR125
A359	01P21RR125
A35K	01P21RR125
A388	9EA001
A3ST	1GE021
AN72	1ZM001
B38M	01P20CM138
B39M	01P20CM138
B463	1TL003
B701	1PW001
B703	1PW001
B721	1PË008
B731	01P20CM138
B732	1PW008
B733	1CM007
B734	1CM007
B735	1CM007
B736	3CM031
B737	2CM015
B738	2CM015
B739	3CM034
B741	8PW088
B742	1RR011
B743	1PW029
B744	1RR010
B748	13GE157
B74S	8PW088
B752	1RR011
B753	3RR034
B762	1PW026
B763	5GE085
B764	5GE085
B772	3GE060
B773	2RR024
B77L	01P21GE217
B77Ë	01P21GE217
B778	01P21GE217
B779	01P21GE217
B788	02P23RR138
B789	02P23RR138
B78X	02P23RR138
BCS1	16PW111
BCS3	16PW111
C550	1PW037
C560	1PW037
C650	1AS002
C680	7PW077
C68A	7PW077
C700	01P18HN013
C750	6AL024
CL30	11HN003
CL35	01P14HN011
CL60	10GE130
CRJ2	01P05GE189
CRJ7	01P11GE202
CRJ9	01P08GE190
CRJX	01P08GE193
E135	01P10AL033
E145	6AL006
E170	01P08GE197
E190	10GE130
E195	10GE130
E290	04P20PW200
E295	04P20PW201
E35L	6AL006
E545	11HN003
E550	01P14HN016
E55P	01P14HN016
E75L	01P08GE197
E75S	01P08GE197
F100	1RR020
F2TH	01P07PW146
F900	1AS001
FA10	1AS002
FA50	1AS002
FA7X	03P16PW192
FA8X	03P15PW193
G280	01P11HN012
GA5C	01P22PW142
GA6C	01P22PW141
GALX	7PW077
GL5T	4BR004
GL7T	21GE185
GLEX	4BR004
GLF4	11RR048

GLF5	4BR004
GLF6	4BR004
H25B	1AS001
H25C	7PW077
HA4T	01P07PW146
IL62	1KK001
IL86	1KK003
LJ35	1AS001
LJ45	1AS002
LJ55	1AS002
MD11	5GE085
MD90	1IA001
RJ85	1TL004
SU95	01P11PJ004
T154	1KK001

SHTOJCA IV
METODOLOGJITË E MONITORIMIT TË AKTIVITETEVE SPECIFIKE NË LIDHJE ME INSTALIMET
(Pika 2, e nenit 20 të rregullores)

1. RREGULLA SPECIFIKE TË MONITORIMIT PËR SHKARKIMET NGA PROCESET E DJEGIES

A. Fusha e zbatimit

Operatorët e instalimeve monitorojnë shkarkimet e CO_2 nga të gjitha llojet e proceseve të djegies që zhvillohen në kuadër të të gjitha aktiviteteve të renditura në shtojcën II, shtojcën A të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, duke përfshirë edhe proceset përkatëse të pastrimit të gazrave, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë shtojcë. Çdo shkarkim që rezulton nga lëndët djegëse të përdorura si materiale hyrëse në proces duhet të trajtohet si shkarkim nga djegia, në kuadrin e metodologjive të monitorimit dhe raportimit, pa cenuar klasifikimet e tjera që mund të zbatohen për shkarkimet.

Operatori i instalimit nuk duhet të monitorojë dhe të raportojë shkarkimet që burojnë nga motorët e brendshëm me djegie që përdoren për qëllime transporti. Operatori i instalimit konsideron si shkarkime të instalimit të gjitha shkarkimet nga djegia e lëndëve djegëse që ndodhin brenda instalimit, pavarësisht nga eksportet e nxehtësisë ose të energjisë elektrike drejt instalimeve të tjera. Operatori i instalimit nuk duhet t'ia atribuojë instalimit importues shkarkimet që lidhen me prodhimin e nxehtësisë ose të energjisë elektrike që importohet nga instalime të tjera.

Operatori instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të shkarkimeve: kaldajat, djegësit, turbinat, ngrohësit, furrënalta, inceneratorët, kalcinerët (pajisje për procesin e kalcinimit), furrat e pjekjes industriale (kiln), furrat e zakonshme, tharësit, motorët, qelizat e lëndës djegëse *(fuel cells),* njësitë e djegies me qarkullim kimik (*chemical looping combustion*), flakërues *(flare)*, njësitë termike ose katalitike të pasdjegies, si edhe njësitë e pastrimit të gazrave (*scrubber*) që gjenerojnë shkarkime nga proceset, si dhe çdo pajisje ose makineri tjetër që përdor lëndë djegëse, përjashtuar pajisjet ose makineritë me motorë djegieje të brendshme që përdoren për qëllime transporti.

B. Rregulla specifike të monitorimit

Shkarkimet nga proceset e djegies do të llogariten në përputhje me pikën 1, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur lëndët djegëse përfshihen në një bilanc të masës në përputhje me nenin 25. Do të zbatohen shkallët metodologjike të përcaktuara në seksionin 2 të shtojcës II të kësaj rregulloreje. Përveç kësaj, shkarkimet e procesit nga pastrimi i gazrave të çliruara nga djegia do të monitorohen duke përdorur dispozitat e përcaktuara në nënseksionin C.

Për shkarkimet nga pishtarët e gazit (*flares*) zbatohen parashikime të posaçme, siç përcaktohet në nënseksionin D të këtij seksioni.

Proceset e djegies që ndodhin në terminalet e përpunimit të gazit mund të monitorohen duke përdorur një bilanc të masës në përputhje me nenin 25.

C. Pastrimi i gazrave të çliruara nga djegia (flue gas)

C.1. Desulfurizimi

Shkarkimet CO_2 të procesit që burojnë nga përdorimi i karbonatit për pastrimin e gazit acid që buron nga rryma e gazrave të çliruara nga djegia llogariten në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje në bazë të sasisë së karbonatit të konsumuar, metoda A si më poshtë, ose në bazë të gipsit të prodhuar, metoda B si më poshtë. Parashikimet në vijim zbatohen në përjashtim të parashikimeve të seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

<u>Metoda A</u>: Faktori i shkarkimit

Shkalla metodologjike 1: Faktori i shkarkimit përcaktohet nga raportet stekiometrike, siç parashikohet në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje. Përcaktimi i sasisë së **$CaCO_3$** dhe **$MgCO_3$** ose i karbonateve të tjera në materialin

përkatës hyrës kryhet duke përdorur udhëzimet më të mira të praktikës industriale.

Metoda B: Faktori i shkarkimit

Shkalla metodologjike 1: Faktori i shkarkimit është raporti stekiometrik ndërmjet gipsit të thatë ($CaSO_4 \times 2H_2O$) dhe CO_2 të shkarkuar: 0,2558 t CO_2/t gips.

Faktori i konvertimit:

Shkalla metodologjike 1: Përdoret një faktor konvertimi i barabartë me 1.

C.2 De-NOx

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, shkarkimet e CO_2 të procesit që krijohen nga përdorimi i uresë për pastrimin e rrymës së gazrave të çliruara nga djegia llogariten në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje, duke zbatuar shkallët metodologjike të mëposhtme.

Faktori i shkarkimit:

Shkalla metodologjike 1: Përcaktimi i sasisë së uresë në materialin përkatës hyrës kryhet duke përdorur udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë. Faktori i shkarkimit përcaktohet duke përdorur një raport stekiometrik prej 0,7328 t CO_2/t ure.

Faktori i konvertimit:

Zbatohet vetëm shkalla metodologjike 1.

D. **Flakëruesit** *(Flares)*

Kur llogariten shkarkimet që krijohen nga flakëruesit, operatori i instalimit merr në konsideratë shkarkimet që krijohen nga djegia brenda flakëruesit përfshirë djegien rutinë dhe djegien operative (udhëtime, ndezje dhe mbyllje, si dhe masa lehtësuese emergjente). Operatori i instalimit përfshin gjithashtu CO_2 e brendshëm në përputhje me nenin 49 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim të parashikimeve të seksionit 2.1 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, shkallët metodologjike 1 dhe 2b për faktorin e shkarkimit do të përcaktohen, si më poshtë:

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit përdor një faktor shkarkimi reference prej 0,00393 t CO_2/Nm^3 që buron nga djegia e etanit të pastër të përdorur si një tregues konservativ për gazet flakëruese.

Shkalla metodologjike 2b: Faktorët e shkarkimit që janë specifikë të instalimit do të nxirren nga një vlerësim i peshës molekulare të fluksit të flakëruesit, duke përdorur modelet e procesit që bazohen në modelet standarde të industrisë. Duke marrë parasysh përmasat relative dhe peshat molekulare të çdo fluksi që ka një kontribut, nxirret një shifër mesatare vjetore e ponderuar për peshën molekulare të gazit që digjet brenda flakëruesit.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 2.3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, për faktorin e oksidimit në rastin e flakëruesve do të zbatohen vetëm shkallët metodologjike 1 dhe 2.

2. RAFINIMI I NAFTËS SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit monitoron dhe raporton të gjitha shkarkimet e CO_2 që rrjedhin nga proceset e djegies dhe të prodhimit që zhvillohen në rafineritë e naftës.

Operatori duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: kaldajat, ngrohësit/trajtuesit e proceseve, motorët/turbinat me djegie të brendshme, oksiduesit katalitikë dhe termikë, furrat e kalcinimit të koksit, pompat kundër zjarrit, gjeneratorët për raste emergjence/rezervë, flakëruesit (*flares*), inceneratorët, njësi krakimi *(crackers*), njësitë e prodhimit të hidrogjenit, njësitë e procesit Klaus, rigjenerimi i katalizatorëve (nga proceset e krakimit katalitik dhe proceset e tjera katalitike), si dhe kokerët (*cokers*) (koksimi fleksibël, koksimi i vonuar).

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Monitorimi i veprimtarive të rafinimit të naftës bruto kryhet në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce për shkarkimet nga djegia, përfshirë pastrimin e gazeve të çliruara nga djegia (*flue gas scrubbing*). Operatori i instalimit mund të zgjedhë të përdorë metodologjinë e bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, për të gjithë rafinerinë ose për njësi të veçanta të procesit, si p.sh. impiantet e gazifikimit ose impiantet e kalcinimit të naftës së rëndë. Kur përdoren kombinime të metodologjisë standarde dhe bilancit të masës, operatori i instalimit duhet t'i paraqesë AKM-së prova që dëshmojnë se shkarkimet mbulohen në mënyrë të plotë dhe se nuk ndodh numërimi i dyfishtë i shkarkimeve.

Shkarkimet nga njësitë e dedikuara të prodhimit të hidrogjenit monitorohen në përputhje me seksionin 19 të kësaj shtojce.

Në përjashtim nga parashikimet e nenit 24 dhe 25, shkarkimet nga rigjenerimi i krakerit katalitik *(catalytic cracker),* rigjenerimi i katalizatorëve të tjerë dhe nga pajisjet e koksit fleksibël monitorohen duke përdorur një bilanc të masës, duke marrë parasysh gjendjen e ajrit në hyrje dhe gazrat e çliruara nga djegia. Gjithë sasia e CO që përmbahet në gazrat e çliruara nga djegia llogaritet si CO_2, duke zbatuar raportin e masës: t CO_2 = t CO * 1,571. Analiza e ajrit hyrës dhe e gazrave të çliruara nga djegia si dhe zgjedhja e shkallëve metodologjike duhet të jetë në përputhje me dispozitat e neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje. Metodologjia specifike e llogaritjes miratohet nga AKM.

3. PRODHIMI I KOSKIT, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimi duhet të përfshijë të paktën burimet e mundshme të mëposhtme të shkarkimeve të CO_2: lëndët e para (përfshirë qymyrin ose koksin e naftës), lëndët djegëse konvencionale (përfshirë gazin natyror), gazet e procesit (përfshirë gazin e furrës së shpërthimit - GFSH), lëndë të tjera djegëse dhe pastrimin e gazit dalës.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Për monitorimin e shkarkimeve nga prodhimi i koksit, operatori i instalimit mund të zgjedhë të përdorë një bilanc të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, ose metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionet 2 dhe 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

4. PJEKJA DHE SINTERIZIMI I XEHERORËVE SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: lëndët e para (kalcinimi i gurit gëlqeror, dolomitit dhe xeherorëve të hekurit karbonatik, duke përfshirë $FeCO_3$), lëndë djegëse konvencionale (përfshirë gazin natyror dhe koksin kokrizor/koksin pluhur) gazet e procesit (përfshirë gazin e furrës së koksit – GFK dhe gazi i furrës së shpërthimit – GFSH), tepricat e procesit të përdorura si material hyrës, duke përfshirë pluhurin e filtruar nga impianti i sinterimit, konverterin dhe furrën shpërthyese, lëndë të tjera djegëse dhe pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Për monitorimin e shkarkimeve nga pjekja, sinterizimi ose peletizimi i mineralit të metalit, operatori i instalimit mund të zgjedhë të përdorë një bilanc të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje ose metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionet 2 dhe 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

5. PRODHIMI I HEKURIT DHE ÇELIKUT SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mundshme të mëposhtme të shkarkimeve të CO_2: lëndët e para (kalcinimi i gurit gëlqeror, dolomitit dhe xeheve të hekurit karbonatik, duke përfshirë $FeCO_3$), lëndë djegëse konvencionale (gaz natyror, qymyr dhe koks), agjentët reduktues (përfshirë koksin, qymyrin dhe plastikën), gazet e procesit (gazi i furrës së koksit – GFK, gazi i furrës së shpërthimit – GFSH dhe gazi bazë i furrës me oksigjen – GBFO), konsumi i elektrodave grafit, lëndëve të tjera djegëse dhe pastrimin e gazit dalës.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Për monitorimin e shkarkimeve nga prodhimi i hekurit dhe çelikut, operatori i instalimit mund të zgjedhë të përdorë një bilanc të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, ose metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionet 2 dhe 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, të paktën për një pjesë të rrymave të shkarkimit, duke shmangur çdo mangësi ose numërim të dyfishtë të shkarkimeve.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 3.1 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, shkalla metodologjike 3 për përmbajtjen e karbonit përcaktohet si më poshtë:

Shkalla metodologjike 3: Operatori i instalimit llogarit përmbajtjen e karbonit të fluksit hyrës ose dalës sipas neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje, në përputhje me mostrat përfaqësuese të lëndëve djegëse, produkteve dhe nënprodukteve, si dhe me

përcaktimin e përmbajtjes së tyre të karbonit dhe fraksionit të biomasës. Operatori i instalimit bazon përmbajtjen e karbonit të produkteve ose produkteve gjysmë të gatshme në analizat vjetore të kryera sipas neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje ose nxjerr përmbajtjen e karbonit nga vlerat mesatare të përbërjes, siç specifikohet nga standardet përkatëse ndërkombëtare ose kombëtare.

6. PRODHIMI OSE PËRPUNIMI I METALEVE FERROZE DHE JO FERROZE SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit nuk i zbaton dispozitat e këtij seksioni për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO_2 nga prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe aluminit primar.

Operatori duhet të marrë në konsideratë të paktën burimet e mundshme të mëposhtme të shkarkimeve CO_2: lëndët djegëse konvencionale; lëndët djegëse alternative, duke përfshirë materialin e grimcuar plastik nga impiantet postgrirëse; agjentët reduktues, duke përfshirë koksin, elektrodat e grafitit; lëndët e para duke përfshirë gurin gëlqeror dhe dolomitin; xeherore dhe koncentrate metalike që përmbajnë karbon; dhe materialet dytësore që përdoren si hyrje në procesin e prodhimit.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Kur karboni që buron nga lëndët djegëse ose materialet hyrëse të përdorura në këtë instalim mbetet te produktet ose tek elementet e tjera që dalin si rezultat i prodhimit, operatori i instalimit përdor një bilanc të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje. Kur ky nuk është rasti, operatori i instalimit llogarit veçmas shkarkimin nga djegia dhe shkarkimin nga procesi duke përdorur metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 dhe seksionet 2 dhe 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

Kur përdoret një bilanc i masës, operatori i instalimit mund të zgjedhë të përfshijë shkarkimet nga proceset e djegies në bilancin e masës ose të përdorë metodologjinë standarde, në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 1 të kësaj shtojce për një pjesë të rrymave të shkarkimit, duke shmangur çdo mangësi ose numërim të dyfishtë të shkarkimeve.

7. SHKARKIMET E CO_2 NGA PRODHIMI OSE PËRPUNIMI I ALUMINIT PRIMAR OSE ALUMINAS, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori do të zbatojë dispozitat e këtij seksioni për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO_2 nga prodhimi i aluminës (Al_2O_3), prodhimin e elektrodave për shkrirjen primare të aluminit , duke përfshirë impiantet e pavarura për prodhimin e elektrodave të tilla dhe konsumin e elektrodave gjatë elektrolizës.

Operatori duhet të marrë në konsideratë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme për shkarkimet e CO_2: lëndët djegëse për prodhimin e nxehtësisë ose avullit, prodhimin e Al_2O_3 , prodhimin e elektrodave, reduktimin e Al_2O_3 gjatë elektrolizës që lidhet me konsumin e elektrodave, dhe përdorimin e karbonatit të natriumit ose karbonateve të tjera për pastrimin e gazit të shkarkuar.

Shkarkimet shoqëruese të perfluorokarboneve – PFC-ve, që rezultojnë nga efektet e anodës, duke përfshirë shkarkimet jo nga burimet, do të monitorohen në përputhje me seksionin 8 të kësaj shtojce.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Operatori do të përcaktojë shkarkimet e CO_2 nga prodhimi ose përpunimi i aluminit primar duke përdorur metodologjinë e bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje. Metodologjia e bilancit të masës do të marrë në konsideratë të gjithë karbonin në *in-pute*, rezerva, produkte dhe eksporte të tjera nga përzierja, formimi, pjekja dhe riciklimi i elektrodave si dhe nga konsumimi i elektrodave në elektrolizë. Aty ku përdoren anoda të parapjekura, mund të aplikohen ose bilance të veçanta të masës për prodhim dhe konsum, ose një bilanc i përbashkët i masës duke marrë parasysh prodhimin dhe konsumin e elektrodave. Në rastin e qelizave *Søderberg*, operatori do të përdorë një bilanc të përbashkët të masës.

Për shkarkimet nga proceset e djegies, operatori mund të zgjedhë t'i përfshijë ato në bilancin e masës ose të përdorë metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 1 të kësaj shtojce të paktën për një pjesë të

rrjedhave nga burimi, duke shmangur çdo boshllëk ose numërim të dyfishtë të shkarkimeve.

8. SHKARKIMET PFC NGA PRODHIMI OSE PËRPUNIMI I ALUMINIT PRIMAR SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit zbaton parashikimet më poshtë për shkarkimet e perfluorokarboneve (PFCs) që rezultojnë nga efektet e anodës, duke përfshirë shkarkimet e pakapshme të PFC-ve. Për shkarkimet shoqëruese të CO_2, duke përfshirë shkarkimet nga prodhimi i elektrodave, operatori i instalimit zbaton seksionin 7 të kësaj shtojce. Për më tepër, operatori i instalimit llogarit shkarkimet e PFC-ve që nuk lidhen me efektet e anodës bazuar në metodat e vlerësimit në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë dhe çdo udhëzues të publikuar nga Komisioni Evropian për këtë qëllim.

B. Përcaktimi i shkarkimeve të PFC

Shkarkimet e PFC-së llogariten nga shkarkimet e matshme në një tubacion ose oxhak (shkarkimet nga burime të përcaktuara (*point source)*), si dhe shkarkimet nga shkarkimet e pakapshme duke përdorur efikasitetin e grumbullimit të tubacionit:

Shkarkimet e PFC (totali) = Shkarkimet e PFC (tubacion) / efikasiteti i grumbullimit

Efikasiteti i grumbullimit matet kur përcaktohen faktorët specifikë të shkarkimit për instalimin. Për përcaktimin e efikasitetit të grumbullimit përdoret versioni më i fundit i udhëzuesit të përmendur në shkallën metodologjike 3 të seksionit 4.4.2.4 të udhëzimeve të IPCC-së 2006.

Operatori i instalimit llogarit shkarkimet e CF_4 dhe C_2F_6 të shkarkuara përmes një tubacioni ose oxhaku duke përdorur një nga metodat e mëposhtme:

a) Metodën A ku regjistrohen efektet e anodës të shprehur në minuta për çdo qelizë - ditë;

b) Metodën B ku regjistrohet mbitensioni i efektit të anodës.

Metoda e llogaritjes A - Metoda e pjerrësisë:

Operatori i instalimit do të përdorë ekuacionet e mëposhtme për përcaktimin e shkarkimeve të PFC:

Shkarkimet CF_4 [t] = AEM × (SEF_{CF4}/1 000) × Pr_{Al}

Shkarkimet C_2F_6 [t] = CF_4 shkarkime × F_{C2F6}

Ku:

AEM = Efekti i anodës në minuta / qelizë – ditë;

SEF_{CF4} = Faktori i shkarkimit të pjerrësisë [(kg CF_4 / t Al të prodhuar) / (efekti i anodës në minuta / qelizë – ditë)]. Kur përdoren lloje të ndryshme qelizash, mund të zbatohen SEF të ndryshme, sipas rastit;

PrAl = Prodhimi vjetor i aluminit primar [t];

FC_2F_6 = Fraksioni i peshës së C_2F_6 (t C_2F_6 / t CF_4).

Minutat e efektit anod për çdo qelizë në ditë duhet të shprehë shpeshtësinë e efekteve anodike (numri i efekteve anodike / qelizë-ditë) të shumëzuar me kohëzgjatjen mesatare të efekteve anodike (minuta të efektit anod / rast).

AEM = frekuenca × kohëzgjatja mesatare

Faktori i shkarkimit: Faktori i shkarkimit për CF_4 (faktori i shkarkimit të pjerrësisë, SEF_{CF4}) shpreh sasinë [kg] të CF_4 të shkarkuar për ton alumini të prodhuar për çdo minutë të efektit anod / qelizë-ditë. Faktori i shkarkimit (fraksioni i peshës FC2F6) i C_2F_6 shpreh sasinë [t] të C_2F_6 të shkarkuar në proporcion me sasinë [t] e CF_4 të shkarkuar.

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit do të përdorë faktorët specifikë të teknologjisë të shkarkimit nga tabela 1 e këtij seksioni të shtojcës IV të kësaj rregulloreje.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit do të përdorë faktorët specifikë të shkarkimeve për instalimin për CF_4 dhe C_2F_6 të përcaktuara nëpërmjet matjeve të vazhdueshme ose të ndërmjetme në terren. Për përcaktimin e këtyre faktorëve të shkarkimit, operatori i instalimit përdor versionin më të fundit të udhëzimit të përmendur në shkallën metodologjike 3 të seksionit 4.4.2.4 të udhëzimeve të IPCC 2006[2]. Faktori i shkarkimit do të marrë gjithashtu parasysh shkarkimet që lidhen me efektet jo-anodë. Operatori i instalimit do të

[2] Instituti Ndërkombëtar i Aluminit; Protokolli për Gazrat Serrë në Sektorin e Aluminit; tetor 2006; Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Instituti Ndërkombëtar i Aluminit; Protokolli për Matjen e Shkarkimeve të Tetrafluorometanit (CF_4) dhe Heksafluoroetanit (C_2F_6) nga Prodhimi Parësor i Aluminit; prill 2008.

përcaktojë çdo faktor shkarkimi me një pasiguri maksimale prej ± 15 %.

Operatori i instalimit përcakton faktorët e shkarkimit të paktën çdo tre vjet ose më herët kur është e nevojshme për shkak të ndryshimeve të rëndësishme në instalim. Ndryshimet e rëndësishme përfshijnë një ndryshim në shpërndarjen e kohëzgjatjes së efekteve anodike, ose një ndryshim në algoritmin e kontrollit që ndikon në përbërjen e llojeve të efekteve anodike ose në mënyrën e ndërprerjes së efektit anod.

Tabela 1. *Faktorët e shkarkimit specifikë të teknologjisë që lidhen me të dhënat e aktivitetit për metodën e pjerrësisë*

Teknologjia	**Faktori i shkarkimit për CF4 (SEF_{CF4}) [(kg CF_4/t Al) / (AE-min/qelizë - ditë)]**	**Faktori i shkarkimit për C_2F_6 ($_{C2F6}$) [t C_2F_6/ t CF_4]**
Parapjekja e punuar në qendër (CËPB)	0,143	0,121
"Stud Søderberg" Vertikal (VSS)	0,092	0,053

Metoda e llogaritjes B - Metoda e mbitensionit:

Kur matet mbitensioni i efektit të anodës, operatori i instalimit përdor ekuacionet e mëposhtme për përcaktimin e shkarkimeve të PFC-ve:

Shkarkimet CF_4 [t] = OVC × (AEO/CE) × Pr_{Al} × 0,001

Shkarkimet C_2F_6 [t] = Shkarkimet CF_4 × F_{C2F6}

Ku:

OVC = Koeficienti i mbitensionit ('faktori i shkarkimit') i shprehur si kg CF_4 për ton alumini të prodhuar për mV mbitension;

AEO = Mbitensioni i efektit anodë për qelizë [mV] i përcaktuar si integrali i (kohë × tension mbi

tensionin e synuar) pjesëtuar me kohën (kohëzgjatjen) e mbledhjes së të dhënave;

CE = Efikasiteti mesatar i rrymës të prodhimit të aluminit [%];

Pr_{Al} = Prodhimi vjetor i aluminit primar [t];

F_{C2F6} = Fraksioni i peshës së C_2F_6 (t C_2F_6/t CF_4);

Termi AEO/CE (mbitensioni i efektit anodik / efikasiteti i rrymës) shpreh mbitensionin mesatar të efektit anodik të integruar në kohë [mbitensioni mV] në raport me efikasitetin mesatar të rrymës [%].

Faktori i shkarkimit: Faktori i shkarkimit për CF_4 ('koeficienti i mbitensionit' KM) shpreh sasinë [kg] të CF_4 të shkarkuar për ton alumini të prodhuar për mbitensionin milivolt [mV]. Faktori i shkarkimit të C_2F_6 (fraksioni i peshës FC_2F_6) shpreh sasinë [t] e C_2F_6 të shkarkuar në përpjesëtim me sasinë [t] e CF_4 të shkarkuar.

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton faktorët e shkarkimit të teknologjive specifike të përcaktuara nga tabela 2 e këtij seksioni të shtojcës IV.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit përdor faktorët e shkarkimit specifik për instalimin për CF_4 [(kg CF_4 / t Al) / (mV)] dhe C_2F_6 [t C_2F_6/ t CF_4] të përcaktuara nëpërmjet matjeve të vazhdueshme ose të ndërmjetme në terren. Për përcaktimin e këtyre faktorëve të shkarkimit, operatori i instalimit përdor versionin më të fundit të udhëzimit të përmendur në shkallën metodologjike 3 të seksionit 4.4.2.4 të udhëzimeve të IPCC-së 2006. Operatori i instalimit duhet të përcaktojë faktorët e shkarkimit me një pasiguri maksimale prej ± 15 % secili.

Operatori i instalimit përcakton faktorët e shkarkimit të paktën çdo tre vjet ose më herët kur është e nevojshme për shkak të ndryshimeve të rëndësishme në instalim. Ndryshimet e rëndësishme përfshijnë një ndryshim në shpërndarjen e kohëzgjatjes së efekteve anodike, ose një ndryshim në algoritmin e kontrollit që ndikon në përbërjen e llojeve të efekteve anodike ose në mënyrën e ndërprerjes së efektit anodik.

Tabela 2. *Faktorët e shkarkimit të teknologjisë specifike që lidhen me të dhënat e aktivitetit të mbitensionit*

Teknologjia	**Faktori i shkarkimit për CF_4 [(kg CF_4/t Al) / mV]**	**Faktori i shkarkimit për C_2F_6 [t C_2F_6/ t CF_4]**
Parapjekja e punuar në qendër (PPQ)	1,16	0,121
"*Stud Søderberg*" vertikal (SSV)	NA	0,053

C. Përcaktimi i shkarkimeve të CO_2(e).

Operatori i instalimit llogarit shkarkimet e CO_2(e) nga shkarkimet CF_4 dhe C_2F_6 si më poshtë,

duke përdorur potencialet e ngrohjes globale të listuara në shtojcën VI, seksioni 3, tabela 6 të kësaj rregulloreje:

Shkarkimet e PFC [t $CO_2(e)$] = Shkarkimet CF_4 [t] × GËPCF4+ Shkarkimet C_2F_6 [t] × GËPC2F6

9. PRODHIMI I KLINKERIT TË CEMENTIT SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit përfshin të paktën burimet e mundshme të mëposhtme të shkarkimeve të CO_2: kalcinimin e gurit gëlqeror në lëndët e para, lëndët djegëse konvencionale fosile të furrave, lëndët djegëse alternative të furrës me bazë fosile dhe lëndët e para, lëndët djegëse të furrës me biomasë (mbetjet e biomasës), lëndët djegëse që përdoren jashtë furrës, përmbajtja e karbonit jokarbonat të gurit gëlqeror dhe argjilorit dhe lëndëve të para të përdorura për pastrimin e gazit dalës.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga djegia do të monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce. Shkarkimet e procesit nga përbërësit e masës së papërpunuar të lëndëve të para të çimentos (*raw meal*) do të monitorohen në përputhje me seksionin 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, bazuar në përmbajtjen e karbonatit të *in-put*-it të procesit (Metoda e llogaritjes A) ose në sasinë e klinkerit të prodhuar (Metoda e llogaritjes B). Në rastin e metodës A, karbonatet që do të merren parasysh duhet të përfshijnë të paktën $CaCO_3$, $MgCO_3$ dhe $FeCO_3$. Në rastin e metodës B, operatori i instalimit do të marrë parasysh të paktën CaO dhe MgO, dhe duhet t'i ofrojë prova AKM-së se deri në çfarë mase duhen marrë në konsideratë burimet e mëtejshme të karbonit.

Shkarkimet e CO_2 që rrjedhin nga pluhuri i hequr nga procesi dhe nga karboni jokarbonat në lëndët e para do të shtohen në përputhje me nënseksionet C dhe D të këtij seksioni.

Metoda e llogaritjes A: Elementet hyrëse në furrë

Kur pluhuri i furrës së çimentos (PFÇ) dhe pluhuri nga tubacioni terciar (*bypass dust*) largohen nga sistemi i furrës rrotulluese, operatori i instalimit nuk do të konsiderojnë lëndën e parë përkatëse si element hyrës të procesit, por do të llogarisë shkarkimet nga PFÇ në përputhje me nënseksionin C.

Nëse masa e papërpunuar e lëndëve të para të çimentos (*raw meal*) nuk karakterizohet, operatori i instalimit zbaton kërkesat e pasigurisë për të dhënat e aktivitetit veçmas për secilin material me karbon që hyn brenda furrës, duke shmangur numërimin e dyfishtë ose mangësitë e numërimit të materialeve të kthyera ose të anashkaluara. Aty ku të dhënat e aktivitetit përcaktohen në bazë të klinkerit të prodhuar, sasia neto e masës së papërpunuar të lëndëve të para të çimentos (*raw meal*) mund të përcaktohet me anë të një raporti empirik të sasisë neto të masës së papërpunuar të lëndëve të para të çimentos/klinkerit sipas specifikave të impiantit. Ky raport do të përditësohet të paktën një herë në vit duke zbatuar udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë.

Metoda e llogaritjes B: Bazuar në daljen e klinkerit

Operatori i instalimit përcakton të dhënat e aktivitetit si prodhimi i klinkerit [t] gjatë periudhës së raportimit në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me peshimin e drejtpërdrejtë të klinkerit;

b) bazuar në dërgesat e çimentos, sipas bilancit material duke marrë parasysh dërgimin e klinkerit, furnizimet e klinkerit si dhe variacionin e stokut të klinkerit, duke përdorur formulën e mëposhtme:

Klinkeri i prodhuar [t] = ((dërgesat e çimentos [t] – ndryshimi i stokut të çimentos [t]) × raporti klinker / çimento [t klinker / t çimento]) – (klinkeri i marrë [t]) + (klinkeri i nxjerrë [t]) – (ndryshimi i stokut të klinkerit [t]).

Operatori i instalimit ose do të nxjerrë raportin klinker/çimento për secilin prej produkteve të ndryshme të çimentos bazuar në dispozitat e neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje ose do të llogarisë raportin nga diferenca e dërgesave të çimentos dhe ndryshimeve të stokut dhe të gjitha materialeve të përdorura si aditivë të çimentos duke përfshirë pluhurin e tubacionit terciar dhe pluhurin e furrës së çimentos.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II, shkalla metodologjike 1 për faktorin e shkarkimit do të përcaktohet si më poshtë:

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një faktor shkarkimi prej 0,525 t CO_2/t klinker.

C. Shkarkimet që lidhen me pluhurin e eliminuar

Operatori i instalimit do të shtojë shkarkimet e CO_2, nga pluhuri i tubacionit terciar ose pluhuri i furrës së çimentos (PFÇ) që del nga sistemi i furrës, të korrigjuar për një raport të pjesshëm të kalcinimit të PFÇ të llogaritur si shkarkime të procesit, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje. Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, shkallët metodologjike 1 dhe 2 për faktorin e shkarkimit do të përcaktohen si më poshtë:

Shkalla metodologjike 1: Operatori i instalimit zbaton një faktor shkarkimi prej 0,525 t CO_2/t pluhur.

Shkalla metodologjike 2: Operatori i instalimit përcakton faktorin e shkarkimit (FSH) të paktën një herë në vit duke ndjekur parashikimet në nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje dhe duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\mathrm{EFCKD} = \left(\frac{\mathrm{EF}Cli}{1+\mathrm{EF}Cli}\,x\,d\right) / \left(1-\frac{\mathrm{EF}Cli}{1+\mathrm{EF}Cli}\,x\,d\right)$$

Ku:

EFCKD = Faktori i shkarkimit të pluhurit të furrës së çimentos pjesërisht të kalcinuar [t CO_2/t PFÇ];

EF*Cli* = Faktori i shkarkimit specifik për instalimin e klinkerit [t CO_2/t klinker];

d = Shkalla e kalcinimit të PFÇ (CO_2 i çliruar si % e totalit të karbonatit CO_2 në përzierjen e papërpunuar).

Shkalla metodologjike 3 për faktorin e shkarkimit nuk zbatohet.

D. Shkarkimet nga karboni jokarbonat në masën e papërpunuar të lëndëve të para të çimentos (*raw meal*)

Operatori i instalimit përcakton shkarkimet nga karboni jokarbonat të paktën nga guri gëlqeror, shist argjilor(argjila) ose lëndët e para alternative (për shembull, hiri fluturues) i përdorur në farinë në furrë, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përcaktimet e shkallëve metodologjike të mëposhtme për faktorin e shkarkimit:

Shkalla metodologjike 1: Përmbajtja e karbonit jokarbonat në lëndën e parë përkatëse do të vlerësohet duke përdorur udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë.

Shkalla metodologjike 2: Përmbajtja e karbonit jokarbonat në lëndën e parë përkatëse do të përcaktohet të paktën çdo vit sipas dispozitave të neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje do të zbatohen përcaktimet e shkallëve metodologjike të mëposhtme për faktorin e konvertimit:

Shkalla metodologjike 1: Zbatohet një faktor konvertimi i barabartë me 1.

Shkalla metodologjike 2: Faktori i konvertimit do të llogaritet duke zbatuar praktikat më të mira të industrisë.

10. PRODHIMI I GËLQERES OSE KALCINIMI I DOLOMITIT OSE MAGNEZITIT SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit përfshin të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: kalcinimin e gurit gëlqeror, dolomitit ose magnezit në lëndët e para, karbonin jokarbonat në lëndët e para, lëndët djegëse konvencionale me bazë fosile për furrën, lëndët djegëse alternative me bazë fosile për furrën dhe materialet e papërpunuara, lënd djegëse të furrës nga biomasa (mbetjet e biomasës) dhe lëndët djegëse të tjera.

Kur gëlqerja e djegur dhe CO_2 që rrjedh nga guri gëlqeror përdoren për proceset e pastrimit, CO_2 do të konsiderohet i shkarkuar, përveç rastit kur CO_2 është i lidhur në një produkt që plotëson kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 51 të kësaj rregulloreje.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga djegia monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce. Shkarkimet nga procesi që burojnë nga karbonatet e lëndëve të para duhet të monitorohen në përputhje me seksionin 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje. Karbonatet e kalciumit dhe magnezit duhet të merren gjithmonë në konsideratë. Karbonatet e tjera dhe përmbajtja e karbonit jokarbonatik në lëndën e parë duhet të merren në konsideratë sa herë që janë të rëndësishme për llogaritjen e shkarkimeve.

Për metodologjinë e bazuar në materialet dhe lëndët hyrëse në proces, vlerat e përmbajtjes së

karbonateve duhet të korrigjohen në përputhje me përmbajtjen përkatëse të lagështisë dhe të tepricave të padobishme (*gangue*) të materialit. Në rastin e prodhimit të magnezit, duhet të merren në konsideratë, sipas rastit, edhe mineralet e tjera që përmbajnë magnez përveç karbonateve.

Duhet të shmanget çdo numërim i dyfishtë ose mangësi në llogaritje në lidhje me materialet e rikthyera ose të anashkaluara. Kur zbatohet metoda B, pluhuri i furrës së gëlqeres do të konsiderohet si një rrymë shkarkimi e veçantë, kur është e zbatueshme.

C. Shkarkimet nga karboni jokarbonat në lëndët e para

Operatori i instalimit përcakton shkarkimet nga karboni jokarbonat të paktën nga guri gëlqeror, shist argjilor ose lëndët e para alternative në furrë, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përcaktimet e mëposhtme të shkallëve medotoligjike për faktorin e shkarkimit:

Shkalla metodologjike 1: Përmbajtja e karbonit jokarbonat në lëndën e parë do të vlerësohet duke përdorur udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë.

Shkalla metodologjike 2: Përmbajtja e karbonit jokarbonat në lëndën e parë do të përcaktohet të paktën çdo vit në përputhje me dispozitat e neneve 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përcaktimet e mëposhtme të shkallëve metodologjike për faktorin e konvertimit:

Shkalla metodologjike 1: Faktori i konvertimit që do të përdoret duhet të jetë i barabartë me 1.

Shkalla metodologjike 2: Faktori i konvertimit do të llogaritet duke zbatuar praktikat më të mira të industrisë.

11. PRODHIMI I QELQIT, FIBRAVE TË QELQIT, OSE MATERIALIT IZOLUESE ME BAZË LESHI MINERAL SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit zbaton dispozitat e këtij seksioni edhe për instalimet për prodhimin e qelqit ujor (*water glass*) dhe për prodhimin e leshit të gurit/shkëmbit.

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: zbërthimi i karbonateve alkaline dhe alkaline tokësore si rezultat i shkrirjes së lëndës së parë, lëndët djegëse fosile konvencionale, lëndët djegëse alternative me bazë fosile dhe lëndët e para, lëndët djegëse të biomasës (mbetjet e biomasës), lëndë djegëse të tjera, aditivë që përmbajnë karbon përfshirë koksin, pluhurin e qymyrit dhe grafitin, postdjegia e gazrave të çliruara nga djegia dhe pastrimi i gazrave të çliruara nga djegia.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga djegia, duke përfshirë pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia, monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce. Shkarkimet e procesit nga lëndët e para jo karbonate, duke përfshirë koksin, grafitin dhe pluhurin e qymyrit, monitorohen në përputhje me seksionin 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje. Karbonatet që duhet të merren parasysh përfshijnë të paktën $CaCO_3$, $MgCO_3$, Na_2CO_3, $NaHCO_3$, $BaCO_3$, Li_2CO_3, K_2CO_3 dhe $SrCO_3$. Përdoret vetëm metoda A.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përcaktimet e mëposhtme të shkallëve metodologjike për faktorin e shkarkimit të lëndëve të para që përmbajnë karbonate.

Shkalla metodologjike 1: Përdoren raportet stekiometrike të listuara në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje. Pastërtia e materialeve hyrëse në proces përcaktohet me anë të praktikave më të mira të industrisë.

Shkalla metodologjike 2: Përcaktimi i sasisë së karbonateve në çdo material hyrës në proces do të kryhet në përputhje me nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, në lidhje me faktorin e konvertimit, për të gjitha shkarkimet e procesit nga lëndët e para që përmbajnë karbonat dhe jokarbonat zbatohet vetëm shkalla metodologjike 1.

12. PRODHIMI I PRODUKTEVE QERAMIKE, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: lëndë djegëse të furrës, kalcinimin e gurit gëlqeror/dolomitit dhe karbonateve të tjera në lëndën e parë, gur gëlqeror dhe karbonate të tjera për reduktimin e ndotësve të ajrit dhe pastrimin e gazrave të tjera të çliruara nga djegia, aditivët fosile/biomasë të përdorura për të nxitur porozitet, përfshirë polistirolin, tepricat nga prodhimi i letrës ose tallash, përmbajtjen e karbonit jokarbonat në argjilë dhe lëndë të tjera të para.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga djegia, duke përfshirë pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia, monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce. Shkarkimet e procesit nga përbërësit dhe aditivët e masës së papërpunuar të lëndëve të para të çimentos (*raw meal*) monitorohen në përputhje me seksionin 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje. Për qeramikat e bazuara në argjila të pastruara ose të sintetizuara, operatori i instalimit mund të përdorë metodën A ose metodën B. Për produktet qeramike të bazuara në argjila të papërpunuara dhe sa herë që përdoren argjila ose aditivë me përmbajtje të konsiderueshme të karbonit jokarbonat, operatori i instalimit do të përdorë metodën A. Karbonatet e kalciumit duhet të merret gjithmonë në konsideratë. Karbonatet e tjera dhe karboni jokarbonat në lëndën e parë do të merren në konsideratë, atëherë kur është e nevojshme për llogaritjen e shkarkimeve.

Të dhënat e aktivitetit për materialet hyrëse në proces, sipas metodës A, mund të përcaktohen nëpërmjet një metode të përshtatshme të llogaritjes të "kthimit pas" (*back-calculation*), të bazuar në praktikat më të mira të industrisë dhe të miratuar nga AKM-ja. Metoda e llogaritjes së kthimit pas merr në konsideratë matjet e disponueshme për produktet jeshile të thata ose produktet e pjekura, si dhe burimet përkatëse të të dhënave mbi përmbajtjen e lagështisë së argjilës dhe aditivëve, dhe mbi humbjen gjatë ripjekjes (humbja në ndezje) të materialeve përkatëse.

Në përjashtim nga parashikimet e seksionit 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje, për faktorët e shkarkimit për shkarkimet e procesit të lëndëve të para që përmbajnë karbonate zbatohen përcaktimet e shkallës metodologjike si më poshtë:

Metoda A (bazuar në elementet hyrëse):

Shkalla metodologjike 1: Për llogaritjen e faktorit të shkarkimit do të zbatohet në vend të rezultateve të analizave një vlerë konservative prej 0,2 ton $CaCO_3$ (që përkon me 0,08794 ton CO_2) për ton argjilë të thatë. I gjithë karboni inorganik dhe organik në materialin argjilor do të konsiderohet si i përfshirë te kjo vlerë. Aditivët e përdorur në proces nuk konsiderohen të përfshirë te kjo vlerë.

Shkalla metodologjike 2: Për çdo rrymë shkarkimi do të nxirret një faktor shkarkimi dhe do të përditësohet të paktën një herë në vit duke përdorur praktikat më të mira të industrisë që pasqyrojnë kushtet specifike të vendndodhjes së instalimit dhe përzierjen e produkteve të instalimit.

Shkalla metodologjike 3: Përcaktimi i përbërjes së lëndëve të para kryhet në përputhje me nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje. Për konvertimin e të dhënave të përbërjes në faktorë tw shkarkimit, nëse është e nevojshme, përdoren raportet stekiometrike të renditura në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje.

Metoda B (bazuar në elementet dalëse):

Shkalla metodologjike 1: Për llogaritjen e faktorit të shkarkimit do të zbatohet në vend të rezultateve të analizave një vlerë konservative prej 0,123 ton CaO (që përkon me 0,09642 ton CO_2) për ton produkt. I gjithë karboni inorganik dhe organik në materialin argjilor konsiderohet si i përfshirë te kjo vlerë. Aditivët e përdorur në proces nuk konsiderohen të përfshirë te kjo vlerë.

Shkalla metodologjike 2: Faktori i shkarkimit do të nxirret dhe përditësohet të paktën një herë në vit duke përdorur praktikat më të mira të industrisë që pasqyrojnë kushtet specifike të vendndodhjes së instalimit dhe përzierjen e produkteve të instalimit.

Shkalla metodologjike 3: Përcaktimi i përbërjes së produkteve kryhet në përputhje me nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje. Për konvertimin e të dhënave të përbërjes në faktorë shkarkimi, nëse është e nevojshme, përdoren raportet stekiometrike të renditura në shtojcën VI seksioni 2, tabela 3, të kësaj rregulloreje, duke supozuar se të gjitha oksidet e metaleve janë nxjerrë nga karbonatet përkatëse.

Në përjashtim nga parashikimi i seksionit 1 të kësaj shtojce, për pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia zbatohet shkalla metodologjike e mëposhtme për faktorin e shkarkimit:

Shkalla metodologjike 1: Operatori zbaton raportin stekiometrik të $CaCO_3$ siç përcaktohet në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje.

Asnjë shkallë tjetër metodologjike dhe asnjë faktor tjetër konvertimi nuk do të përdoret për pastrimin (*scrubbing*). Duhet të shmanget numërimi i dyfishtë nga guri gëlqeror i përdorur i ricikluar si lëndë e parë në të njëjtin instalim.

13. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË GIPSIT DHE KARTONIT TË GIPSIT, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën shkarkimet e CO_2 nga të gjitha llojet e aktiviteteve me djegie.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga djegia do të monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce.

14. PRODHIMI I CELULOZËS DHE LETRËS SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: kaldajat, turbinën me gaz dhe pajisje të tjera me djegie që prodhojnë avull ose energji, kaldajat rikuperuese dhe pajisje të tjera që djegin mbetjet e lëngjeve që mbeten pas procesit të prodhimit të celulozës, inceneratorët, furrat e gëlqeres dhe kalcinimit, pastrimin e gazit që del si mbetje dhe tharëset që punojnë me lëndë djegie (p.sh. tharëse me infra të kuqe).

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Monitorimi i shkarkimeve nga djegia, duke përfshirë pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia, do të kryhet në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce.

Shkarkimet e procesit nga lëndët e para të përdorura si kimikate ndihmëse, duke përfshirë të paktën gurin gëlqeror ose hirin e sodës, do të monitorohen me metodën A në përputhje me seksionin 4 të shtojcës 2 II të kësaj rregulloreje. Shkarkimet e CO_2 që burojnë nga rikuperimi i llumit gëlqeror në prodhimin e celulozës do të supozohen se janë CO_2 që buron nga biomasa e ricikluar. Vetëm sasia e CO_2 që është në përpjesëtim me elementet hyrëse që burojnë nga kimikatet ndihmëse do të supozohet se shkaktojnë shkarkime CO_2 fosile.

Për shkarkimet nga kimikatet ndihmëse, zbatohen përcaktimet e shkallës metodologjike të mëposhtme në lidhje me faktorin e shkarkimit:

Shkalla metodologjike 1: Përdoren raportet stekiometrike të renditura në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje. Pastërtia e materialeve hyrëse përkatëse përcaktohet me anë të praktikave më të mira të industrisë. Vlerat e përftuara rregullohen në përputhje me përmbajtjen e lagështisë dhe të materialeve të huaja (*gangue content*) të materialeve karbonate të përdorura.

Shkalla metodologjike 2: Përcaktimi i sasisë së karbonateve përkatëse në çdo material hyrës përkatës kryhet në përputhje me nenet 32 deri në 35 të kësaj rregulloreje. Raportet stekiometrike të renditura në seksionin 2 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje do të përdoren për të konvertuar të dhënat e përbërjes në faktorë shkarkimi, aty ku është e nevojshme.

Për faktorin e konvertimit, do të zbatohet vetëm shkalla metodologjike 1.

15. PRODHIMI I KARBONIT TË ZI SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë si burime të shkarkimeve të CO2 të paktën të gjitha lëndët djegëse të përdorura për djegie dhe të gjitha lëndët djegëse të përdorura si material të procesit.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Monitorimi i shkarkimeve nga prodhimi i karbonit të zi mund të monitorohet ose si një proces djegieje, duke përfshirë pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia, në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce ose duke përdorur një bilanc të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 3 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

16. PËRCAKTIMI I SHKARKIMEVE TË OKSIDIT TË AZOTIT (N_2O) NGA ACIDI NITRIK, ACIDI ADIPIK, KAPROLAKTAMI, GLIOKSALI DHE ACIDI GLIOKSILIK SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020 "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Çdo operator instalimi për çdo aktivitet, nga i cili rezultojnë shkarkime të N_2O, mban në konsideratë të gjitha burimet që shkarkojnë N_2O nga proceset e

prodhimit, duke përfshirë rastet kur shkarkimet e N_2O nga prodhimi kanalizohen nëpërmjet ndonjë pajisjeje për zvogëlimin e ndotjes/shkarkimeve. Këtu përfshihen elementet e mëposhtme:

a) prodhimi i acidit nitrik – shkarkimet e N_2O nga oksidimi katalitik i amoniakut dhe/ose nga njësitë për zvogëlimin e ndotjes/shkarkimeve të NOx/N_2O;

b) Prodhimi i acidit adipik – shkarkimet e N_2O duke përfshirë shkarkimet nga reaksioni i oksidimit, çdo shkarkim të drejtpërdrejtë nga procesi dhe/ose çdo pajisje për kontrollin e shkarkimeve;

c) Prodhimi i glioksalitit dhe acidit glioksilik – shkarkimet e N_2O, duke përfshirë shkarkimet nga reaksionet e procesit, çdo shkarkim të drejtpërdrejtë nga procesi dhe/ose çdo pajisje kontrolli të shkarkimeve;

ç) Prodhimi i kaprolaktamit – shkarkimet e N_2O, duke përfshirë shkarkimet nga reaksionet e procesit, çdo shkarkim të drejtpërdrejtë nga procesi dhe/ose çdo pajisje për kontrollin e e shkarkimeve.

Këto dispozita nuk zbatohen për asnjë shkarkim N_2O nga djegia e lëndëve djegëse.

B. Përcaktimi i shkarkimeve të N_2O

B.1. Shkarkimet vjetore të N_2O

Operatori i instalimit monitoron shkarkimet e N_2O nga prodhimi i acidit nitrik duke bërë matje të vazhdueshme të shkarkimeve. Operatori i instalimit monitoron shkarkimet e N_2O nga prodhimi i acidit adipik, kaprolaktamit, glioksalit dhe acidit glioksilik duke përdorur një metodologji të bazuar në matje për shkarkimet që i nënshtrohen procesit të zvogëlimit të shkarkimeve dhe një metodë të bazuar në llogaritje (duke zbatuar një metodologji të bilancit të masës) për rastet e përkohshme të shkarkimeve që nuk i janë nënshtruar procesit të zvogëlimit të shkarkimeve.

Për çdo burim shkarkimi ku zbatohet matja e vazhdueshme e shkarkimeve, operatori i instalimit konsideron shkarkimet totale vjetore si shumën e të gjitha shkarkimeve për orë, duke përdorur ekuacionin 1 të dhënë në seksionin 3 të shtojcës VIII të kësaj rregulloreje.

B.2. Shkarkimet N_2O për orë

Operatori i instalimit llogarit shkarkimet mesatare vjetore të N_2O për orë për çdo burim ku zbatohet matja e vazhdueshme e shkarkimeve, duke përdorur ekuacionin 2 të dhënë në seksionin 3 të shtojcës VIII të kësaj rregulloreje.

Operatori i instalimit përcakton përqendrimet orare të N_2O në gazrat e çliruara nga djegia nga çdo burim shkarkimi, duke përdorur një metodologji të bazuar në matje në një pikë përfaqësuese, në dalje të pajisjes për zvogëlimin e shkarkimeve NOx/N_2O, nëse kjo pajisje është e pranishme dhe përdoret. Operatori i instalimit zbaton teknika që janë në gjendje të matin përqendrimet e N_2O nga të gjithë burimet e shkarkimeve si në kushtet kur përdoren pajisjet për zvogëlimin e shkarkimeve ashtu edhe në kushtet kur këto pajisje nuk përdoren. Kur pasiguria gjatë këtyre periudhave rritet, operatori i instalimit duhet ta marrë atë në konsideratë në vlerësimin e pasigurisë.

Operatori i instalimit duhet t'i korrigjojë të gjitha matjet në bazë të gazit të thatë kur është e nevojshme dhe t'i raportojë ato në mënyrë të qëndrueshme.

B.3. Përcaktimi i fluksit të gazrave të çliruara nga djegia (*flue gas flow)*

Operatori i instalimit përdor metodat për monitorimin e fluksit të gazrave të çliruara nga djegia të përcaktuara në pikën 12, të nenit 44, të kësaj rregulloreje për matjen e fluksit të gazrave të çliruara nga djegia për qëllime të monitorimit të shkarkimeve të N_2O. Për prodhimin e acidit nitrik, operatori i instalimit zbaton metodën e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 12, të nenit 44, të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur kjo nuk është teknikisht e zbatueshme. Në këtë rast, dhe pas miratimit të AKM-së, operatori i instalimit zbaton një metodë alternative, përfshirë metodologjinë e bilancit të masës të bazuar në parametra të rëndësishëm si ngarkesa hyrëse e amoniakut, ose përcaktimin e fluksit përmes matjes së vazhdueshme të fluksit të shkarkimeve.

Fluksi i gazrave të çliruara nga djegia llogaritet në përputhje me formulën vijuese:

$$V \text{ fluksi i gazrave të çliruara nga djegia } [Nm^3/h] = V_{ajrit} * (1 - O_2, \text{ajri}) / (1 - O_2, \text{gazi i çliruar nga djegia})$$

Ku:

V_{ajrit} = Fluksi total i ajrit hyrës në Nm^3/h në kushte standarde;

O_2, ajri = Fraksioni vëllimor i O_2 në ajër të thatë [= 0,2095];

O_2, *gazi i çliruar nga djegia* = Fraksioni vëllimor i O_2 në gazin e *çliruar nga djegia*.

V_{ajrit} llogaritet si shuma e të gjitha flukseve të ajrit që hyjnë në njësinë e prodhimit të acidit nitrik.

Operatori i instalimit zbaton formulën e mëposhtme, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në planin e tij të monitorimit:

$$V_{ajrit} = V_{parësor} + V_{dytësor} + V_{vulosje}$$

Ku:

$V_{parësor}$ = Fluksi parësor i ajrit në hyrje, në Nm^3/orë, në kushte standarde;

$V_{dytësor}$ = Fluksi dytësor i ajrit në hyrje, në Nm^3/orë, në kushte standarde;

$V_{vulosje}$ = Fluksi i ajrit për vulosje në hyrje, në Nm^3/orë, në kushte standarde.

Operatori i instalimit përcakton $V_{parësor}$ përmes matjes së vazhdueshme të fluksit, përpara se të ndodhë përzierja me amoniakun. Operatori i instalimit përcakton $V_{dytësor}$ përmes matjes së vazhdueshme të fluksit, duke përfshirë rastet kur matja kryhet përpara njësisë së rikuperimit të nxehtësisë. Për $V_{vulosje}$, operatori i instalimit merr në konsideratë fluksin e ajrit pastrues (*purged air flow*) në kuadër të procesit të prodhimit të acidit nitrik.

Për rrymat hyrëse të ajrit që përbëjnë në total më pak se 2,5 % të fluksit të përgjithshme të ajrit, AKM-ja mund të pranojë metoda vlerësimi për përcaktimin e prurjes vëllimore të ajrit, të propozuara nga operatori i instalimit dhe të bazuara në praktikat më të mira të industrisë.

Operatori i instalimit duhet të sigurojë prova, përmes matjeve të kryera në kushte normale operimi, se fluksi i matur i gazrave të çliruara nga djegia është mjaftueshëm homogjen për të lejuar përdorimin e metodës së propozuar të matjes. Në rastet kur, përmes këtyre matjeve, konfirmohet një fluks johomogjen, operatori i instalimit duhet ta marrë këtë në konsideratë gjatë përcaktimit të metodave të përshtatshme të monitorimit dhe gjatë llogaritjes së pasigurisë në shkarkimet e N_2O.

Operatori duhet t'i korrigjojë të gjitha matjet në bazë të gazit të thatë dhe t'i raportojë ato në mënyrë të qëndrueshme.

B.4. Përqendrimet e oksigjenit (O_2)

Operatori i instalimit mat përqendrimet e oksigjenit në gazrat e çliruara nga djegia, kur është e nevojshme për llogaritjen e fluksit të gazrave të çliruara nga djegia, në përputhje me nënseksionin B.3 të këtij seksioni të shtojcës IV. Gjatë kësaj procedure, operatori i instalimit duhet të respektojë kërkesat për matjet e përqendrimeve të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 41, të kësaj rregulloreje. Gjatë përcaktimit të pasigurisë së shkarkimeve të N_2O, operatori i instalimit duhet të marrë në konsideratë pasigurinë që lidhet me matjet e përqendrimit të O_2.

Operatori i instalimit duhet t'i korrigjojë të gjitha matjet në bazë të gazit të thatë, kur kërkohet, dhe t'i raportojë ato në mënyrë të qëndrueshme.

B.5. Llogaritja e shkarkimeve të N_2O

Për periudhat specifike të shkarkimeve të pareduktuara të N_2O nga prodhimi i acidit adipik, kaprolaktamit, glioksalit dhe acidit glioksilik — duke përfshirë shkarkimet e pareduktuara që ndodhin për arsye sigurie gjatë shkarkimeve të kontrolluara ose në rastet kur njësia e reduktimit të shkarkimeve dështon — dhe në rastet kur monitorimi i vazhdueshëm i shkarkimeve të N_2O nuk është teknikisht i mundshëm, operatori i instalimit, me miratimin paraprak të AKM-së të metodologjisë specifike, duhet të llogarisë shkarkimet e N_2O duke përdorur metodologjinë e bilancit të masës. Për këtë qëllim, pasiguria e përgjithshme duhet të jetë e ngjashme me rezultatin që do të arrihej duke zbatuar kërkesat e shkallës metodologjike të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, tw nenit 41 të kësaj rregulloreje. Operatori i instalimit duhet ta bazojë metodën e llogaritjes në shkallën maksimale të mundshme të shkarkimit të N_2O që rezulton nga reaksioni kimik që zhvillohet në atë moment dhe gjatë periudhës së shkarkimit.

Operatori i instalimit duhet të marrë në konsideratë pasigurinë në çdo llogaritje të shkarkimeve nga një burim specifik shkarkimi, gjatë përcaktimit të pasigurisë mesatare vjetore orare për atë burim shkarkimi.

B.6. Përcaktimi i normave të prodhimit të aktivitetit

Normat e prodhimit duhet të llogariten duke u bazuar në raportet ditore të prodhimit dhe në orët e funksionimit.

B.7. Normat e marrjes së mostrave

Mesataret e vlefshme orare ose mesataret për periudha më të shkurtra referimi duhet të llogariten në përputhje me nenin 45 të kësaj rregulloreje për:

a) përqendrimin e N_2O në gazrat e çliruara nga djegia;

b) fluksin total të gazrave të çliruara nga djegia, kur matet drejtpërdrejt dhe kur kërkohet;

c) të gjitha flukset e gazrave dhe përqendrimet e oksigjenit që janë të nevojshme për të përcaktuar në mënyrë indirekte fluksin total të gazrave të çliruara nga djegia.

C. Përcaktimi i ekuivalentit vjetor të CO_2 – CO_2(e)

Operatori i instalimit duhet të konvertojë shkarkimet totale vjetore të N_2O nga të gjithë burimet e shkarkimeve, të matur në ton me tri shifra dhjetore pas presjes, në ekuivalent vjetor të CO_2(e), të shprehur në ton të rrumbullakosura, duke përdorur formulën vijuese dhe vlerat e PNG (Potencialit të Ngrohjes Globale) të përcaktuara në seksionin 3 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje.

$$CO_2(e)\ [t] = N_2O_{\ Vjetore}[t] \times PNG_{\ N2O}$$

Ku:

N_2Ovjetore = shkarkimet totale vjetore të N_2O, të llogaritura sipas ekuacionit 1 të dhënë në seksionin 3 të shtojcës VIII të kësaj rregulloreje.

Totali vjetor i CO_2(e) i gjeneruar nga të gjitha burimet e shkarkimeve dhe çdo shkarkim direkt i CO_2 nga burime të tjera shkarkimi të përfshira në autorizimin e shkarkimeve GES do t'i shtohet totalit të shkarkimeve vjetore të CO_2 të gjeneruar nga instalimi dhe që do të përdoren për raportim dhe dorëzimin e kuotave të shkarkimeve.

Shkarkimet totale vjetore të N_2O do të raportohen në ton deri në tri shifra dhjetore dhe të CO_2(e) në ton të rrumbullakosura.

17. PRODHIMI I AMONIAKUT SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit duhet të përfshijë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: djegien e lëndëve djegëse që furnizojnë nxehtësinë për reformim ose oksidim të pjesshëm, lëndët djegëse të përdorura si lëndë e parë në procesin e prodhimit të amoniakut (reformim ose oksidim të pjesshëm), lëndët djegëse të përdorura për procese të tjera djegieje, përfshirë prodhimin e ujit të ngrohtë ose avullit.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Për monitorimin e shkarkimeve nga proceset e djegies dhe nga lëndët djegëse të përdorura si lëndë hyrëse të procesit do të zbatohet metodologjia standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 1 të kësaj shtojce.

Kur CO_2 nga prodhimi i amoniakut përdoret si lëndë e parë për prodhimin e uresë ose kimikateve të tjera, ose transferohet jashtë instalimit për çdo përdorim që nuk mbulohet nga pika 1, e nenit 50 të kësaj rregulloreje, sasia përkatëse e CO_2 duhet të konsiderohet si e shkarkuar nga instalimi që prodhon CO_2, përveç rasteve kur CO_2 lidhet në një produkt që plotëson kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 51 të kësaj rregulloreje.

18. PRODHIMI I KIMIKATEVE ORGANIKË NË MASË, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit merr parasysh të paktën burimet e mëposhtme të shkarkimeve të CO_2:

krakimi (katalitik dhe jokatalitik), reformimi, oksidimi i pjesshëm ose i plotë, procese të ngjashme që çojnë në shkarkime të CO_2 nga karboni i përmbajtur në lëndët hyrëse me bazë hidrokarbure, djegia e gazeve të mbetjeve dhe ndezja, dhe djegia e lëndës djegëse në procese të tjera djegieje.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Nëse prodhimi i kimikateve organike në masë është i integruar teknikisht në një rafineri nafte minerale, operatori i atij instalimi duhet të zbatojë dispozitat përkatëse të seksionit 2 të kësaj shtojce.

Pavarësisht parashikimit në paragrafin e parë më sipër, operatori i instalimit duhet të monitorojë shkarkimet nga proceset e djegies ku lëndët djegëse të përdorura nuk marrin pjesë në/ose nuk vijnë nga reaksione kimike për prodhimin e kimikateve organike në masë duke përdorur metodologjinë

standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 1 të kësaj shtojce. Në të gjitha rastet e tjera, operatori i instalimit mund të zgjedhë të monitorojë shkarkimet nga prodhimi i kimikateve organike në masë duke përdorur metodologjinë e bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje ose metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje. Kur përdor metodologjinë standarde, operatori i instalimit duhet t'i japë AKM-s prova që metodologjia e zgjedhur mbulon të gjitha shkarkimet përkatëse që do të mbuloheshin edhe nga metodologjia e bilancit të masës.

Për përcaktimin e përmbajtjes së karbonit sipas shkallës metodologjike 1, zbatohen faktorët e shkarkimit referues të renditur në tabelën 5 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje. Për substancat që nuk janë të renditura në tabelën 5 të shtojcës VI të kësaj rregulloreje ose në dispozita të tjera të kësaj rregulloreje, operatori i instalimit llogarit përmbajtjen e karbonit nga përmbajtja stekiometrike e karbonit në substancën e pastër dhe nga përqendrimi i substancës në rrymën hyrëse ose dalëse.

19. PRODHIMI I HIDROGJENIT DHE GAZIT TË SINTETIZUAR, SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, PJESA A, TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", TË NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Operatori i instalimit përfshin të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2: lëndët djegëse të përdorura në procesin e prodhimit të hidrogjenit ose gazit të sintetizuar (reformim ose oksidim të pjesshëm), dhe lëndët djegëse të përdorura për proceset e tjera të djegies, duke përfshirë përdorimin për qëllim të prodhimit të ujit të ngrohtë ose avullit. Gazi i sintezës i prodhuar konsiderohet si rrymë shkarkimi në metodologjinë e bilancit të masës.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Për monitorimin e shkarkimeve nga proceset e djegies dhe nga lëndët djegëse të përdorura si lëndë hyrëse në procesin e prodhimit të hidrogjenit, përdoret metodologjia standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje dhe seksionin 1 të kësaj shtojce.

Për monitorimin e shkarkimeve nga prodhimi i gazit të sintetizuar, përdoret një bilanc mase në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje. Për shkarkimet nga proceset veçanta të djegies, operatori i instalimit mund të zgjedhë t'i përfshijë ato në bilancin e masës ose të përdorë metodologjinë standarde në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje të paktën për një pjesë të rrymave të shkarkimit, duke shmangur çdo mangësi në llogaritje ose llogaritje të dyfishtë të shkarkimeve.

Kur në të njëjtin instalim prodhohen hidrogjeni dhe gazi i sintezës, operatori i instalimit llogarit shkarkimet e CO_2 duke përdorur ose metodologji të ndara për hidrogjenin dhe gazin e sintezës, siç përshkruhet në dy paragrafët e parë më sipër të këtij nënseksioni, ose duke përdorur një bilanc mase të përbashkët.

20. PRODHIMI I SODËS DHE BIKARBONATIT TË NATRIUMIT SIÇ PËRMENDET NË SHTOJCËN II, SHTOJCËN A TË LIGJIT NR. 155/2020, "PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE", I NDRYSHUAR

A. Fusha e zbatimit

Burimet e shkarkimeve dhe rrymat e shkarkimeve për shkarkimet e CO_2 nga instalimet për prodhimin e sodës dhe bikarbonatit të natriumit përfshijnë:

a) lëndët djegëse të përdorura për proceset e djegies, duke përfshirë lëndët djegëse të përdorura për qëllimin e prodhimit të ujit të ngrohtë ose avullit;

b) lëndët e para, duke përfshirë gazin e çliruar nga kalcinimi i gurit gëlqeror;

c) gazet e shkarkuara nga proceset e larjes ose filtrimit pas karbonizimit.

B. Rregulla të veçanta për monitorimin

Shkarkimet nga proceset e djegies, duke përfshirë pastrimin e gazrave të çliruara nga djegia monitorohen në përputhje me seksionin 1 të kësaj shtojce. Shkarkimet e procesit nga përbërësit e lëndës së parë dhe aditivët do të monitorohen në përputhje me seksionin 4 të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

CO_2 ndërmjetës për prodhimin e karbonatit të natriumit konsiderohet si i shkarkuar nga instalimi që prodhon CO_2 , me përjashtim të rastit kur CO_2 është i lidhur në një produkt që plotëson kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 51 të kësaj rregulloreje.

21. PËRCAKTIMI I SHKARKIMEVE TË GAZEVE SERRË NGA AKTIVITETET E KAPJES SË CO_2 PËR QËLLIME TË TRANSPORTIT DHE DEPOZITIMIT

GJEOGJEOLOGJIK NË NJË VEND DEPOZITIMI TË LEJUAR

A. Fusha e zbatimit

Kapja e CO_2 kryhet ose nga një instalim i posaçëm tek i cili transferohet CO_2 nga një ose më shumë instalime të tjera, ose nga i njëjti instalim ku kryhen aktivitetet që prodhojnë CO_2-në që kapet, ku këto aktivitete mbulohen nga i njëjti autorizim për shkarkimet GES. Të gjitha pjesët e instalimit që lidhen me kapjen dhe transferimin e CO_2 në një infrastrukturë transporti të CO_2 ose në një vend për magazinimin gjeologjik të shkarkimeve të gazeve serrë CO_2, duke përfshirë çdo objekt, strukturë ndihmëse të lidhur funksionalisht me të, si ruajtja e përkohshme e CO_2, përforcuesit, lëngëzimi, gazifikimi, stacionet e pastrimit ose ngrohësit, duhet të përfshihen në autorizimin për shkarkimet GES dhe të llogariten në planin përkatës të monitorimit. Në rastin kur subjekti kryen edhe aktivitete të tjera të mbuluara nga shtojca II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", i ndryshuar, shkarkimet e këtyre aktiviteteve duhet të monitorohen në përputhje me seksionet e tjera përkatëse të kësaj shtojce.

Operatori i një aktiviteti kapjeje të CO_2 përfshin të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2:

a) CO_2 e transferuar në instalimin e kapjes;

b) djegia dhe aktivitete të tjera të lidhura që kryhen brenda instalimit që kanë të bëjnë me aktivitetin e kapjes, përfshirë përdorimin e lëndëve djegëse dhe materialeve hyrëse.

B. Përcaktimi i sasisë së CO_2 të transferuar dhe të shkarkuar

B.1. Përcaktimi i sasisë në nivel instalimi

Çdo operator instalimi llogarit shkarkimet duke marrë parasysh shkarkimet e mundshme të CO_2 nga të gjitha proceset që krijojnë shkarkime brenda instalimit, si dhe sasinë e CO_2 të kapur dhe të transferuar në infrastrukturën e CO_2, duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$E_{instalimi\ kapës} = T_{hyrëse} + E_{pa\ kapje} - T_{për\ depozitim}$$

ku:

$E_{instalimi\ kapës}$ = *Shkarkimet totale të gazeve serrë të instalimit të kapjes;*

$T_{hyrëse}$ = Sasia e CO_2 e transferuar në instalimin e kapjes, e përcaktuar ose në bazë të një ose më shumë rrymave të shkarkimit siç bëhet në një metodologji të bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje ose bazuar në një metodologji të bazuar në matje në përputhje me nenet 41 deri në 47 dhe nenin 50 të kësaj rregulloreje;

$E_{pa\ kapje}$ = Shkarkimet e instalimit duke supozuar se CO_2 nuk është kapur, pra që do të thotë shuma e shkarkimeve nga të gjitha aktivitetet e tjera në instalim, të monitoruara në përputhje me seksionet përkatëse të shtojcës IV të kësaj rregulloreje, duke përfshirë metodën B në seksionin 22 të shtojcës IV të kësaj rregulloreje për çdo objekt, strukturë ndihmëse, të lidhur funksionalisht*;*

$T_{për\ depozitim}$ = Sasia e CO_2 e transferuar në një infrastrukturë transporti CO_2 ose një vend ruajtjeje, e përcaktuar ose në bazë të një ose më shumë rrymave të shkarkimit siç bëhet në një metodologji të bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje ose bazuar në një metodologji të bazuar në matje në përputhje me nenet 41 deri në 47 dhe nenin 50 të kësaj rregulloreje.

Në rastet kur kapja e CO_2 kryhet nga i njëjti instalim nga i cili buron CO_2 i kapur, operatori i instalimit përdor vlerën zero për $T_{hyrëse}$.

Në rastet e instalimeve të pavarura për kapjen e CO_2, operatorët e këtyre instalimeve marrin parasysh elementet e mëposhtme:

a) operatori i instalimit konsideron se $E_{pa\ kapje}$ përfaqëson sasinë e shkarkimeve të krijuara nga burime të ndryshme nga CO_2 e transferuar në instalim për kapje. Operatori i instalimit përcakton ato shkarkime në përputhje me këtë rregullore;

b) në përjashtim nga parashikimet e metodologjisë së monitorimit të përshkruar në këtë seksion, operatori i instalimit mund të monitorojë shkarkimet e instalimit duke përdorur metodën B siç përshkruhet në seksionin 22 të shtojcës IV të kësaj rregulloreje.

Në rastin e instalimeve të posaçme për kapjen e CO_2, operatori i instalimit që transferon CO_2 në instalimin e kapjes do të zbresë sasinë $T_{hyrëse}$ nga shkarkimet e instalimit të tij, duke u bazuar ose në një ose më shumë rryma shkarkimi, sipas metodologjisë së bilancit të masës, në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje ose në një metodologji të bazuar në matje, në përputhje me nenin 50 të kësaj rregulloreje.

B.2. Përcaktimi i CO_2 të transferuar

Çdo operator i instalimit përcakton sasinë e CO_2 që transferohet nga dhe drejt impiantit të kapjes, duke u bazuar ose në një ose më shumë rryma shkarkimi, sipas metodologjisë së bilancit të masës, në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, ose në një metodologji të bazuar në matje, në përputhje me nenet 41 deri në 47 dhe nenin 50 të kësaj rregulloreje.

22. PËRCAKTIMI I SHKARKIMEVE TË GAZEVE SERË NGA TRANSPORTI I CO_2 PËR RUAJTJEN GJEOLOGJIKE NË VENDDEPOZITIME TË LEJUARA

A. Fusha e zbatimit

Kufijtë për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve nga transporti i CO_2 përcaktohen në autorizimin për shkarkimet GES të infrastrukturës së transportit të CO_2, duke përfshirë të gjitha strukturat ndihmëse të lidhura funksionalisht me infrastrukturën e transportit, siç janë magazinimi i përkohshëm i CO_2, përforcuesit, lëngëzimi, gazifikimi, stacionet e pastrimit ose ngrohësit. Çdo infrastrukturë transporti duhet të ketë të paktën një pikë nisjeje dhe një pikë përfundimi, secila e lidhur me instalime të tjera ose me infrastrukturën e transportit të CO_2 që kryen një ose më shumë nga aktivitetet për kapjen, transportin ose depozitimin gjeologjik të CO_2. Pikat e nisjes dhe përfundimit mund të vendosen në degëzimet e infrastrukturës së transportit dhe në kufijtë ndërkombëtarë. Pikat e nisjes dhe përfundimit, si dhe instalimet ose infrastruktura e transportit të CO_2 me të cilat lidhen, përcaktohen në autorizimin për shkarkimet GES.

Çdo operator i një infrastrukture transporti të CO_2 duhet të marrë në konsideratë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve CO_2 : djegien dhe proceset e tjera në instalimet e lidhura funksionalisht me infrastrukturën e transportit duke përfshirë stacionet përforcuese dhe stacionet e lëngëzimit; njësitë e djegies, duke përfshirë njësitë e djegies së brendshme në automjetet e transportit të CO_2, në masën që shkarkimet nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve për karbonin, sipas legjislacionit në fuqi ose sipas rastit, nuk i nënshtrohen detyrimeve të raportimit të shkarkimeve kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi, në lidhje me aktivitetet e renditura në shtojcën II, pjesët të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", i ndryshuar; Shkarkimet e pakapshme nga infrastruktura e transportit; shkarkimet e kontrolluara nga infrastruktura e transportit; dhe shkarkimet nga incidentet e rrjedhjeve në infrastrukturën e transportit.

CO_2 i transportuar për qëllime të ndryshme nga magazinimi gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar nuk do të jetë pjesë e kufijve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve nga infrastruktura e transportit CO_2. Në rastet kur e njëjta infrastrukturë përdoret për transportin e CO_2 për qëllime të shumta, duke përfshirë depozitimin gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar, në mënyrë të tillë që e bën të pamundur dallimin e dërgesave të ndryshme, operatori i infrastrukturës së transportit të CO_2 duhet ta nënvijëzojë këtë në autorizimin e shkarkimeve GES dhe të vendosë një metodë për regjistrimin dhe dokumentimin e vëllimeve të CO_2 të transportuar për qëllime të tjera përveç depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar. Operatori i një infrastrukture transporti CO_2 monitoron të gjitha shkarkimet që rezultojnë nga vëllimi total i CO_2 të transportuar, por raporton si të shkarkuara vetëm shtojcën e shkarkimeve që korrespondon me vëllimin e CO_2 të transportuar për depozitimin gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar, në përpjesëtim me raportin midis këtij vëllimi dhe vëllimit total të CO_2 të transportuar.

B. Metodologjitë e përcaktimit të sasisë së CO_2-së

Operatori i infrastrukturës së transportit të CO_2 përcakton shkarkimet duke përdorur një nga metodat e mëposhtme:

a) Metodën A (bilanci i përgjithshëm i masës së të gjitha rrymave hyrëse dhe dalëse) e përcaktuar në nënseksionin B.1 më poshtë;

b) Metodën B (monitorimi individual i burimeve të shkarkimit) i përcaktuar në nënseksionin B.2 më poshtë.

Operatori i instalimit zbaton metodën B përveç rastit kur operatori mund t'i provojë AKM-së se aplikimi i metodës A çon në rezultate më të besueshme dhe pasiguri më të ulët të shkarkimeve të përgjithshme, duke përdorur teknologjinë dhe njohuritë më të mira të disponueshme në kohën e kryerjes së aplikimit për lëshimin e autorizimit të shkarkimeve GES dhe miratimit të planit të monitorimit, pa shkaktuar kosto të paarsyeshme. Në rastet e zbatimit të metodës B, çdo operator duhet t'i japë AKM-së prova të mjaftueshme se pasiguria e

përgjithshme për nivelin vjetor të shkarkimeve të gazeve serrë për infrastrukturën e transportit të operatorit nuk i kalon 7,5 %.

Kur operatori i një infrastrukture transporti të CO_2 përdor metodën B, nuk shton në nivelin e tij të llogaritur të shkarkimeve CO_2 që ka marrë nga një instalim tjetër ose nga një infrastrukturë e lejuar për transportin e CO_2 dhe nuk zbret nga niveli i tij i llogaritur i shkarkimeve asnjë sasi CO_2 të transferuar në një instalim tjetër ose infrastrukturë të lejuar për transportin e CO_2.

Çdo operator i një infrastrukture transporti të CO_2 përdor metodën A për vërtetimin e rezultateve të metodës B të paktën një herë në vit. Për kryerjen e këtij vërtetimi, operatori mund të përdorë shkallë më të ulëta metodologjike për zbatimin e metodës A.

B.1. Metoda A

Çdo operator përcakton shkarkimet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$Shkarkimet\ [t\ CO_2] = E_{infrastrukturë\ transporti} + \sum i\ T_{hyrëse\ ,i} - \sum i\ T_{dalëse,\ i} - \Delta E_{në\ tranzit}$$

Ku:

Shkarkimet = shkarkimet totale të CO_2 të infrastrukturës së transportit [t CO_2];

$E_{infrastrukturë\ transporti}$ = Sasia e CO_2 [t CO_2] që krijohet nga vetë aktiviteti i infrastrukturës së transportit, që do të thotë jo shkarkime që rrjedhin nga CO_2 i transportuar, por shkarkime nga djegia ose procese të tjera të lidhura funksionalisht me infrastrukturën e transportit, të monitoruara në përputhje me seksionet përkatëse të shtojcës IV të kësaj rregulloreje;

$T_{hyrëse\ ,i}$ = Sasia e CO_2 e transferuar në infrastrukturën e transportit në pikën hyrëse i, e përcaktuar ose duke u bazuar në një ose më shumë rryma shkarkimi sipas metodologjisë së bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, ose bazuar në një metodologji të bazuar në matje në përputhje me nenet 41 deri në 47 dhe nenin 50 të kësaj rregulloreje.

$T_{dalëse,\ i}$ = Sasia e CO_2 e transferuar nga infrastruktura e transportit në pikën e daljes i, e përcaktuar ose duke u bazuar në një ose më shumë rryma shkarkimi sipas metodologjisë së bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, ose bazuar në një metodologji të bazuar në matje në përputhje me nenet 41 deri në 47 dhe nenin 50 të kësaj rregulloreje.

$\Delta E_{\ në\ tranzit}$ = Sasia e CO_2 e transferuar në infrastrukturën e transportit në pikën hyrëse i, që nuk transferohet në një instalim tjetër ose në një infrastrukturë transporti të CO_2 në të njëjtën periudhë raportuese, por në çdo rast brenda afatit të përcaktuar në pikën 8, të nenit 50 të kësaj rregulloreje në vitin pas periudhës raportuese. Shumat korresponduese nuk do të merren parasysh për $T_{dalëse,\ i}$ për periudhën e ardhshme të raportimit.

B.2. Metoda B

Çdo operator instalimi përcakton shkarkimet duke marrë parasysh të gjitha proceset që lidhen me shkarkimet në instalim, si dhe sasinë e CO_2 të kapur dhe të transferuar në infrastrukturën e transportit duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$Shkarkimet\ [t\ CO_2] = E_{të\ pakapshme} + E_{të\ kontrolluara} + E_{nga\ rrjedhjet} + E_{infrastrukturë\ transporti}$$

Ku:

Shkarkimet = Shkarkimet totale të CO_2 të infrastrukturës së transportit [t CO_2];

$E_{të\ pakapshme}$= Sasia e shkarkimeve të pakapshme [t CO_2] nga CO_2 i transportuar në infrastrukturën e transportit, duke përfshirë nga vulat, valvulat, stacionet e përkohshme të kompresimit dhe objektet e magazinimit të përkohshëm;

$E_{\ të\ kontrolluara}$ = Sasia e shkarkimeve të kontrolluara [t CO_2] nga CO_2 i transportuar në infrastrukturën e transportit;

$E_{\ nga\ rrjedhjet}$ = Sasia e CO_2 [t CO_2] e transportuar në infrastrukturën e transportit, e cila shkarkohet si rezultat i prishjes të një ose më shumë komponentëve të infrastrukturës së transportit;

$E_{\ infrastrukturë\ transporti}$ = Sasia e CO_2 [t CO_2] nga veprimtaria e vetë infrastrukturës së transportit, që do të thotë jo shkarkimet që rrjedhin nga CO_2 i transportuar, por që shkarkohen nga djegia ose proceset e tjera të lidhura funksionalisht me infrastrukturën e transportit, të monitoruara në përputhje me seksionet përkatëse të shtojcën IV të kësaj rregulloreje.

B.2.1. Shkarkimet e pakapshme nga infrastruktura e transportit

Operatori i një infrastrukture transporti CO_2 merr në konsideratë shkarkimet e pakapshme nga të paktën ndonjë nga llojet e mëposhtme të pajisjeve:

a) vulat;

b) pajisjet matëse;

c) valvulat;

ç) stacionet e përkohshme të kompresimit;

d) strukturat e magazinimit të përkohshëm, duke përfshirë ato të montuara në mjete transporti CO_2 .

Operatori përcakton normat mesatare të shkarkimeve ER (të shprehura në g CO_2/njësi kohe) për çdo pajisje, për çdo rast ku mund të parashikohen shkarkime të pakapshme, në fillim të operimit dhe deri në fund të vitit të parë të raportimit në të cilin infrastruktura e transportit është në funksion. Operatori duhet të rishikojë këto norma të paktën çdo 5 vjet, duke marrë parasysh teknikat dhe njohuritë më të mira të disponueshme.

Operatori llogarit shkarkimet e pakapshme duke shumëzuar numrin e pjesëve të pajisjeve në secilën kategori me normën e shkarkimit dhe duke mbledhur rezultatet për secilën kategori siç tregohet në ekuacionin e mëposhtëm:

$$Shkarkimet\ e\ pakashpme\ [t\ CO_2] = (\Sigma_{Kategoria}\ ER[g\ CO_2/ngjarje] \times N_{ngjarje}) / 10^6$$

Numri i ngjarjeve ($N_{ngjarje}$) është numri i pjesëve të pajisjeve të dhëna për kategori, shumëzuar me numrin e njësive kohore në vit.

B.2.2. Shkarkimet nga ngjarjet e rrjedhjeve

Operatori i një infrastrukture transporti të CO_2 duhet të sigurojë dëshmi të integritetit të sistemit duke përdorur të dhëna përfaqësuese (të lidhura me kohën dhe hapësirën) të parametrit të temperaturës dhe të presionit. Në rastet kur të dhënat tregojnë se ka ndodhur një rrjedhje, operatori do të llogarisë sasinë e CO_2 të rrjedhur me një metodologji të përshtatshme të dokumentuar në planin e monitorimit, bazuar në udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë, duke përfshirë përdorimin e ndryshimeve në të dhënat e temperaturës dhe presionit në krahasim me vlerat mesatare të presionit dhe temperaturës të lidhura me integritetin.

B.2.3. Shkarkimet e kontrolluara

Çdo operator i një infrastrukture transporti të CO_2 duhet të sigurojë në planin e monitorimit një analizë në lidhje me situatat e mundshme të shkarkimeve të kontrolluara, duke përfshirë ato që ndodhin për arsye mirëmbajtjeje ose emergjence, dhe të sigurojë një metodologji të përshtatshme të dokumentuar për llogaritjen e sasisë së CO_2 të çliruar në mënyrë të kontrolluar, bazuar në udhëzimet e praktikave më të mira të industrisë.

23. DEPOZITIMI GJEOLOGJIK I CO_2 NË NJË VENDDEPOZITIM TË LEJUAR

AKM-ja përcakton kufijtë për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve që krijohen nga depozitimi gjeologjik i CO_2 mbi bazën e vendit të depozitimit dhe kompleksit të magazinimit siç specifikohet në lejen/autorizimin përkatës në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për fushën e mjedisit, si dhe mbi bazën e të gjitha objekteve ndihmëse të lidhura funksionalisht me kompleksin e depozitimit, siç janë depozitimi i përkohshëm i CO_2, përforcuesit, lëngëzimi, gazifikimi, stacionet e pastrimit ose ngrohësit. Kur identifikohen rrjedhje nga kompleksi i depozitimit dhe çojnë në shkarkime ose çlirim të CO_2 në kolonën e ujit, operatori duhet të kryejë menjëherë veprimet e mëposhtme:

a) të njoftojë AKM-në;

b) të konsiderojë rrjedhjen si rrymë shkarkimi ose burim shkarkimi për instalimin përkatës;

c) të monitorojë dhe të raportojë shkarkimet.

Vetëm kur janë marrë masat korrigjuese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për fushën e mjedisit dhe kur nuk konstatohen më shkarkimet ose çlirimi në kolonën e ujit nga ajo rrjedhje, operatori fshin nga plani i monitorimit rrjedhjen përkatëse të përcaktuar si burim shkarkimi dhe nuk monitoron apo raporton më ato shkarkime.

Çdo operator i një aktiviteti të depozitimit gjeologjik duhet të konsiderojë të paktën burimet e mëposhtme të mundshme të shkarkimeve të CO_2, në tërësi: konsumin e lëndës djegëse nga stacionet ndihmëse të pompimit dhe nga veprimtari të tjera me djegie, përfshirë termocentralet e ndodhura në vendin e instalimit; shkarkimi i kontrolluar nga operacionet e injektimit ose rikuperimit të avancuar të hidrokarbureve; shkarkimet e pakapshme nga injektimi; CO_2-në që del në sipërfaqe nga proceset e rikuperimit të avancuar të hidrokarbureve; si dhe rrjedhjet.

B. Përcaktimi i sasisë së shkarkimeve të CO_2

Operatori i aktivitetit të depozitimit gjeologjik nuk shton në nivelin e shkarkimeve të llogaritura për aktivitetin e tij CO_2-në që ka marrë nga një instalim tjetër dhe nuk zbret nga niveli i shkarkimeve i llogaritur për aktivitetin e tij asnjë sasi CO_2 që ruhet gjeologjikisht në vendin e depozitimit ose që

transferohet në një instalim tjetër. Operatori monitoron shkarkimet nga çdo strukturë ndihmëse e lidhur funksionalisht me kompleksin e depozitimit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në seksionin 22 të shtojcës IV të kësaj rregulloreje.

B.1. Shkarkimet e kontrolluara dhe shkarkimet pakapshme nga injektimi

Operatori përcakton shkarkimet e kontrolluara dhe shkarkimet e pakapshme, si më poshtë:

$$CO_2 \text{ e Shkarkuar } [t\ CO_2\ ] = V\ CO\ [t\ CO_2] + F\ CO_2\ [t\ CO_2]$$

Ku:

V CO_2 = sasia e CO_2 nga shkarkimet e kontrolluara;

F CO_2 = sasia e CO_2 nga shkarkimet e pakapshme

Çdo operator duhet të përcaktojë V CO_2 ose si një ose më shumë rryma shkarkimi sipas metodologjisë të bilancit të masës në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, ose duke përdorur një metodologji të bazuar në matje në përputhje me nenet 42 deri në 47 të kësaj rregulloreje. Në përjashtim nga parashikimet e fjalisë së parë të këtij paragrafi dhe pas miratimit nga AKM-ja, operatori mund të përfshijë në planin e monitorimit një metodologji të përshtatshme për përcaktimin e V CO_2, bazuar në praktikën më të mirë të industrisë, në rastet kur zbatimi i metodologjive të monitorimit të përmendura në fjalinë e parë të këtij paragrafi do të shkaktonte kosto të paarsyeshme ose kur operatori mund të provojë se metodologjia e bazuar në praktikën më të mirë të industrisë lejon përcaktimin e sasive me të paktën të njëjtën saktësi si metodologjitë e bazuara në matje.

Operatori duhet të konsiderojë F CO_2 si një burim të vetëm, që do të thotë se kriteret e pasigurisë të lidhura me shkallët metodologjike të përcaktuara sipas seksionit 1 të shtojcës VIII zbatohen për vlerën në total dhe jo për pikat individuale të shkarkimit. Çdo operator duhet të përfshijë në planin e monitorimit një analizë në lidhje me burimet e mundshme të shkarkimeve të pakapshme dhe të sigurojë një metodologji të dokumentuar të përshtatshme për të llogaritur ose matur sasinë e F CO_2, bazuar në udhëzimet më të mira të praktikës së industrisë. Për përcaktimin e F CO_2, operatori mund të përdorë për impiantin e injektimit të dhënat e mbledhura në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar për depozitimin gjeologjik të CO2, kur janë në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje.

B.2. Shkarkimet e kontrolluara dhe shkarkimet e pakapshme nga operacionet e avancuara të rikuperimit të hidrokarbureve

Çdo operator konsideron të paktën burimet e mëposhtme të mundshme shtesë të shkarkimeve nga rikuperimi i avancuar i hidrokarbureve (EHR):

a) njësitë për ndarjen naftë-gaz dhe impianti i riciklimit të gazit, ku mund të ndodhin shkarkime të pakapshme të CO_2;

b) oxhaku i djegies së gazrave, ku mund të ndodhin shkarkime për shkak të përdorimit të sistemeve të vazhdueshme të pastrimit me presion pozitiv dhe gjatë çpresimit të instalimit të prodhimit të hidrokarbureve;

c) sistemi i pastrimit të CO_2 për të shmangur përqendrimet e larta të CO_2 që do të shuanin flakën.

Çdo operator llogarit shkarkimet e pakapshme ose CO_2-në e shkarkuar në mënyrë të kontrolluar në përputhje me nënseksionin B.1 të këtij seksioni të shtojcës IV.

Çdo operator llogarit shkarkimet nga oxhaku i djegies së gazrave në përputhje me nënseksionin D të seksionit 1 të kësaj shtojce, duke marrë parasysh CO_2-në e brendshëm të mundshëm në gazin e djegies në përputhje me nenin 49 të kësaj rregulloreje.

B.3. Rrjedha nga kompleksi i depozitimit

Shkarkimet dhe çlirimi në kolonën e ujit llogariten si më poshtë:

$$CO_2 \text{ shkarkuar } [t\ CO_2] = \sum_{T_{fillim}}^{T_{Fund}} L\ CO_2\ [t\ CO_2/d]$$

Ku:

L CO_2 = masa e CO_2 e shkarkuar ose çliruar për ditë kalendarike për shkak të rrjedhjes, në përputhje me të gjitha elementet vijuese:

a) për çdo ditë kalendarike gjatë të cilës monitorohet rrjedhja, çdo operator duhet të llogarisë LCO_2 si mesataren e masës së rrjedhur në orë [t CO_2/orë] të shumëzuar me 24;

b) çdo operator përcakton masën e rrjedhur për orë në përputhje me parashikimet në planin e

miratuar të monitorimit për vendin e depozitimit dhe rrjedhjen;

c) për të shmangur nënvlerësim gjatë llogaritjes së shkarkimeve, për çdo ditë kalendarike përpara fillimit të monitorimit, operatori konsideron masën e rrjedhur për çdo ditë të barabartë me masën e rrjedhur ditën e parë të monitorimit për t'u siguruar që nuk ndodh një nënvlerësim i shkarkimeve;

T_{fillim} = data më e fundit nga datat e mëposhtme:

a) data e fundit kur nuk janë raportuar shkarkime ose çlirime të CO_2 në kolonën e ujit nga burimi i marrë në konsideratë;

b) data kur ka filluar injektimi i CO_2-së;

c) një datë tjetër, për të cilën ekzistojnë prova që vërtetojnë, në mënyrë të pranueshme për AKM-në se shkarkimi ose çlirimi në kolonën e ujit nuk mund të ketë filluar përpara asaj date.

T_{fund} = data në të cilën janë marrë masa korrigjuese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kur nuk konstatohen më shkarkime ose çlirim të CO2 në kolonën e ujit.

AKM-ja miraton dhe lejon përdorimin e metodave të tjera për përcaktimin e sasisë së shkarkimeve ose çlirimin e CO_2 në kolonën e ujit nga rrjedhjet, kur operatori mund t'i vërtetojë AKM-së se këto metoda sjellin një saktësi më të lartë sesa metodologjia e parashikuar në këtë nënseksion.

Operatori përcakton sasinë e shkarkimeve të rrjedhura nga kompleksi i depozitimit për çdo ngjarje rrjedhjeje me një pasiguri maksimale të përgjithshme përgjatë gjithë periudhës raportuese prej 7,5 %. Kur pasiguria e përgjithshme e metodologjisë së përdorur për përcaktimin e sasisë së shkarkimeve tejkalon 7,5 %, çdo operator duhet të zbatojë një korrigjim sipas përcaktimit të mëposhtëm:

$$CO_{2,\ Raportuar}\ [t\ CO_2] = CO_{2,\ Kuantifikuar}\ [t\ CO_2] \times (1 + (Sistemi\ i\ Pasigurisë\ [\%]/100) - 0{,}075)$$

Ku:

CO_2, Raportuar = sasia e CO_2 që do të përfshihet në raportin vjetor të shkarkimeve lidhur me rastin e rrjedhjes në fjalë;

CO_2, Kuantifikuar = sasia e CO_2 e përcaktuar përmes metodologjisë së përdorur për përcaktimin e sasisë për rastin e rrjedhjes në fjalë;

Sistemi i pasigurisë = niveli i pasigurisë i lidhur me metodologjinë e kuantifikimit të përdorur për rastin e rrjedhjes në fjalë.

SHTOJCA V

Kërkesat minimale të shkallës metodologjike për metodologjitë e bazuara në llogaritje që përfshijnë instalimet e kategorisë A, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 19, të rregullores, dhe subjektet e kategorisë A që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 98, të rregullores dhe faktorët e llogaritjes për lëndët djegëse standarde komerciale të përdorura nga instalimet e kategorive B dhe , referuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2, të nenit 19, të rregullores dhe subjektet e kategorisë B që parashikohen në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 98, të rregullores

Tabela 1. *Shkallët metodologjike minimale që zbatohen për metodologjitë e bazuara në llogaritje në rastin e instalimeve të kategorisë A dhe në rastin e faktorëve të llogaritjes për lëndët djegëse standarde komerciale për të gjitha instalimet, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 26, të rregullores*

Aktiviteti/Lloji i rrymës së shkarkimit	Të dhënat e aktivitetit		Faktori i shkarkimit (*)	Të dhënat e përbërjes (përmbajtja e karbonit)(*)	Faktori i oksidimit	Faktori i konvertimit
	Sasia e lëndës djegëse ose materialit	Vlera kalorifike neto				
Djegia e lëndëve djegëse						
Lëndët djegëse standarde komerciale	2	2a/2b	2a/2b	n.a.	1	n.a.
Lëndët djegëse të tjera të gazta dhe të lëngshme	2	2a/2b	2a/2b	n.a.	1	n.a.
Lëndët djegëse të ngurta, përjashtuar mbetjet	1	2a/2b	2a/2b	n.a.	1	n.a.
Mbetjet	1	2a/2b	2a/2b	n.a.	1	n.a.

Metodologjia e bilancit të masës për terminalet e përpunimit të gazit	1	n.a.	n.a.	1	n.a.	n.a.
Flakërues	1	n.a.	1	n.a.	1	n.a.
Pastrim (karbonat)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Pastrim (gips)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Pastrim (ure)	1	1	1	n.a.	1	n.a.
Rafinimi i naftës						
Rigjenerimi i krakerit katalitik	1	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi i koksit						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Lënda djegëse si lëndë hyrëse në proces	1	2	2	n.a.	n.a.	n.a.
Pjekja dhe sinterizimi i xeheve të metaleve						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Karbonat hyrës	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi i hekurit dhe çelikut						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Lënda djegëse si lëndë hyrse në proces	1	2a/2b	2	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi ose përpunimi i metaleve ferrore dhe joferrore, përfshirë aluminin sekondar						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Shkarkimet e procesit	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi primar i aluminit ose i aluminës						
Bilanci i masës për shkarkimet e CO_2	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Shkarkimet e PFC (metoda e pjerrësisë)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Shkarkimet e PFC (metoda e mbitensionit)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi i klinkerit të çimentos						
Bazuar te hyrjet në furrë (Metoda A)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi i klinkerit (Metoda B)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
CKD	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Hyrja e karbonit jokarbonat	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi i gëlqeres dhe kalcinimi i dolomitit dhe magnezitit						
Karbonatet (Metoda A)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Lëndë hyrëse të tjera të procesit	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Oksid alkal i tokës (Metoda B)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi i leshit të xhamit dhe gurit						
Karbonat hyrës	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Lëndë të tjera hyrëse të procesit	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Prodhimi i produkteve qeramike						
Input-et e karbonit (Metoda A)	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Lëndë të tjera hyrëse të procesit	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1

Okside alkaline	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	1
Pastrim	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi i gipsit dhe kartonit të gipsit: shih djegien e lëndëve djegëse						
Prodhimi i celulozës dhe letrës						
Kimikatet ndihmëse	1	n.a.	1	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi i karbonit të zi						
Metodologjia e bilancit të masës	1	n.a.	n.a.	1	n.a.	n.a.
Prodhimi i amoniakut						
Lënda djegëse si lëndë hyrëse në proces	2	2a/2b	2a/2b	n.a.	n.a.	n.a.
Prodhimi në masë i kimikateve organike						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Prodhimi i hidrogjenit dhe gazit të sintetizuar						
Lënda djegëse si lëndë hyrëse në proces	2	2a/2b	2a/2b	n.a.	n.a.	n.a.
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Prodhimi i hirit të sodës dhe bikarbonatit të natriumit						
Bilanci i masës	1	n.a.	n.a.	2	n.a.	n.a.
Kapja, transferimi dhe magazinimi gjeologjik i CO_2 në vendin e depozitimit të lejuar						
Bilanci i masës i CO_2 të transferuar	2	na	na	2	na	na
CO_2, shkarkim i kontrolluar nga rrjedhjet dhe shkarkimet e pakapshme	2	na	na	2	na	jo

("n.a." do të thotë "i pazbatueshëm")

(*) Shkallët metodologjike të faktorit të shkarkimit lidhen me faktorin paraprak të shkarkimit dhe përmbajtja e karbonit lidhet me përmbajtjen totale të karbonit. Për materialet e përziera, fraksioni i biomasës duhet të përcaktohet veçmas. Shkalla metodologjike 1 do të jetë shkalla metodologjike minimale që do të zbatohet për fraksionin e biomasës në rastin e instalimeve të kategorisë A dhe për të gjitha instalimet në rastin e lëndëve djegëse standarde komerciale në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 26 të kësaj rregulloreje.

Tabela 2. *Shkallët metodologjike minimale që do të zbatohen për metodologjitë e bazuara në llogaritje në rastin e subjekteve të kategorisë A dhe në rastin e faktorëve të llogaritjes për lëndët djegëse standarde tregtare për subjektet e rregulluara, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 98, të rregullores*

Lloji i rrymës së lëndës djegëse	Sasia e lëndës djegëse të hedhur për konsum	Faktori i konvertimit të njësisë	Faktori i shkarkimit (*)
Lëndë djegëse komerciale standarde	2	2a/2b	2a/2b
Lëndë djegëse të tjera të gazta dhe të lëngëta	2	2a/2b	2a/2b
Lëndë djegëse të ngurta	1	2a/2b	2a/2b

(*) Shkallët metodologjike për faktorin e shkarkimit lidhen me faktorin paraprak të shkarkimit. Për materialet e përziera, fraksioni i biomasës përcaktohet veçmas. Shkalla metodologjike 1 është shkalla metodologjike minimale që duhet të zbatohet për fraksionin e biomasës në rastin e subjekteve të kategorisë A dhe në rastin e lëndëve djegëse standarde tregtare për të gjitha subjektet e rregulluara, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 98, të rregullores.

SHTOJCA VI
VLERAT E REFERENCËS PËR FAKTORËT E LLOGARITJES (NENI 31, PIKA 1, SHKRONJA "A", TË RREGULLORES)

1. FAKTORËT E SHKARKIMIT TË LËNDËS DJEGËSE LIDHUR ME VLERAT KALORIFIKE NETO (NCV)

Tabela 1. *Faktorët e shkarkimit të lëndës djegëse lidhur me vlerat kalorifike neto (NCV) dhe vlerat kalorifike neto për njësi mase të lëndës djegëse*

Përshkrimi i llojit të lëndës djegëse	**Faktori i shkarkimit (t CO_2/TJ)**	**Vlera kalorifike neto (TJ/Gg)**	**Burimi**
Nafta e papërpunuar	73,3	42,3	IPCC 2006 GL
Bituminë	77,0	27,5	IPCC 2006 GL
Lëngje të gazit natyror	64,2	44,2	IPCC 2006 GL
Gazoil motorrik	69,3	44,3	IPCC 2006 GL
Kerosene (të ndryshme nga keroseni i mjeteve ajrore)	71,9	43,8	IPCC 2006 GL
Nafta e papërpunuar e sintetizuar	73,3	38,1	IPCC 2006 GL
Naftë/gazoil	74,1	43,0	IPCC 2006 GL
Naftë e rëndë	77,4	40,4	IPCC 2006 GL
Gaze të lëngshme të naftës	63,1	47,3	IPCC 2006 GL
Etani	61,6	46,4	IPCC 2006 GL
Naftë	73,3	44,5	IPCC 2006 GL
Bitum	80,7	40,2	IPCC 2006 GL
Lubrifikantë	73,3	40,2	IPCC 2006 GL
Koks nafte	97,5	32,5	IPCC 2006 GL
Lëndët e parë të rafinerisë	73,3	43,0	IPCC 2006 GL
Gaz rafinerie	57,6	49,5	IPCC 2006 GL
Dyllë parafine	73,3	40,2	IPCC 2006 GL
Hollues i bardhë dhe solvent i bazuar në naftë (*SBP*)	73,3	40,2	IPCC 2006 GL
Produkte të tjera të naftës	73,3	40,2	IPCC 2006 GL
Antracite	98,3	26,7	IPCC 2006 GL
Qymyr koksi	94,6	28,2	IPCC 2006 GL
Qymyre bituminoze të tjera	94,6	25,8	IPCC 2006 GL
Qymyr nënbituminoz	96,1	18,9	IPCC 2006 GL
Linjitet	101,0	11,9	IPCC 2006 GL
Naftë shist argjilor dhe rëra bituminoze	107,0	8,9	IPCC 2006 GL
Lëndë djegëse e ngurtë e prodhuar artificialisht (*Patent fuel*)	97,5	20,7	IPCC 2006 GL
Koks në furrë koksi dhe koks linjiti	107,0	28,2	IPCC 2006 GL
Koks gazi	107,0	28,2	IPCC 2006 GL
Katrani i qymyrit	80,7	28,0	IPCC 2006 GL
Gaz i prodhuar	44,4	38,7	IPCC 2006 GL
Gaz nga furrat e koksit	44,4	38,7	IPCC 2006 GL
Gaz nga furrat e shkrirjes	260	2,47	IPCC 2006 GL
Gazi i furrës së çelikut me oksigjen	182	7,06	IPCC 2006 GL

Gazi natyror	56,1	48,0	IPCC 2006 GL
Mbetje industriale	143	n.a.	IPCC 2006 GL
Vajra të përdorura	73,3	40,2	IPCC 2006 GL
Torfe	106,0	9,76	IPCC 2006 GL
Dru/Mbetje drusore	—	15,6	IPCC 2006 GL
Biomasë tjetër e ngurtë parësore	—	11,6	IPCC 2006 GL (vetëm VKN)
Qymyrdruri	—	29,5	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Biogasolinë	—	27,0	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Bionaftë	—	27,0	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Biokarburantet e tjera të lëngshme	—	27,4	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Gazi i landfillit	—	50,4	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Gaz llum	—	50,4	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Biogaz tjetër	—	50,4	IPCC 2006 GL (vetëm NCV)
Mbetje gomash	85,0 (1)	n.a.	*World Business Council for Sustainable Development – Cement Sustainability Initiative (WBCSD CSI)*
Mbetjet bashkiake (fraksioni jobiomasë)	91,7	n.a.	IPCC 2006 GL
Monoksidi i karbonit	155,2 (2)	10,1	J. Falbe and M. Regitz, Römpp Chemie Lexikon, Stuttgart, 1995
Metan	54,9 (3)	50,0	J. Falbe and M. Regitz, Römpp Chemie Lexikon, Stuttgart, 1995

(1) Kjo vlerë është faktori paraprak i shkarkimit, pra përpara zbatimit të një fraksioni të biomasës, nëse është e aplikueshme.
(2) Bazuar në NCV 10,12 TJ/t
(3) Bazuar në NCV 50,01 TJ/t

2. FAKTORËT E SHKARKIMIT QË LIDHEN ME SHKARKIMET NGA PROCESET

Tabela 2. *Faktori stekiometrik i shkarkimit për shkarkimet e procesit nga dekompozimi i karbonatit (Metoda A)*

Karbonat	**Faktori shkarkimit [t CO_2/ t Karbonat]**
$CaCO_3$	0,440
$MgCO_3$	0,522
Na_2CO_3	0,415
$BaCO_3$	0,223
Li_2CO_3	0,596
K_2CO_3	0,318
$SrCO_3$	0,298
$NaHCO_3$	0,524
$FeCO_3$	0,380
E përgjithshme	Faktori i shkarkimit = $[M(CO_2)] / \{Y * [M(x)] + Z * [M(CO_3^{2-})]\}$ X = metal M(x) = pesha molekulare e X në [g/mol] $M(CO_2)$ = pesha molekulare e CO_2 në [g/mol] $M(CO_3^{2-})$ = pesha molekulare e CO_3^{2-} në [g/mol] Y = numri stekiometrik i X Z = numri stekiometrik i CO_3^{2-}

Tabela 3. *Faktori stekiometrik i shkarkimit për shkarkimet e procesit nga dekompozimi i karbonatit bazuar në oksidet alkale të tokës (metoda B)*

Oksidi	**Faktori i shkarkimit [t CO_2/ t *Oxide*]**
CaO	0,785
MgO	1,092
BaO	0,287
E përgjithshme: X_YO_Z	Faktori i shkarkimit = [M(CO_2)] / {Y * [M(x)] + Z * [M(O)]} X = metale alkaline tokësore, ose metal alkali M(x) = Pesha molekulare e X në [g/mol] M(CO_2) = Pesha molekulare e CO_2 [g/mol] M(O) = Pesha molekulare e O [g/mol] Y Numri stekiometrik i X = 1 (për metalet tokësore alkale) =2 (për metalet alkale) Numri stekiometrik i X = 1 (për metalet tokësore alkale) = 2 (për metalet alkale) Z = Numri stekiometrik i O = 1

Tabela 4. *Faktorët e shkarkimeve për shkarkimet e procesit nga materialet e tjera të procesit (prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe përpunimi i metaleve ferrozë) (1)*

Materiali hyrës ose dalës	**Përmbajtja e karbonit (t C/t)**	**Faktori i shkarkimit (t CO_2/t)**
Hekur i përftuar me reduktim të drejtpërdrejtë (DRI)	0,0191	0,07
Elektroda karboni për furra me hark elektrik (EAF)	0,8188	3,00
Karboni i ngarkimit të furrës me hark elektrik (EAF)	0,8297	3,04
Hekur me briketa të nxehta	0,0191	0,07
Gazi i furrës së çelikut me oksigjen	0,3493	1,28
Koks i naftës	0,8706	3,19
Hekur i papërpunuar	0,0409	0,15
Hekuri / skrap hekuri	0,0409	0,15
Skrap çeliku/çeliku	0,0109	0,04
(1) IPCC 2006 udhëzuesi për inventarët kombëtarë të gazit serrë		

Tabela 5. *Faktorët stekiometrikë të shkarkimit për shkarkimet e procesit nga materialet e tjera të procesit (kimikatet organike në masë) (1)*

Substanca	**Përmbajtja e karbonit (t C/t)**	**Faktori i shkarkimit (t CO_2 / t)**
Acetonitril	0,5852	2,144
Acrylonitrile	0,6664	2,442
Butadien	0,888	3,254
Karbon i zi	0,97	3,554
Etilen	0,856	3,136
Diklorur i etilenit	0,245	0,898
Etilen glikol	0,387	1,418
Oksid etileni	0,545	1,997
Cianid hidrogjeni	0,4444	1,628
Metanol	0,375	1,374
Metan	0,749	2,744
Propan	0,817	2,993

Propilen	0,8563	3,137
Monomeri i klorur vinilit	0,384	1,407
(1) IPCC 2006 udhëzues për inventarët kombëtarë të gazeve serrë		

3. POTENCIALI I NGROHJES GLOBALE TË GAZEVE ME EFEKT SERË QË NUK JANË CO_2

Tabela 6. *Potencialet e ngrohjes globale*

Gazi	Potenciali i ngrohjes globale
N_2O	265 t $CO_{2(e)}$/t N_2O
CF_4	6 630 t $CO_{2(e)}$/t CF_4
C_2F_6	11 100 t $CO_{2(e)}$/t C_2F_6

SHTOJCA VII
SHPESHTËSIA MINIMALE E ANALIZAVE (NENI 35 I RREGULLORES)

Lënda djegëse/materiali	Shpeshtësia minimale e analizave
Gazi natyror	Të paktën çdo javë
CO_2 i transferuar	Të paktën çdo javë
Gazra të çliruara nga djegia për qëllim të pikave 5, 6 e7, të nenit të kësaj rregulloreje	Çdo 50 000 ton të CO_2 total, por të paktën një herë në muaj
Gazet e tjera, në veçanti gazet e sintetizuara dhe ata të procesuara, si gaze të përziera në rafineri, gaze nga furrat e koksit, gaze nga furra e shpërthimit, gazi i konvertorit, si dhe gazi i fushave naftëmbajtëse dhe gazmbajtëse.	Të paktën çdo ditë – duke përdorur procedurat e duhura në kohë të ndryshme të ditës
Lëndë djegëse naftë (për shembull lëndë djegëse naftë e lehtë, mesatare dhe e rëndë, bituminë)	Çdo 20 000 ton lëndë djegëse dhe të paktën 6 herë në vit
Qymyr, qymyr koksi, koks, koks nafte, torfë	Çdo 20 000 ton lëndë djegëse/material dhe të paktën 6 herë në vit
Lëndë djegëse të tjera	Çdo 10 000 ton lëndë djegëse dhe të paktën 4 herë në vit
Mbetje të ngurta të patrajtuara (fosile të pastra ose biomasë/fosil i përzier)	Çdo 5 000 ton mbetje dhe të paktën 4 herë në vit
Mbetje e lëngshme, mbetje e ngurtë e paratrajtuar	Çdo 10 000 ton mbetje dhe të paktën 4 herë në vit
Mineralet karbonate (përfshirë gurin gëlqeror dhe dolomitet)	Çdo 50 000 ton material dhe të paktën 4 herë në vit
Argjila dhe shist argjilor	Sasi të materialit, që përkojnë me 50 000 ton të CO_2 dhe të paktën 4 herë në vit
Materialet e tjera (produkte fillestare, të ndërmjetme dhe përfundimtare)	Në varësi të llojit të materialit dhe varieteteve, sasi të materialit të cilat përkojnë me 50 000 ton të CO_2 dhe të paktën 4 herë në vit

SHTOJCA VIII
METODOLOGJITË E BAZUARA NË MATJE (NENI 42 I RREGULLORES)

1. PËRCAKTIMET E SHKALLËVE METODOLOGJIKE TË METODOLOGJIVE TË BAZUARA NË MATJE

Metodologjitë e bazuara në matje miratohen në përputhje me shkallët metodologjike duke zbatuar pasiguritë maksimale të lejuara të shkarkimeve mesatare vjetore në orë të mëposhtme, të llogaritura në përputhje me ekuacionin 2 të përcaktuar në seksionin 3 të kësaj shtojce.

Tabela 1. *Shkallët metodologjike të CEMS (sistemi i vazhdueshëm i monitorimit të shkarkimeve) (pasiguria maksimale e lejuar për çdo shkallë metodologjike)*

Në rastin e CO_2, pasiguria duhet të aplikohet mbi sasinë totale të CO_2 të matur. Kur përqindja e biomasës përcaktohet duke përdorur një metodologji të bazuar në matje, i njëjti nivel metodologjik (tier) si për CO_2 duhet të aplikohet edhe për përqindjen e biomasës.

	Shkalla metodologjike 1	**Shkalla metodologjike 2**	**Shkalla metodologjike 3**	**Shkalla metodologjike 4**
Burimet e shkarkimeve të CO_2	± 10 %	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %
Burimet e shkarkimeve të N_2O	± 10 %	± 7,5 %	± 5 %	N.A.
Transferimi i CO_2	± 10 %	± 7,5 %	± 5 %	± 2,5 %

2. KËRKESAT MINIMALE TË SHKALLËVE METODOLIGJIKE PËR INSTALIMET E KATEGORISË A

Tabela 2. *Shkallët medotologjike minimale që zbatohen në instalimet e kategorisë A për metodologjitë e bazuara në matje, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 42, të rregullores*

Gazi me efekt serrë	***Shkalla metodologjike minimale e kërkuar***
CO_2	2
N_2O	2

3. PËRCAKTIMI I GAZEVE ME EFEKT SERRË DUKE PËRDORUR METODOLOGJITË E BAZUARA NË MATJE

Ekuacioni 1: Llogaritja e shkarkimeve vjetore në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 44, të kësaj rregulloreje:

$$GES\ SH_{total}\ [\mathrm{t}] = \sum_{i=1}^{Orw_p} GES\ perq_{ore,i} \cdot V_{ore,i} \cdot 10^{-6}\ [\mathrm{t/g}]$$

Ekuacioni 2: Përcaktimi i shkarkimeve mesatare për orë:

$$GES\ SH_{mesatare}\ [\mathrm{kg/h}] = \frac{GES\ SH_{total}}{Orw_p} \cdot 10^{3}\ [\mathrm{kg/t}]$$

Ekuacioni 2a: Përcaktimi i përqendrimeve mesatare në orë i GES për qëllime të raportimit, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 9 të shtojcës 10, seksioni 1, të kësaj rregulloreje:

$$GES\ përq_{mesatar}\ [\mathrm{g/Nm^3}] = \frac{GES\ SH_{total}}{\sum_{i=1}^{Orë_p} V_{ore,i}} \cdot 10^{6}\ [\mathrm{g/t}]$$

Ekuacioni 2b: Përcaktimi i fluksit mesatar në orë i gazit të çliruar nga djegia, për qëllime të raportimit, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 9 të shtojcës 10, seksioni 1, të kësaj rregulloreje:

$$\textit{Fluksi}_{mesatar}\ [\mathrm{Nm^3/h}] = \frac{\sum_{i=1}^{\textit{Orë}\ p} V_{ore,\,i}}{\textit{Orë}\ p}$$

Ekuacioni 2c: Llogaritja e shkarkimeve vjetore për qëllime të raportimit të shkarkimeve vjetore, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 9 të shtojcës 10, seksioni 1, të kësaj rregulloreje:

$$\textbf{GES SH}_{\textbf{total}}\ [\mathrm{t}] = \textbf{GES përq}_{\textbf{mesatar}} \cdot \textit{Fluksi}_{mesatar} \cdot \textbf{Orë}_{\ p} \cdot 10^{-6}\ [\mathrm{t/g}]$$

Ekuacionet

1 deri në 2c kanë përdorur shkurtimet e mëposhtme:

Indeksi "*i*" i referohet çdo ore specifike të operimit. Kur një operator përdor periudhë referimi më të shkurtër, në përputhje me pikën 1, të nenit 44 të kësaj rregulloreje, për këto llogaritje do të përdoret periudha më e shkurtër e referimit që përdor operatori në vend të orëve.

GES SH_{total} = Shkarkimet totale vjetore të gazeve me efekt serrë në ton

GES $përq_{orë,\,i}$ = Përqendrimet në orë të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në g/ Nm^3 në fluksin e gazeve të shkarkuara nga djegia, të matura gjatë operimit në orën i:

$V_{orë,\,i}$ = Vëllimi i gazeve të shkarkuara nga djegia në Nm^3/orë (d.m.th fluksi i integruar përgjatë orës ose gjatë një periudhe më të shkurtër referimi);

GES $SH_{mesatarae}$ =sasia mesatare e shkarkimeve në orë gjatë një viti në kg/h nga burimi;

$Orë_p$ = Numri total i orëve për të cilat është zbatuar metodologjia e bazuar në matje, duke përfshirë dhe orët për të cilat janë zëvendësuar të dhënat në përputhje me pikat 2 dhe 4, të nenit 46 të kësaj rregulloreje.

GES $përq_{mesatar}$ = mesatarja vjetore e përqendrimeve të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në orë, të shprehura në g/ Nm^3;

$Fluksi_{mesatar}$ = mesatarja vjetore e fluksit të gazeve të shkarkuara nga djegia të shprehura në Nm^3/h.

4. LLOGARITJA E PËRQENDRIMIT DUKE PËRDORUR MATJEN INDIREKTE TË PËRQENDRIMIT

Ekuacioni 3: Llogaritja e përqendrimit

$$\textbf{GES}_{\textbf{perqendrim}}\ [\%] = 100\% - \sum_{i} \text{Perqendrimi i komponentit i}\ [\%]$$

5. ZËVENDËSIMI I TË DHËNAVE TË PËRQENDRIMIT QË MUNGOJNË NË METODOLOGJITË E BAZUARA NË MATJE

Ekuacioni 4: Zëvendësimi i të dhënave që mungojnë në metodologjitë e bazuara në matje

$$C^{*}_{\textbf{subst}} = \overline{C} + 2\sigma c_$$

Ku:

$\overline{C}$ = Mesatarja aritmetike e përqendrimit të parametrit specifik gjatë të gjithë periudhës së raportimit ose në rrethana të veçanta kur ka ndodhur humbja e të dhënave, një periudhë e përshtatshme e cila reflekton rrethanat e veçanta;

$\sigma_{C_}$ = Vlera e përafërt e devijimit standard të përqendrimit të parametrit specifik gjatë periudhës së raportimit ose në rrethana të veçanta kur ka ndodhur humbja e të dhënave, një periudhë e përshtatshme e cila reflekton rrethanat e veçanta;

SHTOJCA IX
TË DHËNAT DHE INFORMACIONI MINIMAL QË RUHET, NË PËRPUTHJE ME PIKAT 1 DHE 2, TË NENIT 74, TË RREGULLORES

Operatori i instalimit, operatori i avionit dhe subjekti i rregulluar duhet të ruajnë të paktën të dhënat vijuese:

1. ELEMENTET E PËRBASHKËTA PËR INSTALIMET, OPERATORËT E AVIONIT DHE SUBJEKTET E RREGULLUARA

1) Plani i monitorimit i miratuar nga AKM-ja;

2) Dokumentacioni i cili justifikon metodologjinë e monitorimit të zgjedhur nga operatori dhe dokumentacioni i cili justifikon ndryshimet e përkohshme ose jo të përkohshme të metodologjive të monitorimit dhe, aty ku është e zbatueshme, shkallët metodologjike të miratuara nga AKM-ja;

3) Të gjitha përditësimet e planeve të monitorimit, që i janë njoftuar AKM-së në përputhje me nenet 15 dhe 94 të kësaj rregulloreje, si dhe përgjigjet nga AKM-ja;

4) Të gjitha procedurat me shkrim të përmendura në planin e monitorimit, përfshirë planin e marrjes së mostrave aty ku është i zbatueshëm, procedurat për aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe aktivitetet e kontrollit;

5) Një listë e të gjitha varianteve të planit të monitorimit që janë përdorur dhë të gjitha procedurat e lidhura me to;

6) Dokumentimi i ndarjes së përgjegjësive lidhur me monitorimin dhe raportimin;

7) Vlerësimi i riskut i kryer nga operatori i instalimit, operatori i avionit ose subjekti i rregulluar, kur kjo është e zbatueshme;

8) Raportet e përmirësimit në përputhje me nenin 76 të kësaj rregulloreje;

9) Raporti i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve vjetore të GES i verifikuar nga verifikuesi i akredituar;

10) Raporti i verifikimit i lëshuar nga verifikuesi i akredituar;

11) Çdo informacion tjetër, i cili identifikohet si i nevojshëm për verifikimin e raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve vjetore të GES.

2. ELEMENTET E POSAÇME PËR INSTALIMET:

1) Autorizimi për shkarkimet e GES dhe çdo përditësim i tij;

2) Çdo vlerësim i pasigurisë, kur është e zbatueshme;

3) Për metodologjitë e bazuara në llogaritje që zbatohen në instalime, elementet e mëposhtme:

a) të dhënat e aktivitetit të përdorura për të gjitha llogaritjet e shkarkimeve për çdo rrymë shkarkimi, kategorizuar sipas procesit dhe llojit të lëndës djegëse ose materialit;

b) një listë e të gjitha vlerave standarde të përdorura si faktor llogaritës, kur është e zbatueshme;

c) seti i plotë i marrjes së mostrave dhe rezultatet e analizave për përcaktimin e faktorëve llogaritës;

ç) dokumentacioni i të gjitha procedurave joefektive që janë korrigjuar dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra në përputhje me nenin 71 të kësaj rregulloreje;

d) çdo rezultat të kalibrimit dhe mirëmbajtjes të instrumenteve matëse.

4) Për metodologjitë e bazuara në matje të përdorura në instalime, elementet e mëposhtme shtesë:

a) dokumentacioni i cili justifikon përzgjedhjen e një metodologjie të bazuar në matje;

b) të dhënat e përdorura për analizat e pasigurisë të shkarkimeve nga çdo burim

shkarikimi, të kategorizuara në përputhje me procesin;

c) të dhënat e përdorura që mbështesin llogaritjet dhe rezultatet e llogaritjeve;

ç) një përshkrim teknik të hollësishëm të sistemit të matjeve të vazhdueshme, duke përfshirë dokumentacionin e miratimit nga AKM-ja;

d) të dhënat e papërpunuara dhe ato të përpunuara të nxjerra nga sistemi i matjeve të vazhdueshme, përfshirë dokumentacionin e ndryshimeve të ndodhura përgjatë kohës, ditarin e testimeve, kohën jashtë funksionit, kalibrimet, shërbimet dhe mirëmbajtjen;

dh) dokumentacioni i çdo ndryshimi që ka ndodhur në sistemin e matjeve të vazhdueshme;

e) çdo rezultat i kalibrimit dhe mirëmbajtjes së instrumenteve matëse;

ë) ku është e zbatueshme, modeli i bilancit të masës ose energjisë i përdorur për qëllimin e përcaktimit të të dhënave zëvendësuese, në përputhje me pikën 4, të nenit 46, të kësaj rregulloreje së bashku me supozimet themelore që qëndrojnë në bazë të këtij modeli.

5. Kur zbatohet një metodologji rezervë, siç parashikohet në nenin 22 të kësaj rregulloreje, ruhen të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin e shkarkimeve nga burimet e shkarkimeve dhe rrymat e shkarkimeve për të cilat është përdorur ajo metodologji, si dhe të dhënat zëvendësuese të të dhënave të aktivitetit, të faktorëve llogaritës dhe parametrave të tjerë që raportohen në kuadër të një shkalle metodologjike;

6. Për prodhimin primar të aluminit ose aluminës, elementet e mëposhtme shtesë:

a) dokumentimi i rezultateve nga fushatat e matjes për përcaktimin e faktorëve specifikë të shkarkimit të instalimit për CF_4 dhe C_2F_6;

b) dokumentimi i rezultateve të përcaktimit të efikasitetit të grumbullimit për shkarkimet e pakapshme;

c) të gjitha të dhënat me vlerë mbi prodhimin primar të aluminit, frekuenca dhe kohëzgjatja e efektit të anodës ose të dhënat e mbitensionit;

7. Për veprimtarinë e kapjes, transportit dhe depozitimit gjeologjik të CO_2, kur është e zbatueshme, elementet e mëposhtme shtesë:

a) dokumentimi i sasisë së CO_2 të injektuar në kompleksin e depozitimit nga instalimet që kryejnë depozitimin gjeologjik të CO_2;

b) të dhënat e presionit dhe temperaturës nga një infrastrukturë transporti, të grumbulluara në mënyrë përfaqësuese;

c) kur është e zbatueshme, një kopje e lejes së depozitimit, përfshirë planin e miratuar të monitorimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë e kapjes, transportit dhe depozitimit gjeologjik të CO2;

ç) kur është e zbatueshme, raportet e paraqitura, në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e kapjes, transportit dhe depozitimit gjeologjik të CO2;

d) kur është e zbatueshme, raportet mbi rezultatet e inspektimeve të kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e kapjes, transportit dhe depozitimit gjeologjik të CO2;

dh) kur është e zbatueshme, dokumentimi i masave korrigjuese, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e kapjes, transportit dhe depozitimit gjeologjik të CO2;.

8. Për CO_2 e lidhur kimikisht në mënyrë të përhershme, aty ku është e zbatueshme, elementet e mëposhtme shtesë:

a) dokumentacioni i sasisë së CO_2 të lidhur kimikisht në mënyrë të përhershme;

b) llojet, sasitë e prodhuara dhe përdorimet përkatëse të produkteve me të cilat CO_2 ishte i lidhur kimikisht.

3. ELEMENTET E POSAÇME PËR AKTIVITETET E AVIACIONIT:

1. Lista e mjeteve ajrore në pronësi, të marra dhe të dhëna me qira dhe provat e nevojshme që dëshmojnë se lista është e plotë; për çdo mjet avion data në të cilën është shtuar ose hequr nga flota e mjeteve ajrore të operatorit të avionit;

2. Një listë të fluturimeve të kryera në secilën periudhë raportimi dhe për çdo fluturim kodi i caktuar ICAO i të dyja aerodromeve, si dhe prova të nevojshme që dëshmojnë që lista është e plotë;

3. Të dhënat përkatëse të përdorura për përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimeve;

4. Me qëllim monitorimin e shkarkimeve, duhet të ruhet dokumentacioni mbi metodologjinë e përdorur për rastet e mungesës së të dhënave, kur është e zbatueshme, numrin e fluturimeve për të cilat ka pasur mungesë të të

dhënave, të dhënat e përdorura për plotësimin e këtyre mungesave kur ka pasur raste të tilla, si dhe — në rastet kur numri i fluturimeve me mungesë të të dhënave tejkalon 5 % të fluturimeve të raportuara — arsyet e mungesës së të dhënave dhe dokumentacionin mbi masat korrigjuese të ndërmarra.

5. Me qëllim monitorimin dhe raportimin e efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, operatori i avionit duhet të mbajë të gjitha të dhënat e monitoruara, në përputhje me pikën 2, të nenit 64 të kësaj rregulloreje, kur këto të dhëna përdoren për të llogaritur CO_2(e) për çdo fluturim, në përputhje me metodën e përcaktuar në nenin 63 të kësaj rregulloreje.

6. Me qëllim monitorimin e efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2 dhe në rastet kur operatori i avionit nuk përdor sistemin NEATS, duhet të regjistrohet numri i fluturimeve për të cilat ka pasur mungesë të të dhënave, si dhe vlerat e përcaktuara standarde të përdorura nga shtojca IIIa, seksioni 5, dhe shtojca IIIb i kësaj rregulloreje për plotësimin e mungesave të të dhënave.

4. ELEMENTE TË POSAÇME PËR SUBJEKTET E RREGULLUARA

1. Lista e rrymave të lëndës djegëse për çdo periudhë raportimi dhe provat e nevojshme që dëshmojnë se kjo listë është e plotë, përfshirë kategorizimin e rrymave të lëndës djegëse;

2. Informacioni mbi mjetet përmes të cilave lëndët djegëse, të përkufizuara sipas nenit 3, pika 40, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", i ndryshuar, hidhen për konsum dhe, kur është i disponueshëm, informacion mbi llojet e konsumatorëve të ndërmjetëm, kur dhënia e këtij informacioni nuk shkakton barrë administrative joproporcionale;

3. Informacion mbi llojin e përdorimit fundor, përfshirë kodin përkatës CRF të sektorëve fundorë në të cilët konsumohet lënda djegëse e përkufizuar sipas pikës 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në nivelin e konsolidimit (agregimit) të disponueshëm;

4. Të dhënat e nevojshme të përdorura për përcaktimin e sasive të lëndës djegëse të hedhur për konsum për çdo rrymë lënde djegëse;

5) Kur është e zbatueshme, lista e vlerave standarde të përdorura dhe faktorëve të llogaritjes;

6) Faktori sektorial për çdo rrymë lënde djegëse, përfshirë identifikimin e çdo sektori të konsumit fundor dhe të gjitha të dhënat mbështetëse përkatëse për kryerjen e këtij identifikimi;

7) Shkallët metodologjike të zbatueshme, përfshirë arsyetimet për devijimin nga shkallët metodologjike të kërkuara;

8) Të gjitha të dhënat e rezultateve të marrjes së mostrave dhe analizave për përcaktimin e faktorëve të llogaritjes;

9) Dokumentacion mbi të gjitha procedurat joefektive të korrigjuara dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra, në përputhje me pikën 1, të nenit 128, të kësaj rregulloreje;

10) Çdo rezultat të kalibrimit dhe mirëmbajtjes së instrumenteve matëse;

11) Lista e instalimeve të cilave u jepet për konsum lënda djegëse e përkufizuar në pikën 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, përfshirë emrat, adresat dhe numrin e autorizimit për shkarkimet e GES, si dhe sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe të furnizuara për ato instalime gjatë periudhave të raportimit.

SHTOJCA X
ELEMENTET E DETYRUSHME TË RAPORTEVE VJETORE TË DHËNAVE TË MONITORIMIT TË SHKARKIMEVE TË GES

(Neni 75, pika 2, e rregullores)

1. RAPORTI I TË DHËNAVE TË MONITORIMIT TË SHKARKIMEVE VJETORE TË GES NGA INSTALIMET

Raporti i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES nga instalimet duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

1) Me përjashtim të instalimeve për incenerimin e mbetjeve bashkiake, për të gjitha instalimet e tjera duhet të përfshihen numri i unik i autorizimit të shkarkimeve GES të lëshuar për instalimin dhe të dhënat e mëposhtme që identifikojnë instalimin:

i) Emri i instalimit;

ii) Adresa e instalimit, përfshirë kodin postar dhe shtetin;

iii) Lloji dhe numri i veprimtarive të

parashikuara në shtojcën II, pjesa A, e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që kryhen në instalimin në fjalë;

iv) Adresa, telefoni, faksi dhe *e-mail*-i i personit të kontaktit;

v) Emri i pronarit të instalimit dhe i çdo shoqërie mëmë.

2. Emrin dhe adresën e verifikuesit të akreditуar që verifikon raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES nga instalimi;

3 Vitin e raportimit;

4. Numrin e referencës së variantit më të fundit të planit të monitorimit që është miratuar nga AKM-ja dhe data nga e cila është i zbatueshëm si dhe numrin e referencës të çdo plani tjetër monitorimi që është i vlefshëm gjatë vitit të raportimit;

5. Ndryshimet përkatëse në veprimtarinë e një instalimi, si edhe ndryshimet e devijimet e përkohshme që kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit në planin e miratuar të monitorimit; ku përfshihen ndryshimet e përkohshme ose të përhershme të shkallëve metodologjike, arsyet e këtyre ndryshimeve, datën e fillimit të ndryshimeve, si dhe datat e fillimit dhe përfundimit të ndryshimeve të përkohshme.

6. Informacion për të gjitha burimet e shkarkimeve dhe rrymat e shkarkimit që përfshin të paktën:

a) shkarkimet totale të shprehura si t CO_2 (e), duke përfshirë CO_2 nga rrymat e shkarkimit të biomasës që nuk përputhen me nenin 38, pikat 5, 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje, ose nga rrymat e shkarkimit të RFNBO ose RCF që nuk përputhen me nenin 40, pikat 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje, ose nga rrymat e shkarkimit sintetike të lëndëve djegëse me karbon të ulët që nuk përputhen me nenin 40, pikat 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje;

b) kur shkarkohen gaze me efekt serrë të ndryshme nga CO_2, shkarkimet totale të shprehura në t;

c) nëse zbatohet metodologjia e matjes ose e llogaritjes e përmendur në nenin 21 të kësaj rregulloreje;

ç) shkallët metodologjike që zbatohen;

d) të dhënat e aktivitetit:

i. në rastet e lëndës djegëse, sasinë e lëndës djegëse (e shprehur në ton ose Nm^3) dhe vlerë kalorifike neto (GJ/t ose GJ/ Nm^3) të raportuara më vete;

ii. për të gjitha rrymat e tjera të shkarkimit, sasinë e shprehur në ton ose Nm^3;

dh) faktorët e shkarkimit, të shprehur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 36 të kësaj rregulloreje; fraksioni i biomasës; fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni RFNBO ose RCF, fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero, fraksioni sintetik me karbon të ulët, fraksion sintetik me karbon të ulët, me normë zero, faktorët e oksidimit dhe të konvertimit, të shprehur si fraksione pa njësi matëse;

e) kur faktorët e shkarkimeve për lëndët djegëse lidhen me masën ose vëllimin dhe jo me energjinë, duhet të përdoren vlerat e përcaktuara, në përputhje me pikën 7, të nenit 26 për vlerën kalorifike neto të rrymës përkatëse të shkarkimit;

ë) kur një rrymë shkarkimi është ndonjë lloj mbetjeje, kodet përkatëse të përcaktuara në katalogun e mbetjeve në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

7. Kur zbatohet metodologjia e bilancit të masës, duhet të regjistrohen fluksi i masës dhe përmbajtja e karbonit për çdo rrymë shkarkimi që hyn dhe del nga impianti; si dhe, kur është e zbatueshme, fraksioni i biomasës, fraksioni i biomasës me normë shkarkimi zero, fraksioni RFNBO ose RCF, fraksioni RFNBO ose RCF me normë zero, fraksioni sintetik me karbon të ulët, fraksioni sintetik me karbon të ulët me normë zero, dhe vlera kalorifike neto.

8). Informacion që raportohet si informacion shtesë dhe që përfshin të paktën:

a) sasitë e biomasës dhe të biomasës me normë zero, të djegura, ose sasitë e RFNBO ose RCF dhe të RFNBO ose RCF me normë zero, të djegura, ose sasitë e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët dhe të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, të djegura, të shprehura në TJ, ose të përdorura në procese, të shprehura në t ose Nm^3;

b) shkarkimet e CO_2 nga biomasa dhe nga biomasa me normë zero, ose shkarkimet nga RFNBO ose RCF dhe nga RFNBO ose RCF me normë zero emetimi, ose emetimet nga karburantet sintetike me karbon të ulët dhe nga lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët me normë zero, të shprehura në t CO_2, kur për përcaktimin e shkarkimeve përdoret metodologjia e bazuar në matje;

c) një vlerë zëvendësuese të vlerës kalorifike neto të rrymave të shkarkimit të biomasës, ose të RFNBO ose RCF ose lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët të përdorura si lëndë djegëse, kur është e zbatueshme;

ç) shkarkimet, sasitë dhe përmbajtja energjetike e lëndëve djegëse me bazë biomasën dhe e biolëngjeve të djegura, ose e RFNBO ose RCF të djegura, ose e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët të djegura, të shprehura në t dhe TJ, si dhe informacionin që tregon se lëndët djegëse me bazë biomasën dhe biolëngjet me normë zero, ose RFNBO ose RCF, ose lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët, janë në përputhje me nenin 38, pikët 5, 6 dhe 7, ose nenin 40, pikat 4 dhe 5, ose nenin 40, pikat 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje;

d) CO_2 ose N_2O të transferuar në një impiant ose të marrë nga një impiant, si dhe çdo CO_2 në tranzit, kur është i zbatueshëm neni 50 ose neni 52 i kësaj rregulloreje, të shprehura në t CO_2(e);

dh) CO_2 i brendshëm (inherent) i transferuar në një impiant ose i marrë nga një impiant, kur është i zbatueshëm neni 49, i kësaj rregulloreje, i shprehur në t CO_2.

e) Kur është e zbatueshme, emrin e impiantit dhe kodin e identifikimit të tij, siç rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi:

i. të impiantit(eve) tek i cili (ose te të cilët) transferohet CO_2 ose N_2O, në përputhje me shkronjat "d" dhe "dh" të kësaj pike;

ii. të impiantit(eve) nga i cili (ose te të cilët) merret CO_2 ose N_2O, në përputhje me shkronjat "d" dhe "dh" të kësaj pike.

Në rastet kur impianti nuk ka një kod të tillë identifikimi, duhet të jepen emri dhe adresa e impiantit, si edhe të dhënat përkatëse të kontaktit të një personi kontakti.

ë) sasinë e CO_2 të transferuar nga biomasa, të shprehur në t CO_2;

f) sasinë e CO_2 të lidhur kimikisht në produkt, në përputhje me nenin 51, pikat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, të shprehur në t CO_2;

g) llojet dhe sasitë e produkteve të prodhuara, në të cilat CO_2 është lidhur kimikisht në përputhje me nenin 51, pikat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, të shprehura në t produkti.

9. Në rast se zbatohet një metodologji e bazuar në matje, elementet e mëposhtme:

a) informacion nëse CO_2 matet si shkarkime vjetore të CO_2 nga burime fosile dhe shkarkime vjetore të CO_2 nga përdorimi i biomasës;

b) informacion mbi orët e funksionimit të sistemit të vazhdueshëm të matjes së shkarkimeve (CEMS), përqendrimet e matura të gazrave me efekt serrë dhe fluksin e gazrave nga djegia, të shprehura si mesatare vjetore orare dhe si vlerë totale vjetore;

c) kur është e zbatueshme, informacion mbi vlerën zëvendësuese të përmbajtjes energjetike nga lëndët djegëse fosile dhe materialet dhe nga biomasa e përdorur si lëndë djegëse dhe materialet, si edhe nga RFNBO ose RCF, ose nga lëndët djegëse sintetike me karbon të ulët.

10. Kur zbatohet një metodologji e përmendur në nenin 22 të kësaj rregulloreje, duhet të mblidhen të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin e shkarkimeve për burimet e shkarkimeve dhe rrymat e shkarkimeve për të cilat zbatohet ajo metodologji, si edhe të dhënat zëvendësuese (proxy) për të dhënat e aktivitetit, faktorët e llogaritjes dhe parametrat e tjerë që do të raportoheshin sipas një metodologjie të bazuar në shkallë metodologjike.

11. Në rastet kur ka mungesa të të dhënave dhe këto janë plotësuar me të dhëna zëvendësuese, në përputhje me nenin 73, pikat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, elementet e mëposhtme:

a) rryma e shkarkimit ose burimi i shkarkimit për të cilin ka mungesë të dhënash;

b) arsyet për secilin rast ku ka mungesë të të dhënave;

c) data dhe ora e fillimit dhe e përfundimit për secilin rast ku ka mungesë të të dhënave;

ç) shkarkimet e llogaritura në bazë të të dhënave zëvendësuese;

d) në rastet kur metoda e vlerësimit për të dhënat zëvendësuese nuk është përfshirë ende në planin e monitorimit, duhet të jepet një përshkrim i detajuar i metodës së vlerësimit, duke përfshirë provën që tregon se metodologjia e përdorur nuk çon në nënvlerësim të shkarkimeve për periudhën përkatëse të kohës.

12. Çdo ndryshim tjetër në impiant gjatë periudhës së raportimit që ka rëndësi për shkarkimet e gazeve me efekt serrë të atij impianti gjatë vitit të raportimit.

13. Kur është e zbatueshme, niveli i prodhimit të aluminit parësor, frekuenca dhe kohëzgjatja

mesatare e efekteve të anodës gjatë periudhës së raportimit, ose të dhënat e mbitensionit të efekteve të anodës gjatë periudhës së raportimit, si dhe rezultatet e llogaritjeve më të fundit të faktorëve specifikë të shkarkimit të impiantit për CF_4 dhe C_2F_6, siç përcaktohet në shtojcën IV të kësaj rregulloreje, dhe rezultatet e llogaritjeve më të fundit të efikasitetit të grumbullimit të tubave të gazrave.

Shkarkimet nga i njëjti instalim që vijnë nga burime të ndryshme shkarkimi, ose nga rryma shkarkimi të të njëjtit lloj që i përkasin të njëjtit lloj aktiviteti, mund të raportohen në mënyrë të përbashkët për atë lloj aktiviteti.

Në rastet kur brenda një periudhe raportimi kanë ndryshuar shkallët metodologjike, operatori i instalimit duhet t'i llogarisë dhe t'i raportojë shkarkimet si seksione të veçanta të raportit vjetor, për pjesët që përkojnë me periudhën e raportimit.

Operatorët e vendeve të depozitimit të CO_2 mund të përdorin raporte të thjeshtuara të shkarkimeve pas mbylljes së vendit të depozitimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për depozitimin e CO_2, me kusht që autorizimi për shkarkimet e gazeve me efekt serrë të mos përmbajë burime shkarkimi.

2. RAPORTI I TË DHËNAVE TË MONITORIMIT TË SHKARKIMEVE VJETORE TË GES NGA OPERATORËT E AVIONËVE

Raporti i i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve vjetore të GES të një operatori avioni përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Të dhënat e mëposhtme që identifikojnë operatorin e avionit dhe sinjalin e thirrjes os kode të tjera unike të përdorura për qëllime të kontrollit të trafikut ajror, si dhë detajet përkatëse të kontaktit:

i. emrin e operatorit të avionit;

ii. adresën e operatorit të avionit, duke përfshirë kodin postar dhe shtetin;

iii. numrat e regjistrimit të avionëve dhe llojet e avionëve të përdorur gjatë periudhës që mbulon raporti, për kryerjen e aktiviteteve të aviacionit të renditura në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, për të cilat subjekti është operatori i avionit;

iv. numri dhe autoriteti lëshues i certifikatës së operatorit ajror dhe i licencës së operimit, në bazë të të cilave janë kryer aktivitetet e aviacionit renditura në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, për të cilat subjekti është operatori i avionit;

v. adresën, numrin e telefonit, faksin dhe adresën e postës elektronike të një personi kontakti;

vi. emrin e pronarit të avionit.

2. Emrin dhe adresën e verifikuesit të akreditуar që verifikon raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES nga operatori i avionit;

3. Vitin e raportimit;

4. Numri i referencës të variantit më të fundit të planit të monitorimit që është miratuar nga AKM-ja dhe data nga e cila është i zbatueshëm si dhe numrin e referencës të çdo plani tjetër monitorimi që është i vlefshëm gjatë vitit të raportimit;

5. Ndryshimet përkatëse të veprimtarive si dhe devijimet nga plani i miratuar i monitorimit që kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit;

6. Numrat e regjistrimit të avionëve dhe llojet e avionëve që janë përdorur nga operatori i avionit gjatë periudhës së mbuluar nga raporti për kryerjen e aktiviteteve të aviacionit të renditura në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

7. Numrin total të fluturimeve për çdo çift shtetesh të mbuluara nga raporti;

8. Masën e lëndës djegëse të papërzier (në ton), sipas llojit të lëndës djegëse për çdo çift shtetesh, duke përfshirë informacionin mbi të gjitha elementet vijuese:

a) Nëse lënda djegëse alternative e aviacionit është me normë zero, në përputhje me nenin 60 të kësaj rregulloreje;

b) Nëse lënda djegëse është një lëndë djegëse e kualifikuar për aviacionin;

c) Për lëndët djegëse të kualifikuara për aviacion, lloji i lëndës djegëse ;

9. Shkarkimet totale të CO_2 në tCO_2, duke përdorur faktorin paraprak të shkarkimit si dhe faktorin e shkarkimeve të ndara sipas shtetit të nisjes dhe mbërritjes.

10. Kur shkarkimet llogariten duke përdorur një faktor shkarkimi ose përmbajtje karboni që

lidhet me masën ose vëllimin, informacion për të dhënat zëvendësuese për vlerën kalorifike neto të lëndës djegëse.

11. Në rastet kur ka pasur mungesa të të dhënave dhe këto janë plotësuar me të dhëna zëvendësuese, në përputhje me nenin 73, pikat 3, 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje, informacion mbi elementet e mëposhtme:

a) numrin e fluturimeve, i shprehur si përqindje e fluturimeve vjetore (i rrumbullakosur në 0,1 % më të afërt) për të cilat ka pasur mungesë të dhënash, si edhe rrethanat dhe arsyet përkatëse të këtyre mungesave;

b) metodën e vlerësimit të përdorur për të dhënat zëvendësuese;

c) shkarkimet e llogaritura në bazë të të dhënave zëvendësuese.

12. Informacion shtesë për:

a) sasinë e lëndëve djegëse alternative të aviacionit të përdorura gjatë vitit të raportimit (në ton), e renditur sipas llojit të lëndës djegëse, dhe nëse këto lëndë djegëse janë në përputhje me nenin 60 të kësaj rregulloreje;

b) vlerën kalorifike neto të lëndëve djegëse alternative.

13. Sasinë totale të lëndëve djegëse të kualifikuara për aviacionin, të përdorur gjatë vitit raportues (në ton) të renditura sipas llojit të lëndës djegëse;

14. Si shtojcë të raportit vjetor të shkarkimeve, operatori i avionit duhet të përfshijë shkarkimet vjetore dhe numrin vjetor të fluturimeve për çdo çift aeroportesh. Kur është e zbatueshme, duhet të tregohet sasia e lëndëve djegëse alternative të aviacionit dhe lëndëve djegëse të kualifikuara për aviacionin (në ton) për çdo çift aeroportesh. Me kërkesë të operatorit të avionit, AKM -ja duhet ta trajtojë këtë informacion si konfidencial.

2a. RAPORTI I TË DHËNAVE TË MONITORIMIT TË SHKARKIMEVE VJETORE NGA OPERATORËT E AVIONËVE PËR EFEKTET NË AVIACION TË PALIDHURA ME SHKARKIMIN E CO_2

Për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO_2, raporti i veçantë i përmendur në pikën 3, të nenit 75, të kësaj rregulloreje duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Të dhënat që identifikojnë operatorin e avionit dhe sinjalin e thirrjes ose kode të tjera unike të përdorura për qëllime të kontrollit të trafikut ajror, si dhe detajet përkatëse të kontaktit:

2. Emrin dhe adresën e verifikuesit të akreditуar që verifikon raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve vjetore nga operatori i avionit;

3. Vitin e raportimit;

4. Numrin e referencës të variantit më të fundit të planit të monitorimit që është miratuar nga AKM-ja dhe data nga e cila është i zbatueshëm si dhe numrin e referencës të çdo plani tjetër monitorimi që është i vlefshëm gjatë vitit të raportimit;

5. Ndryshimet përkatëse të veprimtarive si dhe devijimet nga plani i miratuar i monitorimit që kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit;

6. Numrat e regjistrimit të avionëve dhe llojet e avionëve që janë përdorur nga operatori i avionit gjatë periudhës së mbuluar nga raporti për kryerjen e aktiviteteve të aviacionit të renditura në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar;

7. Numrin total të fluturimeve për çdo çift shtetesh të mbuluara nga raporti;

8. Shuma e CO_2(e) e fluturimeve të monitoruara të operatorit të avionit, për çdo çift aeroportesh, e shprehur sipas treguesve klimatikë (*climate metrics*) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 63 të kësaj rregulloreje.

9. Një tabelë XML që përmban, për çdo fluturim dhe sipas përcaktimeve të shtojcës IIIa, seksionit 1, të kësaj rregulloreje, informacionin e fluturimit, llojin e avionit, identifikuesin e motorit dhe vlerën e CO_2(e), të shprehur sipas treguesve klimatikë (*climate metrics*) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 63, të kësaj rregulloreje.

10. Nëse operatori i avionit nuk përdor sistemin NEATS për të llogaritur CO_2(e), por përdor mjetet e veta informatike ose mjetet e palëve të treta, siç parashikohet në shkronjën "b", të pikës 7, të nenit 63, të kësaj rregulloreje, ai duhet të paraqesë një përshkrim të mënyrës se si zbatohet efikasiteti në këto mjete, në përputhje me këtë rregullore dhe me NEATS, për të përmirësuar vlerën e GWP (Potencialit të Ngrohjes Globale). Nëse efikasiteti nuk është zbatuar në këto mjete, operatori i avionit duhet të paraqesë një përshkrim që shpjegon arsyet pse nuk është zbatuar efikasiteti.

4. RAPORTI I TË DHËNAVE TË MONITORIMIT TË SHKARKIMEVE VJETORE TË GES NGA SUBJEKTET E RREGULLUARA

Raporti i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES nga subjekti i rregulluar duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

1. Të dhënat e mëposhtme që identifikojnë subjektin e rregulluar si dhe numrin unik të autorizimit për shkarkimet GES të subjektit të rregulluar:

i. Emrin e subjektit të rregulluar;

ii. Adresën e subjektit të rregulluar përfshirë kodin postar dhe shtetin;

iii. Llojet e lëndëve djegëse që hedh për konsum dhe veprimtaritë me anë të të cilave hedh lëndët djegëse për konsum, përfshirë teknologjinë e përdorur;

iv. Adresën, telefonin, faksin dhe *e-mail*-in e personit të kontaktit; dhe

v. Emrin e pronarit të subjektit të rregulluar dhe të çdo shoqërie mëmë.

2. Emrin dhe adresën e verifikuesit të akredituar që verifikon raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES nga subjekti i rregulluar;

3. Vitin e raportimit;

4. Numrin e referencës të variantit më të fundit të planit të monitorimit që është miratuar nga AKM-ja dhe data nga e cila është i zbatueshëm si dhe numrin e referencës të çdo plani tjetër monitorimi që është i vlefshëm gjatë vitit të raportimit;

5. Ndryshimet në operacionet e subjektit të rregulluar dhe ndryshimet, si dhe devijimet e përkohshme që kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit, ndaj planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja; duke përfshirë ndryshimet e përkohshme ose të përhershme të shkallëve metodologjike, arsyet e këtyre ndryshimeve, datën e fillimit të ndryshimeve, si dhe datat e fillimit dhe të përfundimit të ndryshimeve të përkohshme;

6. Informacion për të gjitha rrymat e lëndës djegëse që përfshin të paktën:

a) shkarkimet totale të shprehura si tCO_2, duke përfshirë CO_2 nga rrymat e lëndës djegëse të biomasës që nuk përputhen me nenin 38, pikat 5, 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje, ose nga rrymat e shkarkimit të RFNBO ose RCF që nuk përputhen me nenin 40, pikat 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje, ose nga rrymat e shkarkimit të lëndëve djegëse sintetike të lëndëve djegëse me karbon të ulët që nuk përputhen me nenin 40, pikat 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje;

b) shkallët metodologjike që zbatohen;

c) sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum (të shprehura në tonë, Nm^3 ose TJ) dhe faktori i konvertimit të njësisë, i shprehur në njësi të përshtatshme, të raportuara veçmas, kur është e zbatueshme;

ç) faktorët e shkarkimeve, të shprehur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99, të kësaj rregulloreje; fraksioni i biomasës, fraksioni i biomasës me normë zero, fraksioni i RFNBO ose i RCF, fraksioni i RFNBO ose i RCF me normë zero, fraksioni sintetik me karbon të ulët, fraksioni sintetik me karbon të ulët me normë zero, të shprehur si fraksione pa dimension;

d) informacion mbi vlerat e përcaktuara sipas pikës 4, të nenit 101, të kësaj rregulloreje për faktorin e konvertimit të njësive për rrymën përkatëse të lëndës djegëse, kur faktorët e shkarkimeve për lëndët djegëse lidhen me masën ose vëllimin, në vend të energjisë;

dh) mjetet me anë të të cilave lënda djegëse hidhet për konsum;

e) përdorimi(et) fundor(e) i rrymës së lëndës djegëse të hedhur për konsum, përfshirë kodin CRF, në nivelin e detajit të disponueshëm;

ë) faktorin sektorial, të shprehur si fraksion pa dimension, deri në tri shifra dhjetore. Kur, për një rrymë lënde djegëse, përdoret më shumë se një metodë për përcaktimin e faktorit sektorial, jepen informacionet mbi llojin e metodës, faktorin përkatës sektorial, sasinë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe kodin CRF, në nivelin e detajit të disponueshëm;

f) kur faktori sektorial është zero sipas pikës 2 të nenit 110, të kësaj rregulloreje:

i. një listë e të gjitha entiteteve të sektorit të aviacionit civil, transportit detar dhe instalimeve të mbuluara nga Shtojca II, pjesët A, B dhe C, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, të identifikuara me emrin, adresën dhe, kur është e zbatueshme, numrin unik të autorizimit për shkarkimet e GES-eve;

2) sasitë e lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe të furnizuara për secilin nga subjektet e sektorit të aviacionit civil, transportit detar dhe

instalimeve të mbuluara nga shtojca II, pjesët A, B dhe C, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, gjatë periudhës përkatëse të raportimit, të shprehura në t, Nm^3 ose TJ, si dhe shkarkimet përkatëse;

g) pasigurinë.

7. Informacion që raportohet si informacion shtesë dhe që përfshin të paktën:

a) një tregues zëvendësues për vlerën neto kalorifike të biomasës, të RFNBO-ve ose RCF-ve, ose të rrymave të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, kur është e zbatueshme;

b) shkarkimet, sasitë dhe përmbajtja energjetike e biokarburanteve, biolëngjeve, lëndëve djegëse nga biomasa, RFNBO-ve dhe RCF-ve, si dhe e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët të hedhura për konsum, të shprehura në t dhe TJ, dhe informacion nëse ato janë në përputhje me nenin 38, pikat 5, 6 dhe 7, ose nenin 40, pikat 4 dhe 5, ose nenin 40, pikat 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje;

8. Në rastet kur ka mungesa të të dhënave dhe këto janë plotësuar me të dhëna zëvendësuese, në përputhje me nenin 73, pikat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, elementet e mëposhtme:

a) rryma e lëndës djegëse për të cilat ka mungesë të dhënash;

b) arsyet për secilin rast kur ka mungesë të të dhënave;

c) data dhe ora e fillimit dhe e përfundimit për secilën rast ku ka mungesë të të dhënave;

ç) shkarkimet e llogaritura në bazë të të dhënave zëvendësuese;

d) në rastet kur metoda e vlerësimit për të dhënat zëvendësuese nuk është përfshirë ende në planin e monitorimit, duhet të jepet një përshkrim i detajuar i metodës së vlerësimit, duke përfshirë provën që tregon se metodologjia e përdorur nuk çon në nënvlerësim të shkarkimeve për periudhën përkatëse të kohës.

9. Çdo ndryshim tjetër që ka ndodhur në subjektin e rregulluar gjatë periudhës së raportimit, që ka rëndësi për shkarkimet e gazeve serrë të këtij subjekti të rregulluar gjatë vitit të raportimit.

SHTOJCA Xa
RAPORTIMI MBI FURNIZUESIT E LËNDËVE DJEGËSE DHE PËRDORIMIN E LËNDËVE DJEGËSE NGA INSTALIMET DHE, KUR ËSHTË E ZBATUESHME, OPERATORËT E AVIONIT DHE SHOQËRITË E TRANSPORTIT DETAR

Së bashku me informacionin e përfshirë në raportin vjetor të shkarkimeve, në përputhje me shtojcën X të kësaj rregulloreje, për çdo lëndë djegëse të përkufizuar sipas nenit 3, pikës 40, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, të blerë nga operatori, ky i fundit duhet të paraqesë informacionin vijues:

a) Emrin, adresën dhe numrin unik të lejes/licencës/autorizimit të furnizuesit të lëndës djegëse, i cili është i përkufizuar si subjekt i rregulluar në përputhje me parashikimet e nenit 3, të pikës 42 të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Në rastet kur furnizuesi i lëndës djegëse nuk është subjekt i rregulluar, operatorët duhet të paraqesin, kur është e mundur, një listë të të gjithë furnizuesve të lëndëve djegëse, duke filluar nga furnizuesit e drejtpërdrejtë të lëndës djegëse deri te subjekti i rregulluar, duke përfshirë emrin, adresën dhe numrin unik të lejes/ licencës/autorizimit të secilit;

b) Llojet dhe sasitë e lëndëve djegëse të blera nga secili furnizues i përmendur në shkronjën "a" më sipër, gjatë periudhës përkatëse të raportimit;

c) Sasinë e karburantit të përdorur për aktivitetet e përcaktuara në shtojcën II, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, që është blerë nga secili furnizues lënde djegëse, gjatë periudhës përkatëse të raportimit.

SHTOJCA Xb
RAPORTET MBI LËNDËT DJEGËSE TË HEDHURA PËR KONSUM NGA SUBJEKTET E RREGULLUARA

Së bashku me informacionin e përfshirë në raportin vjetor të shkarkimeve, në përputhje me shtojcën X të kësaj rregulloreje, për çdo lëndë djegëse të blerë, të përkufizuar sipas pikës 40, të nenit 3, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar,:

a) emrin, adresën dhe numrin unik të autorizimit për shkarkimet GES të operatorit të instalimit, dhe kur është e zbatueshme të lejes/licencës/autorizimit të operatorit të avionit dhe shoqërisë së transportit detar për të cilin është hedhur për konsum lënda djegëse. Në rastet e tjera kur lënda djegëse shkon për përdorimin fundor në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesët A, B dhe C të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, subjekti i rregulluar paraqet kur është e disponueshme, listën e të gjithë konsumatorëve të lëndëve djegëse, duke filluar nga blerësi i drejtpërdrejtë deri tek operatori i instalimit, duke përfshirë emrin, adresën dhe numrin unik të autorizimit për shkarkimet GES të secilit, kur kjo nuk shkakton një barrë administrative joproporcionale;

b) llojet dhe sasitë e lëndëve djegëse të shitura për secilin blerës të përmendur në shkronjën "a" më sipër gjatë periudhës përkatëse të raportimit.

c) sasinë e lëndës djegëse të përdorur për veprimtaritë e përmendura në shtojcën II, pjesët A, B dhe C, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, për secilin blerës të përmendur në pikën "a" më sipër gjatë periudhës përkatëse të raportimit.

VENDIM
Nr. 513, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NR. IV NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DHE *DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT* (GIZ) *GMBH*, SI PËRFAQËSUESE E QEVERISË GJERMANE DHE AGJENCI ZBATUESE, PËR PROGRAMIN "ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE RAJONAL, NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL" (PROSEED)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. IV ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) *GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për programin "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimi dhe formimi profesional" (ProSEED), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE ZBATIMI Nr. IV

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

- në vijim e referuar si "partner zbatues"

dhe

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

-në vijim i referuar si "GIZ" -

në lidhje me programin

" Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (ProSEED)

- në vijim i referuar si "programi"-

MARRËVESHJE PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE TË BASHKËPUNIMIT TEKNIK

Përmbajtja
Bazat e Marrëveshjes
1. Objektivi dhe indikatorët e Programit
2. Kontributet për Programin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ- it
2.1 Sigurimi i ekspertëve
2.2 Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve
2.3 Kostot operative dhe administrative
2.4 Kontribute të tjera
3. Kontributet nga Organizatat Partnere
3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës
3.2 Kostot
3.3 Sigurimi i objekteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës
4. Dispozita të tjera
4.1 Vlerësimi
4.2 Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes
4.3 Afati i Marrëveshjes
4.4 Përshtatja e Marrëveshjes
4.5 Forma me shkrim
4.6 Marrëveshjet me organizata zbatuese individuale
4.7 Zbatimi i Marrëveshjes
4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
4.9 Hyrja në fuqi
5. Shtojcat

Bazat e Marrëveshjes

Teksti i mposhtëm do të përbëjë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988 (shihni Shtojcën 1)
- Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), të miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5.03.2018", (shihni Shtojcën 2).
- Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 60/2021, datë 26 mars 2021 dhe Protokolli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020. (shih Shtojcën 3)

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 2 të Marrëveshjes së lartpërmendur; Paragrafi 3, Neni 2 i ligjeve Nr. 11/2018; detajet e programit duhet të përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet GIZ-it dhe Organizatës Partnere MFE. GIZ është duke vepruar në përmbushjen e mandatit me të cilën është ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

1. Objektivi dhe indikatorët e Programit

Objektivi i këtij Programit është: **Situata e punësimit në Shqipëri është përmirësuar, duke përfshirë elementët dixhitalë dhe të gjelbër.**

Programit do të zhvilloje aktivitetin në nivel kombëtar, në të gjitha rajonet e Shqipërisë.

GIZ dhe **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** si **partner zbatues kyç** angazhohen bashkërisht për të arritur këtë objektiv.

Indikatorët e objektivit janë:

Treguesit objektivë janë:

- **1,100 të diplomuar/certifikuar nga masat e modernizuara të kualifikimit profesional janë të punësuar ose të vetëpunësuar; 450 prej tyre janë gra dhe 220 emigrantë të kthyer.**
- **1,500 vende pune janë siguruar apo krijuar rishtas në 850 ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) të mbështetura në fushat e digjitalizimit dhe zhvillimit të gjelbër ekonomik.**
- **Elementë kryesorë të një strategjie apo plani të ri veprimi në lidhje me digjitalizimin ose zhvillimin e gjelbër ekonomik, që synon përmirësimin e gjendjes së punësimit, janë miratuar nga organet përkatëse politike vendim-marrëse.**

Rezultatet e përgjithshme të programit përfshijnë: (1) përmirësimin e ofertës së fuqisë punëtore të kualifikuar, (2) përmirësimin e konkurrencës së MSME-ve dhe kapacitetin e tyre për krijimin e vendeve të punës, (3) mbështetjen e zhvillimit të politikave në fushat e AFP-së dhe Zhvillimit të Sektorit Privat, integrimin e dixhitalizimit dhe ekonomisë së gjelbër në të gjitha aktivitetet. Tre fushat e ndërhyrjes do të përmbajnë masat kryesore të mëposhtme:
Fusha e Ndërhyrjes 1 (AFP): Të përmirësojë ofertën e fuqisë punëtore të kualifikuar në sektorët me potencial të lartë punësimi, duke integruar sistematikisht në sistemin AFP-së elementët digjitalë dhe të gjelbër nëpërmjet kurrikulave mësimore si dhe zbatimin e tyre në kualifikimin profesional formal dhe jo formal. Masat do të përfshijnë për shembull: (a) ngritjen e kapaciteteve për ofruesit publikë dhe privatë të APS-së për mbështetjen e ofrimin e formimit profesional me cilësi të lartë, (b) zhvillimin e programeve të reja ose rishikimin e kurrikulave ekzistuese duke integruar elementët e gjelbër dhe digjitalë; c) trajnimin e personelit të APF-së, d) zbatimin e mëtejshëm të planit digjital dhe (e) pilotimin e zhvillimit të aftësive të gjelbra (në profesione shumë të rëndësishme). f) mbështetja e ofruesve publik të AFP-së me pajisje të TIK-ut për të mundësuar lëvrimin e kurrikulave të reja; dhe çështjet e gjelbërta (p.sh. parandalimi i mbeturinave, riciklimi dhe eliminimi i sigurt, përdorimi efikas i energjisë dhe ujit, shëndeti dhe siguria në punë).
Fusha e Ndërhyrjes 2 (ZhSP): Rritja e konkurrencës së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), për të siguruar vendet ekzistuese ose për të krijuar vende të reja pune. Kjo përfshin përdorimin e potencialit të zhvillimit dixhital dhe të gjelbër për të rritur perdorimin e proceseve dhe menaxhimit, mbështetur ne modernizimin e teknologjise dhe informacionit. Ndërsa në zhvillimin e biznesit të gjelbër

NMVM - pavarësisht nga sektori – proceset e biznesit duhet të mbështeten në qasje miqësore ndaj mjedisit. MSM-të do të përfshihen në zbatimin e masave të gjelbërta ose futjen e elementëve digjitalë me grante financimi të forcuara nga projekti. Përveç kësaj, elementët thelbësorë të zbatimit të strategjisë BIDS 2021-2027 do të mbështeten (duke përfshirë zhvillimin e marrëdhënieve të furnizimit, qasjet grumbulluese) për të integruar NMVM-të në zinxhirët rajonalë ose evropianë të vlerave. Organizatat e përfaqësimit dhe mbështetëse të NMMVM-së do të fuqizohen me këshillim mbi zhvillimin e qëndrueshëm, të gjelbër dhe dixhital të biznesit.
MSM-të e goditura nga krizat e Kovidit do të mbështeten për të kapërcyer vështirësitë dhe për të përshtatur me sukses modelet e biznesit për t'u bërë elastike, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt të ardhmes e ndaj kushteve të reja të tregut.
Fusha e Ndërhyrjes 3 (Mbështetja e Zhvillimit të Politikave): Mbështetje MFE, AKPA, AKAFPK, dhe AIDA për të zhvilluar politika të reja, strategji dhe për të përmirësuar kushtet kornizë për integrimin e digjitalizimit dhe elementëve të gjelbër në zhvillimin e Sektorit Privat, Punësimin dhe Aftësive Profesionale për të rritur zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe punësimin. Masat do të përfshijnë: (a) zhvillimin e elementëve të zgjedhur të strategjisë së re SKPA 2022-2027, (b) analiza sektoriale për VET në sektorin e gjelbër / gjelbërimin e AFP-se, (c) mbështetje për monitorimin e BIDS 2021-2027, dhe (d) mbështetjen e zhvillimit të politikave në fushat e digjitalizimit dhe ekonomisë së gjelbër.

Të gjitha veprimtaritë do të synojnë meshkuj e femra të rritur si dhe të kthyerit që vijnë nga Gjermania dhe vende të tjera anëtare të BE.

2. Kontributet për Programin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me:

Protokollin e Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020 dhe Shkëmbimit të Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë Shqiptare VN-Nr.: 60/2021, të datës 26 mars 2021, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i ofron GIZ-së për zbatim vlerën deri në 8.5 milionë Euro (me fjalë tetë milion e pesëqind mijë Euro). Kjo shumë do të përfshijë shpenzimet e bëra nga Organizata Gjermane e Zbatimit.

Buxheti i përgjithshëm i programit ProSEED arrin vlerën 33.65 milion Euro. Një tabelë që përshkruan të gjitha alokimet buxhetore është bashkëngjitur si Shtojca 4 e kësaj Marrëveshjeje Zbatimi.

Kohëzgjatja e përgjithshme e programit është planifikuar deri në 30/09/2025. Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit do të mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej gjashtë muajsh, deri më 31/03/2026 për të siguruar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumenteve të projektit tek pala partnere.

2.1 Sigurimi i ekspertëve

GIZ do të vërë në dispozicion për programin:

- një ekspert ndërkombëtar përgjegjës për kontributin e GIZ i cili në të njëjtën kohë do të jetë menaxher/udhëheqës i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion të këtij programi për të gjithë kohëzgjatjen e tij.
- ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushat e:

- Arsimit dhe formimit profesional me fokus në bashkëpunimin me (i) ofruesit publikë dhe privatë të formimit profesional, (ii) integrimin e aspekteve digjitale dhe të gjelbërta në sistemin AFP-së dhe (iii) këshillim mbi politikat;
- Zhvillimit të Sektorit Privat me fokus në (i) shërbimet e këshillimit dhe trajnimet e sipërmarrjes për të ndërtuar kapacitetet e NMVM, (ii) promovimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve me fokus zhvillimin rajonal, (iii) këshillim mbi politikat;
- Monitorimit të programit, Raportimt dhe aktivitete informuse e promocionale.
- Menaxhimit të zyres me detyra administrative dhe logjistikë;
- Shërbime mbështetëse për zyrat e programit.

Periudha e kohore e punës për ekspertët e huaj përfshin edhe lejet vjetore në përputhje me dispozitat e ligjit gjerman.

2.2 Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve

GIZ do të furnizojë artikujt e mëposhtëm për të pajisur infrastrukturën teknike:

- Përdorimin e automjeteve të projektit (të blera në fazën e mëparshme të programit);
- Mobilje, pajisje dhe infrastrukturë komunikimi për zyrat e programit në Tiranë;
- Pajisje të reja dhe/ose përdorimi i pajisjeve ekzistuese për ofrues të zgjedhur publikë të AFP-së;
- Pajisje të reja për organizatat partnere të nevojshme për arritjen e objektivave të programit.

Këto pajisje, pas përfundimit të përdorimit nga programi GIZ, do të transferohen në institucionet partnere përkatëse.

2.3 Kostot operative dhe administrative

GIZ do të mbulojë kostot operacionale dhe/ose administrative që lidhen me administrimin e kontributit gjerman për Programin.

2.4 Kontribute te tjera

GIZ do të japë kontributet shtesë të mëposhtme:

- Sipas buxhetit vjetor dhe nevojave konkrete të partnerëve, GIZ do të ofrojë konsulencë për zhvillimin e kapaciteteve të partnerëve, grupeve të synuara, ndërmjetësve dhe aktorëve të tjerë kryesorë në nivel kombëtar dhe mikro, për zhvillimin dhe menaxhimin e njohurive në fushat specifike të ndërhyrjes ose objektivave të programit. Shërbimet e konsulencës do të dakordësohen midis GIZ dhe institucioneve të saj partnere.
- Përdorimi, nëse konsiderohet i nevojshem i instrumenteve të GIZ-it për zbatim, si Kontratat e Konsulencës (lokale dhe ndërkombëtare), Marrëveshjet Financiare, Subvencionet Lokale dhe Kontratat (lokale dhe ndërkombëtare) për shërbimet dhe mallrat, pajisjet dhe /ose mbështetjen e konferencave, seminareve per çështjet e lidhura me programin.
- Zbatimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese.
- Kontribute të tjera në përputhje me planin e operacional të programit.

3. Kontributet nga Organizatat Partnere

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

Organizata Partnere Zbatuese duhet:

- të sigurojë përfaqësimin e duhur nga MFE dhe agjencitë përkatëse ekzekutuese, në Komitetin Drejtues Politik (KDP) të programit. Të organizoje dhe thërrasë takimin e KDP të paktën dy herë në vit, duke përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e Minutave të Takimit për të gjithë pjesëmarrësit. Një përfaqësues i ambasadës gjermane do të jetë gjithashtu i pranishëm në KDP.
- të sigurojë një interlokutor të kualifikuar të Ministrisë për programin në nivel teknik për menaxhimin e përditshëm të programit, i cili gjithashtu mund të këshillojë strategjikisht programin.
- të vënë në dispozicion stafin partner të kualifikuar për të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e programit.
- të sigurojë pjesëmarrjen e stafit nga MFE dhe agjencitë ekzekutuese në masat e ndërtimit të kapaciteteve.

3.2 Kostot

Organizatat partnere, do të sigurojnë kostot e TVSH-së për aktivitetet e programit që përfitojnë institucionet e tyre përkatëse dhe shpenzimet e lidhura me të në Shqipëri (shpenzimet operative dhe prokurimet) si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare. Sigurimi i buxhet të mjaftueshëm deri në datën e përfundimit të programit 31.03.2026. Angazhimi për të rimbursuar TVSH-në është i vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të programit.

3.3 Sigurimi i objekteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës

Organizata partnere (MFE) duhet:

- të vërë në dispozicion të Programit pa pagesë (nëse është e mundur) si dhe përdorimin e ambjenteve dhe sallave të konferencës duke përfshirë pajisjet për të kryer aktivitete dhe trajnime që lidhen me programin.
- të vërë në dispozicion hapësirat dhe ndërtesat e ofruesve publikë të AFP-së, laboratorët, pajisjet dhe orenditë përfshirë edhe ato pajisje që nuk janë blerë nga GIZ nëse është e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve që lidhen me programin ProSEED komponenti i AFP-së.

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

GIZ mund të ndërmarrë një vlerësim të Programit gjatë ose pas zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ do të nënkontraktojë ekspertë/vlerësues për Programin. Organizatat Partnere do të marrin pjesë në vlerësim. Në të gjitha rastet do të ndihmojnë ekspertin(ët)/vlerësuesin(ët) në punën e tyre dhe do t'i lejojnë ata për të shqyrtuar të gjitha dokumentet e nevojshme.

Organizata partnere do të informohen për rezultatet e vlerësimit me anë të raporteve.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

GIZ mund të pezullojë kontributin e saj nëse:

- Organizata Partnere nuk arrin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, ose
- lindin rrethana, të cilat përjashtojnë apo rrezikojnë ndjeshëm objektivin e Programit të përshkruar në Klauzolën 1 më sipër.

Nëse lind një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më sipër dhe ekziston ende pas një afati të rënë dakord nga GIZ-i me Organizatën Partnere ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ-i, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të përfundojë para kohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveç kur parashikohet në Klauzolën 4 më sipër mbi pezullimin e kontributeve dhe përfundimit të Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e fazës vazhduese të Programit (aktualisht i planifikuar të vazhdojë deri në 30/09/2025). Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit do të mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej tre muajsh, deri më 31/03/2026 për të mundësuar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumentacionit të përshtatshëm tek organizata partnere. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të vonesave në zbatimin e kontributeve të palës gjermane sipas termave të shkruar në Marrëveshjen Zbatimin dhe kontributeve të dakordësuara të Organizatës Partnere. Zgjatja e afatit të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të gjitha palët e përfshira.

4.4 Përshtatja e Marrëveshjes

Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndihmojnë në arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më sipër, atëherë GIZ-i dhe Organizat Partnere mund të përshtasin ose ndryshojnë këto dispozita me pëlqim të ndërsjellë në çdo fazë gjatë zbatimit të programit. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ mund të përfundojë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje, nëse mandati me të cilin është ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, është tërhequr.

4.5 Forma me shkrim

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si edhe deklarata dhe komunikime të tjera të rëndësishme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, do të jetë e mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit te ekspertëve të vënë në dispozicion.

4.6 Marrëveshjet me organizata zbatuese individuale

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ-i dhe personin (at) përgjegjës për kontributet nga organizata partnere ose organizata të tjera zbatuese mund të lidhin bashkërisht një marrëveshje detyruese për detaje shtesë në lidhje me ekzekutimin e programit (p.sh. në bazë të një plani të veprimeve), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme për të përcaktuar ato detaje me shkrim dhe, kur është e nevojshme, për të përshtatur ndonjë marrëveshje të tillë për të marrë parasysh zhvillimet e programit.

4.7 Zbatimi i Marrëveshjes

Në lidhje me dispozitat që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, referencë do të bëhet me dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik (shihni Shtojcën 1) dhe Marrëveshjen/Shkëmbimin e Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për angazhimet në lidhje me bashkëpunim teknik (shihni Shtojcën 3), të dyja të përmendura në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve, rekomandohet që të zgjidhet me anë të bisedimeve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje e tillë, komunikimi duhet të ndiqet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4.9 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përmbushjes së procedurave të brendshme të palëve. Ajo hartohet në katër kopje origjinale: dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, 10.05.22

GIZ

Znj. Sonja Kurz
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Irina Kausch
Drejtuese Programi

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Znj. Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

nr. prot. 3485/12 6.6.2022

5.Shtojcat

Shtojca 1: Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988.

Annex1 Agreement 1988_FRG and GOA.d

Shtojca 2: Ligji No. 11/2018 për Ratifikimine Marrëveshjesh me anë të Shkëmbit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional", miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5.03. 2018.

LIGJ
Nr. 11/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK 2017, PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE RAJONAL, NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMI PROFESIONAL (SHTIM I DYTË FONDESH)"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin "Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimi profesional (shtim i dytë fondesh)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10741, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për të forcuar dhe për të thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;
të ndërgjegjshme se nxitja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

Shtojca 3: Notë Verbale 60/2021, datë 26 mars 2021, dhe Protokolli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020.

21-03-26-VN-NR-60 -ProSEED(002).pdf

TIRA_2020-11-27_48 268_Anlage_01_Signe

Shtojca 4: Përmbledhje e alokimeve buxhetore për ProSEED

Marrëveshje Qeveritare (Notë verbale)	Akt ligjor	Marrëveshje ndërmjet partnerëve zbatues	Buxheti
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 59/2017 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional", miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 20 prill 2017	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet GIZ ZKM, MMSR, dhe MZHTTS 19/06/2017	5.5 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 60/2017 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 20 prill 2017"	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet GIZ ZKM, MMSR, dhe MZHTTS 19/06/2017	5 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5 Mars 2018.	Amendim i Marrëveshjes bazë të Zbatimit Nr. I, ndërmjet GIZ ZKM, dhe MFE 19/12/2017	6 milion Euro
Instrumente për Para-Aderim (IPA II)	Marrëveshje me Delegacionin e Bashkimit Evropian (ctr. 2018/400-907) me Organizatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) për zbatimin e fondit deri në 4.4 milion Euro (katër pikë katër milion Euro).	Kontratë Numër 2018/400-907 24/09/2018	4.4 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për	Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin "	Marrëveshje Zbatimi II, ndërmjet GIZ dhe MFE 21/12/2019	3 milion Euro

Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 314/2018, të datës 30 nëntor 2018.	Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5 mars 2018.		
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 146/2020, datë 28 korrik 2020, dhe VN-Nr.: 38/2021, datë 17 shkurt 2021	Marrëveshje me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga qeveria shqiptare me VKM Nr. 631 date 27.11.2021.	Marrëveshje Zbatimi III, ndërmjet GIZ dhe MFE	1.25 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 60/2021, datë 26 mars 2021 dhe Protokolli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020	Marrëveshje me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar qeveria shqiptare me VKM. Nr. 262, datë 29.04.2022.	Marrëveshje Zbatimi IV, ndërmjet GIZ dhe MFE	8.5 milion Euro
Totali i programit ProSEED			**33.65 milion Euro**

VENDIM
Nr. 514, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NR. II NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DHE *DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT* (GIZ) *GMBH*, SI PËRFAQËSUESE E QEVERISË GJERMANE DHE AGJENCI ZBATUESE, PËR PROJEKTIN "MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN NË SEKTORIN EKONOMIK" (SANECA II)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. II, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarb*eit (GIZ) *GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në sektorin ekonomik" (SANECA II), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MFE 11447/1
DT 4.7.2023

MARRËVESHJE ZBATIMI Nr.II

ndërmjet

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5

65760 Eschborn

- në vijim i referuar si "GIZ" -

dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

- në vijim i referuar si "pala zbatuese" -

në lidhje me projektin
"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik" (SANECA II)

- në vijim e quajtur si "Projekti" -

MARRËVESHJE ZBATIMI PËR PROJEKTET E BASHKËPUNIMIT TEKNIK

Përmbajtja
Baza e Marrëveshjes
1. Objektivi dhe treguesit e Projektit
2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it
2.1 Sigurimi i ekspertëve
2.2 Kostot operacionale dhe administrative
2.3 Kontribute të tjera
3. Kontributet e MFE-së
3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës
3.2 Kostot
3.3 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)
4. Dispozita të tjera
4.1 Vlerësimi
4.2 Pezullimi i kontributeve dhe mbarimi i Marrëveshjes
4.3 Afati i Marrëveshjes
4.4 Modifikimi i Marrëveshjes
4.5 Forma me shkrim
4.6 Marrëveshjet me organizatat zbatuese individuale
4.7 Marrëveshja e Zbatimit
4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
4.9 Hyrja në fuqi, kopjet
Shtojcat

Baza e Marrëveshjes

1) Parashikimet e mëposhtme do të formojnë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik e datës 21 tetor 1988 (Shtojca 1).

- Ligji nr.65 datë 03/10/2019 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)" (Shtojca 2).

- Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtur virtualisht më 24 nëntor 2020 (Shtojca 3). Në këtë procesverbal parashikohet që Qeveria Gjermane do të sigurojë vazhdimin e angazhimit për projektin vijues SANECA II (Shtojca 3)

- Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë i mbajtur më 13.12.2022 (Shtojca 3.1). Në këtë procesverbal parashikohet që Qeveria Gjermane do të siguroje financimin e projektit vijues SANECA II me një fond shtesë mbi atë të rënë dakord në procesverbalin e negociatave të datës 24 nëntor 2020.

- Nota Verbale VN-Nr.: 181/2022, datë 31/08/2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për shtimin e fondeve të projektit vijues SANECA II (Shtojca 4), duke bërë referimin në Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik" (SANECA), datë 25 qershor 2019 (shih Shtojcën 2). Në këtë marrëveshje parashikohet se ajo është e aplikueshme për masa të tjera vijuese nga Qeveria Gjermane.

- Autorizimi, nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i datës 12.01.2023 (Shtojca 5)

- Shtojca 6 jep një përmbledhje të alokimeve buxhetore për projektin SANECA II.

2) Në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes së sipërpërmendur të ratifikuar me ligjin nr. 65/2019, detajet e projektit duhet të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet GIZ-s dhe MFE-së. GIZ-ja vepron në zbatim të autorizimit, i cili i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3) Kjo Marrëveshje mbulon fazën e zbatimit nga 2023 deri më 31/01/2026.

1. Objektivi dhe treguesit e Projektit

Objektivi i këtij Projekti është:
Administrata shqiptare është e aftë të zhvillojë bisedimet e anëtarësimit në BE në grupkapitujt e tregut të brendshëm, me pjesëmarrjen e palëve të interesit.
GIZ dhe MFE janë të angazhuar bashkërisht për këtë objektiv.
Treguesit për arritjen e këtij objektivi janë:

(1) Raporti vjetor i Komisionit të BE-së vëren një nivel më të mirë përgatitjeje ose progres vjetor në përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në 8 nga 10 kapitujt e mbështetur të grupkapitujve (*cluster*) të tregut të brendshëm (+ kapitullin 20).

(2) Për 50% të akteve ligjore për të cilat projekti ka ofruar këshillim për administratën shqiptare në fushën e grupkapitujve (*cluster*) të tregut të brendshëm, janë në dispozicion vlerësimet përkatëse të ndikimit rregullator çka dokumenton se aktet ligjore janë shqyrtuar lidhur me rëndësinë që kanë për barazinë gjinore.

(3) 50% e përafërsisht 120 anëtarëve joshtetërorë të Tryezave të Konsultimit të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian, në mesatare e vlerësuan procesin e trajtimit të rekomandimeve dhe pozicioneve të aktorëve joshtetërorë në Platformë si të mirë ose si shumë të mirë.

Fushat e ndërhyrjes (Rezultatet) përfshijnë:
1) **Rezultati 1** synon të sigurojë që anëtarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Europian (GNPIE-të) të jenë të pajisur me instrumentet e nevojshme të punës dhe të këshillohen për përgatitjen e 10 paketave të prezantimeve për takimet dypalëshe, në mënyrë që procesi i shqyrtimit analitik, si një moment i rëndësishëm në bisedimet e pranimit në BE, të finalizohet me cilësinë e duhur.
2) **Rezultati 2** synon të sigurojë harmonizim të mëtejshëm me *acquis* e BE-së në fusha të përzgjedhura që janë me prioritet të lartë dhe të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, duke garantuar përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator (RIA) dhe marrjen në konsideratë të aspekteve të barazisë gjinore. Kjo do të kontribuojë në rritjen e nivelit të përafrimit duke e vendosur qeverinë shqiptare në një pozicion më të mirë negociues në bisedimet e anëtarësimit dhe duke siguruar një kuadër rregullator më të mirë në fushat në fjalë, i cili reflekton standardet e BE-së.
3) **Rezultati 3** synon të përmirësojë dialogun midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në lidhje me procesin e negociatave dhe të promovojë një kulturë besimi dhe bashkëpunimi të ndërsjellë, duke siguruar që ata të jenë të informuar siç duhet, si edhe të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të konsultohen për çështjet që i prekin. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore ndaj palëve të interesuara gjatë procesit të negociatave.
Ndryshimi i objektivit ose fushave të ndërhyrjes është gjithmonë subjekt miratimi nga Qeveria Gjermane.

Treguesit e Projektit janë përcaktuar në autorizimin e BMZ-së. Çdo ndryshim, teknik apo financiar, do të zyrtarizohet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet palëve.
Projekti do të zbatohet së bashku me MFE-në si partneri kryesor i Projektit. Në varësi të aktiviteteve në përputhje me objektivin e Projektit, SANECA II mund të përfshijë institucione të tjera si partnerë të drejtpërdrejtë të Projektit.
GIZ dhe MFE do të krijojnë dhe mbajnë strukturën drejtuese dhe zbatuese të mëposhtme për kohëzgjatjen e Projektit:

Emri	Përfaqësimi	Roli	Shpeshtësia
Komiteti i Drejtimit Politik (KDP)	Ministri/ja dhe Zëvendësministri/ja e Financave dhe Ekonomisë, Kryenegociatori/ja; Përfaqësues nga Ambasada Gjermane; Drejtuesi/ja e GIZ për Shqipërinë; Drejtuesja e Projektit SANECA II;	Vendimmarrje në rast të ndryshimeve madhore që kërkohen gjatë zbatimit të projektit. Shkeljet themelore të vlerave të përbashkëta trajtohen në këtë nivel.	Mblidhet vetëm nëse ndodh ndonjë ndryshim madhor në zbatimin e projektit
Komiteti i Drejtimit Strategjik (KDS)	Zëvendësministri/ja e MFE, Negociatorët/et e kapitujve në fokus, Përfaqësues të zyrës së Kryenegociatorit/es, Drejtuesi/ja e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Përfaqësues nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Përfaqësues nga Ambasada Gjermane, Drejtuesi/ja e GIZ për Shqipërinë, Drejtuesja e Projektit SANECA II, Të tjerë sipas nevojave.	Drejtimi strategjik, miratimi i planit operacional vjetor, monitorimi i performancës	Njëherë në vit dhe sipas nevojës
Grupi(et) i Drejtimit Operacional (GDO)	Personat teknikë të kontaktit për cdo kapitull, Anëtarët e sekretariatit teknik për kapitujt në fokus, Përfaqësues nga departamentet e Integrimit të MFE-së dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse për kapitujt në fokus, Menaxherët/et e trajnimit në ASPA, Stafi i projektit SANECA II, etj.	Planifikimi i detajuar dhe zbatimi i aktiviteteve sipas planit operacional të miratuar	Çdo tremujor (ose më shpesh nëse gjykohet e nevojshme)

Komunikimi dhe raportimi:
Të dyja palët angazhohen të mbajnë njëra-tjetrën të informuar dhe të përditësuar me zhvillimet më të fundit të aktiviteteve të Projektit, si dhe me informacione të tjera, materiale, dokumente dhe raporte që ndikojnë ose janë të dobishme për zbatimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të projektit.

2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-së.

Në përputhje me autorizimin nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i jepet GIZ-së një shumë prej 3'000'000 EURO (tre milion euro) për kontributin Gjerman. Kjo shumë duhet të përfshijë kostot e Organizatës Zbatuese Gjermane.

Kohëzgjatja e përgjithshme e projektit është planifikuar deri në 31/01/2026. Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej 6 (gjashtë) muajsh, deri më 31/07/2026, për të siguruar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumenteve të projektit tek pala tjetër.

2.1 Sigurimi i ekspertëve

GIZ-ja do të bëjë të disponueshme për projektin

- një ekspert kombëtar afatgjatë për Integrimin Europian, që në të njëjtën kohë do të jetë drejtues i grupit të ekspertëve të disponueshëm për këtë Projekt për kohëzgjatjen e fazës aktuale të tij;
- katër ekspertë kombëtarë afatgjatë që do të jenë përgjegjës për të koordinuar dhe për të dhënë ekspertizën teknike lidhur me aktivitetet e projektit, komunikimin me institucionet partnere, menaxhimin financiar dhe të njohurive, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të projektit;
- një menaxher për financat dhe zyrën
- një punonjës mbështetës (part time)
- deri në 2400 ditë pune për ekspertët ndërkombëtarë dhe deri në 3950 ditë pune për ekspertët kombëtarë afatshkurtër për fushat specifike dhe për aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve, sic do përcaktohet në planin e aktiviteteve.

2.2 Kostot operacionale dhe administrative

GIZ-ja do të përballojë kostot operacionale dhe/ose administrative të lidhura me administrimin e kontributit Gjerman për Projektin.

2.3 Kontribute të tjera

GIZ-ja do të japë kontributet e tjera të mëposhtme:

- do të mbulojë financimin e shërbimeve të përkthimit dhe redaktimit për materiale dhe takime përkatëse që lidhen me zbatimin e aktiviteteve të projektit.
- do të mbulojë financimin e publikimeve të ndryshme sipas planit të aktiviteteve.

3. Kontributet e MFE

MFE cakton personat e kontaktit brenda Ministrisë për t`i siguruar mbështetje Projektit për nevojat ditore në zbatimin e aktiviteteve, përgjatë gjithë fazës së zbatimit.

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

MFE:
- do të sigurojë personel të kualifikuar për të planifikuar dhe zbatuar bashkërisht aktivitetet e vecanta të parashikuara në planin e aktiviteteve;
- do të këshillojë në mënyrë strategjike mbi procesin e zbatimit të Projektit dhe ndryshimet organizative në zbatim të prioriteteve dhe strategjive të qeverisë shqiptare, në koordinim edhe me burime të jashtme të asistencës teknike dhe financiare;
- do të marrë pjesë në Strukturat Drejtuese të Projektit;
- do të sigurojë përfaqësimin e duhur nga MFE dhe agjencitë përkatëse zbatuese, në strukturat drejtuese të Projektit. Të organizojë dhe zhvillojë mbledhjen e Komitetit të Drejtimit Strategjik (KDS) të paktën një herë në vit, duke përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e Procesverbalit të Mbledhjes për të gjithë pjesëmarrësit;
- do të sigurojë përfshirjen dhe pjesmarrjen e institucioneve të tjera shqiptare gjatë zbatimit të Projektit;
- do të sigurojë informacion dhe komunikim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me Projektin lidhur me të gjitha çështjet e aktiviteteve të tij.
- do të sigurojë pjesëmarrjen e stafit të MFE dhe institucioneve të tjera të linjës, në masat e zhvillimit të kapaciteteve.

3.2 Kostot

MFE do të mbulojë kostot e aktiviteteve të përbashkëta (publikime, seminare, turne studimi, etj) vetëm nëqoftëse ato e tejkalojnë kontributin e GIZ-së, sipas planit të aktiviteteve të rënë dakort. MFE do të garantojë se kostot që do të specifikohen në planin e aktiviteteve do të buxhetohen në kohën e duhur.

3.3 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

MFE:
- mbart TVSH për kostot e aktiviteteve të projektit dhe shpenzimet përkatëse të kryera në Shqipëri (shpenzime operative dhe prokurime) si edhe për prokurimet/importet ndërkombëtare në një shumë përafërsisht 35.000,00 EUR (rreth 4.000.000,00 ALL) dhe siguron buxhetim të mjaftueshëm në kohën e duhur.
- Rimbursimi i TVSH-së ndaj GIZ-së është i vlefshëm për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, me përjashtim të prokurimeve/importeve ndërkombëtare, të cilat nuk i nënshtrohen rimbursimit të TVSH por vetëm përjashtimit prej saj, në perputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për TVSH.

4. Dispozita të tjera

GIZ-ja (Drejtuesi i Projektit) dhe MFE (Personi përgjegjës për Projektin) do të takohen në intervale të rregullta kohe për të monitoruar zbatimin dhe për të rënë dakort mbi ndonjë ndryshim që mund të jetë i nevojshëm.

GIZ-ja dhe MFE do të informojnë njëra-tjetrën mbi çdo zhvillim të ri që mund të influencojë Projektin.

4.1 Vlerësimi

GIZ-ja dhe MFE bien dakort për monitorimin dhe vlerësimin e përbashkët të Projektit. GIZ-ja mund të ndërmarrë një vlerësim për Projektin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Për këtë qëllim, GIZ-ja do të delegojë ekspertë/vlerësues për Projektin. MFE do të marrë pjesë në vlerësim. Ajo në të gjitha rastet do të ndihmojë ekspertin(ët)/vlerësuesin(t) në punën e tyre dhe do t'i lejojë ata të ekzaminojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MFE do të informohet në lidhje me rezultatet e vlerësimit me anë të një raporti.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe mbarimi i Marrëveshjes

GIZ-ja mund të pezullojë kontributin e saj nëse:

- MFE nuk përmbush detyrimet që dalin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, ose
- lindin rrethana që e përjashtojnë, ose vendosin në rrezik, objektivin e Projektit të përshkruar në Klauzolën 1 më lart.

Nëse lind një prej rrethanave të përshkruara në fjalinë 1 më lart dhe është akoma në ekzistencë mbas një afati të rënë dakord nga GIZ dhe MFE, ose nëse nuk është eliminuar brenda kësaj periudhe, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, GIZ mund ta mbarojë parakohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveçse kur përcaktohet në Klauzolën 4.2 më lart për pezullimin e kontributeve dhe mbarimin e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e Projektit (aktualisht i planifikuar të vazhdojë nga 2023 deri në 01/2026). Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej gjashtë muajsh, deri më 31/07/2026 për të mundësuar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumentacionit të përshtatshëm tek pala tjetër.

Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të vonesës në ekzekutimin e kontributit Gjerman siç parashikohet në këtë Marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të rëna dakord të MFE.

4.4 Modifikimi i Marrëveshjes

Në rast se klauzolat e kësaj Marrëveshje nuk ndihmojnë në arritjen efiçente të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më lart, atëherë GIZ dhe MFE mund t'i ndryshojnë ose amendojnë këto klauzola me pëlqim reciprok në çdo fazë gjatë zbatimit të Projektit. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

GIZ mund ta mbarojë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje nëse tërhiqet autorizimi që i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

4.5 Forma me shkrim

Amendamentet dhe shtesat në këtë Marrëveshje, dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme dhe komunikim domethënës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ, do të mjaftonte që ato të merreshin nga udhëheqësi i grupit të ekspertëve të siguruar.

4.6 Marrëveshjet me organizatat zbatuese individuale

Personi përgjegjës për kontributin e GIZ dhe personi(at) përgjegjës për kontributet nga organizatat partnere ose organizatat e tjera zbatuese mund të lidhin së bashku marrëveshje të detyrueshme për detajet shtesë në lidhje me zbatimin e Projektit (p.sh. në bazë të një plani veprimesh), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtashme t'i përcaktojnë këto detaje me shkrim dhe, sipas rastit, të ndryshojnë atë marrëveshje që të marrë në konsideratë ndryshimet në Projekt.

4.7 Marrëveshja e Zbatimit

Për parashikimet që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, referimi bëhet në parashikimet e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik e datës 21 tetor 1988 (Shtojca 1) dhe në ligjin nr. 65/2019 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projekin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik" (Shtojca 2).

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, ato do të bëjnë përpjekje për t`i zgjidhur nëpërmjet negocimeve. Nëse kjo nuk arrihet, komunikimet do të ndiqen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4.9 Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të palës shqiptare për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore. Kopjet në të cilat shtypet marrëveshja, janë po aq sa palët në marrëveshje. Ajo do të hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe dy kopje origjinale në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, 04.07.2023

Për Deutsche Gesellschaft für (GIZ) GmbH

Dr. Sonja Kurz
Drejtor i GIZ-it për Shqipërinë

Tiranë, 04.7.23

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Znj. Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Shtojcat

Shtojca 1:
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, e datës 21 tetor 1988.

Shtojca 2:
Ligji nr. 65 datë 03/10/2019 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)"

Shtojca 3:
Procesverbali Përmbledhës i Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mbajtur në Tiranë më 24 nëntor 2020

Shtojca 3.1:
Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë i mbajtur më 13.12.2022

Shtojca 4:
Nota Verbale VN-Nr.: 181/2022, datë 31/08/2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për shtimin e fondeve të projektit vijues SANECA II

Shtojca 5:
Autorizimi, nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i datës 12.01.2023

Shtojca 6:
Përmbledhje e alokimeve buxhetore për SANECA II

Marrëveshje Qeveritare (Notë verbale)	**Akt ligjor**	**Marrëveshje e zbatimit ndërmjet palëve**	**Buxheti**
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin	Ligji nr. 65/2019 "*Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Mbështetje për negociatat për*	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga MFE dhe GIZ në lidhje	2.000.000 Euro[1] (dy milionë Euro)

[1] Seksionin 2, Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-së.

Teknik, datë 21 tetor 1988. **Rezultatet e Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 22 Nëntor 2018.**	*anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik*" Miratuar nga Parlamenti Shqiptar në datën 03.10.2019.	me projektin *"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik"* (SANECA I)	
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, datë 21 tetor 1988. **Neni 1 pika 2 është bazë për marrëveshjen e zbatimit.** **Rezultatet e Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim mbi Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë më 24 nëntor 2020**	Akti i miratimit të Projektmarrëveshjes së Zbatimit nr.II për SANECA II	Projekt-Marrëveshje Zbatimi nr.II ndërmjet GIZ dhe MFE, në lidhje me projektin *"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik"* (SANECA II)	3.000.000 Euro[2] (tre milionë Euro)

[2] Seksioni 2, Kontributet nga GIZ/Projekt-marreveshja e zbatimit ndërmjet GIZ dhe MFE, në lidhje me projektin SANECA II, varianti i dt.10.10.2022.

Nota Verbale VN-Nr.: 181/2022, datë 31/08/2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për shtimin e fondeve të projektit vijues SANECA II

VENDIM
Nr. 522, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË KRITEREVE DHE TË MASËS PËR TRAJTIME TË TJERA FINANCIARE TË TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE, SI DHE TË FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT TË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "c", "d" e "dh", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i vendimit

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) rregullave, kritereve dhe masës për trajtime të tjera financiare, me qëllim krijimin e një sistemi të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm që nxit performancën e lartë dhe inovacionin në administratën publike;

b) fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit, për të cilat pozicione apo funksione të caktuara përfitojnë shtesën e veçantë të kushtëzuar.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Ky vendim zbatohet për nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë (në vijim "i/të punësuari/t"), në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura apo njësitë e vetëqeverisjes vendore e institucionet e tyre të varësisë, me përjashtim të:

a) të zgjedhurve;

b) funksionarëve politikë;

c) funksionarëve të emëruar nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës;

ç) punonjësve me kontrata të përkohshme mbi numrin organik të punonjësve të institucionit.

2. Për të punësuarit dhe/ose institucionet për të cilët/cilat ligjet e tyre specifike kanë përcaktime dhe rregulla të veçanta për shpërblimin e punonjësve, ky vendim zbatohet për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këto akte.

3. Shpërblimet për rezultate në punë, çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion dhe çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara, nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi, jepen nga institucioni përkatës ku i punësuari ushtron detyrën, brenda fondit të miratuar për këtë qëllim në buxhetin vjetor të institucionit.

Neni 3
Parimet

Dhënia e trajtimeve të tjera financiare bazohet në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës dhe paanësisë.

Neni 4
Përkufizimet

Në kuptim të këtij vendimi:

a) "Programe operative shumëvjeçare IPA III dhe programi IPARD III" janë ato programe të përcaktuara në vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)", i ndryshuar, dhe në vendimin nr. 206, datë 7.4.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)", i ndryshuar;

b) "Strukturat e ngarkuara me menaxhimin indirekt të programeve operative shumëvjeçare IPA III dhe programit IPARD III" janë strukturat e listuara në nenin 3, nga shkronja "c" deri në shkronjën "dh", dhe në nenet 5 e 7, të vendimit nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, si dhe në kreun II, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", të vendimit nr. 206, datë 7.4.2023, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar;

c) "Epror direkt" ka të njëjtin kuptim me atë të miratuar në legjislacionin për nëpunësin civil;

ç) "KMMP" është Komisioni *ad hoc* i Mbikëqyrjes së Menaxhimit të Performancës që krijohet në fillim të vitit kalendarik, pranë çdo institucioni të administratës publike;

d) "Persona me aftësi të kufizuara" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

KREU II
SHPËRBLIMI PËR REZULTATE NË PUNË

Neni 5
Kriteret për shpërblimin për rezultate në punë

1. Shpërblimi për rezultate në punë është trajtimi financiar që i jepet të punësuarit në administratën publike, për:

a) realizimin ose tejkalimin e objektivave të përcaktuar individualë, në fund të vlerësimit periodik të rezultateve të punës; dhe/ose

b) arritjen e rezultateve të jashtëzakonshme/të dalluara në punë (individualisht ose në grup), që kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e performancës së njësisë apo institucionit, në realizimin e qëllimeve strategjike të institucionit dhe/ose prioriteteve të qeverisë.

2. Të punësuarit përfitojnë shpërblim për rezultate në punë, të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, nëse plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) Janë vlerësuar përmes një procesi formal të vlerësimit të rezultateve të punës për realizimin e objektivave individualë, të përcaktuar paraprakisht, të matshëm dhe të lidhur me objektivat institucionalë;

b) Janë vlerësuar me nivelin më të lartë, në rastet kur sistemi i vlerësimit ka deri në katër nivele apo me njërin prej dy niveleve më të larta, në rastet kur sistemi i vlerësimit përbëhet nga më shumë se 4 nivele.

3. Të punësuarit përfitojnë shpërblim për rezultate në punë, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, nëse plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) rezultatet e arritura tejkalojnë standardet e pritshme të performancës dhe janë përtej detyrave të zakonshme të funksionit apo pozicionit;

b) rezultatet e punës kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në përmirësimin e performancës së njësisë apo institucionit, në realizimin e qëllimeve strategjike të institucionit dhe/ose prioriteteve të qeverisë, të përcaktuara në programin e qeverisë apo dokumente të tjera strategjike, duke sjellë, por pa u kufizuar, rritje të cilësisë së shërbimeve, rritje të eficiencës në punë ose implementim të praktikave më të mira;

c) rezultatet e arritura janë të matshme.

4. Matja e rezultateve të arritura për përfitimin e shpërblimit për rezultate në punë, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, bazohet në indikatorët e performancës, të përcaktuar në urdhrin e titullarit të institucionit për kryerjen e detyrës apo realizimin e iniciativës me të cilën është/janë ngarkuar i/të punësuarit.

Neni 6
Masa e shpërblimit për rezultate në punë

1. Masa e shpërblimit për rezultate në punë, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) në institucionet ku sistemi i vlerësimit të rezultateve të punës ka deri në katër nivele vlerësimi, shpërblimi jepet në masën e deri 1 (një) page bruto mujore për të punësuarit e vlerësuar me nivelin më të lartë të performancës, por, në asnjë rast, më pak se 80% të pagës bruto mujore;

b) në institucionet ku sistemi i vlerësimit të rezultateve të punës ka më shumë se 4 (katër) nivele, shpërblimi jepet në masën:

i. deri në 1 (një) pagë bruto mujore për të punësuarit e vlerësuar me nivelin më të lartë, por, në asnjë rast, më pak se 80% të pagës bruto mujore;

ii. deri në 50% të pagës bruto mujore për të punësuarit e vlerësuar me nivelin e dytë më të lartë, por, në asnjë rast, më pak se 30% të pagës bruto mujore.

2. Masa e shpërblimit për rezultate në punë, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, përcaktohet në varësi të rëndësisë së kontributit të dhënë dhe shkallës së ndikimit të tij në përmirësimin e performancës së njësisë apo institucionit, në realizimin e objektivave strategjikë të institucionit dhe/ose prioriteteve të qeverisë, të përcaktuara në programin e qeverisë apo dokumente të tjera strategjike, në masën deri në 1 (një) pagë bruto mujore në vit.

3. Në rast se puna e caktuar është kryer në nivel grupi, masa e shpërblimit është në masën deri në 1 (një) pagë bruto mujore në vit për secilin anëtar të grupit, bazuar në kotributin e gjithsecilit.

4. Shpërblimi për rezultate në punë jepet 1 (një) herë në vit. Në rastet kur vlerësimi periodik i rezultateve të punës kryhet në periudha më të shkurtra se një vit, shpërblimi jepet, gjithashtu, një herë në vit, mbi bazën e përmbledhjes së rezultateve të arritura gjatë të gjitha periudhave të vlerësuara brenda vitit përkatës.

Neni 7
Ngritja dhe përbërja e KMMP-së

1. Në fillim të vitit kalendarik, pranë çdo institucioni të administratës publike krijohet KMMP-ja.

2. KMMP-ja përbëhet nga 3 ose 5 anëtarë, në varësi të numrit organik të punonjësve të institucionit.

3. Anëtarët e KMMP-së duhet të jenë të paktën në nivel të mesëm drejtues për ato institucione të administratës publike që kanë pozicione të këtij niveli në strukturat dhe organikat e tyre.

4. Numri i anëtarëve dhe përbërja specifike e KMMP-së përcaktohet me urdhër të sekretarit të Përgjithshëm/titullarit të institucionit. Rekomandohet që KMMP-ja të ketë si anëtarë të paktën drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit mbështet nga ana teknike dhe shërben si sekretariat i KMMP-së.

Neni 8
Organizimi dhe funksionimi i KMMP-së

1. KMMP-ja mblidhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

2. Në rast të lindjes së nevojës së zëvendësimit të anëtarëve të KMMP-së, për arsye të pamundësisë apo pengesës ligjore, zbatohen dispozitat për zëvendësimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Jo më vonë se muaji janar, eprorët direkt paraqesin pranë KMMP-së së institucionit listën e të punësuarve që plotësojnë kriteret për të përfituar shpërblimet për rezultate në punë.

4. Në rastin e shpërblimit për rezultate në punë, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, lista e të punësuarve të propozuar shoqërohet me një raport për secilin prej tyre, ku argumentohen rezultatet e të punësuarve sipas kritereve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 5, të këtij vendimi.

5. KMMP-ja, brenda 15-ditëshit të parë të muajit shkurt verifikon plotësimin e kritereve për përfitimin e shpërblimit për rezultate në punë, mbështetur në dokumentacionin përkatës. KMMP-ja, nëse e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë nga eprori direkt i të punësuarit të përfshirë në listë, informacion dhe/ose dokumentacion shtesë.

6. Nëse në përfundim të vlerësimit, rezulton se kriteret për përfitimin e shpërblimit për rezultate në punë plotësohen nga më shumë të punësuar sesa lejon fondi buxhetor i parashikuar për këtë qëllim, Komisioni i Mbikëqyrjes së Menaxhimit të

Performancës përzgjedh të punësuarit përfitues të shpërblimit me precedencë, sipas renditjes së mëposhtme:

a) të punësuarit që nuk kanë masë disiplinore në fuqi;

b) të punësuarit me nivelin më të lartë të vlerësimit në fund të vlerësimit periodik të rezultateve të punës;

c) të punësuarit që nuk kanë qenë përfitues të shpërblimit gjatë vitit/ve të mëparshëm;

ç) të punësuarit me vjetërsinë më të madhe në institucion;

d) të punësuarit që i përkasin grupit të personave me aftësi të kufizuara;

dh) të punësuarit që i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar në institucion.

7. Në përfundim të vlerësimit sipas pikave 5 dhe 6, të këtij neni, KMMP-ja miraton listën e të punësuarve që propozohen për të përfituar shpërblimin. Vendimi i arsyetuar i KMMP-së i përcillet sekretarit të përgjithshëm/titullarit të institucionit, i cili, pasi verifikon që procedura e ndjekur është në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, bën miratimin përfundimtar të listës.

8. Pas marrjes së vendimit sipas pikës 7, të këtij neni, njësia përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit të institucionit kryen pagesat përkatëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për vendimin, por, në çdo rast, jo më vonë se muaji mars.

KREU III
ÇMIMET APO SHPËRBLIMET PËR IDE INOVATIVE DHE INOVACION

Neni 9
Kriteret për çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion

1. Çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion janë trajtime financiare që u jepen të punësuarve në administratën publike për prezantimin, apo paraqitjen e ideve inovative, për politika, shërbime, procese, apo metoda organizative pune, që sjellin përmirësime të dukshme në performancën institucionale ose më gjerë të administratës publike.

2. Përfitues të një çmimi apo shpërblimi për ide inovative dhe inovacion mund të jenë një i punësuar i vetëm, apo një grup të punësuarish të administratës publike.

3. Në kuptim të këtij vendimi, një ide konsiderohet inovative apo inovacion, nëse plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme:

a) përbën risi – ideja duhet të jetë e re për institucionin apo sektorin publik ose të përfaqësojë një ndryshim të ndjeshëm nga praktika e ndjekur deri në atë moment;

b) është e zbatueshme – ideja duhet të jetë e pilotuar ose të ketë një plan zbatimi të realizueshëm;

c) ka impakt ose vlerë të shtuar – ideja duhet të paraqesë përfitime potenciale ose rezultate të arritura në përmirësimin e efektivitetit, eficiencës, transparencës në ofrimin e shërbimeve publike, rritjen e kënaqësisë së publikut ose uljen e shpenzimeve publike;

ç) mund të zbatohet në shkallë të gjerë – ideja duhet të jetë e zbatueshme edhe në njësi të tjera organizative ose në të gjithë institucionin apo administratën publike;

d) shoqërohet me vlerësimin e fizibilitetit dhe të riskut – ideja duhet të shoqërohet me një plan realist për zbatimin e saj, ku të adresohen risqet teknike, financiare dhe institucionale;

dh) përbën kontribut përtej detyrave dhe përgjegjësive funksionale – ideja duhet të jetë rrjedhojë e angazhimit të të punësuarit përtej detyrave dhe përgjegjësive të tij të zakonshme, të përcaktuara në përshkrimin e punës apo objektivat individualë të performancës.

Neni 10
Rregullat dhe procedura për çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion

1. Çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion jepen 1 (një) herë në vit, në kuadër të Javës së Administratës Publike.

2. Të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së planifikuar për organizimin e Javës së Administratës Publike, ministri përgjegjës për administratën publike shpall thirrjen për aplikim për konkursin e inovacionit.

3. Thirrja publikohet në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe të Departamentit të Administratës Publike dhe përmban kriteret për aplikim, afatin dhe mënyrën e aplikimit për të punësuarit dhe institucionet e administratës publike. Afati i dorëzimit të aplikimit

duhet të jetë jo më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e publikimit të thirrjes.

4. Të punësuarit, individualisht apo në grup, dorëzojnë idetë apo propozimet e tyre inovatore, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton përmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 9, të këtij vendimi.

5. Shqyrtimi e vlerësimi i aplikimeve, si dhe përzgjedhja e fituesve kryhet nga një komision *ad hoc* (këtu e në vijim "komisioni"), që ngrihet nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe ka në përbërje të tij 5–7 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) anëtar në nivel të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për fushën e inovacionit, i cili kryeson komisionin;

b) 1 (një) anëtar në nivel drejtues nga Departamenti i Administratës Publike;

c) 3 (tre)–5 (pesë) personalitete në fushën e inovacionit, pjesë të institucioneve të arsimit të lartë apo Akademisë së Shkencave/instituteve kërkimore-shkencore, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor.

6. Departamenti i Administratës Publike i bën me dije ministrisë përgjegjëse për kërkimin shkencor fushat e inovacionit për të cilat janë paraqitur aplikimet, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve.

Neni 11

Përzgjedhja e personaliteteve të komisionit

1. Ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor, nëpërmjet një procesi të hapur e publik, përzgjedh personalitetet e përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 5, të nenit 10, të këtij vendimi, brenda 1 (një) muaji nga momenti i marrjes dijeni mbi fushat e inovacionit, për të cilat janë paraqitur aplikimet.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jenë personalitete të shquara, me kontribute të spikatura në fushat e inovacionit, për të cilat janë paraqitur aplikimet ose të ngjashme me to;

b) të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushat e përcaktuara në publikimin për shprehjen e interesit.

3. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, ministri përgjegjës për kërkimin shkencor i përcjell ministrit përgjegjës për administratën publike emrat e personaliteteve të përzgjedhura.

4. Komisioni funksionon sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të nenit 8, të këtij vendimi.

5. Departamenti i Administratës Publike mbështet nga ana teknike dhe shërben si sekretariat teknik i komisionit.

Neni 12

Verifikimi paraprak i aplikimeve dhe i listës së aplikanëtve të kualifikuar

1. Brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga momenti i ngritjes së komisionit, Departamenti i Administratës Publike i përcjell komisionit listën e aplikantëve, bashkë me dokumentacionin përkatës.

2. Komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga përcjellja e aplikimeve nga Departamenti i Administratës Publike, kryen verifikimin paraprak të përmbushjes së kritereve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 9, të këtij vendimi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët. Gjatë verifikimit të aplikimeve, komisioni mund të kërkojë informacione shtesë nga institucioni dhe/ose eprori direkt i të punësuarit, me qëllim verifikimin nëse aplikimi përmbush kriteret e përcaktuara.

3. Në përfundim të verifikimit paraprak, në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe të Departamentit të Administratës Publike publikohet lista e aplikantëve që plotësojnë kriteret, të renditur sipas rendit alfabetik.

4. Aplikantët, që nuk plotësojnë kriteret, njoftohen individualisht, duke iu bërë të ditura arsyet e moskualifikimit. Ata kanë të drejtë të parashtrojnë ankim me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit individual për moskualifikimin.

5. Komisioni shqyrton ankesën brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit dhe njofton ankuesin, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike.

6. Në përfundim të afatit për shqyrtimin e ankesave, Departamenti i Administratës Publike publikon listën përfundimtare të aplikantëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrje.

Neni 13

Vlerësimi dhe shpallja e fituesve

1. Komisioni, në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së fituesve, mbështetet në vlerësimin e ndikimit potencial ose real që paraqet ideja inovatore në performancën institucionale ose të administratës

publike, shkallën e inovacionit të demonstruar, si dhe potencialin e saj për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët ose rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit.

2. Komisioni përzgjedh 3 (tre) fitues, të renditur sipas nivelit të ndikimit potencial ose real të idesë inovatore apo inovacionit, si më poshtë:

a) çmimi I, 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) çmimi II, 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë;

c) çmimi III, 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Fituesit shpallen gjatë Javës së Administratës Publike, duke siguruar transparencë dhe vizibilitet për idetë inovative të përzgjedhura.

KREU IV
ÇMIMET APO SHPËRBLIMET PËR PROJEKTE TË FITUARA NGA TË CILAT JANË PËRTHITHUR FONDE DHE/OSE KA PËRFITUAR INSTITUCIONI APO VENDI

Neni 14
Kriteret për çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi

1. Çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi janë trajtime financiare që u jepen individëve, apo grupeve të të punësuarve në administratën publike, që kanë fituar projekte të suksesshme, me ndikim të matshëm në tri nivele kryesore:

a) Përthithja e fondeve. Projekti ka arritur të sigurojë financime të jashtme (kombëtare ose ndërkombëtare), si: grante, fonde zhvillimi, investime apo mbështetje financiare nga burime të ndryshme, duke rritur kapacitetin financiar të institucionit.

b) Përfitimi i institucionit. Projekti ka sjellë përmirësime në funksionimin, shërbimet, kapacitetet apo burimet e institucionit, si dhe rritje të efikasitetit e të cilësisë së punës së tij.

c) Përfitimi i vendit. Projekti ka sjellë përmirësim të infrastrukturës, zhvillim ekonomik, social, mjedisor apo institucional që kontribuon në avancimin e zhvillimit të vendit në aspekt të qëndrueshmërisë, rritjes apo inovacionit.

2. Çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara, nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi jepen për të punësuarit e angazhuar në këto projekte jo për shkak të detyrave të tyre funksionale.

Neni 15
Rregullat dhe procedura për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi

1. Të punësuarit e administratës publike, të cilët gjatë vitit kalendarik kanë fituar projekte, sipas përcaktimeve në nenin 14, të këtij vendimi, paraqesin pranë institucionit ku ushtrojnë detyrën aplikimin për përfitimin e çmimit apo shpërblimit për këtë qëllim.

2. Aplikimi, sipas pikës 1, të këtij neni, paraqitet deri në datën 31 dhjetor të vitit kalendarik përkatës dhe duhet të përmbajë:

a) përshkrimin e projektit;

b) rezultatin e arritur në drejtim të fondeve të përthithura ose përfitimeve për institucionin apo vendin;

c) dokumentacionin mbështetës, që vërteton përthithjen e fondeve ose përftimin në nivel institucional apo kombëtar;

ç) vërtetimin që angazhimi i të punësuarit në projektin e fituar nuk është për shkak të detyrave të tij funksionale, të përcaktuara në përshkrimin e punës dhe/apo në çdo akt tjetër të brendshëm të institucionit.

3. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit kryen, brenda datës 15 janar të vitit pasardhës, verifikimin paraprak për plotësimin e kërkesave dokumentare të aplikimeve dhe i përcjell KMMP-së listën e aplikimeve që plotësojnë kërkesat.

Neni 16
Vlerësimi dhe dhënia e çmimeve për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi

1. KMMP-ja, brenda 15-ditëshit të parë të muajit shkurt, mbështetur në dokumentacionin përkatës:

a) verifikon plotësimin e kritereve për përfitimin e çmimit apo shpërblimit për projekte të fituara, të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu;

b) vendos për masën e shpërblimit në varësi të impaktit të projektit të fituar dhe/ose shumës së fondeve të përthithura;

c) i propozon sekretarit të përgjithshëm/titullarit të institucionit listën e të punësuarve që duhet të përfitojnë çmimin apo shpërblimin dhe masën përkatëse, i cili bën miratimin përfundimtar.

2. Pas marrjes së vendimit sipas pikës 1, të këtij neni, njësia përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit të institucionit kryen pagesat përkatëse brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin, por, në çdo rast, jo më vonë se muaji mars.

3. Çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi jepen nga institucioni ku i punësuari ushtron detyrën. Masa e çmimit apo shpërblimit për çdo projekt të fituar është 10 000–50 000 lekë.

KREU V
FUSHAT DHE NËNFUSHAT PRIORITARE TË ZHVILLIMIT TË VENDIT DHE SHTESA E VEÇANTË E KUSHTËZUAR

Neni 17
Fushat prioritare të zhvillimit të vendit

Në kuptim të këtij vendimi, konsiderohen fusha prioritare të zhvillimit të vendit:

a) Zhvillimi i sektorit të shoqërisë së informacionit e të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (qeverisja elektronike), e fokusuar në nënfushat, si më poshtë vijon:

i. infrastruktura dhe sistemet e informacionit dhe të komunikimit, përfshirë projektimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve;

ii. ndërveprimet dhe transaksionet elektronike nëpërmjet shërbimeve të besuara, përfshirë integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian;

iii. siguria e bazave të të dhënave shtetërore, përfshirë auditimin e sistemeve TIK;

iv. hartimi i akteve rregullatore në fushën TIK.

b) Zhvillimi i infrastrukturës së informacionit kombëtar gjeohapësinor, e fokusuar në nënfushat, si më poshtë vijon:

i. përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës;

ii. mbledhja, administrimi dhe përpunimi i informacionit gjeohapësinor;

iii. hartimi i akteve rregullatore në fushën e sistemeve të informacionit kombëtar gjeohapësinor.

c) Garantimi i përthithjes efektive dhe në kohë të fondeve të programeve operacionale IPA III dhe programit IPARD III.

Neni 18
Shtesa e veçantë e kushtëzuar mbi pagën bruto mujore sipas fushave dhe/ose nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit

1. Shtesa e veçantë e kushtëzuar mbi pagën bruto mujore për pozicionet e punës që kryejnë funksione, sipas fushave dhe nënfushave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 17, të këtij vendimi, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për një periudhë kohe deri në katërvjeçare, përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Shtesa e veçantë e kushtëzuar mbi pagën bruto mujore sipas shkronjës "c", të nenit 17, të këtij vendimi, jepet për një periudhë pesëvjeçare për të punësuarit e angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në programimin, prokurimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin në strukturat e ngarkuara me menaxhimin indirekt të programeve operative shumëvjeçare IPA III dhe programit IPARD III dhe është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet Zyrtarit Kombëtar Autorizues, pas marrjes së miratimit nga strukturat përkatëse të Komisionit Evropian, njofton me shkrim autoritetet dhe strukturat zbatuese të programeve operative shumëvjeçare IPA III dhe programit IPARD III për fillimin e zbatimit të shtesës sipas shkronjës "c", të nenit 17, të këtij vendimi. Shtesa fillon të aplikohet nga data e njoftimit zyrtar.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

1. Përjashtimisht, për periudhën 2026–2027 përfitojnë shpërblim për hapjen dhe mbylljen e kapitujve/kritereve të negociatave:

a) Kryenegociatori, zëvendëskryenegociatorët dhe negociatorët e përcaktuar sipas vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar;

b) të punësuarit në Kryeministri, përfshirë departamentin përgjegjës për çështjet e integrimit evropian në Kryeministri në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Integrimit Evropian;

c) të punësuarit e institucioneve të administratës publike, të cilët angazhohen drejtpërdrejt në procesin e përafrimit të legjislacionit, hartimit ose vlerësimit të përputhshmërisë së akteve, si dhe në procesin e hapjes e të mbylljes së kapitujve, apo kritereve të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

2. Shpërblimi jepet për kryenegociatorin, zëvendëskryenegociatorët, negociatorët dhe të punësuarit e tjerë organikë të institucioneve të administratës publike, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, të cilët në momentin e lindjes së të drejtës për shpërblimin përkatës janë në marrëdhënie punësimi në një institucion të administratës publike.

3. Shpërblimi llogaritet në raport me kohën gjatë së cilës kanë kontribuar të punësuarit, por, në çdo rast, jo më shumë se masa e shpërblimit e përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, për:

a) Kryenegociatorin, zëvendëskryenegociatorët, negociatorët dhe të punësuarit e tjerë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës, por që janë ende në marrëdhënie pune në institucionet e administratës publike. Shpërblimi jepet nga institucioni përkatës ku kanë kontribuar për hapjen dhe/ose mbylljen e kapitujve/kritereve të nogociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, sipas pagës bruto mujore që kanë pasur në pozicionet e mëparshme.

b) Kryenegociatorin, zëvendëskryenegociatorët, negociatorët dhe të punësuarit e tjerë të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të punësuar në këto pozicione pas fillimit të proceseve të përgatitjes për hapjen dhe/ose proceseve të përgatitjes për mbylljen e kapitujve/kritereve të negociatave.

4. Masa e shpërblimit është, si më poshtë vijon:

a) 1 pagë bruto mujore për hapjen e kapitujve/kritereve të negociatave dhe 2 paga bruto mujore për mbylljen e tyre, pavarësisht në sa kapituj/kritere janë të angazhuar, për grupin e përfituesve sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni;

b) 1 pagë bruto mujore për hapjen e kapitujve/kritereve të negociatave dhe 1 pagë bruto mujore për mbylljen e tyre, pavarësisht në sa kapituj/kritere janë të angazhuar, për grupin e përfituesve sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni;

c) 1 pagë bruto mujore për hapjen e kapitujve/kritereve të negociatave dhe 1.5 paga bruto mujore për mbylljen e tyre, pavarësisht në sa kapituj/kritere janë të angazhuar, për grupet e përfituesve sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni.

5. Të punësuarit e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për Kryeministrinë dhe institucionet e varësisë së Kryeministrit, me urdhër të ministrit për ministrinë dhe institucionet e tij të varësisë dhe me urdhër të titullarit të institucionit të pavarur për institucionin që drejton.

6. Urdhrat sipas përcaktimit në pikën 5, të këtij neni, përpara miratimit të tyre dakordësohen me Kryenegociatorin, në lidhje me numrin e përfituesve për çdo institucion, i cili për të gjitha institucionet së bashku nuk duhet të jetë më i madh se 890. Urdhrat e miratuar i përcillen ministrisë përgjegjëse për financat.

Neni 20
Shfuqizime

Vendimi nr. 419, datë 7.7.2023, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit dhe të shtesës së veçantë të kushtëzuar", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 21
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2026 dhe përballohen nga:

a) fondi i veçantë i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, për përcaktimet në nenin 19, të këtij vendimi;

b) fondet e secilit institucion për të gjitha përcaktimet e tjera.

Neni 22
Autoritetet zbatuese

Ngarkohen institucionet e administratës publike për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	620 000
Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	110 000
Drejtor drejtorie te permbajtjes ne zyren qendrore. Drejtor i drejtorive IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve qendrore.	110 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e programimit, zhvillimit, menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve dhe hartimin e standarteve e strategjive TIK, infrastrukturave sistemeve dhe sigurisë së informacionit, përditësimit të shërbimeve elektronike, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve, ndërveprimet dhe transaksionet elektronike, auditimin e sistemeve TIK nëpërmjet shërbimeve të besuara, nxitjen e teknologjive të avancuara, menaxhimin e riskut, menaxhimin e investimeve dhe fondeve të huaja TIK dhe E-GOV,	95 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e regjistrit të bazave të të dhënave shtetërore, sektorit juridik, si dhe integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian.	70 000
Specialist në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e programimit, zhvillimit, menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve dhe hartimin e standarteve e strategjive TIK, infrastrukturave sistemeve dhe sigurisë së informacionit, përditësimit të shërbimeve elektronike, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve, ndërveprimet dhe transaksionet elektronike, auditimin e sistemeve TIK nëpërmjet shërbimeve të besuara, nxitjen e teknologjive të avancuara, menaxhimin e riskut, menaxhimin e investimeve dhe fondeve të huaja TIK dhe E-GOV, dhe inteligjenca artificiale.	72 000
Specialist në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e regjistrit të bazave të të dhënave shtetërore, sektorit juridik, si dhe integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian.	50 000

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për nëpunësit e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	65 000
Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	60 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë, të akteve rregullatore në fushën e sistemeve të informacionit kombëtar gjeohapësinor, të koordinimit dhe projekteve si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	55 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë.	45 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e hartim-monitorimit të standardeve, të gjeoportalit kombëtar, koordinimit dhe projekteve, si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	40 000
Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë.	35 000
Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e hartim-monitorimit të standardeve, të gjeoportalit kombëtar, koordinimit dhe projekteve, si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	31 000

Lidhja 2

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për për të punësuarit e angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në programimin, prokurimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin në strukturat e ngarkuara me menaxhimin indirekt të programeve operative shumëvjeçare IPA III dhe programit IPARD III

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Drejtor i Përgjithshëm përgjegjës për procese të menaxhimit të programeve operative shumëvjecare IPA III dhe Programin IPARD III.	37 000
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm dhe Drejtor Drejtorie, përgjegjës për procese të menaxhimit të programeve operative shumëvjecare IPA III - dhe Programin IPARD III.	32 000
Përgjegjës sektori në sektorët përgjegjës për procese të menaxhimit të programeve operative shumëvjecare IPA III dhe Programin IPARD III.	27 000
Specialist në sektorët përgjegjës për procese të menaxhimit të programeve operative shumëvjecare IPA III - dhe Programin IPARD III.	20 000

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 736 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 142|Datë: 03.07.2026 12:25:47 +02:00|50dbbf73-63b7-49a2-b829-f92123de0a5a

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)